

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT
NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, MBAJTUR MË
15, 16 DHE 19 DHJETOR 2005

TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
15,15 I 19 DECEMBRA 2005 GOD

DHJETOR – DECEMBAR 2005

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Provimin e Jurisprudencës;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Gjuetinë;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2006;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Veprimtarinë Botuese dhe Librin;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institucionet e Kulturës;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Arsimin dhe Aftësimin Privat;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës;
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të Drejtat dhe Liritë e Organizimit Sindikal;
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Produkteve të Ndërtimit;
11. Shqyrtimi i propozimit për krijimin e Komisionit për siguri;
12. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e deputetit Mahir Yagcilar, anëtarë të Kryesisë;
13. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e deputetit Xhezair Murati, për anëtar të Komisionit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim euroatlantik;
14. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit;
15. Rekomandimi i Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me mocionin e grupit parlamentar ORA;
16. Përgjigja e Kryeministrit të Kosovës në pyetjen e deputetit Berat Luzha.

DNEVNI RED

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice;
2. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Pravosudnom Ispitu;
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Lovu;
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Konsolidovanom budžetu Kosova za 2006.god.;
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Izdavačkoj Delatnosti i Knjizi;
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Kulturnim Institucijama;
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Privatnom Obrazovanju i Osposobljavanju;
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Operi, Baletu i Filharmoniji Kosova;
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Pravu i Slobodi Sindikalog Organizovanja, i
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Inspektoratu Građevinskog Proizvoda;
11. Razmatranje predloga o osnivanju Komisije za bezbednost;
12. Razmatranje predloga o imenovanju poslanika Mahira Yagcilara za člana Predsedništva;
13. Razmatranje predloga o imenovanju poslanika Xhezaira Muratija za člana Komisije za međunarodnu saradnju i evroatlanske integracije;
14. Razmatranje predloga o imenovanju članova u odboru Agencije ptotiv korupcije;
15. Preporuka Komisije za pravosuđe, zakonodavstvo i Ustavni okvir u vezi sa predlogom (mocijom) Parlamentarne grupe ORA;
16. Odgovor Premijera Kosova na pitanja poslanika Berata Luža

Seancën plenare të Kuvendit e kryesoi, Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Seanca u mbajt në sallën plenare të Kuvendit, me fillim në orën 10,00.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Mirëmëngjesi dhe mirë se ardhjet në seancën e rregullt të Parlamentit tonë. I dëshirojmë mirëseardhje edhe z. Limaj sot, kryeministrit, ministrave të Qeverisë, mirëseardhje të gjithë mysafirëve. Mendoj që sot e kemi një moment shumë solemn në Parlamentin e Kosovës, për partitë politike e besoj edhe për rajonin. Ju ka kthyer në mënyrën më të denjë një personalitet i verifikuar i angazhimeve për çlirimin e Kosovës, një personalitet që në vazhdimësi në jetën politike, me mesazhet, me angazhimin e tij ka shpërndarë frymën e tolerancës në Parlamentin e Kosovës, për një tolerancë ndër rajonale, ndërretnike, një vizion të ri për Kosovën. Prandaj më lejoni që me pak fjalë t'ju drejtohem me këtë rast.

Të nderuar deputete dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Sot e ndaj me gjithë ju dëshirën si dhe obligimin moral dhe njerëzor që ta ftojë në këtë mbledhje plenare të Kuvendit të Kosovës ish- deputetin e Kosovës, shefin e Grupit Parlamentar, anëtarin e vyeshtë të shoqërisë së Kosovës dje, sot dhe më tepër nesër. Siç e dini z. Fatmir Limajt iu ndërpre dhunshëm mandati i deputetit të Kuvendit të Kosovës dhe funksioni i shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Meqë tash u shpall i pafajshëm nga Tribunali i Hagës, e shoh të arsyeshme që Fatmir Limaj të rifillojë aktivitetin e tij në shërbim të çështjes kombëtare dhe të zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës, pikërisht në këtë Kuvend, në institucionin më të lartë të demokracisë si simbol i shprehjes së unitetit dhe angazhimit të përbashkët.

Të nderuar deputetë, përpjekjet shekullore për liri të popullit të Kosovës, në veçanti ato gjatë 10 vjetëve të fundit të pushtimit dhe sidomos sublimimi i luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, janë faqe të lavdishme të përkushtimit dhe të sakrificës të bijve dhe të bijave më të mira të Kosovës për të jetuar për, gjithmonë të lirë e më dinjitet në trojet tona, për të ndërtuar shtet demokratik e më perspektivë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Pikërisht kjo luftë, së bashku me angazhimin intelektual, arsimor, ekonomik, kulturor e të përgjithshëm të shumë gjeneratave na bënë që ne sot si qytetarë të lirë, si institucione të zgjedhura në mënyrë demokratike të kemi fatin që një herë e mirë ta zgjedhim drejtë statusin e Kosovës sipas vullnetit të shprehur lirshëm të popullit që gjithsesi do të jetë shtet i pavarur dhe sovran, i integruar në strukturat euroatlantike dhe i ndërtuar në principet dhe standardet demokratike. Duke e përgëzuar z. Fatmir Limajn, duke pritur shumë nga angazhimi i tij në këto momente vendimtare dhe në ndërtimin e ardhmërisë sonë, duke shprehur respekt për vendimin e drejtë dhe duke kërkuar lirim dhe kthim pranë familjeve të tyre për të gjithë luftëtarët dhe veprimtarët e lirisë e thërras z. Fatmir Limajn që me një fjalë rasti t'i drejtohet seancës plenare të Kuvendit të Kosovës.

Z. Limaj, me kënaqësi, foltorja është juaja. Urdhëroni.

FATMIR LIMAJ, ish deputet i Kuvendit të Kosovës

I nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, të nderuar ish- kolegë deputetë.

Sot jam i nderuar, por edhe i emocionuar që përsëri jam në mesin tuaj , që kam rastin t'ju drejtohem juve dhe përmes jush edhe qytetarëve të Kosovës, për të vlerësuar së pari të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur që nga shkuarja dhe kthim im në vend, në Kosovën tonë të lirë. Gjatë kthimit në Kosovë ose shkuarjes nga Kosova, skenën politike e lamë në një bashkëqeverisje të gjerë të domosdoshme për kohën dhe për momentin në të cilin kalonte Kosova. Tani Kosovën dhe Parlamentin e saj i gjej në një start të ri të zhvillimit demokratik, që tregon një pjekuri, një rrugë të drejtë të konsolidimit demokratik. Me faktin së një strukturë pozitive - opozitive tregon se klasa dhe skena politike në Kosovë kanë marrë rrugën drejt konsolidimit demokratik, drejt një pjekurie politike ,që do t'i përgjigjej kohës, që ne kërkojmë të krijojmë një shteti të qytetëruar dhe demokratik. Pra , pozita dhe opozita është ende në kërkim të pozicionimit , të stabilizimit të tyre ose në kërkim të rolit që duhet ta kenë edhe pozita edhe opozita, megjithatë është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit dhe konsolidimit demokratik të vendit tonë.

Të nderuar deputetë

Para tre vjetësh dhe pas publikimit të aktakuzës sime,pak para saj, ne shefat e grupeve parlamentare të atëhershme së bashku me kryetarin e Parlamentit, por edhe me shefat e partive tona ,arritëm një unitet që u shpreh me anë të një nënshkrimi për të nxjerrë një rezolutë të atëhershme për pavarësinë e Kosovës. Unë jam jashtëzakonisht i kënaqur dhe i nderuar që dy javë para se të mbërrij këtu grupet parlamentare të këtij Parlamenti kanë arritur një marrëveshje, ose kanë realizuar rezolutën e para tre vjetëve, prandaj shfrytëzoj rastin t'ju përgëzoj për pjekurinë, për unitetin e shfaqur lidhur me këtë rezolute që do të jetë i rëndësishëm për bisedimet e ardhshme për statusin e Kosovës. Në veçanti dua t'i falënderoj grupet parlamentare për përpjekjet që kanë bërë pas aktakuzës sime, për të më ndihmuar dhe mbështetur mbrojtjen time. Prandaj, me këtë rast i falënderoj të gjitha grupeve parlamentare e posaçërisht të tri partive të mëdha dhe të grupeve të minoriteteve. I falënderoj të gjithë ata që në një mënyrë ose në një tjetër kanë dërguar mesazhe përkrahjeje dhe mbështetje për mua. Falënderoj të gjithë qytetarët e Kosovës që kanë qenë boshti kryesor për atë që ndodhi pas tre vjetëve.

Zonja dhe zotërinj,

Duke u futur në një proces shumë të rëndësishëm , ka nevojë për të gjithë ne, para së gjithash që ky institucion të jetë uverturë e të gjitha zhvillimeve që do të rrjedhin në definimin e statusit tonë final, për të cilin të gjithë jemi unikë,për një Kosovë të lirë, të pavarur dhe sovranë. Për t'i bërë këto Kosova ka nevojë për një bashkëpunim të ngushtë me njëri me tjetrin. Ne si qytetarë, si klasë politike,në çdo mënyrë dhe formë duhet ta mbështesim delegacionin e Kosovës të zgjedhur nga ky Kuvend, delegacion që përfaqëson votën e qytetarëve të Kosovës për negociatat e ardhshme. Pa dyshim se rruga në të cilën do të kalojmë ka qenë , është dhe do të jetë jashtëzakonisht e vështirë, por duhet respektuar ndryshimet ndërpartiake ,sepse ato janë shëndet për demokracinë.Pra, dallimet konceptuale që mund të jenë në **Parlamentin e Kosovës ,po ashtu janë në**

shërbim të demokracisë , në asnjë mënyrë nuk duhet të përzihen, nuk duhet të tejkalohen kur është çështja e interesave nacionale, për interesa të Kosovës. Për këto interesa(të Kosovës) të gjithë duhet të jemi unikë, sepse ky është obligim, kjo është vota e qytetarëve të Kosovës. Pavarësisht për cilin grup politik qytetarët kanë votuar, ata presin që vullneti i tyre të realizohet e atë vullnet duhet ta realizojmë ne, sepse kemi marrë obligime para qytetarëve të Kosovës. Nuk dua të flas për atë se çka ka ndodhur rreth meje, për arsye se këtu nuk është vendi të flasim për këto çështje, por dua të them në qoftë se në një kohë të caktuar nuk është bërë sa duhet për drejtësinë, për të vërtetën, ftoj institucionet e Kosovës, Parlamentin, së beteja për drejtësi ende vazhdon, që të marrin pjesë në betejën për drejtësi. Ftoj institucionet e Kosovës që ta ndihmojnë të vërtetën, e për ta ndihmuar të vërtetën duhet ndihmuar të gjithë ata djem që kanë nevojë për të vërtetën. E vërteta e individit ,e vërteta e ushtarit të UÇK-së është e vërteta e Kosovës. Fitorja e ushtarit të UÇK-së është fitorja e Kosovës, është fitore e perspektivës , e të ardhmes sonë, është fitore e fëmijëve tanë. Prandaj ju ftoj së tani ende nuk është vonë të merrni pjesë në këtë betejë për drejtësinë.

Drejtësia individuale në Hagë është drejtësi për Kosovën dhe kjo është e domosdoshme. Këtë e kërkon edhe bashkësia ndërkombëtare. Asgjë ata më tepër nuk kërkojnë përveç të vërtetës dhe ne duhet ta ndihmojmë këtë të vërtetë. Ne asgjë nuk kërkojmë përveç të zbardhet e vërteta. Ne asnjëherë nuk iu kemi frikësuar të vërtetës dhe drejtësisë, por e vërteta dhe drejtësia të **nderuar deputetë kërkojnë ndihmën dhe përkrahjen tuaj. Ju ftoj** tash e tutje njerëzit që kanë nevojë për të vërtetën, drejtësinë, për ndihmën tuaj. Parlamenti i Kosovës është i qytetarëve të Kosovës. Qytetari i Kosovës në asnjë mënyrë dhe në asnjë moment nuk duhet ta ndiej vetën të lënë anash. Mendoj së është koha dhe momenti që në çdo mënyrë institucionet tona ta demonstrojnë, ta shfaqin atë. Ne nuk duhet të frikësohemi nga drejtësia. Ne nuk duhet të frikësohemi nga e vërteta, sepse e vërteta është në anën tonë, drejtësia është në anën tonë. Ne vetëm duhet ta themi, duhet ta argumentojmë në çfarëdo mënyre që kërkojnë, po qe nevoja dhe përmes gjykatës, edhe nëpërmjet shkencës. Në çdo mënyrë që e kërkon bota e qytetëruar ne duhet t'i përgjigjemi drejtësisë të vërtetës, sepse kjo është garanci për perspektivën e fëmijëve tanë, për themelet e një shteti demokratik ligjor. Nuk mund të ketë shtet demokratik në qoftë se nuk i përgjigjemi ligjit, në qoftë se nuk dalim para ligjit dhe me argumente tregojmë se ne kemi bërë një luftë çlirimtare të ligjshme, se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë një luftë të drejtë, se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e pastër dhe si e tillë dhe nëse ajo kërkohet të dëshmohet edhe përmes drejtësisë dhe këtë duhet ta bëjmë . Askush nuk është kundër saj, mirëpo këto institucione duhet të jenë përkrah atyre që janë të interesuar ta njohin të vërtetën dhe drejtësinë.

Të nderuar deputetë. I di situatat në të cilat keni kaluar dhe po kaloni , janë situata të vështira. E di që keni kaluar nëpër situata jashtëzakonisht të vështira, sidomos pas ngjarjeve të marsit. Ju ftoj juve që keni fituar votat e popullit ta bartni edhe zërin e tij në këtë Parlament. Nuk mjafton të mbështeteni vetëm në votën e qytetarit të Kosovës. Këtu duhet ta themi zërin e qytetarit të Kosovës. Ju ftoj që të jeni më afër qytetarit, që të gjithë ta ndihmojmë vetveten, në përmbushjen e kriterëve demokratike,por ato nuk do të përmbushen asnjëherë me deklarata, duhet të jemi përherë në terren për të ndihmuar që sa më shpejtë vendi ynë të jetë atje ku duhet. Delegacioni dhe pozicioni i Kosovës në

bisedime mund të jenë të fortë vetëm nëse ne të gjithë angazhohemi në terren duke biseduar, ndërtuar duke punuar në ndërtimin e atyre kritereve demokratike, që nuk janë vetëm të bashkësisë ndërkombëtare, por janë edhe për qytetarët tanë për jetë më të mirë dhe demokratike.

Të nderuar deputetë. Ne nuk duhet të frikësohemi asnjëherë për t'u thënë qytetarëve shumicë të Kosovës se Kosova asnjëherë nuk do të jetë e lumtur, nuk mund të jetë demokratike në qoftë se vetëm një qytetar i etnitetit tjetër do të ndihet i pasigurt, në qoftë se edhe një qytetar i etnitetit tjetër do të ndihet i injoruar, i shtypur si rezultat i shumicës. Askush nuk ka arsye më tepër se ne, po mendoj shumica shqiptare për ta dëshmuar, sepse shumica prej nesh e dinë mirë se si ka qenë para 5-6 vjetëve. Prandaj ne duhet të jemi ata që duhet ta bartim procesin e ndërtimit të bashkëjetesës në gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallime etnike ose fetare, jo për një qytetar, jo për një grup etnik, qoftë ai i madh apo i vogël, por për të mirë të Kosovës, për fatin e ardhshëm të Kosovës, në emër të Kosovës. Për fatin e Kosovës ne duhet të jemi të gatshëm gjithmonë për t'i realizuar idealet tona të kamotshme.

Nuk dua ta zgjas më. Ju falënderoj që më dhatë këtë rast për t'iu drejtuar këtij Parlamenti. Jam jashtëzakonisht i emocionuar për rastin që m'u dha, prandaj u përpoqa në pika të shkurtra për t'u parë me ju dhe sigurisht që do të kemi kohë për t'i shpalosur platformat e përbashkëta politike që do të qojnë drejt stabilizimit të shtetit tonë. Në emër të kësaj ju ftoj që të jemi së bashku, t'i unifikojmë qëndrimet tona politike për të mirën e vendit tonë. Kosovës i duhet një unitet real, veprues, që materializon frytet me qëllim të realizimit të interesave tona në këtë fazë të rëndësishme. E di se në këtë Parlament ka pasur, ka dhe do të ketë njerëz të tillë. Kam pasur fatin të bashkëpunoj me njerëz të tillë dhe nuk është vështirë të gjendet gjuhë e përbashkët dhe e rëndësishme kur është vullneti. Jam i bindur që ky Parlament do ta ketë nderin, por edhe përgjegjësinë që shumë shpejt të bëjë, të shpallë ose ta pranojë njohjen ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës. Ju faleminderit.

Duartrokitje në sallë.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit zoti Limaj. Për të pasur mundësi që të gjithë deputetët të përshëndeten dhe t'i dëshirojnë mirëseardhje shëfit të mëparshëm të Grupit Parlamentar të PD ju ftoj të gjithëve të bëjmë gjysmë ore pauzë, ku do të jenë edhe gazetarët bashkë me ne. Ju faleminderit.

Pas pauzës

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Mendoj se mund ta fillojmë punën. Në pjesën e parë kishim 96 deputetë, tani kemi kuorum të duhur, 85 deputetë. Kalojmë në rendin e ditës. Kemi një kërkesë me shkrim të

deputetit tonë që është kryetar i IRDK-së z. Bislim Hotit, prandaj po e shfrytëzoj rastin, sepse është informatë që duhet ta kemi dhe është e shkurtër.

DEPUTETI BISLIM HOTI

Ju faleminderit z. kryetar.

Të nderuar ministra, të nderuar deputetë. Jam i vetëdijshëm se cili është rendi i ditës së seancës, por nuk kam dashur që të bëj ndryshime në rendin e ditës. Dola para jush të bëj një demant, që ka të bëjë me z. Noman Baliq .Ai në mediat elektronike dhe ato të shkruara flet në emër të komuniteteve të tjera e po ashtu në emër të komunitetit egjiptian, gjëja se ai përfaqëson edhe këtë komunitet. Mua më vjen keq ,sepse ne përfaqësohemi me 3 deputetë këtu dhe nuk ka mbetur që z. Numan Baliq të japë deklarata të tilla se gjëja komuniteti ynë i frikësohet pavarësisë së Kosovës. Kjo nuk qëndron ashtu, sepse ne nuk i frikësohemi asaj që me sakrificë e ndërtoam, asaj çka kemi ëndërruar me shekuj ta ndërtojmë një shtet të pavarur ku të gjithë qytetarët e tij do të jenë të lirë dhe të barabartë. Ne nuk jemi ata që i frikësohemi realitetit, sepse dyert e ardhmërisë sonë i shohim vetëm në pavarësinë e Kosovës. Nuk do të jap sqarime se si e kemi dëshmuar se mendoj se tërë opinioni është i njoftuar për punën , aktivitetin tonë që duhet ta bëjmë, e kemi bërë dhe do ta bëjmë për ta pasur një Kosovë të pavarur. E di që pas diskutimit tim do të ketë prapë zëra, por deputetë të nderuar këta zëra i quaj gjela të ngordhur dhe ju bëj me dije se ata nuk kanë mundësi ta helmojnë një det të tërë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Z Hot ju faleminderit.

Z. Numan Baliq, r e p l i k ë

DEPUTETI NUMAN BALIQ

Ja naravno želim da selamim sve deputete, zastupnike i nisam očekivao da će predsednik Daci dozvoliti da se Skupština ovako zloupotrebljava, mislim da je ovo veoma ružno tako da uopšte nije trebalo da se dolazi u situaciju da institucije Kosova i kosovske Albance brani Bislim Hoti od Numana Balića. Zaisza je došlo ružno vreme i oni koji su 1990 godina bili ko zna gde i skim su bili sada treba oni da brane Kosovo, a Numan Balić neće da ga brani. Ja želim da kažem nešto veoma jasno što mediji nisu preneli kako treba, a juče se to desilo i ono se sastoji u tri sledeće rečenice: prvo, jasno sam rekao i sada ću to da kažem ZDA Kosova je podržavala, onda kada mnogi od vas ko zna gde su bili, nezavisno Kosovo, i sada ga podržava: drugo, predsednik ZDA Kosova Numan Balić i tada je podržavao, kada je bili najteže, i sada podržava nezavisno Kosovo i tu nema dvoumljenja. Ali ja molim predstavnike institucija Kosova i sve vas da ozbiljo razmislite i razmotrite koja je situacija i bošnjaka, roma, egipćana, aškljija i ostalih. Njihova situacija jeste teška oni se brinu i naveo sam razloge a oni su sledeći: iza rata bilo je masa slučajeva nasilja, mnogo prognanih ljudi, mnogo ljudi među bošnjacima i manjinama su izgubili svoje stanove, svoje kuće i sve ostalo. Ja molim kosovsku javnost i medije koji su namerno falsifikovali ono što sam rekao i koji su prećutali prvi deo moje izjave, a koji

kaže da i ja i moja partija podržavamo nezavisno Kosovo, ali da se neke zajednice boje toga zbog svoje sigurnosti, dakle da se prekine sa tom kampanjom i pozivam vas

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju lutem, pasi që koha është e caktuar, kërkoj nga regjia që t'i vazhdohet edhe një minutë.

DEPUTETI NUMAN BALČ

Dakle nastavlja se sa starom praksom, oho što se sata radi moram da budem veoma jaran. Prošla vlast i režim protiv koka sam se ja borio sa nakim časnim ljudima ode je imao svoje Bajramoviča i Sejde Bajramoviča, Kosovska vlast, dobro razmislite o tome i predsednik Daci i Rugova i Kosumi nemaju potrebe da imaju anas neke Bajramoviče, nema potrebe da Kosovo se brani od Nomana Baliča, to ču vam pokazati jednoga dana, ali ja pozivam i Dacija i Rugou i Kosumija neka pođu u Dakovicu i u sjevernom Mitrovicu, neka posete rome i egipčane i neka pitaju njih ako ne vjeruju meni neka pitaju i bonjake, rome i egipčane zapto oni hoše i zapto oni se boje nezavisnosti Kosova, to je njihov posao i njihova obaveza.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Numan, ju faleminderit shumë. Fjalën e ka Ram Buja. Urdhëroni po e shoh në monitor.

DEPUTETI RAMË BUJA

Të nderuar kolegë deputetë, z. kryetar, e ndiej nevojë personale dhe besoj edhe për shumicën e kolegëve të Kryesisë dhe për deputetët, që nga ju të kërkoj sqarim, sot, shumë logjik që të na sqarohet përfundimisht ai spekulim i mediave për abuzimin e buxhetit të Kuvendit të Kosovës për 235.600 €, për të cilat unë si anëtar i Kryesisë nuk di asgjë, Nuk di ku është marrë vendimi, kush e ka ekzekutuar, cilët janë këta njerëz? Besoj se edhe opinionit të Kosovës ka nevojë të dijë që të mos spekulohet edhe më tej për këtë gjë. Besoj se do ta sqaroni, sepse edhe shumica absolute e deputetëve nuk e di me siguri siç nuk e di as unë si anëtar Kryesie. Shpesh ka ndodhur dhe tash ndodh që për 100 euro të shpenzimeve të një deputeti që shkon në Shqipëri duhet të merremi ne si Kryesi, por për shumë të tillë, siç është ajo për makinë të blinduar nuk di as unë as të tjerët, andaj e thashë para se të fillojmë me procedim të rendit të ditës ta sqarojmë së bashku këtu në mënyrë që të mos fyhemi krejt komplet. Nëse ka nevojë dikush të fyhet ai le të fyhet. Këto ditë e fundit qytetarët më janë drejtuar: "Ju blini këtë makinë kaq para dhe unë heq për këtë dhe këtë". Mendoj se është vendi për të sqaruar këtu edhe pse ka qenë rendi të merret vendim në Kryesi ose për ta kundërshtuar këtë vendim, por nuk është marrë, andaj ta shohim si qëndron kjo edhe pse të them të drejtën më vjen keq për ata që e ndiejnë nevojën për të udhëtuar me makina të blinduara, por si do që të jetë nuk dua të hyjë në këtë çështje. Është mirë që t'ua sqarojmë deputetëve, opinionit të Kosovës pse është bërë ky abuzim dhe pse nuk përfillet institucioni që është mekanizëm i Kuvendit, i votës së tij, Kryesia për të marrë vendime të këtilla. Ju falënderoj.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Plotësisht e mbështes idenë tuaj që as nga Parlamenti as nga qytetarët e Kosovës nuk duhet të fshihet asgjë, sepse mungesa e transparencës automatikisht do të linte dyshime. Andaj mendoj se informata e plotë duhet t'u përgatitet, sepse nuk bën që kryetari i Kuvendit të flasë ose të mos flasë. Informata oficiele, e dokumentuar, t'i paraqitet Kryesisë dhe ajo vendos e pastaj edhe Parlamenti. Një çështje ,në media sforcohet 4 vjet me radhë nga një individ dhe nga një kompani .Deputetët dhe qytetarët e Kosovës duhet ta dinë që përgatitjen,përcjelljen dhe sigurinë teknike, kryetari i Kuvendit e ka më të thjeshtë, më të dobëtën dhe më të lirën nga të gjitha institucionet, por plotësisht e pranoj kërkesën dhe them: Çdo keqpërdorim duhet t'u nënshtrohet përgjegjësive për çdokënd, andaj ju lutem që të vazhdohet me rendin e ditës. Po pati nevojë dikush për këtë punë, ju thashë në mënyrë shumë serioze se edhe një çështje tjetër ka më se për 4 vjet, për hir të opinionit, them se kryetari i Parlamentit për veti asnjëherë as me shkrim as gojarisht nuk ka pasur kërkesa. Është bërë analiza e situatës së sigurisë të kryetarit të Parlamentit, e mbrojtjes teknike të kryetarit, Qeveria është e informuar me kohë, këto përgatitje zgjasin nga fillimi i hershëm i pranverës dhe unë asnjëherë nuk kam pasur kërkesa të veçanta. Deputetë të nderuar, kryetari i Parlamentit të Kosovës një vit me radhë ka ardhur në Parlament me **rent a car** dhe kurrë nuk kam pasur kërkesa. Kryetari i Parlamentit në jetën private, i ka pasur gjithmonë gjenetikisht begatitë e veta normale dhe nuk ka pasur nevojë,në asnjë fazë- ata që e njohin mirë e dinë, të keqpërdorë dikë e më së paku buxhetin e institucionit, prandaj po ju them se nga kryetari i Kuvendit nuk do të ketë në asnjë fazë asnjë vështirësi për çdo lloj informacioni as hetimesh ,sepse ka një praktikë shumë të sukseshme.Po ju informoj së Parlamenti një kohë të gjatë do të punojë në analizën për t'ua bërë transparente edhe të tjerëve nga krijohen pasuri enorme .Pra,gjithmonë Parlamenti do të jetë në përkrahje të proceseve të këtilla, prandaj mos trokitni kurrë në derë të kryetarit të Parlamentit , sepse është e hapur 24 orë në ditë, për çdo pyetje dhe çdo informacion . Edhe një herë po ju them le të përgatitet informata e duhur për Kryesinë dhe kjo e vlerëson pastaj edhe në komisionet përkatëse funksionale dhe në seancë plenare. Kjo është përgjigjja ime z. Buja.

Mendoj se mund të vazhdojmë me rendin e ditës.

Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Ta miratojmë një praktikë të rëndomtë. Çdo deputet që ka vërejtje ta bëjë me shkrim ose pa pati nevojë dikush të prononcohet edhe gojarisht mund ta shfrytëzon këtë. Fjalën e ka z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Z. kryetar, të nderuar deputet Grupi Parlamentar i PDK-së disa herë e ka cekur se Kuvendi as nuk ka mundur e as që do të mund t'i kryejë[obligimet e tij karshi problemeve të shumta që ka pasur dhe ka vendi ynë. Karshi obligimeve që kemi marrë nga qytetarët e Kosovës nga zgjedhjet e lira dhe demokratike. Kryesia edhe pse është

organ i drejtimit të Kuvendit, ajo është uzurpuar nga kryetari i cili në vend të punës po e imponon mospunën duke menaxhuar keq të gjitha segmentet e funksionimit të Kuvendit. Kryetari e ka vonuar dhe shtyrë deri në harresë debatin për raportin 100 ditor të Qeverisë, nuk ka marrë qëndrim për interpelancën e kryeministrit që e obligon Rregullorja e punës, ka shtyrë interpelancën e ministres së Shërbimeve Publike, e ka shmangur problemin e arsimit ndaj procesit të arsimit, ndaj problemeve të shumta që janë në këtë proces dhe që janë në interes edhe për të ardhmen e qytetarëve. Ne mendojmë se kryeparlamentari pasi edhe është akademik është dashur ta ketë një qasje tjetër edhe personale ndaj procesit të arsimit. Kështu me papërgjegjësi është sjellë edhe ndaj procesit të reformimit të pushtetit vendor, decentralizimit të sigurisë e të gjyqësisë, zbatimit të ligjeve, nuk e ka lejuar formimin e komisionit parlamentar hetimor në kohën kur ka pasur keqpërdorime të shumta në shfrytëzimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Për të gjitha këto probleme ne kemi kërkuar të debatohet, ndonjëherë edhe është debatuar, por nga kryetari i Kuvendit është penguar marrja e masave adekuate, pra është debatuar si në odat tona pa nxjerrë asnjë përfundim, vetëm sa për të bërë llafe dhe përgojime. Këto i kemi në odat e Kosovës nuk i është dashur Parlamenti. Kjo metodë e punës e ka degraduar deri në pakuptim punën e Kuvendit të Kosovës dhe e ka bërë përgjegjës për mosfunksionimin demokratik të tij. Lexoni raportet e monitoruesit, ne jemi të bindur se për të gjitha këto shkelje të procedurave dhe të ligjeve ka pasur një aleancë ndërmjet Qeverisë dhe kryeparlamentarit. Me veprimet e veta Kuvendi dhe Qeveria gjatë këtij mandati kanë dhënë shembullin më të mirë se si nuk duhet punuar dhe e gjithë kjo nuk mund të mos reflektojë në proceset politike dhe në zhvillim. Kush duhet të marrë përgjegjësinë për të gjitha këto pengesa? Gjatë këtij mandati kemi parë se si nuk funksionojnë institucionet demokratike, si nuk respektohen ligjet, si bëhen diferencimet, si pengohet puna profesionale në administratë, si nuk funksionojnë segmentet kryesore në të tri nivelet e pushtetit, si korruptohet shoqëria, aty ku ka me bollëk korrupsion financiar. Jo më pak i rrezikshëm për shoqërinë është korrupsioni në planin politik dhe moral. Deri më tani Kuvendi nuk ka arritur t'i kryejë me përgjegjësi asnjë nga obligimet e tij, përveç të dhënies së përgjegjësisë për të përgjegjshmit, për të qeverisur keq, si për financa po ashtu edhe për njerëzit. Prandaj grupi ynë parlamentar kërkon nga grupet e tjera parlamentare të na mbështesin me kërkesën tonë që të shtohet angazhimi i Kuvendit të Kosovës në raport me nevojat e vendit, prandaj kërkojmë:

seancë javore, ku përveç tjerash do të trajtoheshin edhe këto çështje në tre muajt e parë të vitit 2006, çështjet e dokumentit të Grupit Negociator, çështjet e arsimit, debati për raportin njëvjeçar të Qeverisë, krijimi i një komisioni parlamentar hetimor për çështjet buxhetore të Kuvendit dhe të Qeverisë dhe për çështjet e shëndetësisë. Një raport nga Grupi Negociator për zhvillimin e proceseve politike për Kosovën dhe rreth saj, debat për raportin financiar për vitin 2005, debat për siguri në drejtësi, Reformimi i pushtetit vendor dhe decentralizimi duhet të jenë pikë e veçantë në muajt e parë të vitit 2006. Çështja e regjistrimit të popullsisë, të banesave, të ekonomive familjare, të çështjeve sociale dhe programi i Qeverisë për këto çështje, për muajt e tjerë kërkojmë nga Kryesia e Kuvendit me shëfat e grupeve parlamentare të bëjmë planifikimin në vazhdim. Në kohën kur po vendoset çështja e statusit politik të Kosovës Kuvendi i Kosovës duhet të punojë me kapacitet të shtuar, seancat javore janë domosdoshmëri e kohës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Z. shef i PDK-së, ju faleminderit për krejt komplimentet, po do të ketë shumë seriozitet në akceptimin e të gjithave që shpien në progres të institucioneve, prandaj edhe për akuzat ju faleminderit.

Për fjalë është paraqitur Teuta Sahatçija.

DEPUTETJA TEUTA SAHATCIJA

Ju faleminderit z. kryetar.

Unë do të përqendrohem në rendin e ditës dhe para se të fillojë e përkrah kërkesën e kolegut tim Jakup Krasniqi për të gjitha kërkesat e PDK-së e sidomos për dinamizmin më të madh të punës së Kuvendit të Kosovës, d.m.th për seancat javore.

Aprovimi i rendit të ditës nga Kuvendi është bërë një çështje problematike e çdo seance plenare të këtij kuvendi. Në çdo seancë të radhës jemi dëshmitarë të anashkalimit kryeneç të aprovimit të rendit të ditës dhe krijimit të problemit të panevojshëm seancë pas seance. Ndoshta Kuvendi ynë me seanca të rralla mujore harron këtë problem nga seanca e kaluar dhe përsëri pafundësisht herr të njëjtin problem apo ndoshta ky është sporti i kryetarit që me këtë kryeneçësi e vërteton pafundësisht para këtij Kuvendi se Rregullorja e tij ka prioritet ndaj rregullores së aprovuar para këtij Kuvendi. Përderisa deputetëve t'u hyjë në krye se kush është më i forti. Rendi i ditës me këtë rregullore të aprovuar nga deputetët e Kuvendit i parashtrohet Kuvendit për miratim. Pra Kuvendi vendos a do të vijohet puna me këtë rend dite e jo Kryesia ose kryetari i Kuvendit. Në rregullën 23 të kësaj rregulloreje e cila nuk ka prioritet nga ana e Kryesisë dhe e kryetarit, ceket në pikën 1, që rendi i ditës së seancës së ardhshme caktohet në fund të seancës vijuese. Pika e dytë, për ndryshimin e rendit të ditës Kryesia paraqet propozimin për miratim në Kuvend, pika 3. Kryesia konsultohet me shefat e grupeve parlamentare për caktimin e rendit të ditës së seancës plenare, që nuk ndodh. Pika 4, Kryesia konsultohet me shefat e grupeve parlamentare më së paku 1 herë në muaj për çështje të përgjithshme të orarit të punës, gjë e cila nuk është praktikë te ne. Pika 5, Kryesia me nismën e vet ose me kërkesën e kryeministrit apo të një a më shumë grupeve parlamentare që përfaqësojnë jo më pak se 1/3 të deputetëve, përkatësisht të 40 deputetëve në Kuvend thërret seancën e jashtëzakonshme, në mënyrë që ta trajtojë një çështje të ngutshme dhe në këtë rast shqyrtohen vetëm çështjet që përbëjnë bazën e kërkesës. Nëse 40 deputetë shohin të arsyeshme që një çështje të trajtohet në seancën e jashtëzakonshme ,atëherë as Kryesia, as kryetari nuk kanë kompetencë ta heqin nga rendi i ditës, por duhet në afatin sa më të shkurtër ta procedojnë në Kuvend, përsëri gjë e cila nuk ndodh. Gjithashtu edhe kjo pikë e Rregullores nuk është pikë që respektohet nga ana e Kryesisë së Kuvendit. Si shembull është kërkesa e Grupit Parlamentar Ora e mbështetur nga 40 nënshkrime të deputetëve të Kuvendit më shumë se të një grupi parlamentar të protokolluar me 7 nëntor 2005 me nr. protokollin . 02/808 me kërkesë për debatin lidhur më mënyrën e vendimmartjes për ndërtimin e Qendrës administrativo-protokollare në Gërmi si dhe debatin lidhur me shpenzimet buxhetore të Kuvendit për periudhën janar – qershor 2005. Kjo kërkesë ka mbështetje në rregullore, por realisht nuk ka mbështetje në Kryesi. Pra ne kërkojmë që rendi i ditës të propozohet në miratim Kuvendit dhe të fillojë respektimi i Rregullores në

tërësi, ose që rregulla 23 të hiqet fare nga Rregullorja dhe të lihet vendimi në vullnetin e kryetarit dhe të mos çuditemi atëherë pse nuk ka asnjë shkelje e Rregullores, e ligjit në Kuvend, por të kërkojmë dënim për të gjithë të tjerët që e thyejnë Rregulloren dhe ligjet që ne i kemi aprovuar për të tjerët e jo për vete. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit. Unë kam vetëm një fjali:

Që sot e tha në një takim të rastit z. Xhavit Haliti që t'u shpërndahet Rregullorja atyre që pjesërisht e citojnë kur u duhet ajo, ndërsa respektimi i Rregullores është obligim ligjor, në një është: Respektimi i Kushtetutës e pastaj i Rregullores dhe do të respektohet plotësisht, sepse nuk është dhënë nga Kryesia propozimi i grupit parlamentar, sepse ajo ka propozuar konform Rregullores që çdo kërkesë ta ketë një material si arsyetim .Kryesia pastaj ia orienton grupit funksional parlamentar dhe vendos, d.m.th. asgjë nuk ka përfunduar, prandaj akuzat janë të mirëseardhura dhe ju falënderoj. A ka edhe dikush të thotë diçka? Gjergj Dedaj.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ

I nderuari z. kryetar, ministra, deputetë.

Unë prita që kryetari i Kuvendit akademik Daci, në fillim të kësaj seance t'i njoftojë deputetët për formimin e grupit të ri parlamentar për integrim. Atëherë më është dashur të dilja dhe t'ju merrja pak kohë vetëm sa për t'ju njoftuar se së bashku me kolegët nga Partia e Drejtësisë, nga partia e Aksionit Demokratik, nga Partia Demokratike e Ashkalinjve dhe nga Partia e Iniciativës së Qytetarëve të Gorës, jemi marrë vesh 6 deputetë ta formojmë grupin e ri parlamentar për integrim, në mënyrë që të kemi më shumë mundësi për debat të hapur për të gjitha çështjet që na preokupojnë në Kuvendin e Kosovës. Ka mjaft probleme dhe shumë çështje për të cilat do të duhej të merremi vesh në Kuvendin e Kosovës . Arsye tjetër pse e kemi formuar këtë grup për integrim është edhe një shembull se ne që ishim të diskriminuar për disa dekada e dimë më së miri se çka do të thotë të jesh i diskriminuar dhe i shtypur dhe kemi parashenja që partitë e mëdha që janë aktualisht në pushtet nuk po bëjnë mjaft për t'i mbrojtur interesat e bashkësive të ndryshme etnike, prandaj bashkësitë e ndryshme etnike përmes grupit parlamentar për integrim do të kenë mundësi që më shpejt, më mirë dhe më drejt të integrohen në shoqërinë e Kosovës. Për këtë arsye mendoj se është një shembull i mirë dhe një shanse edhe më e madhe.Ka një vit e më tepër që është konstituuar Kuvendi i Kosovës dhe vetëm një herë e kam pasur rastin të dal në këtë foltore.Ka ndoshta 6 muaj që e kam kërkuar fjalën nja 30 herë në këto seanca të Kuvendit dhe s'kam pasur mundësi asnjëherë ta marr fjalën. Mendoj ndoshta dikujt po i ngutet që të ma ndalë fjalën, por tash e tutje nuk do ta keni këtë kënaqësi dhe këtë privilegj, sepse Kuvendi i Kosovës është i të gjithë qytetarëve të saj, i të gjitha partive politike, i të gjitha grupeve etnike dhe nuk është pronë private e asnjë subjekti, pa marrë parasysh numrin e deputetëve në këtë kuvend. Kërkojmë që konform Rregullores së Kryesisë së Kuvendit që përfaqësuesit e bashkësive etnike dhe të partive të vogla parlamentare të përfshihen në të gjitha punimet e Kuvendit. Në Kryesinë e Kuvendit jemi marrë vesh që të jetë përfaqësuesi nga bashkësitë etnike,që aty drejtpërdrejt të jenë sa më shumë anëtarë të

bashkësive etnike që në të gjitha komisionet parlamentare ,posaçërisht në Komisionin për Siguri, të jenë të përfshirë të gjithë përfaqësuesit e bashkësive të ndryshme etnike, sepse është një komision me shumë ndjeshmëri dhe i rëndësishëm.Edhe në të gjitha komisionet parlamentare, edhe kryetarë të komisioneve të jenë përfaqësuesit e bashkësive të ndryshme etnike si dhe në delegacionin negociator të mendohet shumë seriozisht që të përfshihen. E di se normalisht është pakëz e papranueshme ,sepse jemi mësuar me injorime dhe përjashtime të njëri tjetrit, mirëpo kjo praktik tash e tutje duhet t'i takoj të kaluarës dhe të jemi të përfshirë të gjithë sepse në praktikat parlamentare demokratike partitë ndahen në parlamentare dhe jo parlamentare dhe partitë parlamentare kanë detyrime ndaj votuesve, d.m.th. të marrin pjesë në të gjitha zhvillimet dhe në të gjitha proceset dhe tash e tutje në asnjë çështje nuk duhet t'i përjashtojmë bashkësitë etnike, por do të jenë pjesë e integruar e shoqërisë së Kosovës dhe duhet të jenë të mbrojtura dhe të mos përsëritet e kaluara kur ishim të shtypur e tash me të njëjtat metoda t'i shtypim pse u takojnë bashkësive të ndryshme etnike. Ju faleminderit për vëmendje dhe shpresoj se Grupi Parlamentar për Integrim do të jetë një befasi e këndshme në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Para se t'ia jap fjalën profesor Gashit ,vetëm një sqarim.

Z. Dedaj u nxituat, unë më herët “më duket “se isha i qartë, u shkel rregullorja, sepse Kryesia informohet zyrtarisht për këtë. Unë e kisha ndërmend që t'ju them në pikën e rendit të ditës nr. 12, kur e kemi propozimin për anëtar të Kryesisë dhe shef të grupit të komuniteteve serbe se do të realizohet, do t'i ndjekim rregullat dhe procedurat dhe nuk ka asnjëri qëllim që të mos informoj ose të mbaj diçka në vete.

Profesor Gashi, urdhëroni.

DEPUTETI ALUSH GASHI

Faleminderit z. kryetar.

Që në fillim u dëgjuan akuza shumë të rënda në adresë të Kryesisë dhe të kryetarit të Kuvendit. Grupi Parlamentar i LDK-së nuk është në dijeni dhe kërkon që Kryesia e Kuvendit ta marrë në konsideratë përgatitjen e një raporti të punës së Kryesisë së Kuvendit .Me këtë raport të informohet seanca plenare. Ne i japim mbështetjen e plotë në kuadër të Rregullores së punës së Kuvendit dhe distancohemi nga të gjitha akuzat e bëra publike,që ende nuk janë të argumentuara. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ende nuk kemi hapur debat.Z. Gani Koci është paraqitur, urdhëroni.

DEPUTETI GANI KOCI

Ne e kemi marrë rendin e ditës ku janë 16 pika dhe diku në mesin e tyre është shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin për vitin 2006. Çdo kund në praktikat parlamentare dhe në parlamentet vërtet demokratike kur shqyrtohet buxheti ka vetëm një pikë të rendit të ditës dhe si e tillë shqyrtohet e vetme. Së paku të ishte në fillim pas miratimit të procesverbalit etj, por është lënë pas miratimit të dy projektligjeve që janë në leximin e dytë. Nuk po dua ta mohoj rëndësinë e këtyre dy projektligjeve, por miratimi i buxhetit është shumë i rëndësishëm jo vetëm për Qeverinë ,por edhe për Kuvendin dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, prandaj konsideroj se kjo si pikë e rendit të ditës të jetë pikë e vetme e rendit të ditës dhe pastaj të fillohet me pika të tjera që janë të parashtruara këtu.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit. Mendoj që të gjithë do ta mbështetni me kënaqësi, nuk ka pasur asnjë qëllim tjetër dhe se ne mendojmë që pas shqyrtimit të këtyre projektligjeve ,që një kohë e gjatë dhe aq sa i duhet shqyrtimit të buxhetit, por në qoftë se seanca, sepse unë me kënaqësi e pranoj se është pika kryesore e rendit të ditës, si pikë e parë ose në një periudhë tjetër, nuk ka asnjë problem, kam vetëm një kërkesë, ka pak diskrepancë në mendim, Komisioni funksional për këtë çështje ka bërë një propozim të bazuar dhe Kryesia e ka respektuar, është mendim i Kryesisë dhe njëkohësisht lutje që për shkak të rrethanave që ky do të jetë buxheti i fundit që promulgohet si rregullore, me gjithë atë që ne mund ta debatojmë si ligj të rregullt autorizimi ose promulgimi nuk është kompetencë e Parlamentit që ta bëjmë në një lexim dhe të zgjasë aq sa ka nevojë seanca plenare dhe do të ketë aq sa ka nevojë pauza dhe nuk ka askush ndonjë shqetësim tjetër, prandaj besoj se e kemi përkrahjen dhe le të jetë pika e parë e rendit të ditës të seancës së sodit dhe pastaj vazhdojmë me të tjerat. Ju faleminderit.

Kalojmë në rendin e ditës

Pra le të jetë si pikë e dytë pika katër siç e keni në rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006.

Prandaj kërkoj që ministri ta marrë fjalën.

Ju lutem edhe njëherë e kërkoi fjalën Gani Koci

DEPUTETI GANI KOCI

Ne nuk e kemi ende të qartë lidhur me kërkesën që Projektbuxhetit të miratohet me një shqyrtim, për këtë çështje Kuvendi nuk morri kurrfarë vendimi edhe pse ka qenë kërkesë, prandaj si i tillë, si vendim, do të duhej të merrej paraprakisht dhe jo në mes të diskutimit ose pas përfundimit të diskutimeve.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Nuk mora vendim dhe as nuk ju propozova, pas shqyrtimit, pas fjalës së ministrit dhe debatit ,seanca vendos, nuk vendos kryetari. Unë ju thashë si argumentim dhe se për herë të parë kemi mundësinë që në fund të vitit kalendarik ta kemi buxhetin e nënshkruar. Ministër foltorja është juaja.

MINISTRI HAKI SHATRI

I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë

Sot kam kënaqësinë që para jush në emër të Qeverisë të prezantoj Projektligjin për buxhetin e vitit 2006. Siç jeni në dijeni brenda këtij viti kalendarik Qeveria e Kosovës ka përgatitur dhe proceduar për miratim dy projektligje për buxhetin , të vitit 2005 në fillim të këtij viti dhe këtë për vitin 2006.

Procedura e përgatitjes, struktura dhe përmbajtja e Projektbuxhetit për vitin 2006 paraqet hap të rëndësishëm në progresin fiskal dhe demonstroi një vendosshmëri për disiplinë të rreptë buxhetore.

Dëgjimet buxhetore të organizatave buxhetore nga ana e MEF sipas kalendarit buxhetor kanë përfunduar në shtator. Ky proces ka mundur të përmirësojë planifikimin e shpenzimeve, sepse nga organizatat buxhetore paraprakisht kërkohen përgatitjet e planeve të detajuara të shpenzimeve operative dhe të projekteve kapitale sipas programit të investimeve publike.

Në këtë dokument që po e shqyrtojmë respektohen kufijtë e shpenzimeve buxhetore të përcaktuara në kornizën afatmesme buxhetore për vitet 2006-2008 të aprovuar nga Kuvendi në korrik të këtij viti. Kjo është edhe kërkesë që del nga Ligji për MFPP, standardet ekonomike për Kosovën dhe institucionet financiare ndërkombëtare (FMN, BB etj).

Me këtë dokument ,gjithashtu,mundësohet realizimi i këtyre objektivave: Disiplina dhe qëndrueshmëri buxhetore,

Cilësi e shpenzimeve buxhetore dhe transparenca në vendimmarrje Frenim i shpenzimeve qeveritare.

Buxheti i vitit 2006 bën ndërlidhjen e planifikimit të buxhetit me prioritetet e Qeverisë, si vijon:

Realizimi i standardeve për Kosovën,

Zhvillimi i infrastrukturës si bazë për nxitjen e sektorit privat dhe për rritjen ekonomike

Rritjen e efektshmërisë së shpenzimeve qeveritare.

Në këtë dokument, po ashtu ,përmbahen:

Organizimi i Qeverisë dhe mobilizimi i resurseve në përputhje me praktikatat ndërkombëtare,

Sigurohen shërbimet e domosdoshme për qytetarët e Kosovës.

Sigurohen të hyra shtesë jo me anë të rritjes së tarifave, por përmes zgjerimit të bazës së të hyrave (taksa në ekstra profit, licenca, etj)

Siguron grantet komunale në nivelin e buxhetit të vitit 2005, pra (22%) pjesëmarrje. Përkrah projektet investive publike që kanë kaluar nëpër fazat e shqyrtimit rigoroz (procesi i PIP)

Brenda kufijve të shpenzimeve prej 700 milionë € sigurohet mbështetja e aktiviteteve kyçe për Kosovën, si:

Diskutimi për statusin e Kosovës Procesi i decentralizimit dhe

Bartja e përgjegjësisë nga FR në institucionet vendore, përfshirë këtu themelimin e dy ministrive të reja

Të hyrat buxhetore

Rritja e shpejtë e të hyrave buxhetore, që ishte karakteristikë e viteve të mëhershme, ka mbaruar. Tani trendi i të hyrave është stabilizuar. Rritja modeste e të hyrave nënkupton që shpenzimet e Qeverisë dhe kapaciteti i saj për ofrimin e shërbimeve do të jenë të limituara edhe në vitin 2006.

Projeksioni i të hyrave buxhetore për vitin 2006 është zhvilluar në kontekst të kornizës afatmesme makroekonomike, sipas këshillave të autoriteteve kompetente (Administrata Tatimore dhe Shërbimi Doganore), në pajtim me rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, përfshirë këtu FMN. Për vitin 2006 janë planifikuar të hyra të përgjithshme në shumë prej 656 milionë euro. Kjo shumë përfshin edhe tarifën nga shfrytëzimi i minierave, dhënien e licencës së operatorit të dytë të telefonisë mobile dhe taksën e ekstraprofit nga PTK.

Deficiti i vlerësuar për vitin 2006 prej 38 milionë eurosh nuk kalon 3% të brutoproduktit vendor dhe është në linjë me udhëzimet e sugjeruara ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare.

Planifikohet që ky deficit të financohet nga kursimet e akumuluar gjatë viteve të kaluara. Në mbarim të vitit 2006, parashikohet ta kemi një bilanc bankar prej 58 milion euro dhe ky bilanc pritet të zvogelohet me tej në 10 milionë deri në mbarim të vitit 2007.

Të hyrat buxhetore në këtë vit paraqesin 27% të bruto produktit vendor, e cila përqindje i përgjigjet nivelit ekonomik të Kosovës.

Në strukturën e të hyrave, të hyrat nga tatimet marrin pjesë me 84 %, të hyrat jotatimore 7.7 %, të hyrat vetanake të komunave 5.2 % dhe të hyrat tjera 3.1 %. Në të hyrat tatimore edhe më tutje vazhdojnë të dominojnë të hyrat që realizohen në kufi me 77.1 %. Dhe kjo është brengë e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për ndryshimin e strukturës së të hyrave nga kufiri në brendi. Të hyrat vetanake të komunave janë projektuar në nivelin e vitit 2005, presim që masat stimulative për komunitat do të ndikojnë në realizimin e këtij projektsioni në vitin 2006.

Shpenzimet

Në linjë me prioritetin e Qeverisë për ngritjen e efikasitetit, buxheti i vitit 2006 kufizon rritjen e faturës së pagave dhe të punësimit në sektorin publik. Fatura e përgjithshme e pagave, krahasuar me shpenzimet totale, është mbajtur në 28%. të shpenzimeve të gjithmbarshme buxhetore. Më tej, është parashikuar zvogëlimi i subvencioneve për NPP-të dhe planifikimi e administrimi më i mirë i transfereve sociale. Me këto masa lirohen resurseve financiare për shpenzimet më të nevojshme kapitale dhe investuese ,që nxisin zhvillimin ekonomik dhe përmirësojnë standardin e jetesës për qytetarët e Kosovës. Shpenzimet kapitale do të arrijnë në gjithsej 177 milionë euro në vitin 2006. Kjo paraqet një rritje prej 4% në shpenzimet kapitale, krahasuar me planin e buxhetit 2005.

Limitimi i shpenzimeve buxhetore në 700 milionë € paraqet një shkurtim për 5 % në krahasim me shpenzimet e lejuara me buxhetin e vitit 2005. Në qoftë se nga ky krahasim abstrahojmë 22 milionë € të huazuara për Aeroportin dhe KEK-un dhe nëse i krahasojmë me shpenzimet reale në këtë vit, atëherë del se kufijtë e përcaktuar me këtë buxhet nuk janë më të ngushtë se sa shpenzimet buxhetore në vitin 2005.

Megjithkëtë është përmirësuar struktura e shpenzimeve në favor të rritjes absolute të vëllimit të investimeve kapitale, është rritur fondi i pagave (201 mil), subvencionet dhe transferet (168 mil). Janë zvogëluar kategoria "mallra e shërbime" mesatarisht për 10% dhe rezervat nga 9 milion në 6 milion euro.

Të gjitha ndarjet për investime kapitale janë bërë në pajtim me prioritetet e Qeverisë dhe në bazë të projekteve me prioritet ,të prezantuara nga organizatat buxhetore

Të nderuar deputetë!

Jemi përpjekur të jemi në dispozicion të komisioneve të Kuvendit gjatë shqyrtimit të buxhetit dhe sot jemi të gatshëm të përgjigjemi për pyetjet dhe për dilemat që dalin gjatë debatit për buxhetin.

Është në të mirë të institucioneve tona që buxhet të miratohet me kohë dhe të shpallet nga ana e PSSP-se para fundit të vitit. Marrë parasysh kohën e shkurtër ju ftoj që pas debatit, vërejtjeve eventuale nga komisionet dhe nga seanca plenare të miratohet sot dhe në këtë mënyrë të krijohen kushtet për fillimin e mbarë të vitit buxhetor 2006.

Personalisht preferoj respektimin e procedurës së miratimit të buxhetit si t ë çdo ligji tjetër, por duke pasur parasysh kalendarin e angazhimit të institucioneve dhe subjekteve që në bazë të Kornizës Kushtetuese janë kompetente për aprovimin dhe për shpalljen e

buxhetit, kërkoi mirëkuptim nga Kuvendi që të gjejë mënyrë të përshtatshme ta përfundojë në procedurën e miratimit në kohën e përshtatshme.

Duke ju uruar Vitin e Ri, uroj që viti 2006 të jetë i mbarë buxhetor. Ju falënderoj për vëmendje e mirëkuptim.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ministër ju faleminderit.

Unë do të doja që grupet parlamentare të deklarohen më parë e pastaj komisionet. Fjalën e ka profesor Alush Gashi

DEPUTETI ALUSH GASHI

I nderuari kryetar, të nderuar zotërinj deputetë, ministra.

Që në fillim shpreh befasinë time për mospranin e z. kryeministër, askund në rruzullin tokësor e as në ndonjë kuvend nuk debatohet as nuk miratohet buxheti në mungesë të kryeministrit, e ndoshta mungesa e tij është e arsyetueshme e ndoshta nga kryetari i Kuvendit.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së t'ju rikujtoj se miratimi i buxhetit është një nga detyrat parësore të Kuvendit dhe fatmirësisht kësaj radhe na është dhënë më shumë mundësi të ushtrojmë një nga detyrat tona parësore, siç është shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Në LDK me kujdes të posqëm e kemi shqyrtuar Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës të vitit 2006. Kemi organizuar debate dhe dëshmi në nivelet e organizimit tonë lokal dhe qendror, si dhe në nivel të Grupit Parlamentar të LDK-së. Është përshtypje e përgjithshme se projekti është serioz, me një strukturim të mirë, por njëkohësisht volumi i mjeteve aktuale është i tillë ,saqë realisht nuk mund t'i përmbushë të gjitha kërkesat e arsyeshme, si për nivel lokal ashtu dhe për atë qendror. Z. kryetar me këtë rast më lejoni t'ju rikujtoj se në paragrafin 29 të rapaortit për Kosovën, të hartuar nga z. Kai Aide, puna e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave vlerësohet si një nga zhvillimet e rëndësishme pozitive në Kosovë. Ne i bashkangjitemi këtij vlerësimi dhe kërkojmë vahdim të përpjekjeve për t'iu përgjigjur kërkesave zhvillimore të Kosovës për jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e saj. Duke i dhënë mbështetje në parim të këtij Projekti falënderojmë ministrin për pjesëmarrje në shumë dëshmi që kanë ndihmuar në sqarim të shumë pozicioneve buxhetore. Po ashtu i jemi mirënjohës Komisionit për Buxhet dhe për Financa për organizim të shumë dëshmimeve dhe të transparencës në këtë proces,por edhe të përgatitjes së sugjerimeve dhe amendamenteve. Ftoj deputetët e Grupit Parlamentar të LDK-së të marrin pjesë në debatin e sotëm . Me amendamente eventuale të japin miratimin deri në atë përfundimtar, në leximin e dytë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Profesor, ju faleminderit.

Para se të vazhdojmë një informatë. Nuk jam për ta mbrojtur askë dhe avokat i askujt, por kryeministri në të dalë më tha se në pikën 4 të buxhetit jam këtu dhe për atë unë e ftova publikisht të nxitojë dhe të vijë, d.m.th .vetëm sa për informatë të seancës.
Për fjalë është paraqitur Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Z. kryetar edhe unë si shef i Grupit Parlamentar të PDK-së përkrah kërkesën e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së që kur të debatohet për buxhetin, jo vetëm kryeministri, por do të duhej të ishte këtu i tërë kabineti qeveritar dhe mendoj është skandaloze kur debatohet për buxhetin e Qeverisë dhe ajo nuk është e pranishme në Parlament.

I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë. Niveli dhe organizimi i një shoqërie të organizuar dhe demokratike varen nga mënyra dhe serioziteti se si ajo shoqëri dhe ato institucione i qasen dhe e trajtojnë buxhetin që e kanë në dispozicion. Nëse nisemi nga kjo premisë mënyra, koha dhe nxitimi se si jemi duke e trajtuar buxhetin e konsoliduar të Kosovës, pa hyrë me seriozitetin ,me përgjegjësini, grumbullimin dhe ndarjen e ti nga institucionet e tona përgjegjëse, janë treguesit më të mirë të papërgjegjësisë si të atyre që e hartojnë, e grumbullojnë dhe e shfrytëzojnë edhe të atyre që e miratojnë e duhet ta kontrollojnë shfrytëzimin e buxhetit. Nëse e analizojmë me kujdes Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006 është e dukshme se në këtë projektligj kemi të meta të shumta. Terminologjia e përdorur nuk është e drejtë e profesionale. Propozuesi ka bërë ngatërrimin e kategorive ekonomike, nuk ka bërë dallime ndërmjet kategorive ekonomike të hyrave dhe të ardhurave . Ka edhe gabime të tjera terminologjike. Nene të caktuara janë në kolizion me ligjin për menaxhimin e financave publike siç është rasti me nenin 9.3 për transformimin e fondeve nga një organizatë buxhetore në organizatën tjetër. Kjo jep mundësi për menaxhimin të keq të parave publike. Si duket me këtë ndryshim në mënyrë kontrabandiste është përpjekur të arsyetohet transferi i paligjshëm i këtij viti nga Ministria e Shërbimeve Publike në buxhetin e presidentit dhe të vazhdohet me keqpërdorime të kësaj natyre.

Projektligji i buxhetit të vitit 2006, ku të hyrat janë paraparë të jenë në lartësinë 656 milionë e 200.000 eurove, është kjo shumë e krahasuar me vitin paraprak më e madhe vetëm për 14 milionë. Në dukje të parë tregon rritje simbolike, por nëse nisemi nga fakti se kemi të bëjmë me të hyra vjetore në nivel vendi, mund të konstatojmë se Kosova ka stagnim në zhvillimin ekonomik dhe në fjalorin ekonomik kemi të bëjmë me riprodhim të thjeshtë, por nëse kemi parasysh faktin se në vazhdim do të kemi krijimin e ministrive të reja e të komunave të reja që janë krijuar, nevojat e tjera të reja, kompetencat dhe përgjegjësitë e tjera shtesë, defakto jo vetëm që nuk kemi ngritje të fuqisë buxhetore,por kemi rënie. Kur kësaj i shtohet mënyra e pakontrolluar e shfrytëzimit të buxhetit nga njësitë buxhetore ,si ka ndodhur në vitin 2005, në vitin 2006 Kosovën do ta përcjellin vështirësi të shumta, deficitit buxhetor do të jetë i pashmangshëm dhe sigurisht i pakontrollueshëm. Po që se e analizojmë strukturën e të hyrave vërehet se dominojnë të hyrat e mbledhura në kufi që në buxhetin e konsoliduar të Kosovës marrin pjesë me 65% në raport me të hyrat totale. Kjo formë e mbledhjes së të hyrave është me leje të institucioneve përgjegjëse, nuk kërkon mund, por është vetëm njëra anë e medaljes, kurse ana tjetër janë tatimpaguesit, bizneset nga fuqia ekonomike prej të cilëve varet zhvillimi ekonomik i vendit. Buxheti rritet me ngritjen e nivelit të

investimeve. Mënyra e mbledhjes së të hyrave në kufi është një ngarkesë shtesë për bizneset, aty ku bizneset janë të obliguara që përveç pagesave të tjera të bëjnë edhe pagesën e obligimeve fiskale, ende pa i shitur mallrat e tyre, kjo do të thotë pengesë për zhvillimin ekonomik. Propozuesi duhet të ketë si qëllim dhe të ofrojë zgjidhje të reja në të mirë të rritjes së të hyrave të brendshme në raport me të hyrat e mbledhura në kufi. Është për t'u brengosur se niveli i të hyrave vetjake e komunave, ku edhe për vitin 2006, lartësia e të hyrave është paraparë të jetë vetëm 34 milionë ose 5% e të hyrave të përgjithshme. Ndarja e buxhetit për komunat ,në mënyrë lineare,për kokë të banorit pa regjistrim zyrtar ,do të thotë vazhdim i diskriminimit për komunat e varfra e të dëmtuara jo vetëm nga lufta e fundit.

Të hyrat ka mundësi të jenë më të larta, por në situatën konkrete kemi të bëjmë me vlerësim joreal të kapaciteteve financiare. Ngritja e të hyrave mund të bëhet pa futur tatime të reja, pa ngritjen enorme të tatimeve, por me ngritjen e disiplinës financiare me aksent të veçantë në kufirin verior të Kosovës, ku kemi një evazion fiskal dhe vrima për ikjen nga dogana, ngritja e disiplinës financiare do të reflektonte në dy pozicione: Nën 1, rritjen e të hyrave buxhetore, nën dy, eliminimin e konkurrencës jo lojale dhe eliminimin e deficitit buxhetor që për këtë vit është paraparë të jetë 44 milionë. Projektligjit të buxhetit për vitin 2006 i mungon transparenca, sepse është paraqitur në pozicione shumë të sintetizuara siç janë: pagat, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet, transferet, shpenzimet kapitale dhe rezervat që kjo paraqitje e sintetizuar le hapësirë për spekulime prej më të ndryshmëve. Bëhet pyetja: brenda pozicionit të mallrave dhe shërbimeve sa do të jenë shpenzimet e telefonit, të derivateve, të reprezentacionit etj, apo Qeveria sa do të shpenzojë për blerjen e veturave, të mobileve e të kompjuterëve, kur dihet se ka prirje të shpenzohen shuma të mëdha parash në këto pozicione. Me një vlerësim më realist ka mundësi të ulen pozicioni i mallrave dhe shërbimeve pa e cenuar funksionimin normal të organizatave buxhetore në favor të shpenzimeve kapitale në pjesët ku më së shumti fitojnë tatimpaguesit. Pjesëmarrja e pagave është shumë e lartë dhe po që se krahasohet me vendet e rajonit është ndër më të lartat. Në këto vende sillet prej 15 deri 20%. Te ne kjo është rreth 30% në raport me të hyrat. Shuma prej 6 milionë eurove e paraparë të kthehet në emër të huas është e diskutueshme dhe jemi skeptik se kjo do të ndodhë, shpenzimet kapitale janë vetëm 26% në raport me shpenzimet totale ku propozuesi është dashur që këtë pozicion ta rris në favor të pozicioneve të tjera. Në mungesë të një specifikimi më të detajuar të pozicioneve buxhetore i është lënë hapësirë e madhe organizatave buxhetore për shpenzimin e parave publike, kurse deputetët janë të privuar nga mundësia për të dhënë kontributin në vlerësimin e tyre. Për arsyen e shpenzimeve të këtyre mjeteve, si në kuadër të këtyre mjeteve si në kuadër të pozicionit të mallrave dhe të shpenzimeve, po ashtu edhe të shpenzimeve kapitale ku mungon nominimi i projekteve dhe është e drejtë që deputetëve t'u ofrohet mundësia të debatojnë për arsyen e këtyre projekteve dhe të caktimit të renditjes së prioriteteve. Gjithashtu njëri nga shpenzuesit e mëdhenj buxhetor paraqitet edhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit,ku deputetët nuk kanë mundësi të dinë se për cilat objektiva, në kuadër të AKM-së, do të shpenzohen, Qeveria edhe këtë vit nuk ka ndarë mjete të nevojshme për ndihmë në sektorin e bujqësisë, siç ndodh në vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian, që do të ishte stimulim për prodhuesit vendorë dhe substituum i artikujve nga importi me ata vendorë. Në mungesë të hyrave,. kontrata kolektive nuk do të gjente zbatim edhe në këtë vit, në pjesët kryesore të saj. Arsimi dhe

shëndetësia nuk do ta marrin hisen e merituar dhe të domosdoshme. Për pensionistët nuk priten ditë më të mira dhe siguri më e madhe materiale, projekti i nivelizimit të pagave, prapë si pasojë e të hyrave të ulëta nuk do të realizohet, as për kategoritë e tjera sociale. Ky buxhet nuk do të ofrojë zgjidhje të kënaqshme. Këto mangësi edhe më shumë i kufizon mënyra e tashme e shfrytëzimit të buxhetit nga drejtuesit më të lartë të institucioneve të Kosovës. Në përgjithësi kemi të bëjmë me teprimet e një buxheti më tepër konsumues sesa investues, si pasojë e mosrritjes ekonomike dhe mosaftësisë për krijimin e kushteve për investime dhe tërheqjen e investimeve të jashtme. Ky buxhet kërkon shfrytëzim me nikoqirllëk, që nuk mund të presim nga shfrytëzuesit e deritashëm të tij. As ky kuvend nuk mund t'i ikë përgjegjësisë së tij për shfrytëzimin e keq që i është bërë buxhetit të konsoliduar të Kosovës, apo mënyrës se si do të shfrytëzohet në vitin 2006. Tendanca për ta miratuar me nguti është e keqe. Është paralajmërim se do të vazhdohet me të vjetrën. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Z. Krasniqi ju faleminderit. Fjalën e ka Gjylnaze Syla shefe e Grupit P-arlamentar të AAK-së

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

Faleminderit zoti kryetar, para se t'ia filloj- me qenë se kjo pikë e rendit të ditës është e rëndësishë së veçantë- edhe unë përkrah kolegët e mi dhe besoj se kryeministri duhet të jetë këtu kur të debatohet për buxhetin, porse më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës të propozoj një pauzë 10 minutash, në mënyrë që ta kemi kryeministrin këtu, kurse një ndër arsytet që e shpjeguat edhe ju z. kryetar, ishte ajo se ministri mendon se do të jetë pika e 4 e rendit të ditës. Kërkoj aprovimin e juaj në mënyrë që kryeministri të jetë këtu kur të shqyrtohet buxheti. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit dhe mendoj se është e arsyeshme kjo dhe propozoj 15 minuta pauzë.

Seanca fillon pas pauzës

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Lus deputetët që të kthehen në sall.

Fjalën e ka Gjylnaze Syla, kurse le të përgatitet shefi i grupit parlamentar Ora Veton Surroi.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

I nderuari z. Kryetar, të nderuar ministra, deputet të nderuar.

Themeli i Kosovës së pavarur dhe prosperuese është pavarësia ekonomike e saj, kurse ndërtimi i pavarësisë ekonomike të Kosovës mbështetet në një buxhet të qëndrueshëm i cili duhet të reflekton stabilitet ekonomik. Buxheti i Kosovës duhet të siguroj të ardhmen e qëndrueshme dhe prosperuese të popullit të saj të familjeve e të individëve. Funkzioni ekonomik i buxhetit është i shumëfishhtë. Në projektligjin e propozuar për buxhetin e konsoliduar të Kosovës nuk zë vend të dukshëm funksioni ekonomik me gjithë atë ky buxhet është më mirë i menaxhuar këtë herë sepse aq sa ka buxhet aq edhe do të shpenzojmë. Procesi i buxhetit nuk ka qen i lehtë, por buxheti i Kosovës ende vazhdon të jetë ekskluzivisht buxhet shpenzues, që të jem më e saktë është buxhet konsumues, ky është konstatimi i parë për buxhetin për vitin 2006. Me gjithë atë është arritur një trend pozitiv në krahasim me vitin 2005 me qenë se në vitin 2005 ka ekzistuar deficit buxhetor prej 95 milion €, kurse në këtë vit ky deficit është zvogëluar në 38 milion €. Duke studiuar buxhetin për vitin 2006 me shumë kujdes grupi parlamentar i aleancës veçon se pjesën dërmuese të të dalurave buxhetore e përbëjnë të ashtuquajtura shpenzime kapitale, shpenzimet për mallra dhe shërbime dhe shpenzimet për subvencione dhe transfero.

Buxheti për mallra dhe shërbime kap shumën prej 130 milion e 951.774 euro kjo përbën gadi 20% të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës, shpenzimet kapitale përbëjnë shumën prej 176 milion e 563.163 € dhe kjo përbën afërsisht 25% të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës. Duke marrë parasysh se këto mjete nuk shpenzohen fare në projekte produktive që do t'i rikthenin këto shpenzime kjo pjesë e buxhetit mund të rikonstruohet si shpenzuese jo ekonomike dhe pjesa e tretë shpenzuese që ka titullin subvencione dhe transfero përbën 23% të tërë buxhetit. Sikur kjo pjesë t'i përmbahej titullit buxhetor që ka dhe t'i dedikohet subvencioneve produktive atëherë ky subvencion do të ishte produktiv dhe ekonomik, mirëpo edhe kjo pjesë hyn në pjesën e atyre shpenzimeve jo produktive. Duke mos llogaritur edhe shpenzimet e komunave dhe shpenzimet për paga të cilat janë gjithashtu shpenzuese, por në një mënyrë produktive nga se për këtë pjesë buxhetore ofrohet shërbim dhe produktivitet, arrin në një përqindje prej së paku 63% të tërë buxhetit që do të shpenzohet për qëllime joproduktive dhe joekonomike. Duke marrë parasysh këtë fakt ne që tani mund të prejudojmë se të hyrat në buxhetin e vitit të ardhshëm nuk do të përfytyrojnë ngritje dhe kjo vetëm për faktin se buxheti i Kosovës nuk jep impuls të ngritjes ekonomike në Kosovë por është fare shpenzues. Nëse marrim parasysh edhe faktin se 423 milion euro pra më tepër se 60% të tërë buxhetit të Kosovës mbledhen në kufij nga mallrat që importohen vërtetohet karakteri konsumues i buxhetit të Kosovës, pra Kosova pas 5 viteve përgatitje dhe shpenzim të buxhetit nuk ka arritur të bëjë një ndryshim rrënjësor ose përmirësim nga buxheti shpenzues në atë investues. Një indikacion për këtë fakt është edhe vetë projektbuxheti që i është dorëzuar Kuvendit i cili nuk përmban të dhëna të mjaftueshme, precize dhe të detajizuara mbi shpenzimet, por i përmbledh si një njësi buxhetore pa e sqaruar edhe shpenzimin konkret të tyre. Me gjithë atë ne nuk dëshirojmë këtu të gjejmë fajtor për gjendjen buxhetore, por të kontribuojmë në evitimin e mangësive, konsiderojmë se mangësitë ekzistojnë tek të gjitha njësitë buxhetore të cilat si prioritet të lartë e kanë shpenzimin dhe prioritet 0 financimin e projekteve që do të reflektonin produktivitet në buxhet dhe në punë. Është evidente se ky buxhet nuk parasheh financimin e projekteve investive ose produktive, kjo mund të arsyetohet edhe me faktin se buxheti i Kosovës është i vogël, 656.2 milion euro, por asnjë

njësi buxhetore nuk ka dëshmuar se përmes veprimeve konkrete ka tentuar të zvogëloj buxhetin shpenzues në favor të atij investues.

Disa prej gazetave ditore vlerësojnë këtë karakter shpenzues dhe konsumues të buxhetit të Kosovës si arrogancë të institucioneve të Kosovës ndaj tatimpaguesve duke krahasuar institucionet me personat të cilët nuk e qajnë kokën për buxhetin ose shpenzimin racional të tij, unë nuk dëshiroj ta komunikoj këtë paragjykim që është prezent tek kritikët, por edhe te qytetarët e Kosovës por dua të apeloj tek këtë gjithë ne që të kontribuojmë që ky paragjykim të zhduket, këtu jam vetëkritike dhe dua të konsideroj se duhet filluar nga vetvetja, pra nga vetë Kuvendi, pra njëkohësisht mund të konstatojë se ky problem nuk është problem i pozitës së sotme ose i opozitës së sotme nga se në këtë aspekt Qeveria e sotme nuk ka pasur ndryshime rrënjësore, sikur që përmenda më lartë që nuk duhet kërkuar fjalësin në një person ose grup personash për gjendjen e krijuar ne konstatojmë se tani është koha për ndryshime dhe lëvizje në një fazë tjetër duke filluar nga eliminimi i mangësive në menagjmentin e buxhetit.

Problemi i menaxhimit dhe shpenzimit të buxhetit është problem i mentalitetit i cili duhet të ndryshohet duke u nisur nga shembujt individual të personave që bartin përgjegjësi publike. Është me rëndësi që politika të jetë e sigurtë dhe të ketë besimin e plotë të qytetarëve të cilët ua kanë dhënë besimin partive politike dhe institucioneve të Kosovës dhe ta arsyetojnë këtë besim. Hapi i parë drejt ndryshimit të mentalitetit është vetëdijesimi i institucioneve të Kosovës dhe personave me përgjegjësi publike se shteti nuk ka buxhet të vetin që mund ta shpenzoj si dëshiron, buxheti vjen nga xhepi i qytetarëve, qytetarët ia besojnë shtetit këto mjete në mënyrë që të ofrohen shërbime cilësore, publike, të financojnë projekte shoqërore dhe të rritet zhvillimi ekonomik dhe standardi jetësor, këto të holla që derdhen nga qytetarët nuk i janë dedikuar shtetit, por janë besuar për menaxhim efikas dhe produktiv dhe jo për shpenzim të panevojshëm. Hapi i dytë është që të kuptojmë se menaxhimi me mjete publike do të thotë përgjegjësi dhe llogari dhënie, pra përgjegjësi profesionale por edhe llogaridhënie dhe përgjegjësi ndaj atyre që kanë kontribuar në këtë buxhet, kjo përgjegjësi është e verifikueshme dhe mund të kërkohej si nga qytetarët po ashtu edhe nga institucionet përkatëse. Hapi i tetë është që përgjegjësia të mos shtrihet vetëm në mënyrën e shpenzimit të mjeteve buxhetore, por edhe të planifikimit të këtyre shpenzimeve. Nëse planifikimi i buxhetit nuk bëhet mirë të velurat dhe shpenzimet buxhetore do të jenë në të njëjtin nivel si dhe planifikimi dhe hapi i fundit është se procesi buxhetor institucional duhet të jetë efikas dhe në këtë aspekt konsiderojmë se Kuvendi duhet të angazhohet më shumë në të ardhmen dhe se Komisioni për Buxhet dhe Financa duhet të jetë më aktiv.

Të nderuar deputet, sfida e sotme për një të ardhme më të qëndrueshme është që të lëvizet nga buxheti shpenzues në atë investues. Kosova synon të hyjë në familjen evropiane, me buxhetin e sotëm dhe këtë nivel të zhvillimit ekonomik realizimi i këtij synimi kërkon ballafaqimin me sfida të shumta. Prandaj shpresojmë se për vitin e ardhshëm institucionet e Kosovës do të kontribuojnë më shumë në hartimin e projekteve zhvillimore me qëllim të rritjes ekonomike dhe zgjerimin e bazës tatimore, dy komponente që sigurojnë rritje dhe stabilitet buxhetor dhe njëkohësisht rritje të standardit jetësor të qytetarëve.

Në këtë kontekst rëndësi të veçantë ka formimi i administratës tatimore dhe krijimi i një administrate moderne e taksave efikase dhe transparente, për vitin e ardhshëm buxhetor grupi parlamentar i AAK-së ka zhvilluar tri orientime lidhur me planifikimin dhe zhvillimin e buxhetit të Kosovës dhe beson se këto tri orientime duhet të jenë orientime të

institucioneve të Kosovës, me qëllim të evitimit të mangësive buxhetore grupi parlamentar i AAK-së kërkon nga Qeveria dhe Kuvendi për vitin e ardhshëm përkushtimin dhe përqendrimin në tri orientime:

1. Investim në projektet zhvillimore dhe produktive,
2. Reformim dhe ristrukturim buxhetor, dhe
3. Konsolidim të buxhetit të Kosovës pas 5 viteve buxhetore.

Për realizimin e këtyre kërkojmë: kursim, racionalizim të kërkesave për shpenzime, mbikëqyrje, përgjegjësi, profesionalitet, modesti. Buxheti i Kosovës duhet të siguroj mbështetjen e administratës së përgjegjshme publike, përmirësimin e pagave për arsimtarët, mjekët, policët, TMK-në, mundësi për punësim dhe zhvillimi të biznesit. Grupi parlamentar i AAK-së do të vazhdoj t'i shtroj këto çështje në Kuvendin e Kosovës dhe fton për mirëkuptim dhe mbështetje në të ardhmen nga deputetët me qëllim të realizimit të këtyre orientimeve politike. Në parim Grupi parlamentar i AAK-së e përkrah këtë Projektligj. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Gjylnaze ju faleminderit, z. Surroi, kurse le të përgatitet Mahir Jakcilar në emër të grupit 6+.

DEPUTETI VETON SURROI

Të nderuar zonja dhe zotërinj, të nderuar koleg. Duke e dëgjuar parafolësen z. Sylja desha t'i uroj mirëseardhje në opozitë, do ta nënshkruaja fjalimin e saj si një fjalim i qëndrimeve tona të përbashkëta me përjashtim të përfundimit të përkrahjes së buxhetit. Do të falënderoja gjithashtu ministrin Shatri për prezantimin e asaj që duhet të jetë buxheti i vitit të ardhshëm, besoj se përkundër pendatërisë me të cilën na janë prezantuar këto fakte dhe për dallim prej parafolësve të mi të partive të tjera që kërkonin praninë e kryeministrit unë mendoj se do të ishte e udhës që kryeministri të na e prezantonte buxhetin e vitit të ardhshëm, për dy fakte të thjeshta sepse buxheti nuk është vetëm përmbledhje shifrash, por buxheti pretendon të jetë një vizion, buxheti pretendon të tregoj ambicien, gatishmërinë, projeksionin, rritjen, nevojat, idetë, dëshirat të gjitha ato që duhet të konsumohen brenda një qeverie. Në vend të shifrave do t'ju ftoja zonja dhe zotërinj të bënim një interpretim semiotik, apo poetik, këtë besoj se do ta kuptonte kryeministri, të asaj që është buxheti i Kosovës. Buxheti i Kosovës për vitin e ardhshëm zonja dhe zotërinj nuk është as konsumues, as shpenzues, ndonëse është edhe konsumues edhe shpenzues, buxheti i vitit të ardhshëm është buxhet i varfërisë, buxhet i fukarallëkut. Ky buxhet reflekton varfërinë, varfërinë e shpirtit, varfërinë e mendjes, reflekton një Qeveri e cila është zhytur në këto varfëri. Një shpjegim qytetarit të thjeshtë në vend të të gjitha shifrave, formulimi shumë i thjeshtë që qytetari shumë i thjeshtë të kuptoj se çka është ky buxhet e ndër ta jam edhe unë është se aq para sa ka pasur vjet për afërsisht aq do të ketë edhe vitin e ardhshëm, aq para sa ka pasur për arsim aq para do të ketë edhe vitin e ardhshëm, aq para sa ka pasur sivjet për shëndetësi, aq do të ketë edhe vitin e ardhshëm, nuk ka asnjë ndryshim substancial në jetën e njeriut, në arsim, shëndetësi, mirëpo jeta ecën e ka ritmin e vetë e ka kohën e vetë, ndërsa buxhetet nuk mund të stagnojnë sepse

atëherë shndërrohen në kthim mbrapa, për qytetarin e thjeshtë në fshatrat tona as nuk janë asfaltuar rrugë e as që do të asfaltohen, apo pritni zgjedhjet e ardhshme sepse ndoshta atëherë do të asfaltohen më shumë. Pritja e vitit 2006 është e njëjtë si e vitit 2005, kaq harç sa ka hyrë në vitin 2005 do të hyjë në vitin 2006 edhe kjo pite do të jetë e njëjta, pos që ka më shumë fëmijë dhe më shumë barkzbrazur. Varfëria e shpirtit këtë buxhet e krijojnë një rrudhje krahësh nga Qeveria e cila del dhe arsyetohet dhe na thotë kaq mundemi sepse po na pengon statusi. Në fakt kjo është varfëri shpirtërore sepse nuk mjafton të thuhet se statusi po e pengon tatimbledhjen, nuk mjafton të thuhet se statusi po pengon që tatimbledhja të shtrihet në horizontale dhe të mos mbështetet vetëm në pikën kufitare të Hanit të Elezit prej nga mblidhet 60% të të ardhurave me të cilat financohet policia, arsimtari, mjeku. Nuk mjafton të thuhet se statusi i pengon qeveritarët tonë të distribuojnë edhe këtë varfëri në formë më të mirë dhe që të kenë kujdes. Varfëria shpirtërore zonja dhe zotërinj krijojnë vetvetiu arrogancë, krijojnë mostransparencë, krijojnë grykësi, krijojnë nevojën që të tejkalohet varfëria individuale personale e pushtetmbajtësve për një kohë relativisht të shkurtër.

Varfëria e mendjes është ajo e cila rrjedh nga kjo varfëri e shpirtit. Qeveria po e bën ridistribucionin e varfërisë, por nuk na erdhi sot që të na tregoj, të na përgjigjet në pyetje të thjeshta fundamentale e pyetje të thjeshtë dhe fundamentale është si do të rriten të ardhurat publike, si do të nxitet ekonomia në mënyrë që t'i rris këto të ardhura publike dhe si pretendon kjo Qeveri të menaxhojë ato të ardhura publike në formë më tumirë në mënyrë që të bëhet një qark jo vicioz, por një qark virtyti, një qark ku Qeveria e ndihmon biznesin dhe ai biznes ia kthen përmes taksave Qeverisë shpenzimeve publike kësaj Qeverie. Do të na arsyetohet dikush se Fondi Ndërkombëtar monetar i ka përcaktuar këta parametra, në fakt Fondi Ndërkombëtar monetar është një kontabilist i mirë i cili vjen i kontrollon letrat dhe je thotë mirë kaq ke shpenzuar, kaq ke fituar je 00 mund të vazhdojë më tutje. Fondi monetar ndërkombëtar nuk është institucion vizionesh, është institucion kontrollues mekanizmash shifrash Qeveria është ajo që duhet ta ketë vizionin. Një proverb Kinez zonja dhe zotërinj thotë: Shtrati mund të jetë i njëjtë, por ëndrrat i kemi të ndryshme. Edhe ky Parlament, ky shtrat i ynë me të vërtetë është i përbashkët, por me asgjë nuk ndajmë me këtë Qeveri. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit, fjalën e ka Mahir Jakxhillar

DEPUTETI MAHIR YAĞCILAR

Sayın Meclis Başkanı, Sayın Başbakan, Sayın Bakanlar ve Değerli Milletvekilleri

6+ Parlamento gurubu, 2006 yılına ait Kosovanın Konsolidasyon Bütçesiyle ilgili Yasa Tasarısını görüştüğten sonra, bütçenin, her ülke ve parlamento için en önemli unsurlardan biri olduğu sonucuna varmıştır. Bu durumda, düşüncemize göre, Bütçenin doğru şekilde hazırlanması, daha doğrusu

varolan araçların en iyi bir şekilde istifade edilmesi, gelir ile giderlerin gereken şekilde değerlendirilmesi ve belirli projeler ile yatırımlarla Kosovanın iktisadi gelişmesi sağlanmalıdır.

6+ Parlamento gurubu olarak, bu kez Bütçenin hazırlanmasında esas ve kararlı rolü Kosova ekonomi uzmanlarının oynadığından memnuniyetlik duymaktayız.

Genel olarak bakılırsa, gelirlerin kaynağı açısından memnun değiliz, çünkü gelirler kaynağının büyük bir bölümü Gümrük vergilerinden sağlanmıştır. Fakat, şunu iyi bilmemiz gerekir ki, bu bizim gerçeğimizdir ve ithalat sonucu değil, üretim sonucu gelirlerin sağlanması doğrultusunda gerektiğinden daha çok ve ciddi bir şekilde çalışmamız gereklidir.

Somut uyarılara gelince, düşüncemize göre, Seçim kampanyası masraflarının giderilmesi için politik partilerin desteklenmesi amacıyla özel fıkra öngörülmedi.

Aynı zamanda, azınlık topluluklarının işe kabul edilmesiyle ilgili saptanan ve kabul edilen standartlar esasınca, azınlık topluluklarına ait boş olan işyerlerin ve bu masrafların giderilmesi için gerekli olan araçların göstergesi de sunulmalıydı.

6+ Parlamento gurubu olarak, Bakanlıklar ile belediyelerle ilgili bireysel uyarılarımız şunlardır:

. Tarımcılık, Ormancılık, Köylerin gelişmesi, Çevre ile Alan planlaması Bakanlığı ve Ticaret ile Endüstri Bakanlığında, tarımcılık ile üretimin gelişmesi için daha fazla proje ve yatırımlar öngörülmedi, Ulaşım ile Telekomunikasyon Bakanlığı, yolların bakımı ile rehabilitasyonu yerine, daha fazla yeni yolların inşa edilmesine yatırımın yapılmasını öngörmeliydi,

Kosovada yaşayan halkın nüfus sayısından başlanarak, Sağlık Bakanlığı, Prizrendeki Yöre Hastanesine daha fazla yatırımın yapılmasını öngörmeliydi,

Kültür, Spor ve Gençlik Bakanlığı, Kosova gençlerinin desteklenmesi ve bununla birlikte azınlık topluluklarına ait kültür örgütlerinin desteklenmesi için daha fazla araçların ayrılmasını öngörmeliydi,

Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanlığı, azınlık topluluklarının dilleri üzere kitapların basılması ve Türk ile Boşnak dili üzere eğitimin desteklenmesi için gerekli olan araçların tutarını ayrı olarak belirlemeliydi, Topluluklar ile Geri dönüş Bakanlığı ne yazık ki çalışmalarını sadece Kosovaya geri dönmek isteyenler yönünde sürdürmektedir, diğer toplulukların kalımı ile ilerideki entegrasyonuna ait istemlerle ilgili projeler nerde acaba?

Priştine, Mitroviça, İpek, Prizren, Vıçitırın ve Dragaşta yaşayan topluluklar için bağışların dağıtılmasında, belirli oranlarla öngörüldüğüne göre, Türk ve Boşnak topluluğuna ait projelerin gerçekleşmesine önem verilmelidir, Mamuşa pilot belediyesi için öngörülen bütçeyle ilgili ise sözkonusu belediye bütçesinin daha fazla olması ve Ulaşım Bakanlığının işbirliği sayesinde Pirane-Mamuşa yolunun inşa edilmesinin öngörülmesinin gerekli olduğu düşüncesindeyiz,

Aynı zamanda, çeşitli acentalara, özellikle Özeleştirme Acentasına gerektiğinden fazla araçların ayrıldığı düşüncesindeyiz.

Ortaya atmış olduğumuz bu gibi öneri ve uyarılarla, yine de şu anda Kosova Konsolidasyon Bütçesiyle ilgili en iyi olası çözümlerin verildiği düşüncesindeyiz ve 6+ Parlamento gurubu olarak, 2006 yılına ait Kosova Bütçesiyle ilgili Yasa Tasarısını prensipte kabul ediyoruz.

İlginize teşekkürler

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Fjalën e ka z. Naser Osmani dhe ju lutem që të respektohet koha e rregullore, pos kryetarit të Komisionit funksional nëse i duhet kohë shtesë do ta ketë.

DEPUTETI NASER OSMANI

I nderuari z. Kryetar, kryeministër dhe ju ministra dhe kolegë deputet.

Kam kënaqësinë që të paraqes para jush vlerësimit tim dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa pranë Kuvendit të Kosovës mbi përmbledhjen e buxhetit të vitit 2006.

Jam i bindur që ky buxhet përfaqëson një hap të rëndësishëm në progresin fiskal ekonomik të Kosovës për dallim nga propozimet e mëparshme buxhetore ky buxhet përfaqëson një disiplinë më të rreptë buxhetore. Për kundër vlerësimit të mëhershëm për procesin e hartimit të buxhetit të vitit 2006 mendoj që respektimi i orarit buxhetor duhet avancuar më shumë me qëllim që komisionet e Kuvendit të kenë më tepër kohë për diskutim dhe miratim të buxhetit, kjo në të njëjtën kohë do të na mundësonte që procesi buxhetor të jetë më transparent dhe më i kuptueshëm. Buxheti i vitit 2006 paraqitet më i avancuar sepse bën ndërlidhjen e procesit të ndërtimit të buxhetit me serinë e prioriteteve të larta të Qeverisë, po ashtu mendoj se vërehet se gjatë hartimit të këtij Projektligji janë shfrytëzuar praktika dhe standarde të mira si dhe janë marrë parasysh vërejtjet e komisionit për buxhet dhe financa lidhur me zvogëlimet e shpenzimeve të Qeverisë që

kanë të bëjnë me kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Sipas Projektligjit të propozuar të hyrat buxhetore për vitin 2006 do të jenë 656.2 milion euro që siguron një ballans të të hyrave dhe shpenzimeve me një deficit prej 43.8 milion euro që është përgjysmuar në krahasim me vitin 2005, në anën tjetër ka edhe një reduktim të shpenzimeve me një vlerë prej 37 milion eurove sipas mendimit tim kjo demonstroi përkushtimin e Qeverisë për të vënë rendin e nevojshëm fiskal, me gjithë atë përveç fakteve pozitive të lartpërmendura duhet theksuar se edhe disa aspekte tjera të rëndësishme për buxhetin e Kosovës. Nën një, sa i përket buxhetit të planifikuar për vitin 2006 nuk kemi ndonjë rritje buxhetore të knaqëshme edhe pse ka një lëvizje pozitive në drejtim të uljes së deficitit dhe shpenzimeve. Të hyrat më të mëdha buxhetore janë edhe më tutje doganat, kjo tregon se inkasimi i taksave dhe tatimeve të brendshme siç është tatimi në të ardhura, tatimi në qarkullim, tatimi në fitim etj, të parapara me ligj në fuqi nuk është në nivelin e duhur, prandaj Qeveria duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim duke hartuar politika më të mira dhe strategji të nevojshme për të ndërmarrë veprime me të cilat do të ndryshohet ky raport i të hyrave, ashtu që do të ketë rritje të buxhetit nga grumbullimi i taksave dhe tatimeve të brendshme.

Aspekti tjetër që duhet potencuar është edhe financimi i ndërmarrjeve publike sidomos ai i KEK-ut si një barrë e cila e rëndon buxhetin e Kosovës. Qeveria duhet ndërmarrë hapat e duhur që ky pozicion i KEK-ut të ndryshohet nga pozicioni shpenzuesit në pozicionin e financuesit të buxhetit.

Nën tre, Qeveria duhet të ndërmarrë masa të nevojshme për të gjitha mjetet e lira të cilat nuk qarkullojnë në Kosovë, por mbahen në forma të depozitave ose letrave me vlerë në BPK ose në ndonjë bankë tjetër jashtë Kosove. Mjetet e buxhetit, mjetet e trustit pensional, mjetet e privatizimit, të gjinden mekanizma që do të ndikojnë në rritjen e buxhetit të Kosovës.

Z. kryetar, Komisioni për Buxhet dhe Financa mendon se në të ardhmen, pra pas definimit të statusit të Kosovës nuk do të duhej të ekzistonin privilegje të fleksibilitetit të cilat i lejon neni 9.3 i paraqitur në këtë Projektligj. Ashtu siç është i propozuar në Ligj për vitin 2006 neni në fjalë lejon transferimin e fondeve nga një organizatë buxhetore në organizatën tjetër buxhetore. Një dispozitë e tillë e bën rrolin tonë si ligjvënës të pakuptimt dhe nuk ekziston në praktika të asnjë parlamenti tjetër.

Nëse dikush, qoftë edhe përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm edhe pas miratimit të buxhetit të kuvendit rezervon pushtetin e transferimit të shumave të konsiderueshme të fondeve nga një organizatë buxhetore në një organizatë tjetër buxhetore pa kërkuar pëlqimin e Kuvendit atëherë çka ka bërë Kuvendi përveç që ka legjitimuar vendimin e dikujt tjetër.

Me krenari mund të deklaroj se Komisioni ka pasur një koncensus të plotë lidhur me këtë pikë të Projektligjit dhe pa marrë parasysh legjislacionin ekzistues ne i rekomandojmë fuqishëm Kuvendit që pika 9.3 të fshihet në tërësi. Mendojmë se ne si Kuvend i Kosovës duhet të mbrojmë me vendosmëri të drejtën tonë të patjetërsueshme për të aprovuar transferet buxhetore.

Zoti kryetar më lejoni që në fund të falënderoj publikisht të gjithë anëtarët e Komisioni për buxhet dhe Financa për përkushtimin që ata e kanë treguar për punën intensive që është bërë në një shqyrtim cilës të Projektligjit dhe duke marrë parasysh të gjitha diskutimet e deritashme për nevojën që ky Projektligj të miratohet sa më parë ju sugjeroj dhe ju rekomandoj që në këtë pikë të përkrahet në parim Projektligji, ndërsa Komisioni

do të tërhiqet që pas përfundimit të të gjitha pikave të parapara për këtë seancë të jetë një pikë e veçantë nëse ekziston ligjërisht që ajo të thirret si seancë e jashtëzakonshme apo vazhdim i kësaj seance dhe Komisioni do t'i kryej të gjitha punët dhe do ta kenë Projektligjin të amendamentuar. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Z. Kryetar i Komisionit FunkSIONAL ju faleminderit.

Unë gjatë pauzës që kishim kam bërë konsultime në të gjitha nivelet duke përfshirë edhe instancat më të larta të UNMIK-ut është një marrëveshje që Komisioni funksional dhe këtë ta marrim si shqyrtimi i parë, ndërsa Komisioni funksional dhe ekspertët e Qeverisë të Ministrisë për Financa të tërhiqen për punë. Aprovimi i kësaj pike të rendit të ditës të jetë pika e fundit e rendit të ditës që do ngjan të hënën apo kur të ketë nevojë, por ju lutem për mirëkuptim, nuk kemi asnjë nevojë funksionale që të konfrontohemi me dike, besoj se seanca e pranon këtë, në qoftë se dikush ka aq shumë argumente kundër, i priti shefat e grupeve politike jo deputetët.

DEPUTETI GANI KOCI

Z. kryetar ne e dimë se autoriteti i fundit për miratimin e buxhetit është zyra e përfaqësuesit special dhe jemi të vetëdijshëm për këtë. Jemi të vetëdijshëm se pavarësisht se si ne do ta miratojmë këtë buxhet me ndryshime apo pa ndryshime prapë autoriteti i fundit është ai i cili do ta ndryshoj, por kjo nuk është argument që ne si Kuvend të thejmë procedurat e miratimit të ligjeve në këtë Kuvend, neve si deputet, por edhe si grupe parlamentare duhet të na lini kohën e mjaftueshme dhe kohën e duhur që në këtë Projektligj të parashtrojmë jo vetëm vërejtjet në këtë shqyrtim të parë, por edhe propozimet dhe amendamentimet e mundshme, prandaj nuk është vetëm Komisioni për buxhet ai që bën ndryshimet dhe amendamentimin, ai mund të jap mendimet dhe qëndrimet e veta, por këtë të drejtë e kanë edhe grupet parlamentare që e kanë edhe secili individ, prandaj nuk e shoh të arsyeshme tërheqjen e komisionit për buxhet që formalisht ne e kemi shqyrtuar dhe jam anëtar i Komisionit për buxhet, i kemi dhënë vërejtjet tona dhe ato do të jenë, por do të jenë vetëm atëherë kur do të ketë afat të caktuar për shqyrtim të dytë si çdo ligj tjetër, për ndryshe është thyerje e rendit, është thyerje e rregullit dhe është një presedant që nesër mund të na ndodh edhe me një Projektligj tjetër, prandaj duhet të shkohet në shqyrtim të parë deri në fund, të bëhet miratimi në parim i këtij Projektligji dhe të kërkohet koha e nevojshme për shqyrtim të këtij Projektligji edhe nëpër komisione dhe grupe parlamentare dhe deputetët secili veç e veç.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Z. Koci, unë nuk mora vendim, unë thash se po e lus seancën plenare, i dimë shumë mirë procedurat, unë po ju them se është krijuar një mirëkuptim, dihet sa i nevojitet kohë dhe kalon në Janar, kur nuk do të jemi në plotni të gjitha instancat. Unë shpresoj dhe jam i bindur se kjo do të jetë hera e fundit e shqyrtimit të buxhetit të shpallur si rregullore në fund, nuk kam asnjë interes personal dhe nuk ka asnjë arsye asnjë individ personal, unë thashë që është arritur mirëkuptim nëpërmjet komisionit funksional të Ministrisë

përkatëse, është kërkesë e instancave më të larta me të cilat jemi në një kooperativitet funksional të mirë dhe nuk e thash që ta aprovojmë sot, t'i lehet kohë, sot, nesër, pasnesër, çdo ditë që e shoh të nevojshme seanca, prandaj po ju lus për mirëkuptim e jo për vendim, nuk ka asnjë interes kryetari i Parlamentit me e thye procedurën, të gjitha këto vite që jemi bashkërisht në këto dy mandate është shpallur si rregullore dhe kemi marrë vendim, prandaj s'kemi nevojë ta bindim njëri tjetrin kur jemi të bindur në të njëjtën gjë. Unë prapë po ju lus dhe nëse doni votojmë, por nuk po dua ta bie seancën pa asnjë nevojë në votim.
Fjalën e kërkon profesor Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI

Ju faleminderit zoti kryetar.

Ne kemi marrë një rend dite ku kjo është e evidentuar si leximi i parë, por duket se këtu ekziston një nevojë që të punohet pak më gjatë. Ajo për çka insiston grupi parlamentar i LDK-së është që Komisioni për Buxhet dhe Financa ta ketë tërë kohën që i nevojitet që këtë çështje ta rregulloj ashtu si e shëf. Nën dy, ju lutem që Komisionit t'i epet kohë që t'i shpërndanë amendamentet për seancën plenare, me këtë çështje nuk e konsiderojmë të mbyllur deri sa ta mbyllim. I përshëndesim zotëritë e UNMIK-ut që e përcjellin seancën, por ne kemi obligim që ta punojmë buxhetin ashtu siç dimë më së miri, kjo është çështje e Kuvendit të Kosovës, unë nuk pres që kjo seancë e filluar do të kryhet nesër apo pasnesër, prandaj ju lutem që Komisionit t'ia jepni tërë kohën që i nevojitet që kjo çështje të rregullohet mirë dhe unë besoj se mund të rregullohet në fillim të javës së ardhshme.
Ju faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Unë plotësisht e mbështes dhe jam i bindur që e mbështesin grupet parlamentare që e krijojnë koalicionin qeverisës, unë ju thash në plotni këtë që e tha shefi i grupit parlamentar të LDK-së se do të respektohet, ne do të bëjmë një punë të nevojshme dhe cilësore dhe politike.

DEPUTETI NAZIM JASHARI

Z. kryetar, z. Kryeministër, kolegë të nderuar deputetë.

Unë si anëtar i komisionit të buxhetit më duhet të them se plotësisht pajtohem me fjalën që e tha kryetari i komisionit, Komisioni ka punuar që në një farë mënyre duke anashkaluar procedurën e zakonshme se para dëgjimit të parë të Projektligjit në Kuvend të bëj përgatitjet e nevojshme që ky Projektligj të trajtohet në mënyrën më të mirë të mundshme nga ky Kuvend, kemi pasur dëgjime dhe përplasje gjithmonë në kuadër të punës së Komisionit, por në fund duhet të thuhet se ky Projektligj nuk është akoma i gatshëm në aspektin teknik për t'u miratuar nga ky Kuvend sepse ekziston një pozicion i agjensionit ku nuk është i definuar në buxhetin e vitit 2005 e kemi pasur Agjensionin për rregullimin e telekomunikacionit si pozicion të veçantë që e ka pasur një buxhet prej 300.000 eurosh. Në këtë projektligj ky agjension nuk trajtohet fare, nuk e pse edhe pse ky është një agjension i pavarur në kuadër të Ministrisë së Transportit dhe

Telekomunikacionit, ky Agjension nuk është trajtuar fare në këtë Projektligj, kemi disa gabime, sugjerime nga ana e këtij Agjensionit me që Kuvendi t'i ndajë buxhetin e po ashtu parashihej edhe në Ligj, mirëpo ne si komision nuk kemi pasur kohë ta bëjmë, por duhet që t'ndalemi dhe të ulemi e t'ia hartojmë buxhetin këtij Agjensionit dhe i cili duhet paraprakisht në një mënyrë të na jap një raport për punën e tij që e ka bërë dhe për të ardhurat që i realizon ai, a janë përfshirë ato të ardhura në këtë buxhet që e kemi përpara në shumë prej 600 milion eurosh apo nuk janë përfshirë fare në këtë buxhet. Në rast se nuk janë përfshirë atëherë duhet të shohim se ku duhet me i marrë mjetet për t'i ndarë Agjensionit, në rast se nuk janë përfshirë të shohim se si funksionon, në që mënyrë funksionin thesari, Ministria e Financave si i kontrollon, si i mbikëqyrë këto fonde të cilat mbesin jashtë buxhetit ose trajtohen si akt buxhetor edhe pse nuk kamë informacion të mjaftueshëm si funksionin kjo, prandaj edhe në aspektin praktik më duhet të them se nuk jemi të përgatitur që këtë Projektligj ta tejkalojmë, ai agjension është agjension i Kosovës, agjension i cili punon me paranë publike dhe realizon të ardhura nga paraja publike, kështu që është absurd të mbetet jashtë këtij Projektligji, prandaj edhe për këtë aspekt duhet të shkohet në dy lëvizime, prandaj a do të bëhet në procedurë të zakonshme apo do të shkoj në procedurë të përshpejtuar është punë e Kuvendit, kurse jam për atë që ta bëjmë me një procedurë më të shpejtë.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit z. Jashari.

Unë mendoj që edhe propozimi i LDK-së, po ashtu edhe i dy anëtarëve të Komisionit, ne nuk caktuam kohë. Përkrahja teknike le t'i epet e plotë komisionit dhe në momentin kur mund t'i shpërndajë amendamentet që e shef të arsyeshme, ne e shtrojmë në rend dite dhe seanca nuk përfundon dhe do të jetë pikë e fundit, sot e shqyrtojmë në lexim të parë. Komisioni le të tërhiqet dhe le të punoj punën e vetë.

Fjalën e ka ish kryeministri Bajram Rexhepi

BAJRAM REXHEPI, ish kryeministri

I nderuari kryetar i Parlamentit, kryeministër, ministra dhe të nderuar kolegë deputet. Do të mundohem të jem i shkurtër edhe pse një kohë të gjatë jemi marrë me çështje buxhetore dhe ndoshta kisha pasur për të thënë shumë, por do të provoj të jem i shkurtër.

Së pari nuk është vetëm ky Projektligj i buxhetit që ka dykuptimësi, ka edhe shumë dokumente tjera si Korniza Kushtetuese dhe shumë tjera që kanë dykuptimësi, natyrisht ne si Parlament do të duhet ta trajtojmë si Projektligj të buxhetit edhe pse në fund të fundit do të jetë si rregullore për buxhet sepse në fund PSSP-ja e ka fjalën përfundimtare dhe ai është ai që mund t'i ndërroj disa pjesë të buxhetit. Mendoj se këtë herë ekziston një vullnet i mirë që amendamentimet që do të bëhen nga Komisioni për Buxhet dhe Financa do të pranohen si të tilla dhe është një kompromis për këtë fazë dhe për vitet e ardhshme do të shkoj si Projektligj. U tha nga parafolësit se është buxhet konsumues, hargjues ose i fukarallëkut që në të vërtetë është si i tillë edhe ky që nga fillimi është programuar si i tillë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar kur kryesisht ky buxhet është

mbushur nga importi dhe nuk mund të them se fondi monetar ndërkombëtar ka për qëllim që Kosova të jetoj në varfëri, të mos ketë zhvillim ekonomik, por ata janë më tepër të interesuar që të jemi të kategorisë hargjuese dhe ata që e udhëheqin buxhetin të jenë shumë të disiplinuar në buxhetin e konsoliduar të Kosovës se hapësira e manovrimit është shumë e vogël, prandaj atyre më tepër ju intereson disiplina financiare sesa mundësitë që ndoshta dikund të thehen ato qëndrime dhe të investohet më tepër në prodhim. Është iluzion me menduar që nga ky buxhet dikund 35% shkojnë në paga të shërbyesve civil dhe të administratës publike që është më e larta në regjion, ta krahasojmë me Maqedoninë që pak më të madh e ka buxhetin se Kosova, ata shkojnë dikund në 16%, kurse te ne është mbi 35% dhe ky buxhet është që kryesisht me i plotësuar nevojat minimale të kategorive shpenzuese, është mirë me mund me i orientu drejt prodhimit ose investimeve që gjenerojnë mjetet, por Qeveria ndoshta duhet të konsistoj më tepër të krijohen lehtësira tjera në politikë fiskale ose eventualisht të konsistoj që disa fonde të cilat janë të bllokuara si fondi pensional ose nga privatizimi ose të tjera që janë të bllokuara në BPK që të krijohet një fond i zhvillimit së bashku me ndonjë bankë dhe nëpërmjet bankave komerciale të plasohen në ekonomi në një përqindje të vogël që do të krijonte një ambient më të shëndetshëm për zhvillim ekonomik dhe për investime. Pajtohem plotësisht edhe me kryesuesin e Komisionit por edhe me të tjerët, Komisionin për buxhet dhe Financa që amendamenti për transferim të mjeteve nga një organizatë shpenzuese në një tjetër nuk duhet të lejohet në asnjë mënyrë për arsye se aty ka mundësi për vullnetarizëm, ka mundësi edhe për keqpërdorim dhe nëse jo për keqpërdorim ka hapësirë bile për dyshime se sa ka qëllim të keqpërdorimit, prandaj kjo kurse si nuk duhet të pranohet.

Mendoj se edhe mëtutje 2/3 e buxhetit menaxhohen nga institucionet vendore ndërsa 1/3 e këtij buxheti menaxhohet edhe mëtutje si e drejtë e rezervuar e PSSP-së, tendenca ka qenë që më tepër të menaxhohet nga institucionet vendore e më pak nga ajo pjesë e rezervuar edhe pse në atë pjesën e rezervuar bëjnë pjesë kategoritë që janë shumë në interes të Kosovës, p.sh, policia, TMK-ja gjyqësia, burgjet etj. Por ka vend që të korrigohet që disa zyre dhe komisione që janë të panevojshme në pjesën e rezervuar, ka trefishim p.sh në zyrën për çështje të komuniteteve. Ekzistojnë tri kategori ose institucione që mirren me çështjen e komuniteteve dhe kthim, është një zyre pranë kryeministrit që nuk e di se a funksionon edhe mëtutje, në kohën kur isha unë nuk ka funksionuar, ka ekzistuar, ekziston një zyre tjetër për çështje të komuniteteve që ju kanë ndarë 3 milion 659.198 euro, që është një shumë tepër e madhe për këtë komision dhe në kohën kur tash e kemi Ministrinë për kthim dhe për çështje të komuniteteve ky është një shpenzim i mjeteve ose një vazhdim i disa zyreve surrogate që janë të panevojshme, le të dihet se çdo gjë që bëhet për komunitetet le të dihet se këto janë mjete të taksapaguesve Kosovarë e jo të mendojnë se ky është një buxhet që vjen nga ndërkombëtarët dhe e menaxhojnë ndërkombëtarët, kjo ka qenë kërkesë edhe më parë dhe duqet si kategori buxhetore.

Është po ashtu Komisioni i Minerave dhe mineraleve, konform ligjit duhet të ekzistoj si një rregullator i pavarur ose agjension i pavarur, por buxhetin e ka shumë të madh 1.8 milion, që e ka më të madh se Ministria e Energjetikës dhe Mineraleve që është tepër i madh dhe i paarsyeshëm, ka edhe zyra tjera, p.sh për çështje gjinore, ne i përkrahim këto dhe pavarësisht që është e vogël 50 mijë, flas për pjesën e rezervuar në kuadër të Kryeministrit ekziston zyra për qeverisje të mirë, çështje gjinore ku hargjohen mjetet,

pse të ketë edhe në pjesën e rezervuar ose të financohet nga buxheti i Kosovës. Mendoj se ka edhe shumë çështje tjera të cilat mund të korrigojnë ose të përmirësohen, mirëpo mendoj se Komisioni për buxhet dhe financa do të bëjë amendamentimin dhe nëse nga diskutimet do të del edhe ndonjë ide si kjo e zyrave të ketë vend edhe për ato dhe të shpresojmë se do të pranohen edhe nga PSSP-ja. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Bajram ju faleminderit, fjalën e kërkon z. Sabri Hamiti, shkurt ju lutem.

DEPUTETI SABRI HAMITI

Diskutimi im nuk ka tash kurrfarë arsyeje sepse problemi është në procedura, në mënyra të palejueshme kemi improvizuar rreth këtij ligji sot, ia kemi ndërruar vendin, tash po ja ndërrojmë mënyrën e diskutimit. Unë tash e shtroj si pyetje dhe ju lutem përgjigjuni: A do t'i ketë dy lexime ky ligj apo jo. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Profesor ju faleminderit, ju e dëgjuat edhe sqarimin e shefit të grupit parlamentar të LDK-së edhe të Komisioneve, unë nuk kam sqarim tjetër. Fjalën e ka Behxhet Brajshori, kurse le të përgatitet Gjergj Dedaj,

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI

Z. kryetar i Kuvendit, z. Kryeministër, ministra, të nderuar kolegë deputet. Gjithmonë kur diskutohet për buxhetin e natyrshme edhe qasje të ndryshme, por është me rëndësi që vërtet të nxjerrim një buxhet i cili në kuadër të projekteve që i ka dhe të masave që i ka të mbulojë sa është e mundur ato kërkesa buxhetore të cilat janë paraqitur edhe nga agjencionet shpenzuese. Unë mendoj se ky hartim i këtij Projektbuxheti ka një përparim në drejtim të asaj që quhet profesionale dhe të një radhitje më të kujdesshme në kuadër të buxhetit total sipas aktiviteteve ekonomike. Vërehet se kemi një stabilizim të shpenzimeve kapitale pa hyr në strukturën e projekteve të paraqitura të agjencioneve shpenzuese dhe po ashtu vërehet një rënie e shtyllës së mallrave dhe shërbimeve që tregon për një disiplinë të shtuar financiare të Qeverisë dhe besojmë se brenda kësaj shtylle të atyre që financohen nga kjo shtyllë nga mallrat dhe shërbimet vërtetë do të ketë një menaxhim të kujdesshëm me qëllim që këto mjete në kuadër të këtij pozicioni të shfrytëzohen ashtu siç edhe mendohet më funksionale. Unë do të përmendi me këtë rast tri agjencione shpenzuese që mendoj se ka qenë e nevojshme të kenë një mbështetje pak më të madhe, e para është Ministria e Shëndetësisë sipas meje e cila edhe pse ka një rritje buxhetore në krahasim me vitin 2005 ajo merrë pjesë vetëm me 0,76% në buxhetin total të vendit dhe ajo që është më karakteristike është fakti se nuk parashihet subvencionimi i prodhimitarisë bujqësore, në shtyllën që ka të bëjë me subvencionet tek Ministria e Bujqësisë figuron zero, e dytë është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Çështjeve jo Rezidente, po them nga përvoja sepse edhe këtu nuk ngritet më tepër se 0.91% pjesëmarrja e buxhetit të kësaj Ministrie në buxhetin total dhe sipas buxhetit të

dedikuar për subvencione shihet se ne në vitin 2006 nuk do të kemi asnjë financim të krijimtarisë filmime në Kosovë, por do të rrezikohet edhe trashëgimia jonë kulturore mëtutje e mos të përmendi të kulturës sonë në përgjithësi të kultivimit të asaj dhe të promovimit të kulturës sonë jashtë dhe të problemeve tjera dhe të kërkesave që kanë të bëjnë me sportistët tanë, me rininë tonë dhe me diasporën e cila ka dhënë shumë dhe tani pak i kushtohet kujdes në veçanti me një shumë tepër simbolike prej 130.00 euro të parapara. Agjensioni tjetër që duhet shtuar kujdes janë komunat e më saktësisht komuna e Prishtinës. Duke pasur parasysh specifikat e Prishtinës edhe pse duhet vlerësuar si shumë të arsyeshme edhe kërkesat e komunave tjera sidomos të atyre me shkallë të ulët të zhvillimit dhe me mundësi të vogla që ato të realizojnë të hyra vetanake më të mëdha, komuna e Prishtinës ka specifikë të veçantë, e dimë të gjithë dhe mendoj se këtu duhet bërë një përparim më të madh, një investim prej 7.1 milion euro për shpenzime kapitale për Prishtinën janë shumë pak, te AKM-ja mendoj se kemi një ndarje të madhe të mjeteve buxhetore edhe për shpenzimet kapitale edhe për mallra dhe shërbime, vëreni pozicionin për mallra dhe shërbime kemi mbi 5 milion për privatizim ose likuidim dhe nuk arsyetohet se për çka në të vërtetë përdoren.

Unë do të bëja disa masa që do të ndikonin në përmirësimin e mëtejme të strukturës buxhetore të shfrytëzimit efikas të buxhetit në vitin 2006:

Nën nji, rritja e të hyrave totale në shkallë vendi, çka do të thotë kjo përmirësimin e politikave fiskale dhe ekonomike dhe në nivelin lokal sidomos duhet bërë përpjekje që komunat të realizojnë të hyrat e veta që i kanë deri më tani në kompetencë, këtu tregohet në 9 muaj që kemi një grumbullim të vogël të mjeteve vetanake nga komunat dhe kjo shtron nevojën e senzibilizimit të mëtejme.

Nën dy, decentralizimi i financave në nivel lokal, unë besoj se edhe me nxjerrjen e ligjit për financat lokale do të bëhet një gjë e tillë, por kjo do të bën që komuna do të bëhen më pak të varura nga autoriteti qendror për grante të mëdha dhe ato do të jenë më të angazhuara për të rritur shkallën e të hyrave vjetore dhe buxhetore vetanake, d.m.th një decentralizim i financave lokale.

Nën tre, ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve bazike në lidhje me shpenzimet buxhetore, kjo do të thotë ndryshimi i ligjit mbi financat publike dhe ligjet e prokurimit publik.

Nën katër, ndryshimi i kritereve për ndarjen e grandeve qeveritare, sidomos për komunat.

Nën pesë, zvogëlimi i mëtejme i shpenzimeve deri në nivelin e sigurimit normal të funksionimit të shtetit.

Nën gjashtë, rritja e mëtejme e transparencës buxhetore e cila do të motivonte taksapaguesit për shlyerjen e obligimeve buxhetore.

Unë e mbështes në parim miratimin e këtij Projektligji dhe si anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa do të japim kontributin tonë të mëtejme. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Fjalën e ka Gjergj Dedaj, kurse le të përgatitet Emrush Xhemajli

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ

Faleminderit z. Kryetar, i nderuari z. Kryeministër.

Unë dua ta dijë nga kryesuesi i seancës a po flas në emër të grupit për integrim a si deputet. Unë mendoj se me rregulloren e Kuvendit të Kosovës formimi i grupit të ri parlamentar vetëm njoftohet Kryesia e Kuvendit të Kosovës, Kryesia nuk mund të merr vendim a të pranohet 6 deputetë apo mos me u pranua, a të refuzohen apo jo, ne kemi formuar grupin për integrim dhe më vjen keq që sot mungon deputeti Ferid Agani nga Partija e Drejtësisë i cili është në udhëtim zyrtar sepse ai ka pasur me udhëhequr këtë grup dhe kam pasur dëshirë që ai me qenë këtu por më ka lutur që ta marrë fjalën në emër të këtij grupi dhe me qenë se kam dëshirë ta dijë nga kryetari se a mund të flas në emër të grupit.

Së pari përfaqësuesit e grupit për integrim asnjëri prej nesh nuk jemi në Komisionin për buxhet dhe Financa, po ashtu është me rëndësi që dua t'ju njoftoj se në kohën e kryeministrit Bajram Rexhepi ka qenë 10% lineare për t'i financuar partitë politike dhe më pastaj kjo bazë lineare është lëshuar në 0% dhe unë në emër të grupit për integrim kërkoj që partive të minoriteteve të bashkësive etnike nga buxheti i konsoliduar i Kosovës t'u ndahet 30% baza lineare dhe të gjitha partive tjera 20% baza lineare dhe pjesa tjetër e buxhetit ndahet në bazë të numrit të deputetëve, me qenë se këto mjete nuk jipen për deputet por për infrastrukturën dhe zhvillimin e partive politike dhe kjo ka qenë shumë e padrejtë që të lëshohet në 0% dhe partitë e vogla dhe minoritetet janë dëmtuar dukshëm.

Një çështje tjetër që mendoj se është me rëndësi është edhe problemi i zyrave lokale të komuniteteve, mendoj se ato zyre nuk duhet të shuhen, por përkundrazi duhet t'i inkurajojmë t'i stimulojmë dhe në mënyrë jo paushalle sepse ka diskrepancë, papërgjegjshmëri sepse ka komuna që kanë fare pak minoritete që marrin ma shumë mjete se sa komuna që kanë ma shumë minoritete dhe kjo bëhet një harmonizim në bazë të numrit të minoriteteve nëpër komuna dhe këto zyra duhet të funksionojnë dhe duhet të parashihen në buxhetin e konsoliduar të Kuvendit të Kosovës. Prandaj këto çështje mendoj se janë me rëndësi dhe kërkoj që në të ardhmen partitë e vogla politike të kenë mbështetje lineare dhe kursesi nuk do të pajtohemi që baza lineare e financimit të partive të vogla politike dhe të minoriteteve të jetë në zero, kërkojmë që duhet t'i stimulojmë bashkësitë etnike dhe duhet që baza lineare të rritet në 30%, ndërsa partitë tjera parlamentare 20% dhe pastaj mjetet ndahen në bazë të numrit të deputetëve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Unë e lus seancën që deputetët të rrinë në sallë dhe pastaj do të bëjmë një pauzë, padrejtësisht po më duket që e kam kaluar Aleancën. Fjalën e ka Emrush Xhemajli, kurse le të përgatitet Mazllum Kumnova.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI

I nderuar kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër, tenderuar kolegë deputet. E përgëzoj Qeverinë veçanërisht Ministrinë përkatëse për ekonomi dhe financa që ka sjellur në Kuvend shumë më herët se herët e kaluara Projektbuxhetion e Kosovës për vitin vijues. Të gjithë neve dhe në veçanti Qeverinë duhet ta shqetësoj gjendja e rëndë e

buxhetit të Kosovës. Në kushtet e tashme me këtë buxhet nuk mund të flasim për perspektivë të mirë dhe për zhvillim. Është për të shqetësuar një buxhet që të hyrat nga tatimet e brendshme mezi kapin shumën 126 milion, ndërsa dogana vazhdon të jetë burimi kryesor i buxhetit të konsoliduar të Kosovës, prej 425 milion eurove. Fuqit e rezervuara me buxhetin e varfur për zemërgjerët e Kosovës punojnë pa e pyetur askend me hiq më pak se 200 milion euro, kundrej Qeverisë që i mbeten të punoj me 330 milion. Sikurse të ishte ndjekur një praktikë e stimulimit më të madh të prodhimit edhe ashtu të vogël vendor dhe të shikohen më mirë se si sillen tagrambledhësit ndaj tyre dhe në anën tjetër të ndaleshin veprimtaritë e jashtëligjshme që dëmtojnë ekonominë do të ishte një situatë tjetër buxhetore. Por si duket Qeveria jonë ka pasur shumë vështirësi dhe shqetësime që i ka shkaktuar veti dhe shumë standarde për t'i plotësuar që i kanë vënë nga jashtë dhe nuk ka pasur kohë që të thellohet në politikën që rrisin buxhetin e vendit. Në bazë të Projektbuxhetit të ofruar Agjencia Kosovare e Mirëbesimit është njëri ndër shpenzuesit më të mëdhej buxhetor edhe për vitin 2006, pjesa e mjeteve që i janë ndarë privatizimit në kuadër të krejt këtyre ndarjeve, fjala është te pjesa e privatizimit mbi 3.300.000 euro që është e panevojshme që të merren nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, tash janë privatizuar shumë ndërmarrje për çka AKM-ja ka marrë mjete nga shitja për këto mjete nuk ka kurrfarë transparence, mendojmë se një pjesë e këtyre mjeteve duhet të ndahen që të vazhdojë privatizimi i mëtejshëm, ndërsa shumë e cekur më lartë e buxhetit të konsoliduar t'i kalojë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe të dedikohet me zë të veçantë sepse nuk është ashtu, për familjarët e dëshmorëve dhe invalidët e luftës me qenë se me kohë po shpresojmë se nuk do të sabotohet mëtutje nxjerrja e ligjit për kategoritë e mësipërme.

Ashtu si nuk është e drejtë forma e tashme e ndarjes së pushtetit lokal po kaq e padrejtë është edhe ndarja për komunat e tashme, kjo ndarje është e dëmshme me numër më të madh të banorëve, siç e cekim me të drejtë njëri nga parafolësit, bie fjala ndaj komunës së Prishtinës. Të gjithë neve na kujtohet debati për formimin e pushtetit lokal atë botë që thënë se pilotkomunat nuk kanë implikime buxhetore sepse ato deri sa të jenë pilot do t'i financoj Bashkësia Ndërkombëtare, unë jam befasur kur e kam par në buxhetin e Kosovës se këto pilot komuna i janë vënë në barrë buxhetit të Kosovës i cili edhe ashtu ka pasur rënje, do të ishte mirë rreth kësaj të fundit të epet një sqarim prej ministrit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit, fjalën e ka z. Mazllum Kumnova.

DEPUTETI MAZLLUM KUMNOVA

Z. kryetar, kryeministër dhe ministra.

Fillimisht Projektligji për buxhetin e Kosovës për vitin 2006 që e kemi në dorë mund të konstatojmë se ka shënuar një përpjekje serioze sipas procedurës që të diskutohet si në komisionet e këtij Kuvendi, po ashtu edhe në organizata buxhetore. Vërehet përpjekje më e organizuar për të zbatuar kriteret dhe praktikën ndërkombëtare, zbritje e deficitit, sigurimi i një infrastrukture të domosdoshme, përpjekje për kursime dhe hapje dhe mbështetje prioritetive politike. Gjithnjë jemi para dilemës se si ta klasifikojmë këtë

propozim buxhet, është ky buxhet shpenzues për mbajtjen e një gjendje ekzistuese, pa një tregues që premtion një nxitje të zhvillimit ekonomik të Kosovës, nga ky pozicion një buxhet i tillë nuk do të jetë i mjaftueshëm për t'i përballuar kërkesat gjithnjë në rritje sociale. Skandaloze për mua është që ky Projektbuxhet duhet të pranohet si dokument themelor të cilin nuk e kontrollojmë rreth 17% ose 120 milion. Sipas kësaj është shumë më keq se një buxhet i kushtëzuar i cili është i instaluar që nga viti 1999 me një monitorim të rreptë të FMN-së. Për mua është absurde kur ky buxhet prej 1 euro deri në 700 milion është nga burimet vetanake të Kosovës, askush nuk na ka dhënë hua që na obligon të respektojmë kriteret e imponuara, skandali më i madh është se na merret një shumë rreth 120 milion dhe për këtë nuk mund as të diskutojmë. Nuk ma merr mendja se ka ndonjë teori ose praktikë e tillë në shkencat e ekonomisë që jep shpjegime të tilla.

Duke u nisur nga ky imponim i dhunshëm jo me inat propozoj dy kërkesa:

1. Kemi premtuar se do të merremi me një paketë sociale, më konkretisht zbatimin e një ligji sipas kontributit të punës, me sa shihet edhe në vitin 2006 nuk do ta realizojmë këtë premtim, por fituesit duhet të presin ditë më të mira, nuk është menduar mirë kjo punë, mund të presin 10 trazira sociale, po ashtu edhe ligjet që dalin Rezoluta dhe vlerat e luftës të luftës kërkojnë mbështetje financiare, çfarë të bëjmë.
2. Gjithnjë po kërkojmë pse arsimit të ketë prioritet, jemi në procesin e reformës dhe me asnjë pozicion financiar nuk e kemi mbështetur këtë proces të ndryshimeve, ku shkolla jonë duhet të komunikoj me shkollën evropiane, të jemi pjesë përbërëse e hapësirës arsimore, ndërsa për reformën e pushtetit lokal kemi planifikuar pozicion të veçantë financiar, jemi zotuar se do t'i zbatojmë ligjet. Ligji për arsim siguron tekste falas për shkollat fillore prej klasës së parë deri në të pestën. Nuk e kemi planifikuar në buxhet, kemi dhënë fjalën se do të bëjmë diçka për përmirësimin e statusit ekonomik të mësimit tonë, po ashtu edhe për këtë nuk ka ndonjë tregues financiar, kështu mund të radhiten edhe Akademia e Shkencave dhe Instituti Albanologjik etj. Por jam i vetëdijshëm se ku të sigurohen mjetet, e di hallin e Qeverisë, aq janë mundësitë buxhetore, e kam një propozim shumë të thjeshtë teknik dhe pa dhembje. Propozoj që së paku 10 -15 milion të merren nga buxheti i rezervuar për AKM-në dhe të tjera, arsytimi është shumë i thjeshtë AKM-ja deri në fund të korrikut të vitit 2006 si ka premtuar do të kryej punën më të madhe të privatizimit dhe duhet të ik, atëherë institucionet tona vazhdojnë këtë kompetencë të rezervuar. Pse të ketë një buxhet të njëjtë si në vitin 2005, kërkoni pozicionin për paga dhe mëditje të AKM-së është 2 – 3 herë më i larë se i ndonjë ministrie. Propozimi im është i drejtpërdrejtë që të zbriten 10 deri në 15 milion nga buxheti i rezervuar dhe t'i kalojmë në pozicione të pensionistëve dhe të arsimit. Nëse më përkrahni në këtë propozim edhe unë e përkrah projektbuxhetin. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit, Unë propozoj një orë pushim dhe vazhdojmë në orën 15,00. Ju faleminderit.

(Vazhdimi i punës së Seancës plenare, datë 15.12.2005 – pjesa e dytë – prej orës 15,15).

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Të nderuar deputetë! Kam një lutje për të gjithë ata që kanë qenë të paraqitur për diskutim, të paraqiten prapë për shkak se teknika i ka shlyer emrat e paraqitur më parë. Kjo ka ndodhur, me rastin e procedurës – regjistrimit.

Unë kam për obligim që t'ju informoj që herën e parë Fatmir Rexhepi, ka qenë i pari në listë për të diskutuar, kurse të tjerët, s'i mbaj mend, kështu që jam i detyruar t'ia jap fjalën në fillim, e pastaj sipas radhës të paraqitur – është Afrim Arzuallxhiu. Urdhëroni zotëri Fatmir.

DEPUTETI FATMIR REXHEPI:

Faleminderit zotëri kryesues. Unë, kësaj radhe s'do të reagoj për procedurë, këtë e thatë vetë. Ju përsëhendes të gjithëve.

Më lejoni të jap kontribut në diskutimin për Projektligjin për vitin 2006. Nga leximi i Projektbuxhetit si dhe debatet e shumta, ku edhe kemi trajtuar përgatitjen, hartimin dhe qëndrueshmërinë buxhetore të ofruar për vitin 2006, do të paraqes vlerësimin tim lidhur me disa objektiva kryesore që synohen të arrihen, por edhe dilemat dhe vërejtjet në parim.

Përkushtimi për reformat kah ndërtimi i ekonomisë së tregut dhe krijimin e një ambienti institucional të volitshëm për zhvillim dhe rritje më të shpejtë ekonomike, si synim duhet të shoqërohet edhe me politikën, si në vijim:

- politikën e qëndrueshme buxhetore;
- politikën e investimeve në infrastrukturë publike;
- kufizimet, kursimet dhe shpenzimet e aparatit qeveritar;
- shkallën e investimeve në përmirësimin e edukimit, e të tjera.

Në këtë kuadër, buxheti i projektuar në vlerë prej 656 milion euro, përbën rreth 28% të brutoproduktit vendor, si tregues që është në kufijtë dhe nivelet që japin përvojat edhe nga vendet tjera, e që – Ministria e Financave, me hartimin e këtij Projektbuxheti, vetëm nga të hyrat e brendshme, edhe një herë ka demonstruar kapacitet për të ndërtuar buxhet të qëndrueshëm i cili paraqet faktor të rëndësishëm për stabilitet ekonomik, por të cilit i duhet edhe pjesa e dytë: qeverisje dhe menaxhim më i mirë gjatë vitit 2006.

Sipas mendimit tim, nga çështjet kritike që e tangojnë Projektbuxhetin, janë: problemet me deficitin buxhetor, me rreth 38 milion; ndarjet e treguara për shpenzime kapitale dhe shpenzime për shërbime dhe mallra, ku të hyrat e planifikuara nuk kanë mund t'i përballojnë kërkesat në rritje për investimet kapitale. Prandaj, ky tregues na sjell deri te konstatimi se ekonomia e Kosovës ka nevojë për financim dhe kreditim ndërkombëtar, duke filluar sa më shpejt gjatë vitit 2006 drejt krijimit të qëndrueshmërisë ekonomike të vendit, si dhe plotësim të standardeve për integrimet e tij në institucionet ndërkombëtare.

Dilemë dhe rezervë në vete në këtë projekt, për mendimin tim, është sa ka hapësirë veprimi dhe burimet e reja të mundshme, jo me ngritjen e taksave e tatimeve, por me një organizim dhe disiplinë më të mirë financiare në grumbullimin e të hyrave të brendshme, si dhe detyrimet buxhetore për ndërmarrjet publike, si Posttelekomi i Kosovës, e tjera, që të paguajnë dividendën e tyre e tyre në shumë prej dhjetëra milion euro për vitet e shkuara dhe për vitin 2006.

Të nderuar kolegë,

Nga komentet dhe vërejtjet e mia në draftin e ofruar, në sy të parë, bie – ndarja për ndihma dhe nevojat sociale në shumë prej 130 milion euro, që na tregon për shkallën e varfërisë në vendin tonë, por njëherit edhe për ngarkesën dhe vështirësitë për buxhetin në vazhdimësi si dhe mundësitë e vogla për të ndryshuar parametrat e tjera.

Pastaj, sektori dhe financimi i arsimit, i vlerësuar në vazhdimësi nga të gjitha forumet në vend dhe jashtë tij si prioritet i zhvillimit të vendit tonë dhe nevoja për arsimim bashkëkohor në shumë prej 104 milion euro. Sa e përmbush këtë synim apo duhet të rritet në shkallë tjetër sepse Kosova vazhdon të mbetet me nivelin më të ulët të përfshirjes në regjistrime me shkollim të lartë – me 10-12% gjersa vendet tjera kanë 30%.

Kjo kërkon dhe determinon nevojën për investime dhe zgjerim të kapacitetit që duhet të shikohet në prioritet, por dilema është – si?

Prandaj, unë po pyes Ministrin Haki Shatri se, a lejohet apo si janë praktikatat e ndërtimit të buxhetit në vendet tjera dhe çka ndodhë nëse ndryshojmë parametrat që mjetet e ndara për shpenzimet operative të dedikohen në këtë sektor të caktuar. A mund ta bëjë këtë Qeveria dhe a është në interesin tonë?

Vërejtja dhe mospajtimi tjetër, është financimi i AKM dhe ndërmarrjeve publike në shumën prej 68 milion euro, Meqë AKM tani ka fondin e vet të privatizimit me mbi 150 milion euro.

Unë mendoj se është një situatë e re dhe që AKM pjesërisht ose me shumicën e mjeteve të financohet nga ky fond, ndërsa mjetet e tjera të shpërndahen për ministritë e Qeverisë së Kosovës.

Më lejoni pak të ndalem te Ministria e Planifikimit Hapësinor, ku janë planifikuar 14 milion euro.

Unë do të veçoj nevojën e financimit të një projekti, që është emergjent për qytetin e Gjilanit. Besoj se nuk ka deputet dhe qytetar që nuk ka dëgjuar lidhur me problemin që ka sot Gjilani. Prandaj, është një fazë emergjente që duhet të reagohet në rregullimin e ujërave të zeza dhe Lumit të Dobrushës, të kaskadave, filtrave dhe infrastrukturës që kalon nga pjesa perëndimore e qytetit deri në lindje, që përfshin edhe paralagjën Zabel, Malishevën dhe të tjera sepse për ambientin e qytetarit dhe rreziku shëndetësor vijnë nga ujërat e zeza dhe kjo ndihmë duhet t'i ndahet Gjilanit me milion euro.

Në këtë rast, nuk e shoh këtu Kryeministrin, por nëse vjen, unë do të kërkoj nga Kryeministri t'na njoftoj këtu para Kuvendit se çka ka bërë lidhur me këtë projekt, a është zotimi për këtë projekt, sepse përndryshe unë kujtoj do t'i mbesim borxh Gjilanit, qytetarëve si një pjesë e vendit tonë - ku nuk e kanë këtë rrezik dhe këtë situatë asnjë qytet në Kosovë, sepse njësoj do të reagoja.. Prandaj, kërkoj sqarim nga Kryeministri lidhur me këtë projekt.

Unë vlerësoj se duhet përkrah Projektbuxhetin në parim, sepse është me interes për financimin e veprimtarive të institucioneve vendore.

Meqë ka të bëjë me buxhetin, unë nga kjo foltore këtu – nëse më lejohet edhe për 1-2 minuta, do të shpreh një reagim timin si deputet. Më ka habitur fakti, nëse është e vërtetë, dhe nuk kam pritur një kërkesë publike drejtuar Petersenit nga zoti Surroi – se duhet t'i

bllokohen mjetet Kuvendit të Kosovës për një kohë të caktuar – e të mos nënshkruaj për ato mjete.

Prandaj, si një njeri që pretendon dhe mendoj se ka kapacitet të caktuar të veprimeve demokratike, kjo më ka brejt dhe unë mendoj se kërkesa për një transparencë nga zoti Surroi në Kuvend për çështje që cekur këtu, është krejt në rregull dhe në pajtim me rregulloren dhe ligjin, e unë kujtoj jo për marketing dhe zhurmë publike dhe këtë pjesën e dytë edhe e kundërshtoj - sepse është një cenim i të drejtës së 120 deputetëve këtu që janë, të gjithë administratës së Parlamentit të Kosovës dhe bllokim - do të thotë - i veprimtarisë dhe punës së Kuvendit. Nuk është pra në frymën e asaj për të cilën thash më parë. Prandaj, shpreh reagimin lidhur me këtë, si deputet. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit. Edhe një herë, më duhet ta përsëris, për ata që nuk kanë qenë brenda në sallë - të paraqiturit që kanë qenë në punën e seancës së paradites, le ta shtypin sustën dhe të paraqiten edhe një herë - kuptohet për ata që s'e kanë shtypur deri tash - për shkak se teknika e ka prishur renditjen e listës së paraqitur. Për replikë, është paraqitur Veton Surroi. I keni dy minuta, zoti Surroi.

DEPUTETI VETON SURROI:

Faleminderit zotëri kryetar. Një përgjigje kolegut të nderuar zotëri Rexhepi. Nuk kam kërkuar që zoti Petersen të bllokojë mjetet e Kuvendit. Kam kërkuar që, përderisa mos të sqarohet a ka një vendim legal nga ana e Kryesisë, ose ndonjë trup tjetër të Kuvendit të Kosovës në të cilën jemi sot ne, ky buxhet mos të nënshkruhet. Po kjo nuk do të thotë që mos të ekzekutohet buxheti. Siç e dini, ekziston klauzola sipas të cilës gjatë 60 ditëve të ardhshme ne mundemi me i përdor mjetet buxhetore.

Çështja është kjo. Verifikimi i asaj se a ekziston një vendim legal dhe legjitim për ndërtimin e vilës në Gërrmi mund të bëhet brenda 24 orëve, hiq më shumë. T'i hyhet dokumentacionit, të verifikohet – nëse ekziston vendimi le të vazhdojë, le të procedojë. Unë do të kërkoj falje publike për një kërkesë të tillë. Nëse nuk ekziston vendimi, atëherë do të thotë këto mjete përdoren jashtë kontekstit ligjor. Si të tilla ky Kuvend nuk mund t'i lejojë, pra nuk mund t'i lejojë as zoti Petersen. Vetëm kaq e pata, jo ndonjë intencë tjetër.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit zoti Surroi. Fjalën e ka Afrim Arzuallxhiu, le të përgatitet Besa Gaxherri.

DEPUTETI AFRIM ARZUALLXHIU:

Faleminderit. I nderuari kryesues, të nderuar ministra prezent, kolegë të nderuar. Sot, në diskutimin tim për Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006 dhe autorizimin e shpenzimeve do të mundohem të jam sa më i shkurtër, prandaj edhe do të përqendrohem vetëm në pjesën ku bëhet fjalë për buxhetin për Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Buxheti i paraparë për këtë Ministri, është diku rreth 5 milion e 352 mijë. Në krahasim me 3 milion e 791 mijë sa ka pasur për vitin 2005 shihet se ka një ngritje. Mirëpo, kjo nuk është as përsëafërmi ajo që duhet të jetë dhe atë çka presin fermerët, sepse në këtë vlerë të

paraparë janë vetëm rrogat e personelit të Ministrisë dhe shpenzimet kapitale prej 2.287.000 për themelimin e agjensioneve të nevojshme. Pra, prapë nuk janë paraparë mjete për subvencione në bujqësi, për atë çka bëjnë të gjitha shtetet në botë dhe shtetet në rajon. Prapë, Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me pjesën e vet të buxhetit ka përqindjen më të ulët në rajon – me vetëm 0,76% të buxhetit, çka nuk është rasti me shtetet tjera.

Në këtë Projektligj dëshmohej se bujqësia, në përgjithësi është lënë prapë pas dore – anash. Fermerët vendor prapë nuk do të jenë në pozitë të barabartë me fermerët e regjionit. Prapë kemi mospërfillje të përpunuesve vendor të produkteve bujqësore. Shtrohet pyetja: ku ngelën premtimet që u dhanë gjatë fushatës elektorale, ku me plotë gojë të gjithë premtuat se bujqësia do të ketë trajtim të veçantë, tretman të posaçëm. Shumë shpejt

harruat premtimet. Sidoqoftë, kështu nuk mund të shkohet shumë larg dhe jam i sigurt se kjo mospërfillje do t'ju kthehet si bumerang.

Arsyetimi se nuk ka mjete të mjaftueshme në buxhet për subvencione në bujqësi, nuk mund të qëndrojë. Do të paraqes vetëm një fakt këtu me çka dëshmohet dhe arsyetohet kjo.

Sipas informatave që posedojmë, baza doganore momentale që aplikohet apo zbatohet për produkte bujqësore, është shumë nën nivelin e çmimeve reale. Shpesh ndodh që baza doganore e prodhimit të jetë nën nivelin e çmimit të ambalazhit. Prandaj, mendoj se në këtë lëmi ka hapësirë prej 50 deri në 100% të ngritjes së bazës momentale doganore.

Mendoj se mjetet e krijuara nga rritja, gjegjësisht aplikimi i drejtë apo real i bazës doganore, do të krijohet hapësirë për lehtësi të nevojshme në këtë lëmi gjegjësisht në agrobiznes pa pasur pasoja negative në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Me mosaplikimin e drejtë të bazës doganore, keni lejuar evazion fiskal në buxhetin e Kosovës dhe keni dëmtuar buxhetin e Kosovës me një shumë mjaft të lartë. Nuk di saktësisht sa janë mjetet e shpenzuara dhe sa janë mjetet që janë krijuar me mallin që është importuar nga jashtë? Nëse përafërsisht janë mjetet e krijuara në buxhet diku 100 milion diku 100 milion, atëherë dëmi që keni krijuar në buxhetin e Kosovës, është diku rreth mbi 50 milion. Për këtë, në shtetet normale, dikush sigurisht se është dashur të japë përgjigje.

Me këto mjete të humbura nga ky evazion fiskal, jo vetëm që do të realizoheshin nevojat e bujqësisë për subvencione, do të hapej rruga për stimulime tjera, siç është heqja e tvsh. për produkte bujqësore të grumbulluara nga fermerët vendor, por edhe buxheti i Kosovës do të ishte më i madh.

Fermerët vendor dhe industria përpunuese e produkteve bujqësore, janë në situatë jashtëzakonisht të vështirë dhe këto rrethana ekzistuese nuk do të mund të durojnë më.

Ky Projektligj, pra – pa mjete të nevojshme për subvencione në bujqësi, do të jetë shkas i shkatërrimit të fondit blegtoral, të bujqësisë dhe të industrisë përpunuese në periudhën e ardhshme.

Mendoj se, në rrethanat ekzistuese në Kosovë, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave duhet të jetë shumë më e shpejtë, shumë më fleksibile dhe shumë më adaptabile me situatën. Shumë lehtë është të konstatohet se nuk ka mjete, por mjeshhtëria dhe dëshmia e aftësisë qëndron në faktin se edhe atëherë mund të gjendet alternativa.

Duhet të mundoheni me përkushtim shumë më të madh të shqyrtoni këtë dhe të gjeni mjete apo forma për subvencione në bujqësi. Për ndryshe, do ta merrni përgjegjësinë për pasoja në këtë lëmi që do të jenë jashtëzakonisht të mëdha.

Dhe, në fund – dje kam qenë në një takim të organizuar nga KSDP-ja me shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit – dhe në bazë të diskutimeve që dëgjova dje

nga prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit, mund t'ju them lirisht se – nëse nuk do të ketë subvencione në bujqësi në periudhën e ardhshme, atëherë mund t'ju paralajmëroj që të mos befasoneni se do të ndodhë “mars i 2006-tes”, kësaj radhe “mars i bujqve”. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit zoti deputet. Fjalën e ka Besa Gaxherri. Le të përgatitet Berat Luzha.

DEPUTETJA BESA GAXHERRI:

Faleminderit zoti kryesues. Përshëndes ministrat e pranishëm dhe kolegët deputetë, Para se ta them mendimin tim për këtë Projektligj, dhe në bazë të diskutimeve të kolegëve të mi, dua ta them këtë. Unë nuk dua të them se ky Projektligj jetik për Kosovën është i përkryer. Por dua të them këtë se, sa zemërngushtë më duken kolegët e mi që dalin në foltore – para popullit të Kosovës – dhe të thonë kjo Qeveri është fajtores për buxhetin ekzistues të Kosovës dhe mbahen këtu fjalime filozofike e patriotike dhe akuzojnë pa ndërgjegjen e pastër personale të tyre. Qe një muaj – kolegë të nderuar – ky ligj është në shqyrtim dhe këta kolegë që kanë qaq vërejtje, qaq akuza, përçudi nuk kanë aftësi profesionale, dhe së paku ne s'na kanë ofruar bërjen e ndonjë propozimi konkret për të kontribuar në këtë drejtim, përveç frazave – të thata.

Buxheti për vitin 2006, është përgatitur brenda kornizës afatmesme makroekonomike ashtu si kërkohet me legjislacionin ekzistues. Përparësia kryesore e kësaj qasje është – që pasojat e vendimeve të tanishme mbi politikat fiskale për vitet e ardhshme janë bërë të qarta. Buxheti për vitin 2006 respekton prioritetet e gjëra të politikave të Qeverisë së Kosovës. Tiparet më të rëndësishme të këtij veprimi janë: vetëm një rritje modeste e projektuar të të hyrave që është parashikuar - është pak a shumë në linjë me zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në përgjithësi. Tërësia e propozuar e masave të definuara të politikave për rrjetin e të hyrave, do të ndihmonte në lehtësimin e situatës. Ekziston një mungesë relative e fleksibilitetit në buxhetin aktual, transferet sociale diku 17.0% - shpenzimet e përgjithshme. Pagat – mëditjet janë mjaft të sforcuara; mallrat e shërbimet tanimë iu janë nënshtuar shkurtimeve të mëdha. Është projektuar një nivel relativisht stabil i investimeve kapitale në sektorin publik; deficitin në sektorin publik është rreth 2.0% të gjidipisë dhe është në linjë me rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare.

Njohja e faktit që një balance minimal i kursimeve të mbajtura në llogarinë qeveritare të BPK-ës është e nevojshme për qëllime të menaxhimit të përditshëm të parasë së gatshme. Ashtu si është përgatitur buxheti, e respekton këtë kërkesë.

Nga perspektiva e politikave, veprimi tregon që ekziston problemi i menjëhershëm i përshtatjes fiskale për Kosovën dhe i koncentruar kryesisht në periudhën 2005-2007. Nëse Qeveria mund të menaxhojë këtë me sukses, atëherë me asistencën e komunitetit ndërkombëtar, presioni në llogarinë fiskale mund të lehtësohet.

Kolegë të nderuar,

Përkundër kompetencës së rezervuar, Komisioni i buxhetit ka punuar një muaj – punë intensive në këtë propozimligj dhe vlen të theksohet se Komisioni ka qenë në nivel të detyrës shumë i unifikuar, dhe është bërë një punë profesionale.

Zoti kryesues,

Ta kesh para vetes një ligj, i cili parashikon t’i menaxhosh vetëm 700 milion euro për një vit, megjithëkëto ankesa dhe kërkesa e nevoja që kanë organizatat buxhetore të institucioneve të Kosovës për t’iu dalë ballë gjithë këtyre sfidave që ka Kosova dhe populli i saj, vërtetë është punë e vështirë. Por, populli i Kosovës – ka të drejtë të jetë i informuar në detaje për mënyrën e menaxhimit të taksave të tyre. Dhe, një gjë të tillë, ky ligj e ofron.

Komisioni i buxhetit, ka dhënë vërejtjet e veta në pjesët tekstuale dhe në ato tabelore, me shumë kujdes. Në pjesën tekstuale, duhet bërë disa ndryshime si në preambulë ashtu edhe në përkufizime.

Për të mos marrë kohë, po i theksoj vërejtjet në nenet e caktuara:

Neni 3.2, duhet të fshihet, kemi menduar.

Neni 3.3, të riformulohet.

Neni 6.5 riformulohet.

Neni 6.6 riformulohet, dhe

Neni 8.5. riformulohet.

Ndërsa, te pjesa tabelore, kam këto vërejtje.

Shuma e ndarë për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, është krejtësisht e papranueshme dhe e paarsyeshme, për mendimin tim.

Shuma e ndarë për KEK-un, duhet rishikuar. Ka mundësi dhe duhet, mendoj unë.

Kam një vërejtje edhe tek Ministria e Shërbimeve Publike – tek vija buxhetore – menaxhmenti i inxhinieringut, i cili departament është i caktuar me ligj – të merret me inxhinieringun apo mirëmbajtjen e objekteve të institucioneve të Kosovës, nuk i janë ndarë mjete për këtë qëllim. Fatkeqësisht, janë ndarë pagat dhe të gjitha shërbimet për këtë departament, por ky departament nuk ka çka të punojë, sepse ministritë e caktuara kanë parashikuar që këto mjete për këtë qëllim t’i menaxhojnë vetë. Domethënë, mendoj se këto duhet rishikuar dhe rregulluar.

Unë përmenda vetëm disa vërejtje, për të cilat na obligon ligji, ose ka mundësi që të ndryshohen. Sepse, realisht, të gjitha organizatat buxhetore të Kosovës e kanë shumë vështirë të ballafaqohen me shumat buxhetore kundrejt kërkesave dhe nevojave. Mirëpo, këto janë mundësitë buxhetore të Kosovës dhe mundësi – vërtetë reale.

Dua të theksoj edhe ndarjen e buxhetit të komunat, ku vërtetë në disa komuna, e nuk do ta theksoj komunën time nga vi siç bënë disa kolegë të mi, por është e vërtetë se kriteret të cilat janë përdorur për ndarje buxhetore të kuvendeve komunale, ka mundësi të ndryshohen, sepse padrejtësisht disa komuna janë dëmtuar në këtë drejtim.

Krejt në fund, dua të përgëzoj Ministrinë e Financave, e cila vërtetë ka qenë gjithë kohën prezent ministri apo përfaqësuesit e kësaj Ministrie dhe mendoj se ligji në fjalë duhet të përkrahet dhe si Komision i buxhetit jemi të gatshëm të japim kontributin tonë. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit zonja deputete. Fjalën e ka Berat Luzha, le të përgatitet Fatmire Mulhaxha-Kollçaku.

DEPUTETI BERAT LUZHA:

Fillimisht, do t'ju kisha pyetur, zoti kryesues se sa është serioz ky debat në Kuvend kur mungon Kryeministri dhe pjesa dërrmuese e kabinetit qeveritar. Prej 15 anëtarëve, i kemi vetëm 2 të pranishëm, dhe sa do të ketë vlerë reale ky diskutim?

Të nderuar deputetë,

Duke ditur se planifikimi i shpenzimeve buxhetore ndikon në stabilitetin ekonomik dhe financiar të një vendi si dhe në zhvillimin ekonomik, do të duhej që planifikimi i shpenzimeve buxhetore të jetë në pajtim me nevojat e domosdoshme dhe me potencialin tonë financiar dhe ekonomik. Kurse, në Projektligjin për buxhetin e vitit 2006, nuk është paraqitur plani i të hyrave buxhetore; nuk janë prezantuar nga zyra e revizionit të përgjithshëm auditimet dhe revizioni i njësive buxhetore qeveritare dhe i mekanizmave me kompetenca të rezervuara. Një raport përmbledhës i shpenzimeve buxhetore gjatë vitit që po kalon është mase i domosdoshëm në mënyrë që të shihen se sa dhe ku ka pasur shpenzime racionale apo joracionale; në cilat njësi ka pasur parregullsi dhe keqpërdorime të mjeteve financiare.

Pa një planifikim financiar dhe pa një kontroll rigoroz të mjeteve të shpenzuara, gjithnjë do të kemi buxhet të pakonsoliduar, që do ta shpie vendin në anarki financiare dhe jo vetëm financiare.

Nuk duhet të lejohen mjete pa dhënë llogari dhe pa pasur përgjegjësi për mjetet e shpenzuara, prandaj raportet e auditimit dhe të revizionit duhet të kërkohen domosdo para se të ndahen mjete të reja për njësitë buxhetore.

Nuk është zhvilluar paraprakisht debat publik me grupe qytetarësh, me ekspertë të fushave të ndryshme, me institucione dhe me përfaqësues të njësive buxhetore, me shoqërinë civile e tjera. Madje, nuk janë marrë parasysh as vërejtjet e komunave dhe as vërejtjet e shumta

që kanë ardhur nga terreni për këtë Projektligj, sidomos vërejtjet nga komunat të cilat, shumica prej tyre, ndihen të diskriminuara.

Të theksoj se, për komunën e Kaçanikut, nuk është paraparë asnjë investim kapital për vitin e ardhshëm, ashtu siç nuk ishte asnjë investim as këtë vit që po kalon.

Caktimet buxhetore, janë vendosur në mënyrë arbitrare, me kriterë të dyshimta dhe me kute të ndryshme.

Duke lexuar Projektligjin për buxhetin për vitin e ardhshëm, konstatojmë se ky Projekt është sipërfaqësor, jo i kompletuar nga aspekti analitik dhe mjaft i ngatërruar. Do t'ishte mirë të ishte bërë ndarje e shumës së pagave nga mëditjet në mënyrë që të dihet saktësisht se sa mjete ndahen për pagat dhe sa për mëditjet, dhe se a janë mëditjet reale dhe në përputhje me mundësitë financiare.

Gjithashtu, duhet ndarë mjetet e parapara për mallra e shërbime, në mënyrë që të dimë se cilat janë ato mallra e cilat janë ato shërbime të cilat buxhetit të Kosovës do t'ia marrin plotë 108 milion euro. Cilat janë edhe ato shpenzime kapitale të cilat buxhetit të Kosovës ia marrin jo më pak 141 milion. Kuvendi do të duhej t'i kishte shënimet më të detajizuara rreth këtyre shpenzimeve sepse nuk dihet saktë se kah shkojnë mjetet për këto shpenzime.

E papranueshme është ndarja e më shumë se 200 milion eurove për institucionet e instaluar të UNMIK-ut që në vete mbajnë të ashtuquajturat kompetenca të rezervuara. Kompetencat e rezervuara janë kompetenca të cilat, në bazë të Rezolutës 1244, Serbia ia ka dorëzuar UNMIK-ut ndërsa UNMMIK-u përsëri në marrëveshje me Serbinë nuk ia dorëzon institucioneve të Kosovës. Ky mosdorëzim apo prolongim i kompetencave është duke e dëmtuar seriozisht zhvillimin dhe prosperitetin e shoqërisë kosovare. Kurse, financimi i këtyre kompetencave, nga ana tjetër, është duke e dëmtuar rënd buxhetin e varfër të Kosovës duke ia marrë atij rreth 30% të substancës së tërësishme. Qeveria e Kosovës nuk duhet t'i financojë njësitë buxhetore, të cilat nuk varen nga ajo dhe nga institucionet tjera të Kosovës, sepse – në këtë mënyrë – ne po e financojmë sundimin e të tjerëve mbi ne. Është koha që me bashkësinë ndërkombëtare të ndërtojmë raporte të reja partneriteti dhe jo raporte koloniale.

Duhet pasur parasysh se buxheti i Kosovës mblidhet nga taksapaguesit më të varfër të Evropës dhe nga një shoqëri shumë e pazhvilluar dhe tejet të dëmtuar nga lufta. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit zoti deputet. Fjalën e ka zonja Mulhaxha, le të bëhet gati Sala Ahmetaj.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU:

Faleminderit zoti kryesues. Më mbetet edhe mua që në fillim të konstatoj me keqardhje mungesën, së paku unë po i ceku të dy ministrave të fushëveprimtarisë të cilën e mbulon

Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, do të thotë mungesën e ministrit për shëndetësi dhe ministrit për punë dhe mirëqenie sociale, sepse mendoj që edhe kontributi i tyre sot do të shihej, ose së paku të na i dëgjojnë vërejtjet tona dhe ishte dashur të jenë këtu.

Do të filloj nga një Projektligj, që është Projektligji për vlerat e luftës, i cili më në fund është në procedim në Komisionin tonë. Projektligji tanimë ka pësuar ndërrime të mëdha, besoj pozitive, mirëpo nuk jam e sigurt që Ministria për Financa i ka paraparë implikimet buxhetore të cilat këtu i ngrehin këto ndërrime, domethënë meqenëse këtu është një shumë me deklaratën e parë financiare së paku gjysmë-përgjysmë më e vogël e ofruar ndërsa këto implikime e parashohin shpenzime shumë më të mëdha. Shpresoj se nuk jemi vetëm deklarativisht për një ligj të tillë, por se ai ligj në fakt do të jetë i implementueshëm dhe këtu vihet në pyetje atëherë komunikimi ndërministror, nëse kjo nuk është paraparë.

Do të flas edhe për një çështje tjetër. Në këtë Kuvend, më 7 korrik, janë nxjerrë disa rekomandime drejtuar Qeverisë së Kosovës për çështjen e pensionistëve. Nuk është nxjerrë vendimi i Komisionit por vendimi është i Seancës plenare ku pensionistëve iu premtohen ndihmë, mos të them lëmoshë, prej 6 milion euro në çdo muaj kalendarik të pjesës së dytë të vitit 2005. Në qoftë se deri më sot nuk është ekzekutuar ky vendim, dikush këtu është dashtë të çohet dhe të thotë: a janë a s'janë mjetet dhe a janë paraparë këto mjete për vitin e ardhshëm. Kjo nuk ka obliguar Qeverinë që t'i sigurojë çdo vit tjetër kalendarik, sepse zgjidhja afatgjate parashihet me ligj dhe me fondin që do të krijohet, por kjo ka qenë ndihmë dhe ajo në emër të pensionistëve që kemi presion të madh si Komision të shtrojmë këtë pyetje.

Nën tre: çështja e shëndetësisë. Mjaftoi vetëm një vizitë e vetme – Qendrës Klinike Universitare, mos të them se e njohim edhe situatën gjithkund tjetër, që t'na tregojë se buxheti i këtij viti, të cilin nuk e analizuam, dhe ne së pari kishte dashur ta analizojmë, e pastaj të flasim për buxhetin e vitit tjetër. Të shohim se, ose është një disproporcion i madh i ndarjes së buxhetit me shëndetësi dhe nevojave, ku konstatoam mungesë, jo vetëm pakënaqësitë e personelit shëndetësor por edhe normal të të sëmurëve, por edhe një mungesë totale e të gjitha mjeteve elementare nëse kemi të bëjmë me mbrojtjen elementare që është e drejta e mbrojtjes për jetë, mos të them për shëndet. Aty, zonja dhe zotërinj, shkoni e vizitoni shërbimin intensiv dhe mund t'ju them se nga mjekët në shërbimin intensiv kuptova që shpesh shërbehen, apo të them, bëhen magjistar, sepse iu mungojnë mjetet elementare dhe të mos vijnë në pyetje me bë triazhimin dhe kujt t'i ndihmojnë në rast se ndodhë një fatkeqësi pak më e madhe e komunikacionit. Domethënë, ose kemi disproporcion në ndarjen e buxhetit ose keqmenaxhim total të mjeteve të buxhetit të Kosovës. Atë dikush duhet me konstatuar dhe këtu është vendi. Komisioni ynë e ka marrë një iniciativë të monitorimit të implementimit, por besoj se është detyrë edhe e Kuvendit të Kosovës, në përgjithësi.

Dhe, në fund, kur flasim për Kuvendin dhe buxhetin e Kuvendit të Kosovës. Zonja dhe zotërinj, ka kulminua në këtë ndërtesë mungesa e shumëçkahit. Në qoftë se flitet ndërtimi i një villo "Gërmia", ajo është diçka reprezentative; në qoftë se kemi të bëjmë me një veturë të vetme që kishte me kushtuar 230 mijë, a sa është ajo shuma e famshme – a

mundet deputetëve tjerë në këtë Kuvend t’iu sigurohet së paku transporti deri në stacion të autobusëve. Besoj se s’është kërkesë shumë e madhe. Në qoftë se deputeti, kryetarja e një komisioni, shërbehet me kartelën e vet personale për t’i kryer punët e Kuvendit të Kosovës, ndoshta nuk është kërkesë e madhe e një karte të vetme, kjo nuk është një kërkesë e madhe për sigurimin e një salle për punë më në fund në këtë kërkesë, sepse ne jemi të detyruar zonja dhe zotërinj të punojmë me një intensitet ndërsa pas një ore pune të na trokasim në derë dhe të thonë lirona sallën se tjetërkush ka këtu me krye punë. Këto janë mungesa të kushteve elementare. Në qoftë se flitet në media, le të dihet edhe ana tjetër e modales, se janë benificionet por nuk i gëzojnë të gjithë këtu.

Prandaj, nëse pretendojmë t’i përmirësojmë kushtet në buxhetin e Kuvendit të Kosovës parashihen më në fund kërkesat e shumta që kanë dalë edhe në takimin e kryetarëve të komisioneve dhe nënkryetarëve me Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, ku është paraparë që ndoshta për dhjetë vite të ardhme do t’na përmirësohen kushtet. Ju faleminderoj për mirëkuptim.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit. Fjalën e ka Sala Ahmetaj, le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETJA SALA AHMETI:

I nderuari kryesues, të nderuar kolegë deputetë,
Buxheti për arsim, as për vitin që vjen s’do të jetë më i madh! Ky është lajmi më i keq sot për Kosovën, për fëmijën tanë, për armatën e madhe të arsimtarëve dhe për ardhmërinë tonë, sepse nëse sot nuk investojmë në arsimim – analfabetizmi dhe pseudovlera do t’na kushtojnë shumëfish më shtrenjtë.

Më habit fakti se si është e mundur që Qeveria të mos e shtojë buxhetin për arsim pas gjithë kësaj përbuzjeje që iu është bërë mësuesve të Kosovës dhe pas lojës së turpshme që është bërë me arsimtarët. Si duket, Qeveria ende vazhdon të tallet me ta. Dhe kjo, si shtresa më e dinjitetshme, që me vite të tëra, me idealizëm të paparë e ka mbajtur mbi supe “dramën e quajtur Kosovë”.

Unë nuk mund të bindem se s’ka mundësi për t’u bërë ndryshime në buxhetin e Kosovës për ta rritur buxhetin e arsimit. Por, mësuesit, që sot duhet ta dijnë se s’do të ketë rritje të pagave. Dhe, tani pyesim: ku është sindikata e arsimit? Ata s’duhet t’i mashtrojnë arsimtarët për greva në muajt që vijnë.

Ne, kërkojmë publikisht tani shtimin e buxhetit për arsim dhe kërkoj përkrahje edhe nga kolegët e mi deputetë në mënyrë që, duke bërë korrigjime të mundshme me qëllim që të bëhet një shpërndarje më e arsyeshme e buxhetit, sidomos për fushën e arsimit nga mjetet e parapara për mallra dhe shërbime nga buxheti i rezervuar ose edhe nga buxheti për KEK-un.

Një çështje tjetër, që do ta shtroj, është edhe buxheti i paraparë për Ministrinë e Kulturës. Ky buxhet tregon se sa pak rëndësi i kushtojmë ushqimit shpirtëror – kulturës. Ndoshta, bën edhe pa të, por do të shndërrohem në diçka tjetër.

Projekte të caktuara nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Kulturës nuk na duket se janë bërë me seriozitetin që kërkon momenti. Disa çështje janë tejet të rëndësishme për t'u paraparë në projekte të këtyre ministrie. Për shembull, ndërtimi i objektit të operës, për operën dhe filarmoninë e Kosovës. Duket anakronike të miratohet një ligj për operën, e të mos jetë paraparë nga këto ministri ndërtimi i shtëpisë së operës. Si do të veprojnë dhe punojë institucioni i operës dhe filarmonisë në këto rrethana? Në këtë kohë që po synojmë të bëhemi shtet, duket domosdoshmëri ta kemi shtëpinë e operës dhe baletit – që janë institucione të cilat duhet të përfaqësojnë vlera kulmore të një shoqërie civilizuese. Sot në Kosovë gjenden mjete për t'u shfrytëzuar për pseudovlera dhe në mënyrën më të papërgjegjshme të mundshme, siç janë rastet për mjetet shpenzuese për mallra e shërbime.

Unë, i lus kolegët e mi deputetë që ta përkrahin këtë kërkesë për të bërë disa ndryshime në projektet e Ministrisë së Kulturës dhe të arsimit, me qëllim që të sigurohen mjetet për shtëpinë e operës, në mënyrë që të kemi një vend të denjë në të cilin do t'i promovojmë vlerat artistike. Shtëpia e operës nënkupton edhe shtetësinë. Ta bëjmë atë bashkë me shtetin.

Për shembull, disa projekte të parapara nga Ministria e Kulturës mund të presin, siç është Projekti për qendrën kulturore ose edhe ai i Teqës së Bektashive. Ato mund të presin, jo pse s'janë të rëndësishme, po pse në Kosovë, në të gjitha komunat, janë shtëpitë e kulturës të cilat ka mundësi të shfrytëzohen më mirë dhe me këto mjete do të mund të bëheshin projekte të tjera të rëndësishme, siç është ai për ndërtimin e shtëpisë së operës. Ju faleminderit për vëmendjen.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit zonja deputete. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputetja Safete Hadërgjonaj.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe ministra të pranishëm, Shqyrtimi i buxhetit për vitin 2006 në Kuvend paraqet një mundësi të mirë për të shikuar dhe vlerësuar mundësitë tona buxhetore, por duhet të jemi konkret dhe duhet të jemi real e objektiv rreth kësaj çështjeje, sepse dëshirat dhe mundësit nuk janë çdoherë të barabarta dhe të realizueshme.

Vlen të veçohet fakti se ky buxhet i Kosovës është shumë më i mirë në shpërndarje të shfrytëzuesve buxhetor sesa ai i mëparshmi, andaj ana tjetër pozitive e këtij buxheti është

se në tërësi sajohet nga të hyrat vetanake, çka është një garanci e madhe se Kosova mund të ketë në këtë drejtim qëndrueshmëri shtetërore.

Në kuptimin e përgjithshëm, ligji mbi buxhetin miratohet në çdo vit kalendarik dhe si i tillë, unë mendoj, edhe ky propozimligj i plotëson kriteret për t'u aprovuar, nga se është i një rëndësie të veçantë, ndonëse i mungon programi i kursimit, programi i pensioneve, i mungon arsyetimi i shkaqeve që ka ndikua në mosrritjen e buxhetit, dhe disa vija buxhetore ndoshta nuk është dashur të ekzistonin fare.

Në analizën e rrafshit buxhetor, në nivelin e pushtetit lokal, do të qëndrohem pak shkurtimisht në qytetin nga vi, fjala është për Mitrovicën, sepse ato të përgjithshmet veç u theksuan.

Duke u mbështetur në miratimin e kufijve final të buxhetit të komunave, i paraqes disa vlerësime mbi reflektimin dhe pasojat e ndarjes së buxhetit për vitin 2006 për Mitrovicën. Mitrovica, në granden e përgjithshme për komunat, merr pjesë vetëm me 5% - sa marrin pjesë disa komuna shumë më të vogla me numër të popullsisë, nëse është i vetmi kriter, kur dihet se Mitrovica ka mbi 150 mijë banorë.

Dy. Buxheti i Mitrovicës, menaxhohet prej administratës komunale me vetëm 73% kurse nga administrata e UNMIK-ut, në veri – 27%, e në këtë pjesë të buxhetit Kuvendi i komunës as që ka qasje për siç është: buxhetin e paraparë për spitalin rajonal, për arsimin, për “Trepçën” e tjera. Formulatat, gjegjësisht metodat e parallogaritje të grandeve për komuna, mendoj se duhet të begatohen edhe me elemente tjera shtesë, duke marrë për bazë edhe specifikat e qyteteve dhe në veçanti të Mitrovicës që ndryshon nga çdo komunë tjetër me pjesëmarrjen e saj në këtë drejtim.

Do ishte mirë të mundësohet vjelja e taksave komunale - nga rastet e transaksioneve të shitblerjes së pasurive të paluajtshme si dhe taksat e trashëgimisë dhe të faljes, pastaj tarifatat rreth regjistrimit të automjeteve e tjera, si dhe të dënimeve nga gjykata – me pjesëmarrje më të madhe.

Buxheti i vitit 2006 nga grandin e mbulon vetëm kategorinë e pagave të komunave, dhe pjesërisht kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, kurse pjesa tjetër mbulohet nga hyrjet vetanake, në dëm të investimeve kapitale.

Shikuar në tërësi, unë mendoj dhe për këtë paraqes kërkesë që duhet të kemi qasje më të madhe te komunat në ndarje dhe alokim të mjeteve nga dënimet në trafik si dhe format e kërkuara të alikuara më parë.

Dhe, duke përfunduar këtë, mendoj se mbështetur në të gjithë atë që u tha më lartë dhe që u tha nga diskutuesit tjerë, kërkojmë që grandeve komunale për buxhetin 2006 t'u bëhet edhe një shikim i veçantë buxhetor nga grandin e Qeverisë për shkak të balancit të buxhetit komunal, duke ditur dhe vlerësuar realisht forcat ekonomike dhe financiare, në veçanti të komunës të Mitrovicës, e cila ka specifika shumë-shumë të veçanta nga komunat tjera, për

të cilat edhe jeni të informuar. Ju falimenderoj duke shpresuar se në këtë drejtim do të ndërmerret diçka në procedurën e mëtutjeshme kuvendore. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ramadan, faleminderit. Jam i informuar se duhet ta marrë fjalën Safete Hadërgjonaj, dhe le të bëhet gati Ragip Zekolli.

DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ:

Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuar deputetë, Do të kishte qenë mirë që pasi po mungon Kryeministri dhe të gjithë ministrat, të ik nga këtu edhe ministri i financave dhe ne t'i flasim njëri-tjetrit. Bile-bile, të them se t'mirë shumë e kemi buxhetin në krahasim me Qeverinë dhe me interesimin e saj për t'i bërë realitet projektet të cilat ajo i ka paraparë.

Buxheti është një dokument ku materializohet aftësia e çdo qeverie për të programuar e menaxhuar tërësinë e burimeve financiare publike në favor të mirëqenies apo të ritmeve më të larta të qëndrueshmërisë ekonomike. Ky dokument, që na është ofruar, është hartuar sipas një praktike rutinë, që krijon përshtypjen se edhe sot duhet të miratohet në Kuvend si pjesë e kësaj rutine.

Në Projektbuxhet duhet argumentuar përse janë vendosur treguesit dhe si e përmes çfarë rrugësh do të garantohet arritja e treguesve të projektit. Deputetët nuk disponojnë me analitikën e shpenzimeve por nuk jemi të njoftuar as me analitikën e të hyrave buxhetore.

Thuhet se ky Projektbuxhet është bazuar në kornizën afatmesme buxhetore. Deputetët, nuk e kanë marrë këtë kornizë së bashku me Projektbuxhetin. Nuk i kanë bërë analizë se sa është e besueshme kjo kornizë afatmesme, si janë trendët fiskale, sa janë reale supozimet makroekonomike, sa është real projeksioni i të hyrave buxhetore, si menaxhohet deficitit buxhetor dhe njëkohësisht t'i bëhet analizë strategjisë së shpenzimeve buxhetore.

Në kornizën afatmesme buxhetore 2006-2008 thuhet se rritja reale e gjidipisë pritet të arrijë në rreth 1 deri 3% në vit, sa zgjatë ky projeksion, gjë që, është plotësisht në kundërshtim me programin e qeverisë që synonte që deri në vitin 2006 rritja ekonomike të ngrihej nga 1 deri në 3% - në 4 deri 6% dhe pastaj të hyhet në zonat e rritjes dinamike të gjidipisë mbi 7%. Bazuar në parashikimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, do të ketë rënie të gjidipisë për 0.5% në këtë vit, që do të kthehet në 2.5 në vitin 2006.

Treguesit negativ janë krejtësisht real me këto institucione inerte, të izoluara, që nuk respektojnë ligjet as parimet etike, nuk janë transparente, abuzojnë me mjetet publike.

Bazuar në raportet periodike, e sidomos në raportin nëntëmujor të buxhetit të vitit të kaluar, që u miratua me deficit që kishte arritur 4.7% të brutoproduktit vendor, shihet se nuk janë arritur objektivat e parapara në realizimin e të hyrave. Atëherë, buxheti i vitit

2006, që po miratohet me një deficit 43.8 milion euro, është një brengë serioze për të gjithë. Ky buxhet, është buxhet i territ të plotë informativ, ku Ministria e Ekonomisë dhe Financave ndërron pozicionet pa përfillur ministritë apo komunat. Është shqetësuese se si Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, pa kurrfarë konsultimi me njësitë buxhetore, i heq nga paga punëtorët me kontrata, ulë pagat apo i heq projektet kapitale. Nëse duhet të bëhen reduktime, atëherë duhet të ketë kritere, e jo të përdoret shkopi politik.

Kur përfundon së analizuari këtë buxhet, vjen në përfundim se është buxhet sa për të mbijetuar, që rrezikon të futet në krizë, e kurrësi një produkt serioz për t'i realizuar prioritetet e programit të Qeverisë për rritjen e mirëqenies së qytetarëve, për mbështetjen e arsimit dhe shëndetësisë, rritjes së infrastrukturës.

Në tabelën 1, shohim se të hyrat janë 656.2 milion euro. Këto të hyra do të ishin shumë më të mëdha, sikur Qeveria të sillte progres në sistemin e administrimit fiskal, sidomos në luftimin e vazhimit fiskal, në krijimin e kulturës fiskale dhe në përmirësimin e klimës në favor të biznesit – objektiva të cilat ia ka parashtruar vetes me programin e Qeverisë.

Mirëpo edhe treguesi i të hyrave, lë bazë për dyshim, sepse 64.81% e të hyrave sigurohet në kufi, kurse 19.23% nga tatimet e brendshme, gjë që tregon edhe një dështim të Qeverisë krahasuar me premtimet e dhëna në programin e saj për rritjen e tatimeve që kanë origjinën në akvitetet ekonomike. Premtimet e Qeverisë ishin se do të bëjë më shumë në politikën doganore, që kjo politikë të fillojë të kalojë në politikë doganore mbrojtëse, ashtu që të aplikohen lehtësi doganore për importin e pajisjeve për investime, si dhe tvsh. për këto pajisje të paguhet më vonë e jo në kufi. Përkundrazi, nuk është bërë asgjë për të tejkaluar asimetrinë doganore ndaj vendeve fqinje për mbulimin më të mirë të kufijve. Atëherë, treguesit e të hyrave buxhetore do të ndryshonin dukshëm.

Të nderuar deputetë,

Në tabelën 2, është bërë shkelje e Kornizës kushtetuese, sepse ka titulli 9.1.7 definojnë Kryesinë e Kuvendit si organ më të lartë të përbërë prej 8 anëtarëve, e jo kryetarin.

Ndërsa, pika 9.1. përcakton përgjegjësitë e Kryesisë. Kodi buxhetor, kryetari i Kuvendit duhet të jetë Kryesia e Kuvendit. Në këtë kod, paga mesatare për 10 punëtorët e stafit të kryetarit të Kuvendit është 1.162 euro. Kështu, kryetarit të Kuvendit i vihen në dispozicion 460 mijë euro dhe i jepet hapësirë për të keqmenaxhuar me buxhetin prej 7.530.999 euro.

Se ku qëndron arsyeshmëria e projektit kapital, siç thuhet për vila "Gërmia", që do të kushtojë 1.590.633 euro – llogaritur edhe shpenzimet tepër jotransparente të këtij viti për këtë projekt, ku sipas raportit nëntëmujor janë shpenzuar 504.749 euro dhe janë zotuar edhe 246.032 euro, le të vlerësojnë deputetët e këtij Kuvendi arsyeshmërinë e këtij projekti. Kryetari i Kuvendit, nuk është ngop as me blerjen e veturave dhe janë paraparë 250 mijë euro për blerje veturash. Zyrës së kryetarit i është rritur buxheti nga 2.274.844 euro në 3.148.970 euro. Kjo zyrë, me 50 punëtorë, vetëm në mallra dhe shërbime ka 1.111.600 euro, që secili punëtor për një muaj mund të shpenzojë 1.853 euro e që do të thotë dhjetë paga mujore të mësimdhënësit.

Në kategorinë – shpenzimet kapitale, janë paraparë 1.400.000 euro të parapara si shpenzime kapitale për “Shtëpinë e bardhë” dhe 400.000 për transportin special. Për tu ndarë këto mjete, ne duhet të dimë se pronë e kujt është rezidenca e presidentit dhe të dimë se çka nënkuptohet me udhëtim special të kryetarit, që si shpenzim kapital i kushton 400.000 euro në këtë buxhet - të varfër të Kosovës.

Buxheti i zyrës së Kryeministrit, është shtuar nga 2.470.818 euro në 2.978.563 euro. Vetëm kabineti i Kryeministrit, me stafin prej 28 vetash, është paraparë të harxhojë 930.462 euro, kurse për mallra dhe shërbime janë paraparë 1.571.500 euro ku secili punëtor mund të harxhojë për një muaj 818 euro. Është e palogjikshme që, saherë që Kryeministri të ndërrojë zyrën, të pajiset me teknologji informative të re dhe me orendi të reja, kështu që shuma prej 198.100 euro - në emër të shpenzimeve kapitale - duhet të orientohet në projektet për përmirësimin e cilësisë së mësimin në shkolla.

Edhe pse buxheti i Ministrisë së Arsimit është rritur për 4 milion euro, që kryesisht është orientuar në vijën buxhetore arsimit i lartë, nivelet tjera të arsimit kanë mbetur në pozicione të njëjta, e po ashtu edhe granti për arsim në komuna mbetet i njëjtë.

Mësimdhënësit, nëse miratohet ky buxhet, duhet të kënaqen me 7 euro të shtuara të pagave të tyre, kështu që Qeveria nuk ka arritur të ngritë nivelin e jetesës së mësimdhënësve dhe as cilësinë e procesit mësimor.

Në anën tjetër:

- zvogëlohet buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë nga 52.188.441 euro që kishte në këtë vit, në 48.544.000 euro për vitin 2006;
- Granti në shëndetësi, në komuna, mbetet i njëjtë, pa llogaritur gjendjen e vështirë në shëndetësinë kosovare;
- Kuvendi i Kosovës ka marrë vendim që në korrik të këtij viti të ndahen 6.000.000 euro për këtë vit për pensionistët dhe të shikohet mundësia edhe për vite tjera. Hartuesit e buxhetit nuk kanë marrë parasysh vendimin e Kuvendit, nuk janë paraparë mjetet sipas këtij vendimi;
- Nuk është caktuar mirë hierarkia e prioriteteve për investime kapitale. Është bërë dublifikimi i shfrytëzuesve buxhetor të Qeverisë dhe fuqive të rezervuara që buxhetit të Kosovës i kushtojnë miliona euro;
- Nuk garantohet realizimi i projekteve të rëndësishme, në mungesë mjetesh;
- Nuk ka paraparë mjete për implementimin e ligjeve që do të miratohen në këtë Kuvend dhe ne do të vijmë në pozita të palakmueshme duke miratuar ligje që nuk do të implementohen për shkak të implikimeve buxhetore;
- Me këtë buxhet, Qeveria nuk do t’i përmbushë obligimet e veta që i ka paraparë në programin e saj, ashtu sikur nuk i përmbushi as në këta 12 muaj që shkuan.

Duke u bazuar në

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Ragip Zekolli, le të bëhet gati Zef Morina.

Para se të filloni, një demant. Do t'ishte kënaqësi e madhe sikur të kishte aq shumë buxhet Kosova dhe zyra e Kryetarit të Kuvendit ta kishte atë buxhet. As 10% të asaj nuk ka, diku vetëm 5% është e vërteta. Prandaj, unë përshëndes diskutimin e Besa Gaxherri, që e kam përcjell me vëmendje gjithherë dhe është mirë t'u lihet kohë të gjithëve dhe ju lutem mosni në këtë mënyrë, sepse opinioni po na përcjell dhe pa faktografi mos flisni ashtu, sepse vërtetë s'ka kurgjo të përbashkët me atë që thuhet. Urdhëroni Ragip.

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI:

Faleminderit për fjalën e dhënë, zoti Kryetar.

Unë desha të bisedoj lidhur me buxhetin për arsim dhe atë në radhë të parë duke u bazuar në Ligjin e parë që është miratuar në këtë Parlament, përkatësisht i nënshkruar më 31 tetor 2002, ku në këtë Ligj, tek neni 3 – e drejta për arsim, citoj, thotë se “tekstet mësimore-shkollore të nivelit të parë janë falas, ndërsa për nivelin e dytë dhe të tretë i ndanë Qeveria, nëse ka mjete”.

Kërkesa ime është që vërtetë, duke parë se po hyjmë në reformë shkollore dhe në ndryshime, ato mund të ecin përpara atëherë kur të gjithë qytetarëve, të gjithë fëmijëve mund t'iu garantojmë këto tekste për arsye se në një analizë të bërë del se në viset kodrinore-malore më shumë se 30% të fëmijëve nuk i kanë këto tekste në duart e veta.

Çështja tjetër, që mendoj se e vlen gjetje të formave të ndryshimit, është çështja e buxhetit kapital në sferën e arsimit. Në këtë vit, që po e lëmë mbrapa, nuk ka pasur fare buxhet kapital për arsim, ndërsa 87 shkolla në Kosovë punojnë në tri turne. Kur them se punojnë në tri turne atëherë asnjëri nga nxënësit nuk mund të qëndrojë më shumë se dy orë e gjysmë përkatësisht tri në shkollë dhe nuk mund të arrihen suksese në mësim, andaj do t'ishte mirë që edhe këtu të krijohet një prioritet, edhe pse në këtë vit është paraparë – po flas për vitin 2006 – që në Ministrinë e Arsimit, përveç ndërtimeve që janë duke u bërë - të jenë vetëm 4 milion buxhet kapital.

Me keqardhje më duhet të them, por këto prioritete – jeni dëshmitarë të gjithë, dhe ta përmend një rast kur pikërisht për t'u ndërtuar një shkollë nxënësi është bërë kurban – e kanë ngrënë qentë deri në përfundim dhe kanë mbetur vetëm kockat e atij fëmije e pastaj të ndërtohet shkolla!

Çështja tjetër, për fat të keq po them, në këtë vit kemi pasur rastin kur rryma të vetmen shkollë që është ndërtuar e ka djegur, edhe tash ndërtohet.

Andaj, unë mendoj se me një pozicionim që mund të rishikohej, për mendimin tim, po them në këtë rast faktori social në Kosovë apo të bëhej një komision ad-hoc që të shikojë këto rrjedha – mund të bëhet diçka më shumë dhe mjete më të mëdha të ndahen në sferën e buxhetit kapital për arsye se kriteret me të cilat ballafaqohemi ne janë kritere tejet të rënda dhe sidomos shkollat të cilat, sikur që thash – punojnë në tri turne. Ju faleminderit zoti Kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Zef Morina, le të bëhet gati Genc Gorani.

DEPUTETI ZEF MORINA:

Faleminderit zoti Kryetar.

Në elaborimin e Projektbuxhetit nga ana e ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe të financave, i orientuar sipas kërkesës së agjencioneve shpenzuese – ka një përparim në përgatitje teknike të materialit, por jo edhe të vlerës së buxhetit.

Është e kuptueshme se Kosova, me këtë ekonomi që ka, nuk mund të ketë buxhet më të lartë, duke pasur parasysh se rreth katër të pestave të të hyrave janë nga doganat, gjë që është njëjtë sikur kur bujku duke shpresuar se do të bjerë si dhe duke u lutur që të mos bie breshër – rendimentet do të jenë të larta. Vërtetë, është një buxhet i varfër, por me një ndarje dhe menaxhim të drejtë, nuk do të jetë shumë i dukshëm dhe të konsiderohej, siç e quajtnë parafolësit buxhet fukara.

Shpërndarja e mjeteve buxhetore sipas agjencive shpenzuese, është dashur të jetë në mënyrë më të drejtë, duke i dhënë përparësi sistemeve kryesore të vendit, siç janë: arsimi, çështjet sociale, shëndetësia dhe infrastruktura.

Vërtetë, është e pakuptimtë që vetëm në raste kur paraqiten protesta, greva ose probleme, qoftë të sindikatave qoftë të qytetarëve – atëherë Qeveria dhe institucionet të orientohen se si të dalin nga kjo krizë.

Për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, këtë vit parashihen rreth 28 milion euro, aq sa kanë qenë edhe vitin e kaluar – pra vitin 2005. Ndërsa, qytetarët, që nga janari i vitit 2005 paguajnë taksën rrugore prej 50 eurove për regjistrim të automjeteve nga e cila shumë grumbullohen rreth 15 milion euro, sepse në Kosovë konsiderohen të jenë rreth 300 mijë automjete dhe ato i shumëzojmë me 50 euro – do të bëjnë 15 milion euro.

Në prioritetet e Ministrisë, sipas Projektbuxhetit parashihet që bashkëfinancimi me kuvendet komunale dhe komunitetet të jetë vetëm 1 milion euro, gjë që është shumë gabim, sepse kemi mbi 50% të infrastrukturës rrugore, e cila është e kategorisë së rrugëve lokale dhe se qytetarët edhe pse paguajnë taksën rrugore për ato rrugë, ato nuk i shfrytëzojnë dhe nuk kalojnë në rrugë të ndërtuara si duhet.

Për këtë arsye, mendoj se buxheti i Ministrisë, në vend që të jetë më i lartë për infrastrukturë, është më i varfër për shkak të politikës së gabuar nga ana e stafit të Ministrisë.

Kemi edhe një shembull, e t' mos merret si subjektiv, por më duhet ta them, sepse për qëllime politike - jo të partisë së tij - por të disa personave domethënë shumë të vegjël të PSHDK-ës, një rrugë e cila është shpall të ndërtohet në vitin 2003 dhe është rruga Gjakovë-Qafë Prushi, e cila është inauguruar në vitin 2004 së bashku me presidentin Rugova – qytetarët e asaj pjese me vetëdëshirë i kanë grumbulluar 108 mijë euro dhe 30 mijë franga zvicerane për të bashkëfinancuar, ndërsa gjatësia e rrugës është rreth 11 kilometra, vlera e së cilës ka qenë rreth 1.8 milion euro, ministri shkon në një vizitë dhe iu thotë se ato mjete duhet t'i tërhiqni nga xhironlogaria, edhepse ato kanë qenë mase dy vite të deponuara për këtë qëllim. Këtë e ka bërë, vetëm e vetëm që t'i mbështesë ata persona të cilët dëshirojnë që të bëjnë propagandë gjëja se ministri nuk ka pasur të drejtë të kërkojë ose bashkë me komunitet dhe komunitetet të ndërtojnë sa më shumë rrugë për të mirën e qytetarëve të Kosovës.

Dëshiroj të them diçka edhe lidhur me buxhetin e partive politike. Kryesia e Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës, është indinjuar me veprimin e Kryesisë së Kuvendit për ndarjen e mjeteve të buxhetit të vitit 2005. Meqenëse këto mjete janë të dedikuara për aktivitetin e partive politike, mendoj se këto mjete është dashur të ndahen në mënyrë të drejtë, bazuar në Rregulloren dhe në vetë vendimin e Kryesisë së Kuvendit.

Prandaj, shpresoj se këtë vit, ndarja do të bëhet ashtu si duhet dhe dëshiroj t'ju njoftoj se ua kam dërguar një shkresë që është vendim i Kryesisë së Partisë Shqiptare Demokristiane që vërtetë Kryesia e Kuvendit të jetë më e drejtë në vendimet që merr kur është në pyetje aktiviteti i mbarë partive politike qoftë edhe i deputetëve të Parlamentit dhe ata të cilët e shfrytëzojnë buxhetin e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën zoti Genc Gorani, le të bëhet gati Bajrush Xhemajli. Më parë profesor Mark Krasniqi paraqitet për fjalë. A është replikë, a? Po s'ua ka përmendur emrin, ka thënë Partia Partia Demokristiane Shqiptare. A doni të merrni fjalën? Po, atëherë urdhëroni. E ka fjalën profesor Mark Krasniqi, replikë.

DEPUTETI MARK KRASNIQI:

Është një e thënë popullore: “mos e nguc grajzin me krane se e nguc të zezën tande”. Zef Morina, u paraqit këtu dy herë në emër të Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës. Dihet edhe nga gazetatat, edhe nga mjetet e tjera të informimit se Zef Morina për malverzimet që i ka bërë – edhe në Parti, por edhe në Ministri, është i përjashtuar nga Partia Shqiptare Demokristiane.

Ai duhet të frikësohet nga Guardia di financa, jo nga buxheti i varfër për Partinë Shqiptare Demokristiane të Kosovës. Kryesia e Parlamentit e ka shkresën zyrtare prej Kryesisë legale që 14 vjet, që Zef Morina nuk e përfaqëson Partinë Shqiptare Demokristiane në këtë Kuvend. Bile, kërkohet që të përjashtohet edhe nga Kuvendi siç është përjashtuar edhe nga Partia dhe nga Ministria e Transportit. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor, ju faleminderit shumë, respekt por deputetët nuk i përjashtojmë ne, sepse është procedurë tjetër. Edhe buxheti i ndahet partisë që është e regjistruar, prandaj do t'i rregullojmë në ndërkohë bashkërisht këto. E ka fjalën Genc Gorani, le të përgatitet Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI GENC GORANI:

Ju faleminderit zoti Kryetar.

(Ndërhyrje, pa kyçje të mikrofonit – nuk dëgjohet qartë për transkriptim)

Po, ju faleminderit! I nderuar zoti ministër, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, Kisha dashur t'i cek vetëm disa vërejtje dhe të mos marr shumë kohë, në veçanti duke marrë parasysh se shumë prej parafolësve të mi kolegë deputetë kanë përmendur çështjet shumë të rëndësishme për çka ka të bëjë ky buxhet me fushën e arsimit dhe të kulturës.

Pikësëpari, kisha dashur të ritheksoj se buxhetit i mungon një vend analitik, që për konsekuencë ka që i mungon transparenca. Çdo tentativë e analizës më serioze të buxhetit has në një opacitet – një mëshehtësi në bazë të titujve si: mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere. Është e pamundur të japim një vlerësim sadopak profesional mbi atë se çka mëshohet pas këtyre titujve.

Çështja tjetër, është drejtpërsëdrejti e lidhur me arsimin. Nuk kisha dashur të përsëris temat të cilat parafolësit e mi dhe anëtarët e Komisionit, të cilit i përkas, i kanë thënë tashmë. Më lejoni vetëm që, për ilustrim, t'i përsëris – t'i them disa shembuj.

Në Prizren, ne kemi shkolla që nuk punojnë vetëm në tri turne, por kemi shkolla që punojnë me katër turne. Vogëlushët tanë duhet t'ia nisin mësimin në orën 7 të mëngjesit. Rrallë diku tjetër mund të gjejmë s shembuj të ngjashëm, aq më tepër që kanë të bëjnë me një kategori të njerëzve prej të cilëve ne presim shumë e faktikisht duhet të investojmë në ta nëse edhe presim diçka prej tyre.

Në këto shkolla, ku punohet në katër turne, nuk punohet... Madje kemi një fenomen tjetër kur ora e mësimin nuk zgjatë 45 minuta, siç është dashur të jetë në minimum, por zgjatë vetëm 30 minuta dhe kjo ndodhë në qendër të Prizrenit. Jam mase i sigurt se edhe në shumë qendra, e fshatra tona, ndodh e njëjta gjë.

Nuk mund të konsiderohet ndarje e buxhetit për arsim – shpenzim i thjeshtë. Duhet të hyjë dhe ta kuptojmë si investim dhe ta trajtojmë si të këtillë, dhe këtë aktivitet ta trajtojmë si një investim i cili do të ketë kthime shumë të rëndësishme për ne. Për ndryshe, mbyllemi në një logjikë ku themi se shpenzojmë e nuk dimë se ku del, ku vjen domethënë përparësia e këtij shpenzimi.

Po ashtu, në kushte normale dhe atë s'po flas për shtete shumë të zhvilluara evropiane, por shtete të cilat na rrethojnë, si Shqipëri, Maqedoni – së paku t'iu sigurojmë vogëlushëve tanë një transport që të mos iu ekspozohen rreziqeve të trafikut në rrugët tona të pazhvilluara dhe të rreziqeve tjera të sigurisë. Po e marr shembullin në Maqedoni, në rrethinë të Tetovës, e kemi transportin e siguruar për fëmijë dhe të cilëve iu mundësohet ardhja me kohë në shkollë dhe kthimi në gjirin familjar. Ne këtë s'e kemi.

Mund t'ju tregoj nga shembulli personal, por të gjithë e keni këtë, në të gjitha regjionet e Kosovës – ende shohim fëmijë të cilët e ndajnë rrugën, shtegun e tyre për shkollë me maunat, makinat tjera, me agresivitetin tonë që e kemi të njohur në rrugë dhe ata shkojnë në shkollë ndërsa ne të tjerët i spërkasim, i gjuajmë me lloç dhe kjo ndodhë atje. Pse? Sepse, për ne duket se prioriteti nuk është aty: duhet të ndërtojmë KEK-un, duhet të ndërtojmë dhe investojmë në kapitale jashtëzakonisht të mëdha, kurse aty ku duhet investim i vogël dhe i cili investim do ta përmirësonte jashtëzakonisht shumë kualitetin e jetës – atë thuaja se e harrojmë.

Në kuadër të sistemit të arsimimit ne duhet t'i prioritetizojmë sendet si duhet. Duhet të investojmë, dhe ky investim duhet të bëhet sa më parë. Unë shpresoj jashtëzakonisht shumë që në kuadër të Komisionit funksional, do t'na jepet rasti edhe pse më duket jemi pak si vonë që disa prej rekomandimeve t'i bëjmë kolektivisht si Komision funksional dhe që këto t'i argumentojmë sa më mirë, sepse besoj shumica prej nesh e pranojnë këtë argument dhe s'jemi kundër apriori. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Genc, të faleminderit. E ka fjalën Bajrush Xhemajli, le të bëhet gati Januz Kastrati.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI:

Faleminderit zoti Kryetar. Ju përshëndes kolegë deputetë, ndërsa në veçanti përshëndes ministrin Shatri, përndryshe ish kolegun tonë këtu.

Vërtetë, është e padrejtë që përveç kryeministrit dhe kolegët tuaj të kanë lënë vetëm, por mbaju he burrë, nuk është bash lehtë me qenë ministër, kështu!

Unë, do të përqendrohem vetëm në pjesën e buxhetit i cili ka të bëjë me kompetencat e rezervuara. Është thënë se buxheti i fuqive të rezervuara duhet të zvogëlohet prej viti në vit në favor të IPVQ-ëve por ka ndodhur e kundërta. Buxheti i fuqive të rezervuara është hiq më pak se 202 milion euro nga buxheti i tërësishëm. Ndarjet e vijave buxhetore, që

kanë bërë fuqi të rezervuara, janë tejet të debalancuara e në veçanti atje ku ka të bëjë me ekonominë, të cilën e mbulon Shtylla e katërtë e UNMIK-ut.

Është rasti dhe vendi të thuhet se fuqitë e rezervuara shumëherë, me ndarje të gabuara të buxhetit dhe me politika të gabuara ekonomike – kanë dëmtuar rënd ekonominë e Kosovës. Në veçanti, kjo ka të bëjë me politikën që është udhëhequr ndaj minierave të Kosovës. Qasja e gabuar dhe mosndarja e buxhetit të mjaftuar për investime kapitale ka bërë që edhe sot, pas 6 vjet nga lufta, minierat të mos rimëkëmbën sa e si do të mund të rimëkëmbeshin.

Për gjigantin ekonomik “Feronikelin” vijën e parë të prodhimit, janë dashur vetëm 7 milion euro për t’u aktivizuar në mënyrë që pastaj prodhimi i vijës së parë të aktivizojë edhe vijën tjetër të prodhimit, ashtu që nga investimi i këtyre 7 milionëve sot do ta kishim në prodhim të tërë këtë objekt kapital duke prodhuar për ne e jo ta qesim në privatizim dhe ta falim, siç thuhet, për një copë bukë për interesa të tjetërkujt. Pra, në vend se ta bëjmë një punë të mbarë e me fitim të madh për Kosovën me 7 milion, ne e shitëm për një kompani e cila i dha 33 milion dhe edhe 20 milion investime, ndërsa si kundërshpërblim fituesi do t’i marrë 400 hektarë tokë në shfrytëzim për 99 vjet dhe do t’i ketë fitim të pastër hiq më pak se 700 milion euro apo çdo vit nga 56 milion euro. Në vend që kjo pasuri të shfrytëzohet nga kosovarët, do të shkojë në xhepa të dy kazakistanezëve dhe të një arabi.

E mora shembull këtë sepse këtë skenar AKM-ja bashkë me Qeverinë e Kosovës po e përgatit edhe për “Trepçën”. Unë kam përcjell gjendjen në këtë gjigant ekonomik dhe sa i përket gjendjes financiare, vazhdimisht ka pasur vështirësi. Në mungesë të mjeteve financiare “Trepça” ka blerë makina të vjetra, të servisuara për prodhimin e xehes. Në procesin e furnizimit me këto makina, janë paraqitur probleme në rend të parë administrative tejet të pakuptimta. Lidhur me blerjen e këtyre makinave dhe për këto arsye ato fizikisht nuk kanë mund të arrijnë ta zëmë gjatë vitit kalendarik 2004 për ç’arsye është kërkuar bartja e 1 milion eurove për pagesë në vitin 2005.

Në shkurt të vitit 2005, menaxhmenti informohet se bartja e mjeteve nuk është lejuar, edhe pse makinat veç kishin arritur. Për vitin buxhetor që po e lëmë, pra 2005, “Trepça” patë kërkuar 11 milion euro nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, kurse iu lejuan 8 milion, kështu që në vitin afarist 2005, i cili ishte vendimtar për të ristartuar prodhimin në miniera – “Trepça” patë hyrë me deficit prej 4 milion euro.

Këto lojëra me miliona në dëm të “Trepçës” sigurisht se i leverdis dikujt, prandaj edhe bën marifete të sofistikuuara. Kurse, tani për vitin 2006, janë ndarë vetëm 6.635.234 euro e që nga kjo shumë janë paraparë 3 milion euro për shpenzime kapitale, edhe pse kërkesa e “Trepçës” ishte që për shpenzime kapitale nga buxheti i konsoliduar të ndahen 6.000.637 euro.

Kërkesë, vërtetë modeste dhe me projekte konkrete! Ta zëmë, projekti për përgatitjen e minierës së Hajvalisë, nuk finanohet - për mungesë të 1.5 milion, edhe pse dihet se është miniera me përqindje më të pasur të metaleve, jo vetëm në Kosovë, por në Evropë e më gjerë dhe në të ka përqindje të lartë të metaleve fisnike – ari dhe argjendi, më shumë se

minierat tjera të Kosovës. Këto investime, jo vetëm që do të nxirreshin shpejt, por edhe do të ishin burim për mbushjen e buxhetit të konsoliduar të Kosovës me të hyra nga kjo minierë. Prandaj, kërkoj që kërkesat e menaxhmentit të “Trepçës” të plotësohen tërësisht sepse janë shumë modeste dhe racionale.

Duke qenë i vetëdijshëm se për të ndarë në një vijë buxhetore duhet të merret nga një vi tjetër buxhetore, unë kam edhe propozim konkret se nga të merren paratë e nevojshme për “Trepçën”. Padyshim se do të duhen nga energjetika dhe, edhe më preciz: nga buxheti i dedikuar për KEK-un të cilit i është ndarë një buxhet tepër i madh dhe i pajustificueshëm – prej 32 milionësh. Këtë ndarje nuk e meriton kjo korporatë sepse menaxhmenti i saj është bërë parazit, as s’është vetë të merr e assesi të konsolidohet dhe nuk pranë së vajtuari për mosinkasim të mjeteve thuaja se kjo është detyrë e tjetërkujt e jo e vetë KEK-ut dhe e Qeverisë.

Për më tepër, menaxhmenti i KEK-ut nuk ka arritur as ta faturojë shpenzimin e energjisë elektrike, pra as nuk e din se kah shkon rryma e prodhuar, e lëre më të inkasojë at çka shpenzohet. Dhe, në vend të kryerjes së punëve që i takojnë, ky menaxhment – parazit – shpëtimin e ka gjetur në planin ABC, që është që në fillim i dështuar.

KEK-ut, nuk duhet t’i jepet kjo shumë paresh edhe për faktin se menaxhmenti vendor dhe dokumentar ka keqmenaxhuar, ka keqpërdorë dhe ka vjedhë parat që janë dhënë, dhe se nuk është e vërtetë se ishte vetëm një Trashler që i vodhi 4 milion e iku, por ka edhe “trashlerë” të tjerë ndërkombëtar e vendor të cilët nuk po ndiqen nga organet kompetente pasi zotëruar e mëdhenj atje në Olimp nuk lejojnë që të ngritën procedurat dhe të zhvillohen hetimet. Madje, ato hetime apo audite të cilat janë bërë disa herë, kanë treguar për vjedhje e vjedhje të njëpasnjëshme e të mëdha në KEK, por siç e kam thënë edhe më parë nga kjo foltore, rezultatet e këtyre hetimeve po fshihen vazhdimisht, kurse prokurorët dhe gjykatat e korruptuara as që guxojnë t’i hyjnë këtyre punëve për t’i kryer.

Megjithatë, shpresoj se një ditë ato do të publikohen, edhe pse vonë dhe me dëme tepër të mëdha.

Dhe, deputetë të nderuar, para se të përfundoj, dua të shtoj se: nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për “Trepçën” megjithatë është ndarë diçka, por në këtë buxhet nuk është asnjë cent për minierat tjera dhe siç duket Shtylla e katërtë e UNMIK-ut dhe Qeveria e Kosovës nuk janë të interesuara për minierat tjera të cilat nuk janë të pakta në Kosovë. Në bazë të kësaj, duket sikur qeveritarëve iu teprojnë disa miniera të Kosovës. Për miniera, ku fryti do të jetë pothuaj i menjëhershëm, pushtetarët janë shumë të shtrënguar, kurse për KEK-un atje ku është mjegull jo vetëm nga tymi, hudhet para në baltë, mjegullave të tilla iu gëzohen miqtë ujçit, apo jo. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë do t'ju lutja që të gjithë të paraqiturit të kenë mundësi për fjalë, transmetim ashtu-ashtu nuk ka televiziv, përqendrohuni, mos i përsëritni shumë çështjet. Prandaj, shkojmë më tej. E ka fjalën Januz Kastrati, le të përgatitet Teutë Hadri.

DEPUTETI JANUZ KASTRATI:

Faleminderit. I nderuari Kryetar, i nderuar ministër, të nderuar kolegë deputetë, Tashmë është bërë shprehi të thuhet se ky Projektligj është ndër më të rëndësishmit, apo i rëndësishëm së veçantë, por ky vërtetë është i tillë sepse sigurisht se çdo veprimtari varet edhe nga ky Projektligj apo më mirë të them nga financat.

Unë s'e kam të qartë në fillim pse në tabelën 4 nuk janë të përfshira të gjitha komunat, në mesin e të cilave shoh se nuk është Malisheva. Se Kosova ka nevojë për një buxhet më të madh se ky që është paraqitur, kjo nuk do koment. Megjithatë, çështja është sa jemi në gjendje të planifikojmë dhe menaxhojmë si duhet këtë buxhet.

Sa i përket shpërndarjes së buxhetit nëpër komuna, duhet të merret parasysh fakti se disa komuna kanë qenë dhe janë në pozita më të palakmueshme, prandaj edhe kanë më shumë nevojë. Nëse mjaft komuna mund të arsyetohen dhe të ankohen se kanë qenë ndër më të shkatërruarat gjatë luftës, Malisheva këtë shkatërrim e përjetoi gjatë tërë viteve të 90-ta.

Po të shohim shpërndarjen e mjeteve buxhetore nëpër ministri, mendoj se ka vend për disa korrigjime në kuadër të këtyre parametrave buxhetore. Ministrinë duhet, jo vetëm të planifikojnë dhe propozojnë buxhetin e tyre, por të shohin se si shfrytëzohen mjetet e tyre. Organet nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale duhet të shohin dhe të marrin masa nëpër komuna, gjegjësisht qendra sociale për ata që – jo vetëm që punojnë - po bile janë edhe në mesin e udhëheqësve komunal dhe janë edhe në listat e përfituesve të ndihmave sociale. Ndërsa, organet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet që të gjejnë zgjidhje që mos t'u lejojnë njerëzve të tillë që edhe regjistrimin e semestrave të fëmijëve të tyre ta bëjnë duke u arsyetuar me vërtetimet e marrura nga qendrat sociale. Nuk ka nevojë të kërkohen mjete për këta keqpërdorues të buxhetit sepse këto mjete mund dhe duhet të shkojnë në vendet ku ka nevojë, e ndër vendet ku ka nevojë unë konsideroj se është gjithësisht arsimit dhe bashkëngjiten në kërkesat e kolegëve të mi që kjo veprimtari duhet të ketë një tretman më të shtuar.

Prandaj, si kërkesë do të kisha që në kuadër të buxhetit të vitit 2006 të shihen mundësitë që kjo çështje, pra çështja e arsimit të shkojë në atë drejtim që në vitin 2007 të mos kemi më shkollat të cilat punojnë jo vetëm në tri ndërrime por edhe në katra sikur u tha këtu, duke përmendur edhe një fakt që shkolla fillore në qendrën komunale të Malishevës jo vetëm që punon në tri ndërrime por tanimë punon në një ndërtesë që tash ka kaluar 50 vjet

dhe nuk e di, nëse s'gaboj, edhe ish kryeministri ka qenë në një vizitë aty dhe natyrisht se besoj të gjithë janë të njoftuar se në çfarë gjendje zhvillohet procesi mësimor aty.

Megjithatë, konsideroj se ky Projektligj duke u mbështetur parimisht duhet të shkojë në leximin e dytë dhe të aprovohet për më tej. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën Teutë Hadri, le të bëhet gati Fadil Kryeziu.

DEPUTETJA TEUTË HADRI:

Të nderuar deputetë, i nderuari zoti Kryetar, Duke iu bashkëngjitur diskutimeve të të gjithë deputetëve që diskutuan deri tani rreth raportit gjashtëmujor për buxhetin e Kosovës, edhe unë kam vërejtje se ky raport nuk ndryshon nga raporti i përparmë i gjashtëmujorëve tjerë dhe ka mungesë faktesh të të prezantuar ashtu siç është dhënë vërejtje edhe nga parafolësit.

Unë do të ndalem kryesisht në buxhetin për shëndetësi, i cili është shumë qesharak dhe matë dhe vlerëson edhe nivelin e njerëzve tanë qeveritar. Nuk mund të ketë qeveri as institucione qeveritare të shëndosha kur nuk patëm shëndetësi të zhvilluar. Këtë e pamë edhe gjatë vizitës që ka bërë Komisioni i shëndetësisë dhe anëtarët e saj në ÇKU dhe qendrat tjera klinike, ku në bisedë me drejtorin e ÇKU dhe të gjithë drejtorët e qendrave është diskutuar për një mungesë shumë të mirë të gjendjes në shëndetësi, për mungesë të medikamenteve, mungesë të infrastrukturës dhe të gjitha këto vërejtje nuk kanë dhënë komisionit në shëndetësi që na t'i paraqesim kështu në Parlament dhe njëherit edhe të qeveritarit.

Unë kam menduar se në mbledhjen e sotme do të jetë si pikë e rendit të ditës edhe çështja e shëndetësisë dhe gjendja e rëndë, por pasi që shkaktar i kësaj gjendjeje të rëndë në shëndetësi është vetë buxheti i ulët i Kosovës, parashoh që këto vërejtje t'i japim sot në Parlament duke shpresuar se në të ardhmen qeveritarët dhe vetë deputetët do të japin kontribut, të angazhohen që buxheti i shëndetësisë ta ketë një ngritje e jo një zbritje siç e kemi dhënë në këtë raport të këtij gjashtëmujori.

Në vend që vërejtjet tona nga raportet e kaluara për shëndetësi që kemi dhënë, për ta ngritur mbi 8.7% buxhetin, ato kanë shkuar edhe në mungesë.

Unë mendoj se për shkak të këtij buxheti të ulët, është bërë edhe diskriminimi i të drejtës kryesore që është e shfrytëzimit të pushimit të lehonave, çka këto lehona nuk kanë mundësi ta shfrytëzojnë të drejtën e pushimit mbi 3 muaj siç e kemi miratuar në Komision dhe në vetë Parlamentin që të jetë 50 me 50% e drejta e shfrytëzimit, ato gra sot mbeten pa e shfrytëzuar drejt pushimin e vet, që vendet dhe shtetet fqinje i stimulojnë këto gra që të bëjnë numër më të madh të lindjeve, për çka sot te ne, nga viti i kaluar në klinikën e gjinekologjisë është paraqitur rënie e natalitetit të fëmijëve tanë që për Kosovën besoj se për një vit i rënies së tillë të natalitetit, në mungesë të shfrytëzimit të së drejtës së pushimit

të lehonave tona është që do të thotë shumë për Kosovën. Dhe prandaj mendoj se qeveritarët duhet të bazohen edhe këtu.

Shëndetësia e Kosovës sot ballafaqohet edhe me një ngritje dhe rritje të numrit të sëmundjeve kancerogjene çka besoj çdo anëtar i familjes sot do të mund ta ketë edhe prezent në rrethin familjar. Kjo rritje e numrit të sëmundjeve kancerogjene e ka rënduar edhe më shumë buxhetin e Kosovës sepse me këtë buxhet familjet tona detyrohen që një të sëmurë nga familja ta çojnë në ente tjera shëndetësore – në Maqedoni apo në Turqi dhe për një mjekim apo terapi rrezatuese në shtetet fqinje duhet të paguajë qytetari i Kosovës deri në 15 mijë euro. Prandaj, mendoj se qeveritarët nuk kanë bërë llogari dhe në vend që ky buxhet me 15 mijë euro për një dozë rrezatuese në shtetet fqinje t'i mbetet buxhetit të Kosovës në organizimin që do ta bëjnë qeveritarët dhe profesionistët për qytetarin tonë është në interes tonin.

Prandaj, zoti Kryetar, mendoj se në mbledhjen e ardhme besoj që një pikë shumë e rëndësishme do të jetë çështja e shëndetësisë dhe propozojmë dhe kemi obligim edhe nga qendrat klinike dhe drejtorët që këtë buxhet për shëndetësinë ta ngritni dhe të mendoni t'ia vëni gishtin kokës që të ngritet nga 8% - 8.7% deri në 15%. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Fadil Kryeziu, le të përgatitet Fetah Berisha.

DEPUTETI FADIL KRYEZIU:

Respekt për të gjithë. Para se gjithash, unë propozoj që RTK-ës me ia këput buxhetin se na ka mbyll dritaren dhe sot më la ulur, e unë përndryshe kur punon RTK çohem në këmbë e diskutoj! Kjo është e para, ndoshta pak si relaks, tash së fundi por më lejoni t'i them disa fjalë rreth këtij buxheti dhe që në fillim të them se unë jam kundër këtij buxheti. Ndoshta, jo pse ka pak pare, por se mundet me pasur më shumë pare, Kosova ka më shumë pare dhe sikur të ishte një organizim ndoshta më i mirë në administratën tatimore, sepse për mua është absolutisht e papranueshme që edhe 4 apo 5 vite të administratës tatimore të organizuar në Kosovë e ne ende të mbështetemi në tatimet në kufi, ndërkaq tatimet e brendshme të mbeten në nivele të ulëta. Për arsye se, edhe në bazë të hulumtimeve tjera, madje edhe analizave të ekspertëve thuhet se Kosova ka potencial së paku për 50% më tepër, sikur administrata tatimore të jetë më efikase, të jetë më e angazhuar në grumbullimin e këtyre tatimeve dhe në parandalimin e ekonomisë joformale që natyrisht shkakton pra edhe këtë pozicion të buxhetit, sikurse edhe ndarjen e shumës kaq të madhe të mjeteve për fuqitë e rezervuara kur edhe në pozicionet e parapara për agjencione shpenzuese prapë fuqitë e përfaqësuesit special janë madje derterminuese.

Në anën tjetër, në bazë të diskutimeve që patën edhe kolegët, pjesë e mirë e kolegëve të mi, domethënë më shtynë më tepër të mendoj që të jam kundër këtij buxheti për arsye se ne të gjithë po flasim për arsimin, po flasim për shëndetësinë, po flasim për rastet sociale, e tjera e tjera, po flasim se ky buxhet nuk është investim, ndërkaq në ndërkohë

angazhohemi pothuaj të gjithë që të kemi një buxhet social, thjeshtë dhe të rrisim ose të favorizojmë papunësinë – mosangazhimin.

T'ju sjell vetëm një shembull se Ministria për Punë dhe Çështje Sociale ka buxhetin prej rreth 128 milion. Unë jam i vetëdijshëm se këtu janë të përfshira edhe pensionet, janë të përfshira edhe persona me aftësi të kufizuar, për invalid të luftës, pensionet e hershme e tjera e tjera, por vetëm asistencë sociale kap shumën rreth 29 milion dhe keni parasysh, përveç rasteve sociale, shfrytëzojmë këtë 29 milionësh, ata favorizohen edhe me lirim nga pagimi i mijëra kilovat orëve, lirohen nga pagesat e shërbimeve tjera komunale, gjë që arrin të përfitojnë pra më shumë se një mësues apo një mjek në punë, apo se edhe një administrator i shërbimit civil.

Prandaj, angazhimi gjithashtu i yni që ne duhet të kemi institucione të varfëra, domethënë të mos kenë institucionet tona kushte për punë, vjen te idea që të qesim në shitje edhe parlamentin e ndoshta e rrisim buxhetin, dhe shkojmë krijojmë pra një buxhet të ashtuquajtur popullor ose social.

Në anën tjetër, bie në sy se sikur që patë angazhime që duhet të rriten pozicionet ndoshta për komunitat, po e them nën shojza “të varfëra”, ndërkaq për mua është ende i paqartë ndarja e buxhetit – e grandeve të Qeverisë për komunitat, për arsye se prapë del që komunitat e varfëra përfitojnë më shumë përkundër faktit se kanë pjesëmarrje më të vogël në këtë buxhet, domethënë në tatimim e tjera, përfitojmë më shumë sepse përfitojmë nga grandet qeveritare, pra nga projektet që i financon Qeveria. Derisa komunitat, që kanë suksese qoftë edhe në të hyra vetanake, dënohen në njëfarë mënyre – dënohen në njëfarë mënyre për arsye se Qeveria krijon komoditet se ato i kanë punët mirë, ta zëmë Prishtinën, Prizrenin apo ndonjë komunë tjetër.

Dhe, së fundi, do të doja që para se ta diskutonim këtë Projektligj, ne këtu të kishim iniciativën qoftë nga Qeveria qoftë nga komisionet funksionale të Parlamentit për ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike që do të mundësonte një alokim më të shpejtë të mjeteve për organizatat buxhetore dhe jo kjo çështje të shtyhet deri në fund të vitit që ndonjëherë krijohet prapë përshtypja se qëllimisht bëhet me vonesë në alokimin e mjeteve për projektet e parapara, pra mjetet e parapara për buxhetin, kam parasysh komunitat sidomos që ato të futen në fund viti në njëfarë të ashtuquajtur suficit të kushtëzuar.

Dhe, e dyta, ndryshimi i Ligjit për prokurimin publik. Domethënë të harmonizohen afatet kohore, sepse ne disa herë edhe në Parlament, edhe kolegët tjerë kanë diskutuar problemin kur projektet shtyhen që të realizohen në kohë të papërshtatshme, si dhe do të doja që të kishim një raport të realizimeve buxhetore të këtij viti dhe shpenzimet buxhetore të këtij viti. Unë jam i bindur që ministri do të na dorëzojë më vonë, prandaj pres që edhe aty të shohim dhe ndoshta në njëfarë mënyre të verifikohet kjo që unë thash se Kosova ka potenciale më të fuqishme për buxhetin e saj të konsoliduar. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Fetah Berisha, le të bëhet gati Hajredin Hyseni.

DEPUTETI FETAH BERISHA:

Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuar kolegë deputetë dhe i nderuar zotni ministër. Sot po shqyrtojmë në këtë seancë Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006. Është për t'u pagëzuar përpjekja serioze nga Ministria për ta bërë një projektligj dhe ndarje për buxhetin e Kosovës. Është thënë se së paku dy herë në vit do të paraqitet raport nga Ministria e Ekonomisë, Qeverisë, Parlamentit, Përfaqësuesit special e tjera. Gjithashtu është thënë se edhe komunat çdo tre muaj do t'i raportojnë Ministrisë për buxhetin për shpenzimet e tjera. Gjithashtu, është thënë se ndarja e mjeteve buxhetore komunale është parashikuar nga burimet financiare vetanake. Prandaj, të hyrat këtu sigurohen nga participimi i pagesave të taksave e të tjera.

Të hyrat nga participimi për kujdesin shëndetësor dhe për arsimin, është thënë këtu se do të përdoren vetëm për qëllime shëndetësore dhe për arsimin. Mirëpo, unë do të veçoja vetëm një segment, pikërisht në të dhënat për ndarjen e buxhetit nëpër komuna, e sidomos në komunën e Rahovecit, të cilës sipas analizës që i është bërë, në grandin e ndarë për komunën e Rahovecit, në Ligjin buxhetor, si në administratën e përgjithshme, shëndetësi e tjera, por në veçanti për arsimin – në këtë lëmi është vërejtur se grandin e ndarë për arsim për komunën e Rahovecit ka mungesë dhe bie në kundërshtim me formulën e ndarjes për grandet për arsim nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Komuna e Rahovecit ka 35 shkolla, me paralele të ndara, në shkolla të mesme, fillore në të gjitha nivelet. Në këto shkolla mësojnë 15.393 nxënës; 15.154 janë shqiptarë, 236 janë nga minoritetet. Buxheti për arsimin komunal është ndarë dhe është kjo shifër: 2.241.000. Sipas numrit, nëse buxheti ndahet për kokë të nxënësve, atëherë është dashtë të jetë 2.660.000, ndërsa buxheti për mallra dhe shërbime këtu është shënuar se 18 euro është për kokë të nxënësit shqiptar, ndërsa është më e madhe për nxënësit e minoriteteve – është 22.5.

Prandaj, Komuna e Rahovecit, ose arsimi i komunës së Rahovecit është dëmtuar për 421.000 euro. Do ta përmend vetëm një shembull.

Të nderuar deputetë, Drejtoria komunale e arsimit në Rahovec, tani për tani ka vetëm 4 punëtorë. Njëri nga këta katër, është edhe punëtori teknik. Pra, ka një drejtor, një profesor dhe një zyrtar që i mban financat.

Ju me siguri e mbajtet mend se në anën tjetër janë 15.390 nxënës, tani çfarë mund të bëjë kjo Drejtori komunale e arsimit me tërë këta nxënës me tre vetë? Nuk do koment. Por vazhdimisht me konsultimet që kemi pasur me Drejtorinë komunale të arsimit edhe në komunë, është thënë: nuk ka buxhet për të pranuar punëtor tjetër.

Kjo çështje, ma thotë mendja, e do një përgjigje duke u përmirësuar buxheti shtesë për arsimin në komunën e Rahovecit, ashtu si do shtuar buxheti në përgjithësi për arsimin në Kosovë. Megjithatë, unë mendoj se ky Projektligj për buxhetin e Kosovës duhet të përkrahët dhe të kalojë në parim. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Fetah faleminderit. E ka fjalën Hajredin Hyseni, le të përgatitet Gazmend Muhaxheri.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI:

I nderuari Kryetar, zoti ministër, të nderuar deputetë,
Buxheti është pjesa më e rëndësishme për funksionimin e një pushteti, ndërsa menaxhimi i tij është treguesi më i mirë i një qeverie se çfarë kapacitetesh posedon ajo për të drejtuar vendin.

Shikuar nga menaxhimi i buxhetit të këtij viti që po e lëmë pas, mund të themi se ne kemi pasur një qeveri të dobët, e cila – edhe ato mjete që i ka pasur në dispozicion – nuk ka ditur t’i menaxhojë ashtu siç duhet dhe nga ky menaxhim i dobët do të ketë suficit edhe në ato fusha ku gjendja është mjaft alarmante, si për shembull në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, e dihet se në çfarë gjendje janë rrugët nëpër Kosovë.

Fatkeqësisht, siç mund të shihet edhe nga ky Projektligj, kjo Qeveri vetëm sa vazhdon në të njëjtën mënyrë të keqmenaxhimit, duke mos bërë shpërndarje të drejtë të buxhetit, duke mos pasur parasysh nevojat akute apo duke mos pasur parasysh zhvillimin dhe mundësitë jo të barabarta të pjesëve të ndryshme të Kosovës kur është fjala për grandet që parashihen t’u jipen komunave për vitin 2006.

Nga ky Parlament dhe nga deputetët kërkohet që të aprovohet ky buxhet pa u dhënë një pasqyrë e plotë dhe pa u specifikuar detajet e nevojshme që duhet t’i dinë deputetët, për shembull se cilat janë prioritetet numër një që financohen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, cilat janë prioritetet numër dy që financohen nga donatorët, si të aprovohet një ligj i tillë kur nuk qartësohen as vetë deputetët e Parlamentit të Kosovës se në cilat projekte do të shkojnë këto mjete të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. A duhet ditur ky Parlament se ku shkojnë shpenzimet kapitale të vetë Kuvendit të Kosovës? Mendoj se kjo nuk ka koment dhe mund të themi se këtu fillon korrupsioni në Kuvendin e Kosovës në qoftë se ne do ta aprovojmë një buxhet pa ditur se si do të shpenzohet ai buxhet.

Një gabim, i cili ishte bërë edhe në vitin e kaluar, sa i përket ndarjes së buxhetit për bujqësinë, vazhdon të përsëritet edhe në këtë vit. Pra, është befasuese kur sheh se për bujqësinë ndahen vetëm 5 milion euro, kur dihet se përmes bujqësisë dhe zhvillimit të saj, shtetet kanë bërë një tranzicion të suksesshëm ekonomik, sepse subvencionimi i bujqësisë do të sillte shumë përparësi e sidomos për një ekonomi, siç është ekonomia e Kosovës dhe tranzicioni që po kalon ajo. Me subvencionimin e bujqësisë do të hapeshin vende të reja të

punës, do të ketë gjenerim të të ardhurave, rritje të hyrave, përmirësim të bilancit tregtar, rritje të eksportit dhe ulje të çmimeve.

Të gjitha këto përparësi do të arriheshin, por me këtë buxhet që parashihet, këto objektiva nuk do të arrihen. Përkundrazi, bujqësia do të vazhdojë të trajtohet pa seriozitetin e duhur, ashtu si është trajtuar edhe në vitin e kaluar.

Të nderuar deputetë,
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit kërkon që të shtohet për 5 milion buxheti i saj, me arsyetim se i nevojitet kjo shumë për të kryer rehabilitimin e magjistrales Prishtinë-Pejë dhe Prishtinë-Kaçanik dhe do të ishte normale dhe e arsyeshme të kërkohej kjo sikur kjo Qeveri të menaxhonte buxhetin që posedon në këtë vit. Sepse, nga një llogaritje në këtë Ministri, do të ketë një suficit i cili vjen nga një menaxhim i dobët i drejtuesve të saj.

Deri te ky konstatim arrijmë duke u bazuar në gjendjen e mjerueshme që mbretëron në rrugët e Kosovës. Se ekziston një politikë e ndarjes së buxhetit jo sipas nevojave reale dhe prioriteteve, që do të duhej të ishte bazë e ndarjes, por sipas preferencave të njerëzve që janë në Ministri, mund t'ju ilustrim vetëm me një shembull se në projektet e kësaj Ministrie nuk parashihet rehabilitimi i rrugës Lluzhan-Orllan, rrugë e cila lidhë disa fshatra dhe do të zhvillonte turizmin, sepse në këtë rajon ekziston liqeni i Batllavës, por në Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit askush nuk punon nga ky rajon, andaj edhe nuk ndahet buxhet për rehabilitimin e kësaj rruge.

Për Kuvendin e Kosovës, ndahen 1.375.000 euro për mallra e shërbime, ndërsa për 119 deputetë parashihen 599.000, afërsisht 419 euro në muaj – çdo deputeti. Nga ky fond, disa deputetë që udhëtojnë, e shfrytëzojnë këtë fond dhe nga ky fond për seanca plenare ne shfrytëzojmë këtë shumë që kemi përpara. Andaj, do të pyetja: ku shkojnë këto të holla dhe si të aprovohet ky Projektligj kur as deputetët nuk dinë si shpenzohet as buxheti që parashihet për ta.

Është ironike të kërkohej të aprovohet ky Projektligj dhe është e pafalshme nga ky Kuvend të lejojë këtë pa ditur se ku do të shkojnë dhe si do të shpenzohen ato kur kjo Qeveri për invalidët e luftës bllokoi mjetet për blerjen e kukëzave, që janë jetike për shërimin e tyre, dhe kur kjo Qeveri nuk qan kokën për familjet pa kulm mbi kokë, për jetën e tyre në errësirë në këtë dimër, kurse ne iu krijojmë mundësi qeveritarëve që buxhetin e Kosovës të mund ta shpërdorin. Kjo, është e pafalshme për këtë Kuvend, sepse ka obligim para qytetarëve ta kontrollojë qeverinë për të mos shpërdoruar fondet që krijohen nga qytetarët.

Të nderuar deputetë,
Kuvendi, është vend ku duhet të shqyrtohen projektligjet. Kuvendi është ai që duhet ta kontrollojë qeverinë për punën e vet, kuvendi duhet të jetë transparent para qytetarëve sepse është detyrë e tij. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Gazmend Muhaxheri, dhe i fundit në Listë Fehmi Mujota, apo ndoshta je tërheq, Fehmi.

(Ndërhyrje)

Ka, ka. Unë thash, ju kornizova në mënyrë që deri në shtatë ose në tetë, ta kryejmë. Urdhëro Gazmend.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI:

Zonja dhe zotërinj, i nderuar zoti ministër.

Në një kuvend të përgjegjshëm dhe funksional, i cili respekton ligjet dhe rregulloren e punës të kuvendit, buxheti i kuvendit të ishte përgatitur dhe miratuar në muajin tetor, do të përgatitej nga komisioni për buxhet, do të diskutohej me shefat e grupeve parlamentare, do të merreshin parasysht nevojat reale të kuvendit, do të caktoheshin prioritetet.

E, prioritet për Kuvendin e Kosovës, është nxjerrja e ligjeve kualitative. Në Kuvendin tonë, kjo nuk ndodh. Sepse, miratimi i buxhetit – i përgatitur në muajin tetor, në Kryesinë e Kuvendit është penguar nga Kryetari me motivacion se do të bëhet në dhjetor. Në dhjetor, kjo nuk ka ndodhë, kështu që, Kryesia e Kuvendit e me këtë edhe grupet parlamentare - janë gjendur para aktit të kryer, domethënë para buxhetit të propozuar në mënyrë të paligjshme.

Buxheti, i cili prioritet edhe për këtë vit e ka ndërtimin e objekteve luksoze dhe blerjen e veturave luksoze! Sipas zhvillimeve të fundit, del se personat vendimmarrës në Kuvendin e Kosovës janë sekretari i Kuvendit zoti Demaj, drejtori i buxhetit zoti Nikci, asistentja e Kryetarit të Kuvendit zonja Bukurie. Nëse, për asgjë tjetër, buxheti i propozuar sot – nuk do të duhej miratuar para se ky buxhet të aprovohet... domethënë buxheti i Kuvendit të aprovohet në mënyrë të rregullt, në diskutim mes shefave të grupeve parlamentare, të miratohet në Kryesinë e Kuvendit, e pastaj t'i dorëzohet Ministrisë për Ekonomi dhe Financa. Kjo mënyrë e papërgjegjshme, nuk mund të tolerohet. Ju mund ta votoni, por kjo është papërgjegjësi totale e deputetëve, e Kryesisë së Kuvendit dhe e Parlamentit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E ka fjalën zoti Fehmi Mujota, le të bëhet gati Sala Berisha-Shala.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA:

Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuar deputetë,

Po të shikojmë buxhetin përkatësisht Projektbuxhetin për vitin 2006 dhe mënyrën e strukturimit të tij, del që objektivat përkatësisht plani i hartimit të këtij buxheti është kornizuar brenda mundësive financiare. Mirëpo, gjithsesi, këtu ka lëshime shumë serioze

në kuptim të racionalizimit të shpenzimit të këtij buxheti. Madje, ka shumë lëshime, të cilat do të mund të përmirësonin kualitativisht shumë gjëra të cilat janë të dëmtuara rënd për jetën e qytetarëve.

Unë do të përqendrohem vetëm në disa nga pikat, të cilat kolegët deputetë kanë kaluar sipërfaqësisht mbi to, ose nuk janë ndalur pak më detajisht të diskutojnë për këto gjëra. Nëse shikojmë fondin stimulues për tatimin në pronë, që është 8 milion euro, nëse shikojmë fondin rezervë të Ministrisë së Ekonomisë dhe fondin rezervë të Kryeadministratorit, po qe se shikojmë të hyrat komunale vetanake që janë 34 milion, po qe se shikojmë transferimin e fondit nga një organizatë buxhetore në organizatën tjetër buxhetore, nëse shikojmë financimin e njësive nënkomunale dhe reformën e pushtetit lokal, nëse shikojmë fondin për rindërtimin, nëse shikojmë fondet për ngritjen e kulteve, nëse shikojmë ndërhyrjet në vijat buxhetore në komuna, nëse shikojmë ministrinë për komunitete dhe kthim – që ka një buxhet jo të vogël dhe komisionet tjera të veçanta që merren me këtë çështje – dhe nëse shikojmë më në fund edhe projektet kapitale që parashihen të realizohen përmes Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit – do të mund të nxjerrim disa përfundime.

E para, të gjitha komunat e Kosovës kanë shprehur shqetësimet e tyre për planifikim të dobët buxhetor ose buxhet të pamjaftueshëm për të realizuar projektet e tyre dhe për të përmbushur detyrat para qytetarëve. Qytetarët e Kosovës dhe natyrisht aty ku organizohet jeta institucionale, zyrtarët e dinë mirë që buxheti për administratën, buxheti për shëndetësinë dhe buxheti për arsimin janë vetëm buxhete që transferohen nga niveli qendror në grandet qeveritare, në komuna dhe shkojnë deri te punonjësit që punojnë në këto grande, përkatësisht në këto resore.

Të gjithë e dimë që këto janë të pamjaftueshme dhe fatkeqësisht, për vitin 2006 porosia është se do të kemi fonde edhe më të zvogëluara. Prandaj, nuk mund të presim arsim më kualitativ, mbrojtje shëndetësore më të mirë dhe nuk mund të presim shërbime administrative më kualitative – me çka nënkupton se mund të ketë rritje të korrupsionit dhe të keqpërdorimeve tjera brenda administratës në Kosovë.

Po të shikojmë gjenerimin e të hyrave në komuna, del që raporti është hiq më pak se 4 me 1. Vetëm 34 milion euro është fuqia e tashme e komunave për të marrë pjesë në buxhetin e përgjithshëm të Kosovës, përkatësisht ato komuna marrin rreth 108 milion euro, që nënkupton se vetëm 34 milion marrin pjesë për të financuar vetveten.

Kjo nënkupton që, padrejtësisht mund të ketë kritere, të cilat i përmendi kolegu Fadil Kryeziu: që komunat me varfërinë më të madhe - janë të privilegjuara. Unë do të thoja se komunat me varfëri më të madhe në Kosovë janë dyfish të dëmtuara. E para, kriteri mbi të cilin ndahet buxheti në Kosovë, është numri i banorëve, kurse ne e dimë se nuk kemi regjistrim të popullatës akoma dhe nuk dimë saktësisht se cili do të duhej të jetë buxheti për këto komuna, me çka nënkuptoj se këtu janë të dëmtuara edhe komunat e mëdha dhe të vogla, por për çfarë janë të dëmtuara komunat e varfëra, ka kritere të tjera të cilat nuk merren parasysh. E para, do të thoja se nuk merret parasysh prapambeturia ekonomike, nuk merret parasysh dëmtimi nga lufta, nuk merret parasysh se në këto regjione kemi numër të madh të familjeve të cilat nuk kanë shtëpi mbi kokë, komunat nuk kanë buxhete

për të bërë këto punë, prandaj duhet shikuar mundësinë që këto komuna të jenë të privilegjuar në një mënyrë ose të jenë të trajtuara ashtu si duhet, si u takon.

Një tjetër kriter, që besoj se do të duhej ta kemi parasysh në këtë rast, është ajo që ne nuk po i kushtojmë rëndësi ngritjes së kulture, ngritjes së vlerave, ngritjes së atyre monumenteve për të cilat të gjithë ne ndihemi krenar, për të cilat të gjithë ne – edhe nxënësit, edhe studentët, edhe ushtarët, edhe policët, edhe deputetët, edhe ministrat – të gjithë qytetarët e Kosovës shkojnë dhe bëjnë nderim, por fatkeqësisht edhe për vitin 2006 nuk shihet një zë i veçantë buxheti ku do të duhej ndarë mjete të konsideruara për Kompleksin memorial në Prekaz dhe për Kompleksin përkujtimor në Reçak.

E di që është një lloj parashikimi, por ai është tepër i pamjaftueshëm, dhe për këtë unë kam një propozim konkret. Nga buxheti për shërbime dhe mallra dhe nga buxhetet ku shpenzohet një numër përkatësisht shumë e madhe e mjeteve financiare në agjencionet shpenzuese do të mund të parashikohen aq mjete sa më në fund të denjëtitshëm të gjithë qytetarët e Kosovës të mund ta bëjnë këtë nderim.

Ministria e pushtetit, përkatësisht Ministria e Pushtetit Lokal do të ketë një problem të veçantë në realizimin e projekteve të veta në kuptimin e dërgimit të buxheteve në njësitë nënkomunale, përkatësisht në reformimin e pushtetit lokal. Këto mjete që janë paraparë prej 1. e 300 e sa mijë euro, nënkupton se nuk do të kemi mundësi të futemi në reforma të tilla dhe aq më tepër kur tani e dimë fatin se si ka rrjedhë procesi i reformimit të pushtetit lokal përkatësisht decentralizimit dhe duket se këto mjete edhe ashtu janë të vogla të parashikuara por nuk do të shpenzohen sepse do të kemi do ecje tjera në këtë drejtim, si duket.

19.136 milion euro të parapara në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit për realizimin e projekteve kapitale, nënkuptojnë një shumë afërsisht të barabartë me atë që kemi pasur në vitin e kaluar. Dhe, qytetarët presin që, në vend të asaj që të realizohen projektet e vitit të kaluar që diku kanë kapur shumën rreth 13 milion euro, që në këtë vit nuk janë të parapara dhe nënkupton se disa projekte asnjëherë nuk do të realizohen. Me këto 19.136 milion euro për projektet kapitale do të mund të realizohet plani për vitin 2006, por plani për vitin 2005 ka ngelur. Atëherë, njërin vit do ta kemi zero për qind të realizua, ose vitin 2005 ose vitin 2006. Me gjasë, vitin 2006 nuk do ta kemi në këtë nivel sepse kemi edhe do procese tjera demokratike, të zgjedhjeve dhe gjërave tjera.

Prandaj, krejt në fund, do të thoja se kriteri i vetëm për ndarjen e buxheteve në komuna po e dëmton këtë proces dhe urgjentisht duhet të ndërhyjmë, duhet të shikojmë se si duhet bërë në të ardhmen dhe natyrisht ka vend akoma për vitin 2006 ta përmirësojmë këtë çështje. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Sala Berisha-Shala, dhe le të bëhet gati Nazim Jashari.

DEPUTETJA SALA BERISHA-SHALA:

Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuar kolegë deputetë, i nderuari zoti ministër, Një ndër karakteristikat themelore të një projektbuxheti duhet të jetë, në mes tjerash – edhe transparenca, ndershmëria dhe përgjegjësia para qytetarëve. Kjo nuk po ndodhë. Hartimi i këtij Projektbuxheti nuk dallon shumë nga ai i mëparshmi, ashtu siç nuk ka dallim edhe në ndarjen e tij të gabuar. Pas kaq vitesh, është dashtë të fitohet një përvojë pozitive në këtë drejtim, apo ndoshta Qeverisë i shkon për shtati kjo praktikë.

Vërejtjet në Projektbuxhet do t'i fokusoj në tri çështje: Nën një, shpërndarja e grandeve për komuna; buxheti i fuqive të rezervuara dhe dublifikimi i stafit nëpër njësi buxhetore.

Përdorimi edhe më tutje i kriterëve unike me ndarjen e buxhetit i dëmton rënd komunitat e varfëra duke i futur kështu në një krizë të thellë prapambeturie. Edhe këto kriterë janë të pabaza kur nuk dihet saktësisht numri i banorëve, që gati të gjithë parafolësit e mi e përmendën se regjistrimi i popullsisë herën e fundit është kryer diku në vitin 81.

Për shembull, komuna e Drenasit ka diku më shumë se 60 mijë banorë, ndërsa grandet i ndahen përafërsisht për 50 mijë banorë, aty diku. Ndarja e grandeve për komuna duhet bazuar në kriterë specifike e jo në kriterë unike. Qeveria duhet të ndajë grande specifike për zhvillim. Pastaj, mendojmë se duhet ndryshuar edhe certifikimi i komunave sepse nuk vlen i njëjti certifikim i të hyrave vetanake për të gjitha komunitat dhe nuk vlen njëjtë sikur për Prishtinën e Drenasin, Malishevën apo dikë tjetër. Kjo të bëhet në bazë të specifikave të komunës përkatëse. Për shembull, çfarë të hyrash mund të krijojë Drenasi nga tatimi në pronë për objekte të dhuruara siç janë shtëpitë e ndërtuara nga donatorët. Mandej, ka edhe pengesa tjera, siç janë mungesa e llogarive bankare, e drejta e komunës vetëm për të depozituar dhe atë depozitim e bën në Prishtinë në zyret regjionale që ekskluzivisht domethënë centralizim i veprimtari nga pushteti qendror.

Sa i përket çështjes së buxhetit në fushën e rezervuar, mendoj se grandet në këtë fushë është dashtë të vjen duke u zvogëluar dukshëm, në të kundërtën, përveç ndarjes jo të drejtë buxhetore me të cilën iu hyhet në hak njësisë të tjera, kjo do të tingëllojë edhe si jogatishmëri për t'i bartë ato kompetenca. Këtu mendoj se duhet rishqyrtuar sidomos energjetikën dhe minierat respektivisht buxhetin e KEK-ut dhe atë të Komisionit të pavarur për miniera dhe minerale.

Në kuadër të Komisionit të pavarur për miniera dhe minerale, ka sektor që ka staf të njëjtë me detyra të njëjta të punës sikurse që ka sektor në kuadër të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave. Mendoj se, edhe kjo dukuri, sikur është dublifikimi i stafit dhe i paguar nga i njëjti buxhet, është tepër i dëmshëm. Këso raste ka edhe nëpër njësi tjera buxhetore, për t'mos i përmend me radhë, sigurisht se Qeveria i dini, dhe se këtë dukuri është dashur ta identifikojë dhe ta eliminojë Qeveria me kohë.

Duhet rishikuar gjithashtu edhe mjetet e dedikuara KEK-ut. Atij KEK-u, që është në bashkëmenaxhim vendor-ndërkombëtar, që vetëm po shfrytëzon buxhetin e Kosovës kohëpaskohe, duke iu ofruar qytetarëve orar të rrymës shumëfishë në favor të territ, e për këtë situatë shpikë plane gjoja në orvatje të gjetjes së një rruge për të inkasuar rrymën. Në këtë mënyrë, duke u përpjekur t'ua hedhë fajin qytetarëve për mospagesë, për vjedhje të rrymës, orvatet t'u ikë përgjegjësive duke u munduar t'i fshehë keqpërdorimet dhe vjedhjet që bën vetë menaxhmenti i saj dhe ngjanë asaj situatë kur hajni bërtet “kapeni hajnin – ndëshkoheni atë”. Këtë e ilustron edhe plani famoz ABC. Ky plan, më drejtpërdrejt godet zonat e varfra, është në njëfarë forme shkelje direkte e të drejtave të qytetarëve.

Të nderuar deputetë,

Përmes planit ABC indirekt mendoj se dora e qeverisë edhe me këtë rast i ndëshkon të gjithë qytetarët, por më së shumti Drenasin dhe Drenicën me një terr total. Dihet se menaxherët në KEK janë të preferuarit e koalicionit qeveritar, kështu që nuk ka arsye për të justifikuar se këtë plan e ka hartuar UNMIK-u. Me zbatimin e këtij plani, është bërë segregacion i llojit të vet. Haraçin e tërë kësaj, siç e dini, e paguan 11 fëmijët e djegur të Fortesës së Drenasit, duke u munduar të bëjnë dritë për ditëlindjen e njërit prej tyre me një bombole gazi. E tërë kjo storie, të kujton kohën e Migjenit – skicën e tij “bukuria që vret”, e nga ana tjetër – qëndrimin e qeverisë e shohim te skica “derr i kënaqur” me maskën e Sokratit të vuajtur. Besoj se, po të ishte këtu kryeministri, do t'më kuptonte sepse një pjesë e kabinetit të tij janë njerëz të “sojit të letrave” siç e patë quajtur ai me një rast në një medium publik.

Të nderuar deputetë,

Do të përpiqem t'ua ofroj një pasqyrë të shkurtër sa i përket situatës energjetike në Drenas. Edhe pa këtë plan famoz, Drenica ishte më shumë në terr sesa në dritë, nga se si është dalë e shkatërruar nga lufta, atje ka pasur vetëm ndërhyrje emergjente të rrjetit të shpërndarjes së rrymës, kështu që ajo ka qenë dyfish e censuruar pa rrymë – një herë nga qendra, nga KEK-u dhe një herë nga mospërmbushja e kërkesës së rrjetit shpërndarës të rrymës.

Po ashtu, desha për hir të opinionit të drejtë, t'ju them se KEK-u i ka hyrë në borxh Drenicës në këtë rast, ngase këtu faturimi i rrymës ka filluar në vitin 2000 ndërsa faza e rindërtimit ekonomik 80% ka përfunduar diku në vitin 2003. Me një fjalë, janë faturuar 70% e qytetarëve për një mall që nuk janë shërbyer me të. Edhe ai faturim, ka qenë paushall – diku 70 euro në muaj. Këtu, ekskluzivisht del se kush kujt i ka borxh. Me këtë situatë, mandej KEK-u dhe Qeveria i kanë borxh Drenicës e Drenasit dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës sepse kjo shihet edhe me buxhet dhe se s'është kah qan kokën fare as për qytetarë as për zona të lira.

Krejt në fund, dua të them se nuk e përkrah këtë buxhet dhe ftoj të gjithë deputetët në sallë t'më përkrahin. Faleminderit për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën zoti Nazim Jashari, le të përgatitet Gani Koci.

DEPUTETI NAZIM JASHARI:

I nderuar zoti Kryetar, të nderuar kolegë deputetë,
Fillimisht desha të jap një sugjerim timin, një vërejtje timen lidhur me punën që po vazhdojmë deri në këto orë të vona të ditës së dimrit. Ne, të gjithë deputetët, nuk jemi banorë të Prishtinës, ka prej nesh që gjenetikisht jemi të përcaktuar të udhëtojmë me autobus dhe me taxi dhe nuk e kemi as shansin që të marrim rentacar për të ardhur në Kuvend, kështu që detyrohemi që këtë rrugë ta bëjmë me autobusa dhe autobusat janë autobusa, ata i kanë oraret e veta dhe nuk na presin ne, kështu që ne jemi shumë në dakord, pavarësisht që jemi të opozitës, të punojmë deri në 12 të natës, por me kusht që t'na sigurohet bujtja në Prishtinë. Kjo sa për fillim.

(Ndërhyrje, pa kycje të mikrofonit)

Pika e parë e vërejtjeve që desha të bëj lidhur me buxhetin, është analiza e kapacitetit fiskal ose financiar të Kosovës për mbushjen e këtij buxheti.

Zonja dhe zotërinj deputetë, të gjithë e dimë se si ka lindur ky buxhet i Kosovës, i është thënë buxhet i konsoliduar, i dimë edhe rrethanat në të cilat ka lind, i dimë edhe plotësimet të cilat i ka pasur ky buxhet veçmas në aspektin e investimeve publike nga na e fondacioneve ndërkombëtare. Në atë kohë, ky buxhet është projektuar tepër ulët, nuk është faji i vendorëve krejt, por një pjesë të madhe të fajit e kanë vendorët sepse “joja” dhe “poja” e tyre kanë qenë ajo definitivja – vendimtarja e cila e ka përcaktuar shumën e këtij buxheti dhe shuma prej 700 milion eurosh aktualisht e cila parashikohet me buxhetin të cilin e kemi në trajtim dhe po ashtu e cila është afërsisht e njëjtë edhe në buxhetin e vitit të kaluar dhe sipas kapaciteteve intelektuale të kësaj Qeverie nuk ka gjasa të ndryshojë as për mandatin e vitit të ardhshëm, pra edhe buxheti i vitit të ardhshëm do të jetë i njëjtë sepse edhe korniza afatmesme me të cilën këta lavdërohen 2006/2008 afërsisht në këto shifra e parashikon buxhetin, nuk e plotëson nevojën e Kosovës për funksionim.

Siç e dini, fuqia ekonomike e Kosovës ndoshta nuk është aq e madhe, ka shumë mangësi, ka shumë pa zhvillim mirëpo remitanat në Kosovë janë shumë të mëdha. Ne kemi shumë njerëz në diasporë. Kemi njerëz të cilët për çdo muaj përcjellin para në Kosovë, të cilat qytetarët tanë pastaj i shndërrojnë në mall dhe kjo ekonomi që mbetet gjallë, këto shërbime të cilat funksionojnë kryesisht funksionojnë në bazë të këtyre remitancave që vijnë nga jashtë. Në këtë kuptim, më duhet të them se është absurde që buxheti i Kosovës të jetë 4 apo 5 herë më i vogël se buxheti i Shqipërisë, duke marrë parasysh potencialin ekonomik që kemi afërsisht të njëjtë, dhe shkallën zhvillimore që e kemi absolutisht të njëjtë. Për më tepër, luksi dhe glamuri në Kosovë është larg më i madh sesa që është në Shqipëri. Dhe, në këtë aspekt, më duhet të them se është pikërisht mungesa e ideve, siç u theksua këtu ma herët nga ana e Qeverisë, e cila duke mos parë të nevojshme, por duke u

kënaqur me këtë buxhet mbijetese, me këtë buxhet skamjeje dhe privimi, mungesa e ideve se si të ndryshohej mënyra e vjeljes së taksave dhe të tatimeve – është ajo që e lë këtë buxhet në këtë nivel që është. Të jeni të sigurt zonja e zotërinj, se me një qeveri më të përgjegjshme ky buxhet do të dyfishohej, e pakta do të dyfishohej por donë punë, donë ide, do kreativitet, do këshilltarë të cilët janë të zotët që ta kryejnë punën e tyre dhe nuk do këshilltarë që janë shokë e dashamirë të ministrave. Kjo është ideja themelore e asaj që desha ta përcjell.

Aspekti tjetër, që desha të flas, këtu një deputet edhe e përmendi nevojën, sigurisht me një thumbim të lehtë, me një theks paksa ironik që ta shesim ndërtesën e Kuvendit të Kosovës e të mund ta mbushim buxhetin. Nuk mund të shitet diçka, ndonjë objekt, të cilit i ka dalë i zoti veç aktualisht pronari dhe pronar zonja e zotërinj në Kuvend të Kosovës është zoti Nexhat Daci. Dhe, nuk mund të shitet diçka që ka pronar. Dhe, kur e them këtë, këtë e mendoj me sinqeritetin më të madh sepse është njeriu i vetëm i cili i merr të gjitha vendimet, është njeriu i vetëm i cili i kontrollon të gjitha rrjedhat e financave – flas për Kuvendin e Kosovës vazhdimisht, dhe i cili me një staf të ngushtë të vetin që e ka rreth zyrës së vet, është njeriu që vranë dhe kthjellë në Kuvendin e Kosovës - pa çka - se me këtë mënyrë të procedimit dhe të punës, të papërputhur askund me rregullore të shërbimit dhe me kornizën kushtetuese, ai në njëfarë mënyre e injoron krejt këtë punë tonën që ne e bëjmë këtu. Po, përderisa po lejohet dhe tolerohet nga shumica parlamentare, nuk kemi edhe ne të tjerët çka të bëjmë vetëm që të ankohe mi por shpresojmë se edhe kësaj pune do t'i vijë një ditë – jo fundi por përfundimi.

Pra, shpresoj se edhe niveli i përgjegjësisë do të rritet në këtë Kuvend dhe do të mund ta kemi një punë paksa më normale siç e kanë kuvendet e mbarë botës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Radhën për fjalë e ka Gani Koci, le të bëhet gati Xhevdet Neziraj.

DEPUTETI GANI KOCI:

Faleminderit zoti Kryetar. Si duket në këto orë, po them të vona të kësaj dite dimri sikur i ka rënë serioziteti diskutimit dhe çështja të cilën e diskutojmë është shumë serioze, po ne vërtetë diskutimet tona nuk duhet t'i bëjmë për atë se t'na sheh dikush në televizion, po kur këtu s'na marrin vesh natyrisht mirë është edhe ajo që t'na marrin vesh bile së paku ata që janë përjashta, sepse flasim për ta.

Dua të filloj diskutimin tim për Projektbuxhetin, me konstatimin se nuk ka asgjë të re në këtë propozimbuxhet përse i përket strukturës së të hyrave dhe shpërndarjen e tyre nëpër njësi buxhetore, përveç asaj që për vitin fiskal 2006 shpenzimet ky buxhet do t'i ketë më të pakta për 14 milion euro, krahasuar me vitin 2005.

Risi tjetër, është edhe e dhëna se Qeveria e Kosovës, për herë të parë, ka krijuar një deficit buxhetor për afër 40 milion euro që, po të shikohet nga pikëpamja ekonomike, është në

kufijtë e të lejueshmes por kur dihet fakti tjetër se kjo Qeveri e ka filluar vitin fiskal 2005 me 160 milion euro suficit atëherë del se kjo Qeveri nuk di se si dhe ku i ka shpenzuar afër 200 milion euro.

Nëse suksesi i çdo qeverie matet me projektimin, shpërndarjen dhe menaxhimin e drejtë të buxhetit, atëherë lirisht mund të vijmë te një konstatim tjetër – se kjo Qeveri e ka keqmenaxhuar buxhetin e vitit 2005 dhe ka dhënë argumente të mjaftueshme që kështu do të vazhdojë edhe në vitin 2006. Këtë të dhënë dua ta ilustruj me një shembull konkret. Është një njësi buxhetore që nuk di ku funksionon ajo qendra financiare e hulumtimit që për nevoja të këtij agjencioni, të kësaj njësie buxhetore për karburante i është miratuar një buxhet prej 66 mijë eurove, ndërsa ka vetëm 13 punëtorë në këtë njësi buxhetore. Po të shndërrohen në litra ato 66 mijë euro, atëherë na dalin 66 mijë litra karburant me çmimin e tregut me pakicë dhe po të ndahet në punëtorë atëherë për një ditë secili punëtor do t'i bie nga 14 litra karburant të shpenzojë dhe po të ishin ato farë agjencione transporti urban – jo ndërurban, sigurisht se ata nuk do të punonin asnjëherë në zyrë sepse s'do të kishin kohë duke lëvizur gjithë ditën e lume me automjetet e tyre. Ndërsa, e njëjta shumë për të njëjtën gjë, Ministrisë së Energjetikës – me 125 punëtorë më duket – ka më pak shpenzime për karburante, do të thotë diku rreth 64 mijë euro. Kjo tregon se si është bërë shpërndarja e buxhetit dhe kësi shembujsh ke të mjaftueshëm.

E keqja më e madhe e këtij projektbuxheti qëndron në atë se Qeveria nuk ka marrë për bazë asnjë faktor ekonomik dhe social në shpërndarjen e buxhetit dhe se ndarjet janë kopjuar gati me saktësi matematikore nga buxheti i vitit të kaluar, me përjashtim të zyrës së Kryetarit të Kosovës që i është rritur buxheti, një buxhet enorm prej 30%.

Ajo që esencialisht e dallon këtë projektbuxhet nga viti i kaluar, është e dhëna se propozuesi ka bërë përpjekje që ilegalisht ta fusë dispozitën 9.3 për të legalizuar veprimet e paligjshme të transfereve buxhetore nga një ministri buxhetore në ministrinë tjetër, siç ka bërë edhe me buxhetin e vitit 2005 dhe që është plotësisht në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Megjithëkëtë, në këtë rast, unë do të ndalem vetëm te buxheti i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe atë kryesisht në linjën e shpenzimeve për infrastrukturë rrugore, që është propozuar në shumë prej 27.274.000 euro, nga të cilat 19 milion euro për projekte kapitale, ndërsa 8 milion për mirëmbajtje të rrugëve dhe është shumë karakteristike se këta 8 milion janë futë në linjën e mallrave dhe shërbimeve dhe ju e dini fort mirë se kjo linjë është makina më e madhe shirëse e parasë publike.

Kur jemi këtu, së pari do të dëshiroja të dije nga propozuesi se çka nënkupton me mirëmbajtje dhe çka në rehabilitim të rrugëve, si dy nëndarje të veçanta. Po të shikonim projektet që do të realizojë kjo Ministri, atëherë të gjitha shpenzimet kapitale do të shkojnë vetëm në rehabilitim dhe mirëmbajtje të rrugëve dhe shumëpak ose hiq në rrugë të re. Kjo Ministri, sikur ka harruar se ky Kuvend ka miratuar një ligj për rrugët dhe se ky ligj saktë

ka përcaktuar përgjegjësitë e Ministrisë po edhe të pushtetit lokal përsa i përket kompetencave për ndërtimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe menaxhimin me rrugët, varësisht nga kategoria e përcaktuar me ligj.

Neni 8.1 i këtij ligji thotë shumë qartë se Ministria është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve magjistrale dhe regjionale, ndërsa komuna të atyre lokale. Ministria nuk ka vepruar drejt dhe në përputhje me këtë ligj dhe se të gjitha shpenzimet kapitale (këtu i kemi të dhënat se ku i orienton shpenzimet kapitale dhe në cilat projekte) i ka orientuar në rrugë të karakterit lokal. Ju lutem, shikojeni këtë listë dhe do ta shihni se këto janë rrugë dhe projekte politike dhe jo rrugë të karakterit publik. Gjatë përcaktimit të buxhetit për vitin 2006 në Qeveri është dorëzuar një kërkesë dhe një projekt për ndërtimin e rrugës Skenderaj-Vushtrri, i cili projekt edhe në Qeverinë e kaluar ka hyrë si prioritet, por nuk di se si dhe për çfarë arsyesh nuk është futur në Projektbuxhetin e vitit 2006.

Zotëri të nderuar të Qeverisë, dua t'ju përkujtoj se kjo rrugë është rrugë e karakterit regional dhe se për këtë rrugë ka pasur edhe një projekt të viteve të 80-ta të shekullit të kaluar, por pushteti i atëhershëm monist, e dini se me çfarë syri e ka shikuar regjionin e Drenicës, prandaj nuk është mirë për pushtetin e sotëm që ta ketë të njëjtin shikim kur dihet se 19 fshatra lidhen dhe kanë dalje të drejtpërdrejtë në këtë rrugë dhe fakti tjetër se kjo rrugë është arterie që do të shkurtonte lidhjet për dhjetëra e dhjetëra kilometra ndërmjet regjioneve të Llapit dhe të Rrafshit të Kosovës, Drenicës e Dukagjinit dhe do të shkarkonte në masë të konsiderueshme dy magjistralet kryesore, atë Mitrovicë-Prishtinë dhe Pejë-Prishtinë.

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, si ajo e kaluara, si edhe kjo e tashmja, e din mirë se në cilat regjione ka investuar më shumë ose më pak në infrastrukturën rrugore. Prandaj, edhe në buxhetin e vitit të kaluar dhe në këtë të vitit 2006 orientimi është vetëm një drejtimesh, po e përsëris, drejt projekteve dhe rrugëve të përkatësisë politike dhe jo drejt atyre regjionale dhe të nevojshme. Që të mos jetë kështu, Qeveria duhet ta fusë si projekt në buxhetin e vitit 2006 dhe për këtë ka ende kohë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë do t'ju lutja për durim. Janë edhe gjashtë diskutues, por duhet të mundohemi të jemi më racional. E ka fjalën Xhevdet Neziraj, le të përgatitet Selvije Halimi.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ:

I respektuar Kryetar i Kuvendit akademik Daci, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë, Buxheti ende është në fazën emergjente dhe është një buxhet i vogël i cili nuk mundëson

rritje të pagave të asnjë sektori, prandaj as të përmirësimit të mirëqenies sociale. Me siguri se edhe ministri do të kishte kritika më pak sikur të ishte buxheti më i madh, por mundësitë ekonomike të Kosovës janë këto.

Unë do të përqendrohem në grandet të cilat janë duke u ndarë nëpër qytete. Kjo u kritikua mjaft mirëpo vi nga qyteti i Pejës që vite me radhë diskriminohet në këtë aspekt. Arsyeja ka qenë numri i regjistrimit të banorëve, ku dihet se edhe Prishtina, edhe Peja janë një prej qyteteve që kanë popullsi më tepër sepse kanë arritur nga qytetet tjera. Dhe, në këto dy qytete janë më të sterngarkuara. Prandaj, edhe janë ashtu pa grande qeveritare janë eliminuar të them padrejtë.

Nuk jam lokalist sikur këta të Prizrenit që deshën me na qitë prej Parlamentit për një institut, që u ankuan, edhe pse Prizreni dhe Peja janë përfaqësuar me banorë të njëjtë e gati dyfishë e kanë buxhetin më të madh. Do të thotë është si një arsye pak që duhet të shqyrtohet.

Përsëritës Ministrinë që ka filluar me grande stimuluuese për tatimet në pronë, grande këto që bëjnë kthimin e një pjese të tatimit dhe aty qytetarët e shohin veten se është duke u kthyer një pjesë e kontributit në infrastrukturë dhe mirëqenie. Mirëpo, këto grande do të ishte mirë t'u jepjen edhe në ato komuna ku bëhet një grumbullim më i madh i të hyrave nga biznesi, nga firmat që posedojnë ato komuna dhe nga të hyrat tjera që dhënë këtë kontribut, dhe kishte me qenë shumë stimulative për këto komuna që kontribuojnë, kështu që do të rriteshin të hyrat buxhetore në buxhetin e Kosovës.

Një çështje që ish kryeministri Bajram Rexhepi e preki janë dhe do të ndalem më tepër, është Ministria për kthim dhe komunitete ku ka afër 9 milion, drejtoria prapë për komunitete ku ka mbi 3 milion, gjithashtu edhe zyra për komunitete pranë kryeministrit por është edhe ndarja e drejtë buxhetore në bazë të komuniteteve. Shumë po flitet për këto mjete, shumë po flitet se po ndihmohet, mirëpo të jeni të sigurt se nuk janë duke i shfrytëzuar të gjitha komunitetet.

Me plotë përgjegjësi e them, komuniteti egjiptian gjatë vitit 2005 nuk ka shpenzuar nga të gjitha këto të hyra asnjë cent, dhe them lirisht ministria duhet të thirret ministria për komunitet dhe jo për komunitete. Unë besoj se në vitin 2006 kjo duhet të jetë një sinjal dhe të ndizen reflektorët dhe të shikohet se për cilat komunitete

duhet të harxhohen. Ne kemi një kthim shumë të madh të komunitetit egjiptas në Rrafsh të Dukagjinit - kthim individual, ndërsa nuk është bërë as nga bashkësia ndërkombëtare as nga ministria dhe nga askush asnjë ndërtim dhe asnjë shpenzim s'është bërë. Prandaj viti 2006 duhet të kthjellat nga të gjitha këto dhe të jetë një sinjal edhe për ministrinë për kthim dhe komunitete. Unë e di se aty ka probleme, e di se janë marrë mjete të mëdha financiare, gjithashtu zyra për komunitete prapë menaxhohet në shumë vende në zyrat lokale nga të huajt kështu që duhet t'ju thuhet stop një herë dhe përgjithmonë sepse shumë po flitet për komunitete ndërsa i shfrytëzon vetëm një komunitet sepse ka mbrojtje institucionale nga shumë mekanizma, ndërsa s'po mbrohen shumë komunitete se s'kanë mbrojtje nga askush. Prandaj, Qeveria duhet të jetë syçelë në këtë drejtim. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit Xhevdet. E ka fjalën Selviqe Halimi, le të përgatitet Shaban Halimi.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI:

Përshëndetje për të gjithë. Unë do të provoj që të jem shumë e shkurtër në diskutimin tim, meqenëse shumë gjëra u përmendën këtu. Mirëpo, nuk mund t'i duroj asaj e të mos them se thellimi i varfërisë në Kosovë ka reflektuar me një ulje të standardit jetësor të popullatës së Kosovës dhe me një shtim të numrit të të sëmurëve dhe pikërisht kësaj Ministrie i ulet buxheti. A është buxhet në shërbim të qytetarëve ky?

Të nderuar deputetë, i nderuari Kryetar i Parlamentit dhe ju ministra që jeni prezent, Unë mendoj se me buxhetin e vitit 2006, qytetarëve të Kosovës iu është ofruar vetëm një mur i shndërruar në blindë në mes të administratës qeveritare dhe shërbimeve që iu ofrohen qytetarëve. Do të thotë, ata nuk do të jenë përfitues qoftë në shëndetësi, arsim, apo në shërbime tjera komunale, infrastrukturë e gjëra të tjera.

Të gjitha projektet që parashihen këtu, megjithë respektin që është munduar të punojë Komisioni funksional, gjegjësisht Komisioni i buxhetit, që të shohë të metat e një shpërndarjeje tabelore të këtyre numrave që rezultojnë me një shifër prej 700 milion, unë e shoh se asgjë nuk është bërë dhe asnjëherë administratës qeveritare, Presidencës dhe Kuvendit të Kosovës asnjëherë nuk i duket boll apo nuk i duket e mjaftueshme se është ngopur me mallra dhe shërbime që mund të kategorizohen në kompjuter dhe vetura, por as nuk është ngopur me paga dhe mëditje që nënkupton se mëditjet edhe janë të tepruara në këtë buxhet të varfër por edhe shpërndahen te poseduesit apo marrësit e këtyre mëditjeve me standard të dyfishtë.

Unë nuk po zgjas më tepër, vetëm ju them se qytetarëve të Kosovës nuk kemi pse t'iu ofrohen inkasantët apo administrata tatimore që të kërkojnë tatime e taksa prej tyre nga se buxheti është vetëm për administratën apo shërbyesit civil në nivel të Qeverisë, Kuvendit apo Presidencës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Shaban Halimi, le të përgatitet Hatixhe Hoxha.

DEPUTETI SHABAN HALIMI:

I nderuari zoti Kryetar, zoti ministër, të nderuar kolegë deputetë, Normal që, pas diskutimeve kaq të gjata, nuk na mbetet edhe neve që të diskutojmë aq shumë të diskutojmë ashtu si kemi planifikuar dhe të diskutojmë lidhur me buxhetin, por jemi munduar që të reduktojmë e të themi atë që s'është thënë deri më tani.

Për mendimin tim, ky buxhet, krahasuar me buxhetin e vitit 2005 ka epërsitë e tija, për çka që në fillim do të them se do t'i jap përkrahje në leximin e parë që të shkojë në leximin e

dytë për këto arsye. Sepse edhe ligji i përpunuar, domethënë Projektligji për këtë buxhet është më cilësor krahasuar me Projektligjin e vitit 2005, që është hap pozitiv në këtë drejtim, ku shënon rezultate ose iniciativa në kursime dhe iniciativa më precize ose më konkrete drejt përpilimit të buxhetit edhe atij sintetik edhe atij analitik.

Nga ana tjetër, është se ky buxhet po ashtu është i vlerësuar, ashtu sikur u tha edhe nga ana e ministrit në raportin e Kai Eides që është një buxhet i mirë, një buxhet që hap perspektivën do të thotë për plotësim të standardeve.

Është e kuptueshme se me buxhetin dhe me ekonominë momentale çfarë e kemi në territorin tonë të Kosovës të kemi një buxhet që të kënaqen të gjitha nevojat tona në përgjithësi çfarë i kemi, duke mos abstrahuar të gjitha ato kërkesa dhe nevoja të cilat u prezantuan këtu, sepse as më pak e rëndësishme nuk është shëndetësia, as pak më e rëndësishme nuk është kultura, as pak më e rëndësishme nuk është zhvillimi ekonomik dhe të gjitha këto. Por, unë këtu kam parasysh se krahasuar me vitin e kaluar, këtë vit Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ka pasur një transparencë më të madhe duke i dëgjuar të gjitha kërkesat do të thotë të agjencive buxhetore, duke u nisur nga agjencitë më të vogla buxhetore e deri te agjencitë më të mëdha.

Kuptohet, se në këtë drejtim asnjëri s'jemi të kënaqur, them edhe unë për komunën time se nuk jam i kënaqur, por këtë duhet ta shikojmë në rrafshin real të shfrytëzimit të këtij buxheti ose të planifikimit të këtij buxheti. Kur kam parasysh këtë, unë them se duhet të lidhemi me pozicione. Atëherë, nëse propozojmë ose kërkojmë një pozicion që të kënaqet, atëherë duhet të kemi edhe propozime tjera konkrete se nga cilat pozicione këto mjete duhet – a kuptoni – të hiqen a të eliminohen.

Krahas shumë kërkesave, krahas shumë kërkesave ose edhe iniciativave të cilat u dhanë në mënyrë konkrete këtu, unë do të përmendja që në këtë drejtim kemi edhe kategori të tjera që në mënyrë indirekte u përmendën, sikur janë: çështjet sociale, çështjet e luftëtarëve por edhe pensionistët të cilët janë në një pozitë për shembull shumë më të palakmueshme, e po ashtu edhe arsimi. Kemi pozicionet, për shembull të pensioneve bazë, subvencioneve të invalidëve dhe të skemave të asistencës sociale. Këtë e përcjell edhe nga praktika e pushtetit lokal, se këto dy skema janë mase të nevojshme të rishikohen, të ripërpunohen edhe një herë dhe të vëhen kritere krejt tjera në përfituesit e këtyre pensioneve dhe asistencës sociale. Shuma, që të dy këto bëjnë diku 80-90 milion euro dhe jam i bindur se nja 30% nga këto mjete mund të kursehen dhe të jenë si një bazë e fortë për rritjen ose për stimulimin e pensionistëve dhe kategorive të tjera tash më të rrezikuara.

Në anën tjetër, sa u përket pozicioneve, unë mund të them këtu se shumë kemi favorizuar subvencionimin ose transferin e korporatës përmes subvencionimit dhe transferim të ndërmarrjeve publike dhe këtu duhet të ushtrojmë ndikim që këto të vëhen në këmbë të veta, të funksionojnë dhe të krijojnë ose të rigjenerojnë të hyra të tyre përmes shërbimeve që krijojnë. Ka mundësi, ka potenciale, mund të përgatiten projekte, mund të përgatiten programe dhe në këtë drejtim do të thotë sigurisht se do të jetë një kursim buxhetor.

Në anën tjetër, absolutisht nuk do të mundnim me pasur një buxhet të konsoliduar, një buxhet të qëndrueshëm që nga një buxhet harxhues të dilet me një buxhet investues dhe këtë unë e them duke pasur parasysh të gjitha rrethanat ekonomike deri në vitin 2008, ashtu siç është edhe në kornizën zhvillimore të buxhetit, sepse dihet se me çfarë trendi dhe me çfarë hapash është duke ecur ekonomia, sidomos biznesi i vogël që unë mendoj se biznesi i vogël në përgjithësi është në një krizë, është në një rrezik dhe nuk pritet gjenerim i shumë të hyrave, në realitet fitimet e tyre në mënyrë që edhe ne si pushtet të realizojmë të hyra, sepse edhe ata janë duke jetuar me kredi, janë duke mbajtur bizneset e tyre me kredi.

Në anën tjetër, për këtë mendoj se duhet një paket e masave – ndoshta të propozuar nga Parlamenti, ndoshta të propozuar nga Qeveria, ose nga njerëz eminent – sidomos rreth një paket masave për kursimet. Unë mendoj se në këtë drejtim kemi praktika që ende mendojmë se paret e buxhetit ose paret e buxhetit të Kosovës janë pare të shtetit dhe me këto mund të manipulohet, me këto mund të përdoren, këto mund të shpenzohen si të mundemi, dhe këtu ka mjaft masa, mjaft argumente se si mund të kursehet buxheti, qoftë edhe përmes masave sanksionuese qoftë edhe përmes masave stimuluese për agjencitë buxhetore të cilat janë të afta të menaxhojnë dhe të kursejnë në buxhetet e tyre.

Në anën tjetër, kemi edhe organet e kontrollit për të cilat shumë pak them se janë të angazhuara në këtë drejtim, edhe në nivelin qendror edhe në nivele lokale, për shembull çështja e revizorëve, që ata duhet të jenë më ofiçient sidomos në shikimin ose kontrollimin e buxheteve dhe shfrytëzimit të tyre. Luftimi i ekonomisë informale, që është në dëm të ekonomisë formale, që dëmton bizneset, që gjithashtu dëmton edhe buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Konkurrenca jolojale dhe njëherit e organet e drejtësisë ose organet tjera përgjegjëse të cilat duhet të jenë më rigorozë dhe të cilat duhet të jenë më aktive në këtë drejtim në ndriçimin sidomos prokuroria dhe gjykatat. Kemi po ashtu edhe mjete të cilat janë jashtë territorit të Kosovës, në bankat do të thotë të shteteve perëndimore, sidomos të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit dhe mjete të tjera, për shembull të agjencioneve të tjera, mjete të cilat rrinë. Ky është një burim i mirë me të cilin mund të vëhet në funksion ndonjë ekonomi, siç është për shembull Trepça, siç janë edhe ekonomitë tjera që mund të sjellin fitime.

Kështu unë për veti kisha për veti sugjerime për planifikimin në realitet të buxheteve dhe në anën tjetër dua të shtroj një çështje që është me interes mendoj për komunën time. Është problemi i ndarjes së drejtë të mjeteve.

Komuna e Dragashit, që nga viti 2000, do të thotë bën përpjekje edhe në Ministrinë e Ekonomisë së Financave, bën përpjekje edhe në zyrën pranë Përfaqësuesit special për ndarje të drejtë të mjeteve për komunitete, e sidomos në lëmin e arsimit, ku kemi probleme të mëdha. Kuptohet, kjo sferë është rregulluar edhe me Ligjin mbi arsimin, ku për nxënësit shqiptar është ndarë buxheti 77 euro për kokë nxënësi dhe një arsimtar është për 21.50 nxënës, kurse për minoritar është 92 ose 95 euro për kokë nxënësi, që në njëfarë forme do të thotë është i favorizuar me Ligj. Komuna e Dragashit ballafaqohet me këtë problem, sepse vetëm nga sektori i arsimit duhet të ndajë 90 deri 110 mijë euro nga pozicioni i investimeve kapitale për të mbuluar këtë diferencë.

Nuk jam kundër kësaj, do të thotë – ndarje, por unë mendoj se është e nevojshme që të rishikohet, nuk është aq në kompetencën e ministrit të financave, por është mirë që kjo të diskutohet në zyrën e Përfaqësuesit special kjo çështje. Faleminderit për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Hatixhe Hoxha, le të përgatitet Xhevat Bislimi. Lus deputetët që të kthehen në sallë.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA:

Zoti Kryetar, të nderuar deputetë,
Në fjalën time do të ndalem tek buxheti për vitin 2006 dhe atë te Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente.

Derisa në buxhetin e vitit 2005, për Departamentin e çështjeve jorezidente kanë qenë ndarë diku rreth 242.000 euro, në buxhetin e vitit 2006 shohim se për Departamentin do të ndahen diku 130.000 euro. Prandaj, është një zvogëlim do të thosha drastik i buxhetit për këtë Departament. Mendoj se do të duhej të ishim shumë të kujdesshëm ndaj diasporës, edhe përkundër faktit se në këtë Departament ka pasur shumë projekte, por ato nuk janë mbështetur.

Ne çdo herë, në fund të vitit miratojmë buxhetin për vitin në vijim dhe asnjëherë nuk kemi një pasqyrë në të cilën do të shohim se mjetet që janë ndarë në vitin paraprak a janë shfrytëzuar vërtetë për qëllimin që janë paraparë apo ka pasur ndryshime të linjave buxhetore. Pra, do të ishte me shumë interes, por edhe shumë e domosdoshme t'na ofrohet një pasqyrë e shpenzimeve buxhetore për vitin 2005.

Të nderuar deputetë,
Do të dëshiroja të përqendroja vëmendjen tuaj dhe të theksoj vetëm disa gjëra që mendoj se ia vlen të theksohen. Për shembull, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente, shohim se kemi ndryshime të linjës buxhetore nga një departament në departamentin tjetër, apo edhe janë shpenzuar mjete aty për projekte të paparapara. Për këtë, më bind rasti i blerjes së dy veturave në Departamentin e Sporteve, që kushtojnë – të dyja së bashku – afërsisht 87.000 euro, edhe pse këto mjete nuk kanë qenë të parapara për blerjen e veturave.

Për shpenzime të paplanifikuara të mjeteve nga buxheti, flet edhe rasti tjetër. Kështu, vetëm për organizimin e festivalit “Kënga magjike” janë shpenzuar afërsisht 150 mijë euro, mjete këto të paplanifikuara.

Atëherë, shtrohet pyetja: a janë siguruar mjetet për projektet e paplanifikuara apo ndoshta ndryshimi i linjave buxhetore ka bërë që mjetet e parapara dhe të ndara për qëllime të caktuara mos të arrijnë në destinacionin e paraparë dhe kështu të krijohen shumë dilema: se vërtetë ato mjete janë menaxhuar drejt apo aty kemi keqmenaxhim të buxhetit.

Sa përket buxhetit të Ministrisë së Transportit dhe Posttelekomunikacionit, do të ndalesha te aviacioni dhe hekurudhat. Sa i përket aviacionit shihet se këtu nuk kemi ndarje nga buxheti i vitit 2006. Shqetësimi im ka të bëjë me faktin se në vitin 2005 u ndanë me vonesë nga buxheti i Kosovës për Aeroportin disa milion euro dhe mua më intereson të di se a ka raport detaj Ministria e Posttelekomunikacionit se si dhe ku janë shfrytëzuar ato mjete, pra a janë menaxhuar drejt.

Sa u përket hekurudhave, shihet se janë ndarë mjete nga fuqia e rezervuar. Por, duke ditur gjendjen në terren, duke pasur parasysh faktin se deri më tash për infrastrukturën hekurudhore është bërë pak ose është treguar kujdes i pamjaftueshëm, na bindin faktet – sikur këtu që pranë vetes kam shumë fotografi ku shihet se vërtetë kjo infrastruktura është lënë pa kujdesin e nevojshëm. Këtu janë disa incizime ku shihet se trupi i hekurudhës është marrë dhe shkëputur. Në këto tjerat këtu, në fund nuk ekziston fare trupi i hekurudhës, e të tjera.

Prandaj, duke pasur parasysh faktin se në çfarë gjendje gjendet infrastruktura hekurudhore, mendoj se duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe se mjetet e parapara për hekurudha të menaxhohen drejt. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit shumë. E ka fjalën Xhevat Bislimi dhe le të bëhet gati Zahrije Jusufi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI:

Zoti Kryetar, kolege dhe kolegë deputetë,
Miratimi i Projektbuxhetit për secilin vend normal është një ngjarje e shënuar, por jo për Kosovën dhe Qeverinë e saj. Mungesa e Kryeministrit dhe e kabinetit të tij në këtë debat, është fakti më i mirë se kjo ngjarje është jo fort e rëndësishme dhe si duket kabineti

qeveritar e ka të siguar tashmë miratimin e këtij Projektbuxheti, pavarësisht asaj se çfarë do të thotë ky Kuvend.

Para se të miratohej ose të debatohej për këtë Projektbuxhet, mendoj se ka qenë e udhës që ky Kuvend të informohet dhe të dinte se si u menaxhua buxheti i vitit 2005. Raporti nëntëmujor për menaxhimin e këtij buxheti, mungon. Ka shkuar deri në Komisionin për buxhet dhe financa, por nuk ka ardhur në Kuvend.

Janë bërë pikërisht në këtë Kuvend një lum akuzash për shpërdorime, korrupsion, menaxhim të dobët të buxhetit e tjera, e tjera. Është bërë edhe nisma – kërkesa për krijimin e një komisioni hetimor, por koalicioni qeverisës dhe kolegët tanë të nderuar të këtij koalicioni e kanë bllokuar këtë nismë. Bllokimi i kësaj nisme rritë edhe më shumë dyshimet se buxheti i vitit 2005 nuk është menaxhuar ashtu siç e do interesi i Kosovës dhe i qytetarëve të saj.

Buxhetit të sotëm, ose buxhetit për vitin 2006 besoj që më së shumti do t'i gëzoheshin ose do t'i gëzohen - në qoftë se miratohet kështu – tre individ drejtues institucionesh: kryetari Rugova, buxheti për zyrën e të cilit është rritur; kryetari Daci, i cili gjithashtu përfiton bukur mirë dhe zyra e tij; si dhe kryeministri, i cili gjithashtu ka një rritje të buxhetit për të, për zyrën e tij dhe për vartësit e tij. Shpenzimi i buxhetit të Kosovës për ndërtim vilash, për vetura luksoze ose superluksoze është veprim që nuk e nderon asnjërin prej këtyre individëve dhe as institucionet tona dhe as Kosovën tonë. Këtij buxheti, sigurisht nuk do t'i gëzohen as arsimit, as shëndetësia, as biznesi i vogël, as kategoritë tjera të rrezikuara sociale – ekzistenca normale e të cilave tashmë është e rrezikuar. Bëhet fjalë për miliona euro që do të shpenzohen nga 3 zyrat kryesore. Këta drejtues të këtyre zyrave sikur janë futur në garë se cili do të përfitojë më shumë, cili do të bëjë vilë më të bukur, cili do të bëjë makinë më luksoze, më të sigurtë e tjera, e tjera.

Dua të tërheq vërejtjen edhe për linjën, ose zërin buxhetor – mallra dhe shërbime. Për institucionet e përkohshme qeverisëse të Kosovës zëri për paga dhe meditime është 47 milion e diçka euro, kurse zëri buxhetor – mallra dhe shërbime është 57 milion e diçka euro. Domethënë, më shumë para ndahen për shërbime dhe mallra sesa për paga. Dhe, asnjëri prej nesh nuk e din se çfarë shërbime do të kryhen me këto 57 milion euro, çfarë mallra do të blihen, sepse nga e kaluara ose nga buxheti i kaluar ne e dimë se nga kjo linjë buxhetore është paguar edhe paga mujore për Simon Hazellokun i cili, me sa e di unë, vazhdon të paguhet prapë nga 115 mijë euro në muaj dhe 3 herë e kam ngritur këtë çështje – për ministrin, për kryeministrin dhe as sot e kësaj dite nuk kam marrë përgjigje nëse vazhdon të paguhet ky zotëri me gjithë këto pare apo jo. Kurse, për shpenzimet kapitale, janë paraparë vetëm 74 milion euro. Domethënë, ky buxhet, këta zëra buxhetor janë vërtetë për çdo kritikë. Miliona të tjerë janë paraparë për kompaninë, që quhet KEK. Për KEK-un që të paktën për këto 6 vite veç sa ka shkatërruar biznesin e vogël, ekonominë e Kosovës me mosfurnizim të rregullt me energji elektrike, veç sa ka shkatërruar jetën normale të qytetarit tonë, të studentit tonë, të nxënësit tonë. Dhe, megjithatë, prapë janë ndarë gjithë ata miliona për këtë kompani dhe nuk e dimë se çfarë do të bëhet me ato miliona – do të përfundojnë prapë nëpër xhepa të dikujt apo do të mirëmbahet rrjeti, do të mirëmbahen termocentralet, a do të bëhet një termocentral i ri, apo një hidrocentral i ri e tjera, e tjera dhe qytetari ynë t'i thotë lamtumirë territ që mesa duket në këtë qeveri nuk do t'i thotë asnjëherë. Vetëm me ikjen e kësaj qeverie mund të vijë edhe dritat ndoshta për Kosovën.

Ndoshta, është për të qeshur. Qeshim, s'ka problem sepse ne institucionet kemi drita, kemi siguruar ata gjeneratorët e fuqishëm dhe asnjëherë nuk na lënë në errësirë, kurse qytetari ynë vazhdon të jetë në errësirë. Ju faleminderit.

Kërkoj, në fund - që ky Projektbuxhet të rikthehet në shqyrtim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit shumë. E ka fjalën Zahrije Jusufi, dhe kapaku - profesor Sabri Hamiti.

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI:

I nderuari zoti Kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë,
Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë prej 48.544 milion euro i zvogëluar mbi 10% prej 53.844 euro nuk shënon përparësi në prioritetet e paraqitura të programit të Qeverisë për përmirësimin e shëndetit të qytetarëve. Fushat kyçe dhe prioritare në shëndetësi përsëri, si edhe vitin e kaluar, do të mbeten të zbrazëta. Kushtet e punës, pajisjet je vjetruara, mos investimi në edukim të kadrove specialistike dhe supspecialistike nuk mund të ngriten në nivel më të lartë, mund të plotësohen vetëm nevojat minimale.

Në institucionet shëndetësore mbretëron një gjendje shumë e rëndë, duke filluar nga mungesa e aparateve më elementare për diagnostifikim, diagnostikë e mangët laboratorike, rëntgenologjike si parakushte të domosdoshme për funksionim. Mungojnë pothuaj se të gjitha barnat e listës esenciale, mungojnë pajisjet dhe barërat për intervenime emergjente, mjetet dezinfektuese. Nuk investohet në edukim të resurseve humane për të zvogëluar nevojën e dërgimit të qytetarëve jashtë Kosovës. Për trajtim jashtë vendit janë ndarë vetëm 500.000 euro. Mendoj se Ministria e Shëndetësisë nuk i parashtrori drejt vlerësimet e shpenzimeve.

Në buxhet nuk janë projektuar pos të tjerash edhe shpenzimet shtesë të propozuara nga Komisioni - për punën e natës të punëtorëve shëndetësor, në mënyrë që të ndihmojnë në shqyrtim të shpenzimeve të reja. Ndërkaq, në raportin e buxhetit shohim rritje të panevojshme buxhetore në disa agjencione buxhetore. Shohim ndarje në shpërputhje me kërkesat, orientim të gabuar të shpenzimeve për arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale, si nga klasifikimi ekonomik dhe funksional.

Sa i përket strukturës së shpenzimeve ajo është në shpërputhje të financimit të nevojave emergjente. Do të veçoj disa orientime të mjeteve në shpërputhje me kërkesat. Për shembull zyra e presidentit, me 50 punëtorë – për paga dhe mëditje 187.370 euro; për mallra dhe shërbime 1.100.000, për investime kapitale 1.800.000, ndërkaq Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me 649 punëtorë – për paga dhe mëditje 1.760.000, për mallra dhe shërbime 1.100.000, ndërkaq për investime kapitale vetëm 2.280.000. Ose zyra e koordinatorit të TMK – me numër të stafit 3.325 – paga dhe mëditje 8.600.000, për mallra dhe shërbime 4.200.000, ndërkaq për investime kapitale vetëm 4.600.000.

Në raport nuk shohim as mundësitë më të vogla për fuqizim financiar të skemave sociale, duke përfshirë edhe pensionistët. Kështu, për pensione bazike janë ndarë 63.500.000 euro, për pensione të personave me paaftësi mendojmë se është numër shumë i madh i tyre dhe se duhet të ndryshohen këto pensione. Duhet të rishqyrtohen sepse u pensionuan edhe ata që nuk i plotësojnë kriteret për pensionim. Ndërkaq, për invalidët e luftës, vetëm 73 milion. Kërkojmë trajtim të pranueshëm, bazuar në merita të familjeve të dëshmorëve, veteranëve, invalidëve të luftës – si obligim institucional – të jetësohet sa më parë ligji për këto kategori. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën profesor Hamiti, besoj e ke lyp për shkurt, zgjate sa të duash, urdhëro.

DEPUTETI SABRI HAMITI:

Jo, shumë jo. Faleminderit zoti Kryetar i Kuvendit.

Unë po shoh që duke u lodhur njerëzit, po bëhen më esencial e s'po flasin në retorikë. Shumë mirë është, domethënë duhet me i lodhë për t'u bërë esencial.

Unë do të flas vetëm për dy fusha, që i njoh më së miri: është problemi i kulturës dhe i arsimit, dhe do t'i jap dy-tri propozime.

Ne kemi këtu një strukturë buxhetore, të cilën unë nuk dua ta kontestoj sepse sigurisht ekziston një baraspeshë i hartuesve që kanë distribuuar materiet ose shumat nga ministria në ministri. Po unë do të them që brenda këtyre shifrave, nëse studiohet distribuimi, ka shumë sende që duken të pasistemuara mirë dhe që nuk i plotësojnë mirë kërkesat. Kam parasysh buxhetin e Ministrisë së Kulturës, ku janë nja 6 milion e 300 e diçka mijë. Nëse analizohet mirë teksti - distribuimi atëherë del që për përkrahje institucionale të kulturës jepen krejt 300 mijë, që është shumë qesharake dhe duhet të rindërtohet ky sistem.

Këtu kemi, në shtyllën e shpenzimeve kapitale - thuhet se janë nja 295 e tjera... Po, keni kujdes – në kulturë shpenzim kapital është botimi i librit të mirë, në kulturë shpenzim kapital është investimi në film të mirë. Nuk është në mbarim vetëm të shtëpive e të mureve. Kjo është veprimtari që kësaj radhe duhet të specifikohet mirë sepse këtu e atje, është thënë edhe në këtë Kuvend por edhe jashtë tij, që kemi pasur disa investime në kulturë ose subvencionime të papërshtatshme – t'i quaj unë me fjalën më të vogël. Në mënyrë që këto të mos ndodhin, unë kërkoj që brenda kësaj shume që është te Ministria – të specifikohet: çka është kulturë dhe çka finanohet si kulturë - ta quajmë ne institucionalisht - që i bie elite.

Unë po ju them, vetëm në fushën e librave në Kosovë, pas kalljes së hatashme të bibliotekave, ka nevojë që librat kapital të rimerren, të botohen dhe të çohen nëpër biblioteka. Nëse jo për shitje të lirë, atëherë është nevojë imanente për bibliotekat që shfrytëzohen, ose në lëmin e filmit, ose të teatrit e tjera.

Pranë kësaj Ministrie, ne kemi këtë që po quhet – fondi i rindërtimit, ku është një shumë e madhe, dhe menjëherë fondi i rindërtimit tani është zero-zero, pastaj del që janë objekte të kultit, shkurt i bie: me i rindërtua kishat. Nëse përkthehet saktë, çka është kjo.

Unë mendoj që ky fondi e rindërtimit, as s'ka njerëz kush e qeverisë, as... Është mirë që të dihet për këto para – kush kujdeset për to? Këtu është zero, nuk thotë kurgjo.

Unë e di, dhe kemi këtu zotin Bajram Rexhepi që e mban në mend kur ka ndodhë kjo dhe çka ka ndodhë. Ka qenë njëfarë komisioni, si është quajtur...? Po tash, këtu nuk dihet sepse në shtylla – krejt janë zero, domethënë nuk dihet veç ekziston ajo shumë. Unë mendoj se është mirë, zoti ministër që të specifikohet: kush i qeverisë ato dhe si, e qysh.

Kalojmë te Ministria e Arsimit. Në bisedë edhe me ministrin, ai thotë që, këta i kanë marrë parasysh ato tronditje sociale që kanë qenë në arsim dhe ato janë llogaritur në masën që janë

tash në këtë buxhet dhe unë – nëse është kështu – ju përgëzoj zoti ministër, sepse e keni mbajtur fjalën dhe po ju marr për fjale që ma thatë publikisht. Domethënë, nëse keni llogaritur këtë formë, unë ju përgëzoj për fjalët që i keni dhënë dhe i keni mbajtur.

Në anën tjetër, unë mendoj që te kjo Ministri që e ka emrin Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, me programin që e keni paraqitur, kjo është veç e arsimit, as s'është e shkencës, as s'është e teknologjisë. Kërkoj zë të veçantë për shkencën.

Ju e keni një element atje, që thoni: institutet. Po unë kërkoj që në këtë shumë të krijohet një zë i veçantë për shkencën. Ne kemi nevojë, zotni që të financojmë dijen. Ne ka vite të tëra që s'po financojmë dijen. Kaq për këtë.

Ndërsa, sa i përket komunave, unë edhe herën tjetër kam thënë po e përsëris edhe pas një viti. Prishtina është vend i ngarkuar me krejt Kosovën. Prishtinën e qarkullojnë gjysma e popullsisë së Kosovës për punë administrative e personale brenda dite. Unë mendoj që në buxhet duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë, me grande që i jepen. Ndërsa, ato që i keni bërë ju, i keni zbritur. Keni zbritur edhe Prizrenin edhe Prishtinën. Unë mendoj që nuk është metodë e mirë, se ju keni parë se këta mbledhin pak më shumë taksa dhe ju keni zbritur grandet. Nuk është metodë shumë e mirë në këtë situatë të veprohet me qytetet si Prishtina. Zoti Kryetar, faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor, pata të drejtë kur thash: vëni “kapak” asaj pjese, ku ishit kompetent për kulturë, shkencë e arsim, prandaj ju faleminderit.

Dëgjuam debatin gjithëditor.

Unë besoj se Komisioni funksional me Ministrinë do t'i bëjë të gjitha lëvizjet e mundshme brenda buxhetit të atillë.

Tani lus regjinë të bëjë përgatitjen për ta aprovuar në shqyrtim të parë Projektligjin. Bëhemi gati për votim.

Votojmë tani. Unë ju falënderoj.

- 48 deputetë kanë votuar për.
- 28 janë kundër.

Prandaj konsideroj se ligji në shqyrtim të parë ka kaluar dhe kërkoj urgjencë pune sa më të mundshme prej Komisionit.

Natën e mirë. Shihemi nesër në orën 10, kur edhe do të vazhdojmë punën.

(Puna e seancës plenare, të datës 15.12.2004 – pjesa e dytë – përfundoi në orën 18,10.)

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI.

Mirëmëngjesi edhe zyrtarisht. Mirëseardhje në vazhdim të seancës, ministra dhe deputetë, të gjithë të pranishmëve. Në rend dite është:

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 25 korrik 2005. Komisionet parlamentare i kanë shqyrtuar dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media ,si komision funksional dhe raportues janë radhitur rekomandimet dhe amendamentet në tekstin e Projektligjit për provimin e jurisprudencës. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për provimin e jurisprudencës e ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për provimin e jurisprudencës dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe financiare. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për provimin e jurisprudencës dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Ju njoftoj se amendamentet dhe rekomandimet janë të komisionit funksional.

Amendamenti 1

Është pa përkrahje të komisionit funksional.

Urdhëro Ramadan.

DEPUTETI RAMADAN KELJMENDI:

Ju faleminderit, kryetar.

I nderuari kryetar , të nderuar ministra dhe deputetë.

Jam një ndër ata që kam paraqitur 16 amendamente dhe vërtet do të ishte mirë një sqarim i bazuar juridik, sepse komisioni funksional ka refuzuar tash unë nuk do të hyj për shkaqe, ndërsa Komisioni për Çështje Kushtetuese e të tjera, i ka aprovuar të gjitha amendamentet. Mendoj se amendamentet e mia të parashtruara janë shumë përmbajtjesore dhe si të tilla do të ishte mirë të harmonizohen me komisionin funksional. Unë do të mendoja dhe do ta kisha përkrahur mendimin që ne si komision edhe një herë t'i shqyrtojmë këto amendamente, nëse më lejoni do t'i them vetëm dy fjalë.

Të gjithë juristëve të diplomuar nuk u bëhet e mundur barabar, por e kemi një ligj që diskriminon ata që nuk kanë punuar në prokurori publike dhe në zyrat e avokatëve, apo në gjykata.. Ky ligj gjeneratën e re e vë në pozitë jo të barabartë. Për shembull kemi dispozitën 3 që thotë: çdo 6 muaj përvojë pune në organet e jurisprudencës llogaritet si 9 muaj. Kjo çështje duhet të shihet, sepse Ligji themelor për marrëdhëniet e punës rregullon stazhin. Po ju drejtohem të gjithëve dhe mendoj se vërtet do të ishte mirë.

E dyta ,provimi i jurisprudencës u pranohet të gjithë atyre juristëve të diplomuar sipas programit të vjetër 4 -vjeçar studimi që kanë arritur gradën shkencore magjistër ose doktor shkence. Në shumicën e shteteve evropiane këta nuk i nënshtrohen provimit të jurisprudencës, ngase kanë përgatitje më të lartë sesa provimi i jurisprudencës dhe provimet që paraqiten. Po ashtu edhe Komisioni ka një përbërje mjaft heterogjene që vërtet nuk përputhet me kriteret që ne dëshirojmë. Në përgjithësi, ju lus, po qe se ka mundësi dhe mbështetje procedurale , sepse ne në një seancë nuk na duhet shumë që t'i harmonizojmë qëndrimet dhe se më duket se amendamentet janë përmbajtjesore. Ju faleminderit. Ka këtu edhe juristë të tjerë që nuk i thërras ta mbrojnë as të mos e mbrojnë, por do të ishte mirë ta thoshin vlerësimin e tyre vërtet të drejtë, ashtu si duhet. Ky propozim i të gjithëve edhe po të mos miratohej nuk prish punë sot , sepse edhe kështu provimi po mbahet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI.

Ramadan faleminderit. Kërkoj falje për një përmirësim të pas ndërhyrjes së këshilltarëve të mi. Për këto 13 amendamente thashë të gjitha janë të komisionit funksional, por janë të deputetit Ramadan Kelmendi .Kërkoj ndihmë nga komisioni funksional dhe mendoj se ka arsye, ka arsye. Z. Fehmi Mujota,

DEPUTETI FEHMI MUJOTA:

Z. kryetar, të nderuar deputetë.

Meqë kryetarja e Komisionit nuk është e pranishme, për arsye të plotë. Pse është marrë vendimi i tillë që komisioni funksional t'i refuzojë amendamentet e deputetit Ramadan Kelmendit, atëherë unë dua t'ua sqaroj deputetëve që vërtet ligji për të cilin po flasim është një ligj që kërkon qasje krejtësisht profesionale, e jo të gjithë të mund të mbështetemi në këtë kriter, prandaj ia lëmë mundësinë të shqyrtohet edhe më tej kjo

çështje edhe pse komisioni funksional ka pasur parasysh renditjen e ligjit. Mendojmë se miratimi i të gjitha atyre rekomandimeve, përkatësisht i amendamenteve që vijnë nga deputeti , do të mund ta prishte radhitjen e gjithë ligjit, prandaj do të na merrte një kohë jo të shkurtër, por megjithëatë është mirë të japim rast rishqyrtimi profesional edhe një herë secilit amendament që të kemi një ligj sa më përmbajtjesor. Në emër të komisionit funksional do të kërkoja që komisioni të ketë mundësi konsultimi qoftë brenda seancës,qoftë në seancën tjetër të radhës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI.

Ramadan faleminderit. Hydajet Hyseni, kryetar i Komisionit për Legjislacion. Urdhëro Hydajet.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI:

Faleminderit z. kryetar.

Duke mbështetur propozimin që sapo u dha do të shtoja vetëm se në fillim Komisioni për Çështje Legjislative e Kushtetuese dhe Juridike ka pasur vërejtje edhe në trajtimin e Komisionit për Shërbime Publike, si të vetmit komision funksional në këtë çështje për arsye që ju i dini, i merrni me mend së paku Komisioni për Çështje Legjislative duhej të ishte po ashtu i trajtuar si komision funksional. Prandaj edhe komisioni ka shqyrtuar amendamentet ,i ka rishqyrtuar, pastaj sipas situatës së krijuar dhe i ka mbështetur, do të dëshiroja që kjo të merret parasysh edhe në shqyrtimin e mëtejshëm ,dua të them që Komisioni për Çështje Legjislative në këtë rast në mbështetje të amendamenteve të parashtruara , i konsideron ,po ashtu ,çështje funksionale të tij. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI.

Faleminderit. I dëgjuam propozimin e amendamentuesit, mendimin e Komisionit Funksional nga nënkryetari dhe të Komisionit për Legjislacion, prandaj shpreh po ashtu gatishmërinë që një ligj të dalë gjithmonë sa të jetë e mundshme sa më cilësor ,por megjithëkëtë fjalën e ka ministrja e Shërbimeve Publike ,ta dëgjojmë.

MINISTRESHA, MELIHATE TËRMKOLLI

Faleminderit z . kryetar, të nderuar deputetë

Pajtohem me propozimet që i dhanë z. Kelmendi dhe të tjerët, po ashtu edhe me qëndrimet e komisioneve ,d.m.th ka nevojë të harmonizohen qëndrimet e caktuara. Ka shumë amendamente që vlerësoj se do të mund të hynin si pjesë. Ato që janë për përkrahje do të duhej përkrahur. Jam në pajtim me atë që shpeshherë i bëhen vërejtje Qeverisë për mos dërgim të ligjeve etj, ose ligje jo krejt profesionale, por shpesh ndodh që në Parlament ligjet stopohen dhe mbeten me muaj të tërë dhe më në fund kur merren në shqyrtim nuk ka një trajtim serioz , i lus komisionet përkatëse të punojnë pak më seriozisht në hartimin e amendamenteve dhe në harmonizimin e tyre. Ky është ligji që shumë muaj është në Parlamentin e Kosovës dhe sot kur duhet t'i miratojmë

amendamentet nuk ka harmonizim. Nuk di pse bëhen këto ,por këto ndodhin, e njëjta ndodh edhe me disa ligje të tjera, ligjet në mënyrë arbitrare stopohen në komisionet parlamentare. Mendoj se nuk është e pranueshme, është diçka tjetër çfarë vendosim, por stopimi nuk ka arsye, pajtohem plotësisht dhe kërkoj të punohet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ministreshë ju faleminderit. Fjalën e ka profesor Alush Gashi. Alush më fal se ka kërkuar fjalën Fehmi Mujota.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA

Sa për informim të ministreshës së Shërbimeve Publike, Komisioni Funkcional e ka mbaruar punën e vet më 16 shtator 2005 dhe kjo tregon se Komisioni ka pasur qasje serioze ndaj këtij ligji, e ka shqyrtuar çdo amendament veç e veç dhe është e vërtetë se i ka refuzuar amendamentet që kanë ardhur, njëri prej tyre është edhe një amendament juaji që besoj se ka arsye të plotë, sepse çështja që duhet të shqyrtohet është çështje e jurisprudencës dhe duhet të kalohet nëpër Ministri të Drejtësisë. Në momentin kur Komisioni Funkcional i shqyrtoi këto amendamente, ishte çështje e ditës që nuk e kishim ministrin e Drejtësisë dhe për t'i shmangur pengesat e mundshme për provimin e jurisprudencës, Komisioni Funkcional pati mendim të ketë emërtim si ministri përkatëse që nuk e nënkupton as Ministrinë e Shërbimeve Publike as Ministrinë e Drejtësisë dhe hap rrugën për t'i kryer obligimet e veta rreth provimit të jurisprudencës, ministria përkatëse. Komisioni e ka pasur parasysh se Ministria e Drejtësisë është ajo që duhet ta ketë këtë çështje para vetes dhe është obligim i saj, por meqë ende nuk e kemi Ministrinë e Drejtësisë dhe nuk e dimë se ku do të kalojnë të gjitha ato kompetenca në kuadër të saj, ka mbetur ky emërtim që besoj se mund t'ju ketë injoruar ose irrituar, por besoj se kemi pasur qasje profesionale lidhur me këtë që të mos i bëjmë bllokadë funksionimit të mëtejshëm, prandaj nëse Kuvendi vendos të shkojë në votim, Komisioni Funkcional mund ta tërheqë propozimin që ishte për kompromis për të gjetur zgjidhje të mirë dhe për të dhënë mundësi që ta kemi një ligj kualitativ dhe që sot të mund të votojmë. Për ta pasur një ligj sa më cilësor ne e tërhoqëm atë vendim që e kemi marr si Komision për t'u dhënë mundësi të reja dy komisioneve që Kuvendi të vendosë, pastaj cila është më e drejtë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit. Fjalën e ka z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI

I nderuari z. kryetar.

Numri i amendamenteve si dhe pjesëmarrja aktive në debat tregojnë përkushtimin e deputetëve që këtë çështje ta zgjidhin sa më mirë. Lidhur me atë si të veprohet, lutja ime është të merren në konsideratë kërkesat si të komisionit, si të propozuesit dhe pasi,- të

shpresojmë - se Kryesia e Kuvendit dhe kryetari do të na mundësojnë të takohemi së paku dy herë në muaj dhe kjo çështje nuk do të vonohet, ju lus ta merrni në konsiderim t'i jepni kohë Komisionit FunkSIONAL që të merret edhe një herë . Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Faleminderit. Po ju garantoj se në momentin kur komisionet e kryejnë punën e vet do të futen menjëherë në procedurë të rregullt,prandaj nuk e shoh të arsyeshme të votojmë, në qoftë se insistoni ,sepse është pajtimi i të gjithëve po e shoh. Ju faleminderit do të thotë e kuptuam, të lutem për mirëkuptim. Urdhëro Hydajet Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Faleminderit, megjithatë z. kryetar. Të nderuar kolegë deputetë, meqë u shtrua çështja e vonesave e të tjera,pasi Komisioni për Çështje Legjislative ka parashtruar amendamentin, mund të krijohet përshtypja sikur është Komisioni ai që e ka vonuar, meqë kishte edhe aluzione e insinuata. Unë dua vetëm të sqaroj dhe t'u referohem fakteve se Komisioni për Shërbime Publike e ka shqyrtuar Projektligjin me 2 shtator, kurse Komisioni për Çështje Legjislative e ka shqyrtuar më 5 dhe 12 shtator dhe ka dalë me qëndrimin se duhet bërë amendamentet e propozuara nga deputeti Kelmendi. Në ndërkohë nuk na ka ardhur asnjë qëndrim nga Qeveria dhe dua ta nënvizoj këtë lëshim të procesit tonë të ligjdhënësit. Qeveria edhe me rregullat e procedurës është e obliguar dhe ka të drejtë të jetë pjesë e procesit të amendamentimit të japë mendime të saj dhe të bëjë edhe amendamente. Kjo nuk po ndodh.

Për më tepër Komisioni, që është konsideruar funksional, nuk i ka shqyrtuar pastaj rishtazi amendamentet e komisionit pas vlerësimit të tij. I theksoj këto së pari për t'ua sqaruar deputetëve dhe opinionit, së dyti eventualisht të merren parasysh në procesin e mëtejshëm të ligjdhënës. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Faleminderit. Ministrja ishte e qartë vetëm për lutjen që të përshpejtohen proceset ,nuk e sulmoi askënd,prandaj s'ka nevojë për këto.

Shqyrtimin e dytë i Projektligjit për gjuetinë

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 3. 10. 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime me amendamente. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor,si komision funksional dhe raportues, janë radhitur radhitur rekomandimet dhe amendamentet në tekstin e projektligjit përkatës. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për gjuetinë ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për gjueti

nga amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për gjuetinë dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Amendamentet dhe rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 1

Lus regjinë të bëhemi gati për votim dhe votojmë tani:

75 deputetë janë **për**,
3 deputetë janë **kundër**.

Ka kaluar amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Në sallë janë 84 deputetë.

71 deputetë janë **pro**,
4 deputetë **kundër**.

Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3

Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:

77 deputetë janë **pro**,
2 deputetë janë **kundër**.

Kalon amendamenti 3 dhe në monitor të pranishëm janë 91 deputetë.

Amendamenti 4

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

70 deputetë janë **pro**,

Kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

72 deputetë janë **pro**,

Ka kaluar amendamenti 5.

Amendamenti 6

Përgatitemi për vendimmarrje dhe votojmë tani:

71 deputetë janë **për**,

Ka kaluar amendamenti 6.

Amendamenti 7

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

72 deputetë janë **për**,
Ka kaluar amendamenti 7.

Amendamenti 8
Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:
73 deputetë kanë votuar **për**,
Ka kaluar amendamenti 8.

Amendamenti 9
Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:
72 deputetë janë **për**,
Ka kaluar amendamenti 9.

Amendamenti 10
Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:
68 deputetë janë **për**,
Ka kaluar amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:
74 deputetë janë **për**,
Ka kaluar amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:
71 deputetë janë **për**,
Ka kaluar amendamenti 12.

Amendamenti 13
Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:
71 deputetë janë **për**,
Ka kaluar amendamenti 13.

Amendamenti 14
Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:
72 deputetë janë **për**,
Ka kaluar amendamenti 14.

Amendamenti 15.
Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:
66 deputetë janë **për**,
Ka kaluar amendamenti 15.

Amendamenti 16
Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:
72 deputetë janë **për**

Ka kaluar amendamenti 16.

Amendamenti 17

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

72 deputetë janë **për**,

Ka kaluar amendamenti 17.

Amendamenti 18

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

67 deputetë janë **për**,

Ka kaluar amendamenti 18.

Amendamenti 19

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

69 deputetë janë **për**,

Ka kaluar amendamenti 19.

Amendamenti 20

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

69 deputetë janë **për**,

Ka kaluar amendamenti 20.

Amendamenti 21

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

64 vota janë **për**,

Ka kaluar amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

71 votë janë **për**,

Ka kaluar edhe amendamenti 22.

Ju në material i keni edhe rekomandimin e komisionit për vërejtjet teknike dhe këto besoj që është pjesë e kompletimit. Të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet që kanë të bëjnë, qoftë për gjuhën, qoftë për ..., prandaj ne na mbetet ta votojmë ligjin në tërësi me amendamentet e aprovuara sot.

Ju lutem bëhuni gati për të votuar ligjin në tërësi dhe votojmë tani:

76 deputetë janë **për**,

2 vota janë **kundër**

3 vetë kanë **abstenuar**

Prandaj konsideroj se u aprovua ligji me të gjitha amendamentet e aprovuara sot. Ju faleminderit.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 28 korrik 2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet, parimet dhe përmirësimet parimore do t'i adresohen për shqyrtim Komisionit FunkSIONAL Përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore. Ftohet zëvendësministrja z. Angjelina Krasniqi që në emër të Qeverisë ta përfaqësojë ligjin. Urdhëroni.

Për informim, para se të fillojë zëvendësministrja, Qeveria ka dërguar edhe akt zyrtar që të mos ketë ndonjë konfuzion, zëvendësministrat janë të zgjedhur nga ky Parlament dhe mund ta arsyetojnë çdo ligj të propozuar. E kam për të ardhmen ,që të mos kemi konfuzion. Urdhëroni foltoja është për ju.

DEPUTETJA ANGJELINA KRASNIQI

Faleminderit i nderuari kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë.

Projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin i përcakton parimet dhe normat themelore për zhvillimin e veprimtarisë botuese.

Qëllimi i këtij projektligji është të përcaktohen të drejtat dhe mundësitë e botuesit në sigurimin, përhapjen dhe afirmimin e librit si vlerë me rëndësi të veçantë. Njëkohësisht ky projektligj përcakton edhe të drejtat dhe rolin e faktorëve të tjerë që marrin pjesë në shkrimin dhe botimin e librit.

Me Projektligjin për veprimtarinë botuese dhe librin sigurohet qarkullimi i lirë i librit brenda dhe jashtë territorit të Kosovës. Gjithashtu me këtë akt ligjor rregullohet dhe sigurohet ndërlidhja e veprimtarisë botuese me institucionet e kulturës e të tjera që kanë të bëjnë me librin, siç janë :bibliotekat dhe organet e tjera kulturore në nivelin qendror e lokal.

Projektligji në fjalë përcakton rregullat në fushën e krijimit, të ruajtjes, të mbrojtjes, të përhapjes dhe të promovimit të librit në Kosovë. Me një fjalë, me këtë projektligj veprimtaria botuese dhe libri në Kosovë do të rregullohen me aktin më të lartë legjislativ, siç është ligji.

Liria e botimit dhe e qarkullimit të librit, formimi i Këshillit të Librit në kuadër të Ministrisë, metodat e nxitjes së veprimtarisë botuese, sigurimi i fondeve për blerje të librit, hapja e bibliotekave të reja, hapja e ekspozitave dhe e panairëve të ndryshme, vënia e numrit ndërkombëtar për standardizimin e të gjitha botimeve në Kosovë, si dhe masat ndëshkuese për ata që shkelin këtë projektligj, janë disa prej veçorive themelore që e bëjnë këtë projektligj të jetë i rëndësishëm dhe funksional në fushën e botimit e të qarkullimit të librit në Kosovë.

Të nderuar deputetë!

Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë një grup i madh i ekspertëve të këtyre fushave të niveleve të larta profesionale. Gjatë hartimit të këtij projektligji janë marrë parasysh edhe standardet e reja legislative, që po krijohen në Kosovë, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Shpresoj se ju sot në parim do ta miratoni këtë projektligj që më pas në komisionet parlamentare, sigurisht se me vërejtjet dhe angazhimin tuaj do të hapni rrugë që ky projektligj në parim të aprovohet.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Zëvendësministër ju faleminderit. E dëgjuam fjalën e propozuesit të ligjit. Për debat në emër të LDK-së është z. Ramadan Musliu. Urdhëroni Ramadan

DEPUTETI RAMADAN MUSLIU

I nderuari z. kryetar, të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar, të nderuar deputetë.

Projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin mund të radhitet në grupin e atyre ligjeve që mund të konsiderohen të një rëndësie të dorës së parë, sepse po që se baza ligjore për një fushëveprim , siç është krijimi i librit, botimet dhe shpërndarja e tij ,që tani zhvillohen brenda një realiteti të ri, njëherazi merret me problemin e identitetit kulturor të vendit tonë. Projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin, ndonëse si shumicë e projektligjeve të tjera që procedohen këtu, shfrytëzohen përvojat rajonale të fushëveprimit të caktuar. Edhe ky ligj është në vijim si të kësaj përvoje, me një përparësi që nuk ka pasur nevojë të përkthehet dhe ka më pak gabime gjuhësore, për të cilat vazhdimisht flasim . Me qenë se veprimtaria botuese dhe libri janë sferë që u takojnë kompetencave të 2 ministrive: Ministrisë së Kulturës dhe të Arsimit ,të Shkencës dhe të Teknologjisë. Në këtë projektligj ka zgjidhje të kënaqshme dhe përcaktim,si të them, të kompetencave të secilës ministri.

Vlera më e madhe e këtij projektligji është se përpiket që libri edhe veprimtaria botuese të trajtohen të beneficuar, që është e domosdoshme, meqë në Kosovë botimi i librit dhe aktiviteti botues nuk mund t'i garantojnë jo fitim, por në një farë mënyre ndoshta mund të konsiderohen si një aktivitet honorari, prandaj beneficimi i tij e heq statusin e librit si mall tregu, duke e konsideruar atë si një vlerë kulturore me rëndësi kombëtare.

Vërejtjet eventuale që mund t'i bëhen këtij projektligji, do të ishin: ndonëse me këtë projekt ka mjaft përpjekje që të forcohet një vijë e stimulimit institucional të veprimtarisë botuese dhe të vetë librit, objekt kryesor është kreu i 4 -të i projektligjit,në të cilin theksohet zvogëlimi i bazës tatimore ,por aty u nuk kemi sqarim se cila eshë shkalla e asaj baze dhe mungon kategorizimi i librave se ekzistojnë kategori të ndryshme të librave, një pjesë e të cilëve mendoj që mund edhe të taten se ka botime të ndryshme që mund quhen botime komerciale dhe të përfshihen te pjesa e tatimit.

Vërejtja e dytë të kreu i 6, që përfshin të drejtat dhe detyrimet e institucioneve, kryesisht kemi të bëjmë me nene të përgjithësuar, në të cilat flitet për veprimtari qendrore, por

pa i përmendur dhe pa i klasifikuar aty, në të cilat theksohet stimulimi i librit me anë të çmimeve të caktuara, por pa u përmendur cilat janë ato dhe për çfarë lloji e kategorish të librit janë dhe kush është sponsor i tyre. Po kështu edhe te neni 15.3 i këtij kreu theksohet nevoja e sigurimit të fondeve për blerjen e librit, në këtë rast është e domosdoshme të precizohet mënyra e blerjes, duke i eliminuar praktikën e tenderimit. Në praktikën e pajisjes së bibliotekave deri tash është ndjekur praktika e tenderimit, d.m.th. është blerë libri prej shitësit, nuk është blerë prej botuesit. Kur pajiset biblioteka ajo duhet t'i ketë botimet e secilit botues për shkak se duhet të ketë prezantim të një periudhe të veprimtarisë botuese d.m.th. të përfshihen të gjithë autorët, kush shkon me tender trajtohet si mall tregu edhe në një farë mënyre bëhet pajisja e pjesës, se disa botues privilegjohen, ndërsa disa të tjerë, që mund konsiderohen se janë të dorës së parë, mbeten anash. Po kaq ka nevojë që brenda këtij drafti të specifikohen mënyrat e organizimit të ekspozitave dhe të panairëve që i përmendi edhe zëvendësministria, sidomos të atyre që janë të karakterit ndërkombëtar, ku libri shqip i Kosovës duhet ta ketë hapësirën e vet në hartën ndërkombëtare të librit. Me këtë rast besoj se është e udhës që institucionet relevante, siç është Ministria e Kulturës, duhet të jenë sponsorë kryesorë. Ky aktivitet duhet të përfshihet brenda skemës së sponsorimit obligativ. Jemi dëshmitarë se ka qenë një zhurmë e madhe për mosprezantimin e librit në Panairin e Frankfurtit, që është ekspozita më e madhe ndërkombëtare e librit, në të cilin deri sivjet libri shqip e ka pasur vendin e vet dhe në njëfarë mënyre libri i Kosovës futej në konkurrencë ndërkombëtare, po kështu edhe pjesa e publicistikës artistike dhe shkencore. Mendoj në gazetartistike dhe shkencore e kulturore të cilat nuk janë përfshirë në pjesën e kufizimeve të problematikës së këtij lig, pothuajse është anashkaluar.

Mendoj se duhet të futet përkufizimi. Kështu që edhe kjo pjesë ta ketë definimin e statusit të vet. Në fund po them se kur e kam parë deklaratën financiare që duhet ta ketë projektligji, me themelimin e organeve të caktuara që i përmendi edhe zëvendësministria, mendoj se është një kosto shumë e ulët, që nuk ndikon në trajtimin e duhur të librit. Mendoj se edhe me këto lëshime që nuk janë edhe ku ta dish çfarë dhe mund të eliminohen gjatë punës së Komisionit Funkcional. Grupi Parlamentar i LDK-së i jep përkrahje dhe mendon që ky është libër i nevojshëm dhe i domosdoshëm të përpilohet sa më shpejt. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Faleminderit Ramadan, prof. Drita Statovci, në emër të PDK-së, urdhëroni.

DEPUTETJA DRITA STATOVCI:

Zoti kryetar, ministra, zonja dhe zotërinj të nderuar.

Projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin rregullon një problematikë komplekse, që ka të bëjë me çështje të ndryshme të shfrytëzimit të vlerave të mirëfillta të prodhimeve të veprimtarisë botuese. Tok me këtë problematikë domosdo përfshihet edhe çështja e krijimit dhe e përhapjes së vlerave të qëndrueshme në kuptimin kulturë, si dhe në kuptimin arsimim, informim, shkencë dhe hulumtime shkencore. Do të thoshim se në

tërësi kjo punë përfaqëson një projekt shumë të nevojshëm të shtruar e të zgjidhur në mënyrë ligjore. Aspekti i përgjithshëm formal i Projektligjit komunikon rregullsi ,natyrisht shfaqje të pritshme që edhe aspekti thelbësor përmbajtjesor i ligjit të komunikonte normalitet dhe zbatim të pranueshëm në praktikë dhe në fushat jetësore, shoqërore ,që i normalizon.

Mirëpo leximi i kujdesshëm tregon se ende ka vend për vërejtje dhe sugjerime. Do të trajtoj vetëm diçka të domosdoshme.

1. Projektligji në fjalë, me instrumentet e veta sanksionon shumë çështje lidhur me problematikën e librit dhe të veprimtarisë botuese . Por nga ajo që është sanksionuar krijohet përshtypja se krijuesi i këtyre vlerave, autori si individ ose si grup dhe e drejta e autorësisë, sikur nuk trajtohen si dhe sa duhet. Autori si krijues, punën e të cilit e karakterizon origjinaliteti dhe që është aktor kyç në zhvillimin e një veprimtarie që rregullon ky projektligj, të duhej të stimulohej më fuqishëm edhe me Projektligjin për veprimtarinë botuese dhe librin. Pra, ajo që shtrohet në strukturën e këtij ligji sikur nuk mjafton ta theksojë si duhet pozitën e autorit(krijuesit).

2. Projektligji sanksionon këshillin e librit si organ veprues, funksional në numërimin e detyrave të këtij këshilli, ndër të tjera thuhet: Këshilli organizon konkurse për dhënien e çmimeve për vepra letrare dhe shkencore e të tjera, por për habi në përbërjen e këshillit aty përskaj të tjerëve të përzgjedhur sipas profileve dhe profesioneve të veçanta nuk figuron asnjë vend për anëtarin shkencëtar. Them më së buti, kjo është anomali që nuk do të duhej të zinte vend në Projektligj. Po në këtë kontekst gjejmë edhe një dukuri tjetër. Në përbërjen e anëtarëve të këshillit të librit nuk figuron vend për përfaqësues të universitetit, si institucion publik, por ka vende për të gjitha institucione e tjera shoqërore e publike. Veprimtaria botuese e lidhur ngushtë me veprimtarinë edukativo- arsimore, shkencore dhe kulturore, nuk do të duhej të trajtohej si pronë e rezervua, sepse në kohën e sotme moderne diçka e tillë shfaqet si absurditet. Me këtë rast unë nuk do ta elaboroj mënyrën e emërimit e as të zgjedhjes së këshillit të librit, por për rrugët demokratike ose të tjera që i komunikojnë ky projektligj lidhur me organin. Këshillin e librit, por shpreh qëndrimin për një ndërtim më të avancuar lidhur me këtë problematikë komplekse dhe të ndjeshme.

3. Është e çuditshme, që me rastin e shqyrtimit të ligjeve në Kuvendin tonë ,vazhdimisht na përcjell një dukuri, për fat të keq, negative që ka të bëjë me çështjen e gjuhës. Do ta veçoj një segment .Duhet të kihet më shumë kujdes kur një formulim, një shprehje e caktuar përdoret si emër që tregon për një kuptim statik të ngurtë, të përfunduar dhe kur përdoret si folje që tregon lëvizje , aktivitet e të tjera. Në këtë kontekst një prej qëllimeve të këtij projektligji, me gjasë ,do të ishte të krijojë kushte për të shpall veprimtari me interes kombëtar hartimin e librit, pra krijimin, krijimtarinë dhe jo shkrimin e tij. Marrë në përgjithësi Projektligji për veprimtari botuese dhe librin është i punuar mjaft mirë ,ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet që shtrohen këtu janë të përballueshme dhe të inkludueshme në strukturën e projektligjit. Prandaj në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe në emër timin shpreh pajtimin që Projektligji për veprimtari botuese dhe librin të kalojë në procedim të mëtejshëm. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit. z. Mazllum Kumnova në emër të AAK-së.

DEPUTETI MAZLLUM KUMNOVA

Grupi i AAK-së në këtë Kuvend e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për veprimtarinë botuese dhe librin dhe me këtë rast ka vlerësuar se ka arritur për herë të parë të rregullohen në fushën e veprimtarisë botuese dhe të librit mjaft çështje, duke pësuar kështu një mangësi në funksionimin e ligjit në Kosovë. Edhe pse hapi i parë serioz ka qenë miratimi i Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e afërta nga ky Kuvend, Projektligji që kemi në dorë protenton që me një rregullim të mirë të sigurojë vlera të mirëfillta, siç thuhet, artistike, letrare, shkencore e kulturore nëpërmjet veprimtarisë botuese. Hartuesi i këtij projektligji i ka kushtuar kujdes rregullimit të marrëdhënieve juridike në veprimtarinë botuese, krijimit të mekanizmit të ri si këshilli për librin ,të drejtat dhe detyrimet nëpërmjet politikave për t'i krijuar kushtet për nxitjen e botimeve, të leximit dhe formave të tjera. Po ashtu ky projektligj pretendon t'i rregullojë mjetet ligjore të kontrollit administrativ të kategorisë së caktuar të prodhuesve artistikë dhe zhvillimit të marrëdhënieve të biznesit artistik, njëkohësisht formimit të privatizimit në fushën e botimeve. Mirëpo, Grupi i AAK-së për kundër fjalëve të mira për këtë projektligj ka konstatuar se ka mangësi në përafrimin me direktivat e Bashkësisë Evropiane në Konventën e Parisit dhe të Bornos si dhe në direktivën për zbatimin dhe për të drejtat që dalin nga pronësia intelektuale. Ne, konkretisht ,gjatë procedimit të këtij projektligji në komisione dhe në shqyrtim të dytë ,duhet të vëmë dorë në përafrimin me këto direktiva, konventa dhe traktate ndërkombëtare, meqë së shpejti duhet të jemi nënshkrues dhe adhurues të tyre. Përfundimisht kemi mendimin se si grup i këtij Kuvendi ky projektligj të përkrahet duke bërë përpjekje që gjatë punës se komisioneve dhe shqyrtimit të dytë, të japim kontributi tonë. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Faleminderit. Genc Gorani në emër të ORA-s

DEPUTETI GENC GORANI:

Ju faleminderit kryetar. z. ministër, të nderuar zotërinj dhe zonja deputetë.

Grupi Parlamentar i Partisë ORA e përkrah këtë projektligj në parim. Dy vërejtje kisha dashur t'i paraqes në këtë rast. E para ka të bëjë me atë se me gjithë pretendimet relativisht të larta që ky projektligj na i shfaq në deklaratë financiare shihet se janë paraparë vetëm 50 mijë euro. Me këtë shumë kaq të vogël të hollave nuk mund të financohet një vendosje e qartë e investimeve të librit. Nuk mund të stimulohet në nivel, madje minimal krijimtaria në këtë fushë. Këtë projektligj e kemi pritur prej kohe, mirëpo është një mungesë e madhe që në aspekt buxhetor nuk është dhënë një tentim më serioz. Kjo është një prej të metave të mëdha dhe jam i bindur se këshilli i librit, që parashihet të

formohet dhe do të mund të realizojë vizionin e tij dhe nuk mund ta zhvillojë rolin e plotë që parashihet në këtë projektligj. Mund të shprej se Ministria e Kulturës së bashku me Ministrinë e Arsimit do t'i bashkojnë mjetet në atë mënyrë që kjo të përmirësohet.

Vërejtja e dytë është më substanciale, madje ka të bëjë vetëm me këshillin e librit, pse a thua në këshill të librit duhet të bëhet një strukturë, ku ministri i Kulturës duhet ta ketë fjalën përfundimtare. Automatikisht këtu, nëse lexojmë këtë strukturë të 11 anëtarëve të këshillit, automatikisht e keni shumicën e zgjedhur nga vet ministri. Pse është dashur ministri ta ketë rolin kryesor në atë që këshilli e ka për detyrë, nxitjen e krijimtarisë të veprimtarisë botuese, pse kjo të mos u lihet shoqatave profesionale të aktivistëve të vet më afër tyre. Madje, personalisht kam frikë a edhe besoj se është e bazuar që katër krijues të afirmuar sipas gjinive letrare një poet, prozator, kritik letrar a dramaturg, zgjidhen sipas parapëlqimit të ministrit të Kulturës. Në rendin e parë është ai, në rendin e dytë është përfaqësuesi i propozuar i Ministrisë së Arsimit, në të tretin është përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Kulturës. Hapësira për krijues të mirëfilltë praktikisht nuk ekziston është transparent pak a shumë ofendues tentimi i ministrit që të marrë nën kontroll këshillin e librit dhe e vë vetveten në krye të këshillit në frymën e monarkëve të plotfuqishëm të mëhershëm, ku tash krijuesi duhet të vijë para tij dhe me një farë dore t'i nënshtrohen, sepse varen prej tij drejtpërdrejt.

Një vërejtje e fundit ka të bëjë me vetë ministrin, sot i ka tri projektligje të rëndësishme në shqyrtim të parë, ministri nuk do ta verifikojë as gjendjen e vet këtu prezent për tri projektligje të njëkohësishme në një seancë. Mungesa e tij është sistematike, pra pres prej Kryesisë që këtë ta shqyrtojë seriozisht. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Genc ju faleminderit. Xhezair Muarati në emër të Grupit 6+. Urdhëro Xhezair.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI

Poštovani predsedniče, drage kolege poslanici i gospodo ministri. Zakon o izdavačkoj delatnosti i knjizi čiji je prevashodni značaj u širenju i afirmaciji knjige ustavri ima i prvorazredni faktor u formiranju lične ljudske ličnosti u prenošenju znanja i drugim segmentima. Ja bih u ovom slučaju pomenuo pre svega mladu ličnost, on je podeljen u 12 poglavlja i u 2 poglavlju koje govori o slobodi izdavanja i prometa knjige u članu 5 citiram:“ Vlada garantuje i štiti i promovise slobodu izdavanja na jezicima zemlje“ ne pominje se izdavanje knjiga na jezicima koji se ne koriste na celoj teritoriji Kosova a namenjena su manjim zajednicama sa već stečenim pravima u ovoj izdavačkoj delatnosti, odnosno želimo da se doda ili precizira ovo kako bi bilo jasnije zakonski regulisano izdavanje udžbenika ili knjige kada je u pitanju školska knjiga ili udžbenik o čemu ću nešto kasnije. Prvo u grupi koja je radila na izradi ovog zakona nevidimo predstavnika ostalih zajednica iako smo i u dosadašnjim analizama i preporukama zakona tražili u više navrata da se koristi pravo da ostale zajednice imaju pojednog člana u grupama za izradu

Nacarta zakona, zatim u trećem poglavlju gde se govori o savetu knjige kojeg čini 11 članova takođe nije regulisano pravo i prisustvo ili učešće, na neki način treba dodati ili pak povećati broj na još najmanje jednog člana koji poznaje jezike koji se ne koriste na celoj teritoriji Kosova ili pak dvojcu, a koji će koristiti jezike sa, ono što sam već govorio, stečenim pravima. Dakle kada je u pitanju poglavlje 5. za koje smo mi najzainteresovaniji a posvećeno je školskoj knjizi ili udžbeniku ovde se pominje i naknadni zakon koji će biti izdat koji će se odnositi na izdavanje školskih udžbenika da se uklopi sa potrebama naših zajednica, s obzirom na osnovnu potrebu školskog udžbenika bez kojih nemože normalno nastava da se izvodi u svim nivoima koje već imamo i onda kažem poglavlje 11. gde se govori u 34. članu tačka 4. mislim da nije najpreciznije određeno kada je u pitanju kaznena odredba od 500-1000 evra za kršenje prava, možda tu može zavisno od tiraža da ide. Naša primedbe smatramo minimumom bez čijeg regulisanja nećemo biti u stanju u drugom čitanju da mu damo podršku, a sada mu dajemo prohodnost i cenimo trud koji je uložen u njegovoj izradi. Hvala!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Xhezair faleminderit. Sanije Alijaj dhe të përgatitet prof. Hamiti.

DEPUTETJA SANIJE ALIJAJ:

I nderuari z. kryetar, ministër ,të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm.

Edhe pse vlerat artistike, letrare, shkencore dhe kulturore sot mund të përcillen dhe përvetësohen nëpërmjet internetit,prapëseprapë, libri si mjet për zgjerimin e diturisë, e ka rëndësinë e veçantë ,sepse mundëson të bëhemi të ndërgjegjshëm për kulturën, historinë dhe për të arriturat shkencore te ne dhe në botë. Prandaj rregullimi me ligj i veprimtarisë botuese dhe i librit, është i një rëndësie të veçantë,sepse mundëson që krijimtaria letrare, artistike dhe shkencore të shfrytëzohet në mënyrë të organizuar nga të gjithë të interesuarit. Objekt trajtimi në këtë projektligj janë rregullat në fushën e krijimit, botimit, të ruajtjes dhe të përhapjes e të promovimit të librit në Kosovë dhe jashtë saj. Caktohen kushtet me të cilat duhet të zhvillohet veprimtaria botuese në të mirë të librit ,që siguron qasje ndaj librit duke nxitur shprehitë e leximit që ndikojnë në formimin e personalitetit njerëzor, në transmetimin e dijes,në përhapjen e kulturës dhe në hulumtimin shkencor. Mendoj se institucionet e kulturës duhet t'i kushtojnë kujdes të duhur kritikës letrare e shkencore lidhur me njohjen e vlerave të mirëfillta letrare, shkencore dhe artistike ,në mënyrë që të ndalet euforia e botimit të librave pa ndonjë përkujdesje institucionale. Pra institucionet e kulturës të kenë kujdes për një koherencë të kritikës dhe të vlerësimeve që i bëhen botimit të librit.

Kreu III i Projektligjit cakton përbërjen e këshillit të librit ,që jep iniciativa për veprimtarinë botuese, konkurruese, propozon forma të nxitjes së leximit dhe të afirmimit të librit në të gjitha nivelet e arsimit, nxit krijimtarinë origjinale dhe organizon takime ndërkombëtare për prezantimin e saj në vend dhe në botë ,që deri më tani nuk ka qenë e aktualizuar dhe nuk e ka pasur trajtim të duhur. Vlen të theksohet se në këtë projektligj mbështetet botimi i veprave që u drejtohen personave me aftësi të kufizuara,

që fuqizon përkujdesje institucionale ndaj kësaj pjese të shoqërisë për ngritjen dhe arsimimin e tyre ,që deri më tani ishte pothuajse ishte simbolike. Masat stimuluese për personat fizikë dhe juridikë që kanë si objekt kryesor veprimtarinë e botimit dhe të shpërndarjes së librit konform ligjeve të aplikueshme në Kosovë, në këtë fazë të zhvillimit, është shumë i domosdoshëm, sepse nxit veprimtarinë botuese dhe stimulon krijuesit e rinj.

Kreu V i Projektligjit i kushtohet librit shkollor, reforma në arsim kërkon që shoqëritë bashkëkohore arsimin të të gjitha fazave duhet t'i krijojnë kushte të mira për mësim duke siguruar libër me standarde bashkëkohore, por edhe libër me letër cilësore dhe me lidhje të mirë .që duhet të garantohet se nxënësit do ta përdorin së paku për një vit mësimor. Edhe pse kjo çështje rregullohet me Ligjin për botimin e teksteve shkollore, konsideroj se me disa nene është dashur të përcaktohej, përgatitja, shtypja, shpërndarja e librit shkollor dhe të mos krijojnë rrethana si në këtë vit shkollor që shfrytëzuesi i librit shkollor të mos dijë cili libër duhet përdorur.

Kreu VI i Projektligjit merret me politikat e botimeve, cakton kushtet për nxitjen e leximit, duke organizuar veprimtari kulturore, edukative dhe informuese, por dhe duke marrë fondin për pasurimin e bibliotekave shkollore publike, në mënyrë që libri të jetë sa më afër lexuesit. Prandaj, caktimi i kriterëve për vlerësimin e cilësive profesionale kulturore dhe etike për ushtrimin e veprimtarisë botuese, të përcaktuara në këtë projektligj mundëson që në të ardhmen të kemi në përdorim libër me cilësi dhe me përmbajtje të duhur.

Dispozitat ndëshkuese në Kreun XI të Projektligjit parashikojnë sanksionet me kundërvajtje administrative të dënuara me gjobë për shkelësit e dispozitave të këtij projektligji, që premtojnë veprimtari botuese cilësore dhe konkurruese, por edhe libër të standardeve bashkëkohore. Projektligjin e përkrah në parim me shpresë që në komisione të amendamentohet dhe të bëhet një ligj i mirë në harmoni me ligjet e BE-së. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Saniqe ju faleminderit, prof. Sabri Hamiti, le të përgatitet prof. Mark Krasniqi, të cilit i kërkoj falje, sepse vonë është paraqitur se do të kishte marrë i pari fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI:

Z. kryetar faleminderit.

Unë dëgjova disa kolegë që folën, do të kisha thënë, në nivelin shumë përfaqësues shumë të lartë rreth këtij ligji . Edhe Musliu, Gorani, Statovci dhe kolegë të tjerë, shihet që e kanë parë esencën e tekstit dhe kanë dhënë vërejtje esenciale për përpunimin e tij. Në anën tjetër duhet të thuhet qartë se këtu kemi një tekst të ndërtuar e jo të përkthyer. Kjo shihet edhe si një send i mirë për Kuvendin dhe për adhuruesit- do të thosha -në anën tjetër, shihet se e kanë ndërtuar njerëzit që merren me këtë veprimtari . Kështu duhej të

bëhej vazhdimisht. Mendoj që ajo për të cilën duhet të flas, është një institucion që quhet Këshilli i librit që është brenda ligjit e unë e shoh si sendin më të rëndësishëm që është brenda ligjit. Nuk u përmend pa arsye këtu mënyra e ndërtimit që gjatë përpunimit duhet të saktësohet me siguri. Ky këshill do të marrë një funksion të jashtëzakonshëm brenda funksionimit të ligjit dhe do të ndikojë në olimpikat sponsoruese të librit - nga ana e shtetit, në këtë rast nga ana e Ministrisë. Prandaj duhet ta ketë strukturimin e plotë të veprimtarive krijuese dhe botuese që mbulon ligji. Këtu kam parasysh krejtësisht veprimtaritë krijuese, letrare dhe shkencore ,sepse puna me librat shkollorë është krejt punë tjetër që duhet të rregullohet me parametra të tjerë dhe ka të bëjë me Ministrinë e Arsimit.

Ky këshillë, po them definitivisht duhet të marrë detyra të përkohshme saktë për atë që e quajmë intervenim i shtetit, i buxhetit në sponsorimin e veprave me rëndësi të veçantë. Ne duhet ta krijojmë këtë nivel të sponsorimit për vepra edhe kulturore edhe shkencore që i bëjnë kulturat shumë më të forta. Pse po e theksoj këtë.? Po e theksoj se ka nja 10 vjet edhe te ne edhe nëpër Ballkan qarkullon si ide që edhe libri është industri dhe duhet të botohet i lirë dhe të funksionojë si mall tregu. As nuk është libri mall tregu, ai është libër, as që ka shans të bëhet mall tregu në kulturat si kjo jona kur ne edhe sot e kësaj dite kemi nevojë që dijen dhe krijimtarinë t'i marrim edhe ta stimulojmë. Faleminderit z. kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Faleminderit prof. Mark Krasniqi, le të përgatitet Nexhat Rexha.

DEPUTETI MARK KRASNIQI:

I nderuar kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë.

Ky ligj i Ministrisë së Kulturës është i mirëseardhur, me qenë se në Kosovë është në kohët e fundit një veprimtari shumë e gjerë botuese, kështu që çdo vit po shtohet numër mjaft i madh i shtëpive të reja botuese. Këtu patjetër duhet të vihet rregull ligjor, të cilit duhet t'i përmbahemi të gjithë.

Ka në mungesë të ligjit të deritashëm raste drastike të keqpërdorimit të së drejtës së autorit. Unë jam dëshmitar këtu,por edhe të tjerët, ndoshta, më tepër këtu. Prandaj ky ligj tash e bënë të funksionojë të drejtën e autorit, të drejtën e botuesit dhe të drejtat dhe obligimet e tjera që këto shtëpi botuese që i kemi ne këtu. Para së gjithash më duket sikur kjo është një plotësim i ligjit për të drejtat e autori,. me gjithë se atje është i detajizuar edhe këtu është cekur të mos harrojmë botuesi se çfarë të drejte ka autori, çfarë të drejte ka shoqëria. Ky është një mall, por ky është një mall shpirtëror që ka rëndësi te posaçme, sidomos për edukimin e brezit të ri , të dihet se çka botohet, për çka botohet , çfarë përmbajtje dhe çfarë qëllimi ka çdo libër që del në treg. Këtu ne nenin 21 përcaktohen të gjitha detyrat e nevojshme që duhet t'i ketë botuesi, d.m.th. titulli i emrit etj, por mungon një gjë shumë me rëndësi, numri i botimit, ribotimit, a është botimi i parë ,i dyti, i treti i katërti. Në këtë fushë bëhen maleverzimet më të shpeshta , kështu që autori kur nuk e sheh librin nuk e di a është ribotuar ai libër, a është botimi i parë, i dyti a i treti,sepse ka raste kur botuesi thotë ky nuk është botimi i dytë, por është plotësim i

botimit të parë, ajo është njësoj, por duhet të ceket edhe kjo: duhet të parashihen në nenet 26 dhe 29 edhe obligimet e tjera që duhet t'i ketë patjetër një libër dhe një botim i ri ose një botim i parë. Me duket se çdo botues është i obliguar që Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare t'ia dorëzojë disa tituj ,sipas ligjit . Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Profesor, ju faleminderit. Nexhat Rexha, le të bëhet gati , i fundit, Fetah Berisha.

DEPUTETI NEXHAT REXHA:

I nderuari z. kryetar, i nderuar z. ministër, të nderuar kolegë deputetë.

Mendoj se Projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin është punuar mirë, por ka vend për diskutim dhe shqyrtim edhe të disa çështjeve që duhet të punohen në fazën e mëtutjeshme, sepse rëndësia e këtij projektligji është domosdoshmëri e kohës, kur dihet se në Kosovë çështja e botimit të librit është mjaft e shkapërderdhur dhe nuk ka emërues të përbashkët.

Gjatë leximit të këtij projektligji kam veçuar disa pikëpamje të miat, që kam specifikuar disa çështje me qëllim të begatimit të mëtutjeshëm.

Do të filloj nga neni 7. Përbërja e këshillit të librit prej 11 anëtarëve në këtë këshill,propozoj të ketë vend edhe për 2 deputetë të propozuar nga Kuvendi i Kosovës. Të gjejnë vend në një nen ku përcaktohen vlerat e librave unikatë nga e kaluara e historisë kombëtare ,sepse këtij projektligji i mungon kjo pasuri që mund të ekzistojë dhe si e tillë vendin e ka në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

Neni 8.9. t'i definojë konkurset dhe çmimet për vepra letrare dhe shkencore,si dhe të përcaktohet ndonjë manifestim letrar apo kulturor me karakter të gjerë shtetëror ,që mendoj se i duhet vendit tonë.

Neni 10 ta definojë tatimin në fitim për secilin lloj të librave. Mendoj se tatimi për librin duhet të jetë simbolik, sepse nga libri në Kosovë nuk fitohet apo më mirë të qartësoj, se nga librat e domosdoshëm për nxënësit e studentët do të duhej tatim tjetër nga librat shkencorë apo letrarë,të ketë tatim më të vogël, kur dihet se sa lejojnë kushtet për blerjen e librave të dëshiruar.

Neni 17.2 t'i shtohet teksti si vijon: të botohen dhe të ribotohen libra enkas për shkollat tona në përputhje me plan- programin që janë të domosdoshmëri për punë praktike dhe teorike në arsimin e Kosovës ,kur dihet se shkollat tona në këtë fushë janë tejet të varfra,që i mungojnë se pari arsimtarit e pastaj edhe vetë shkollarit tonë.

Të formulohet një nen i posaçëm për botimin dhe ribotimin e hartave të Kosovës, sepse në tregun tonë dalin në shitje harta të pa verifikuara nga botues që nuk dihen kush janë.

Konsideroj se gjatë punës së mëtutjeshme ky projektligj do të plotësohet dhe do të punohet edhe më mirë, pra në parim e mbështes këtë projektligj. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Faleminderit, edhe z. Fetah Berisha, urdhëro Fetah.

DEPUTETI FETAH BERISHA:

Faleminderit z. kryetar, i nderuar ministër dhe zëvendësministër, të nderuar kolegë kuvendarë.

Sot kemi para vetes Projektligjin për veprimtarinë botuese dhe librin, i përpiluar nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe po e shqyrtojmë në këtë seancë. Dihet se rëndësia e librit është e gjithanshme, por edhe rëndësia e këtij projektligji është me vlerë. Dihet se botimi i librit është shumë i rëndësishëm dhe kompleks, sepse ngërthen në vete dituri të mendjeve të ndritura, si në fushën e artit, të shkencës dhe të kulturës në përgjithësi, kurse projektligji duhet të ketë rregulla dhe kritere edhe për veprimtarinë botuese dhe librin, prandaj dihet se nëpërmjet librit formohet personaliteti i njeriut dhe kështu përhapen: kultura, shkenca e etj.

Kosova edhe në këtë fazë të transicionit dhe të transformimeve pozitive ka nevojë për një ligj të mirëfilltë, siç është ky për veprimtarinë botuese dhe librin, që nënkupton se botimi, shpërndarja dhe qarkullimi i librit. Marrë në tërësi veprimtaria botuese rregullohet me ligj të mirëfilltë që duhet të ketë kriter për ta siguruar vlerën e librit. Kjo del qartë kur kihet parasysh qëllimi pozitiv i këtij ligji, që e ka përbuzur vlerën e librit, që del nga konkurrenca. Gjithashtu ky projektligj duhet të garantojë dhe po garanton lirinë e botimit të librit, qarkullimit të librit brenda dhe jashtë Kosovës në ato institucione ku merren me librin. Mirëpo nuk ishte gjithmonë kështu, sidomos në sistemet moniste kur si kriter për vlerësimin e librit ishte kriteri ideopolitik, pastaj edhe veprimtaria botuese duhej të kalonte nëpër një filtër censure politike, por edhe në atë kohë kishte literaturë të ndaluar. Pra në atë kohë ngulfateshin vlera e librit dhe e vërteta. Me këtë kriter ideopolitik shkruhej mbrapsht edhe historia.

Në këtë projektligj për veprimtarinë botuese dhe librin janë përcaktuar edhe rregullat e hapjes së bibliotekave, sidomos për ato të nevojshme për shkollat tona. Ky projektligj rëndësinë e vet se parasheh ekspozita, panairë etj. Ato që janë më të rëndësishme, mbrojtja dhe ruajtja e librit, që d.m.th ruajtja dhe mbrojtja e librit është ruajtja e trashëgimisë në këtë rast të popullit tonë.

Ky projektligj garanton të drejtën e autorit si dhe botimin e njëjtë të librit edhe në gjuhët e minoriteteve. Kjo është dëshmi e qëndrueshme se minoritetet në Kosovë gëzojnë të drejta të plota sipas standardeve ndërkombëtare. Kjo del se ata dhe shumica shqiptare këtu zhvillojnë veprimtarinë botuese, arsimohen, zhvillojnë kulturën e tyre në gjuhën amtare. Me këtë në praktikë tregohet niveli i proceseve demokratike në shoqërinë e Kosovës që begatohet edhe me këtë projektligj edhe me respektimin e kulturave të të tjerëve. Natyrisht se ky projektligj për veprimtarinë botuese dhe librin, krahas nivelit të dukshëm standard, në anën tjetër ka zbrazëti. Ne veçqam vetëm këto momente.

Në tërësi me nenet e këtij projektligji rregullohen dhe janë paraparë vetëm dy rregullore, kurse të tjerat rregullohen me akte nënligjore, prandaj mendoj se ka nevojë për udhëzime më të shumta administrative edhe për nenet e tjera nga se qartësojnë përmbajtjen dhe lehtësojnë zbatimin e tij në praktikë. Gjithashtu ma thotë mendja se nenet 10, 12, 13, duhet të riformulohen. Pastaj pika 2 e nenit 10 duhet të qartësohet se cilat janë lëshimet që shfrytëzuesi e ka humbur stimulimin për zvogëlimin e tatimit në fitim. Por, me gjithë vlerat dhe mangësitë që ka ky ligj, ne mendojmë se pas këtij debati në Parlament do të përmirësohej dhe do të bëhej një ligj i mirëfilltë për veprimtarinë letrare. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

I dëgjuam të gjitha vërejtjet dhe ju ftoj të përgatitemi për t'i dhënë mbështetje shqyrtimit në parim të Projektligjit. Regjia bëhemi gati dhe votojmë tani.

68 vota janë **për**
2 vota janë **kundër**

Prandaj Projektligji në shqyrtimin e parë u aprovua dhe tani komisionet duhet ta shqyrtojnë: Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Komisioni për Gjyqësi, Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për Komunitete.

Kalojmë në pikën tjetër të radhës.

Shqyrtimi i parë i Projektligjin për institucionet e kulturës

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 6. 10 2005, pra janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim. Vërejtjet parimore do t'i adresohen për shqyrtim Komisionit Funkcional Përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet zëvendësmistrja ta prezantojë këtë projektligj. Urdhëroni.

DEPUTETJA ANGJELINA KRASNIQI

Ju faleminderit i nderuari kryetar Daci, i nderuari ministër Veliu të nderuar deputetë.

Projektligji për institucionet e kulturës rregullon kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit të institucioneve të kulturës, karakterin, strukturën organizative dhe menaxhuese të tyre, punët dhe veprimtaritë, obligimet dhe përgjegjësitë, çështjet statusore, si dhe çështjet e tjera relevante për veprimtarinë dhe funksionimin e institucioneve të kulturës. Ky projektligj është i domosdoshëm për veprimtarinë dhe funksionimin e institucioneve të kulturës, në veçanti edhe të Ministrisë së Kulturës në përgjithësi.

Siç dihet institucionet e kulturës janë pjesë e strukturës organizative të Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sporteve. Këto institucione deri më tash kanë funksionuar në bazë të rregulloreve të përkohshme, ndërkaq me miratimin këtij projektligji do të rregullohet statusi juridik i këtyre institucioneve.

Projektligji në fjalë do ta rregullojë edhe çështjen e nivelizimit të institucioneve të kulturës, që nga niveli lokal, deri tek ai qendror. Me akte nënligjore, që do të nxirren në bazë të këtij ligji, do të përcaktohen obligimet dhe detyrat e institucioneve qendrore dhe të atyre lokale të kulturës.

Një çështje shumë e rëndësishme e këtij projektligji është fakti se ky është në harmoni të plotë me ligjet e mëparshme të sponsoruara nga Ministria e Kulturës, e sidomos është në harmoni të plotë me Ligjin për trashëgiminë kulturore të Kosovës, i miratuar në parim nga Kuvendi i Kosovës, më 25 korrik të këtij viti.

Në pjesën e parë të Projektligji janë dhënë dispozitat themelore për mënyrën e themelimit të institucioneve të kulturës, si dhe aktet juridike, me të cilat mund të themelohen institucionet e kulturës. Në një kapitull të veçantë janë përcaktuar edhe format dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të institucioneve të kulturës.

Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë ekspertë të fushave përkatëse që janë edhe drejtues të institucioneve të ndryshme të kulturës apo ekspertë të fushave të artit e të kulturës.

Nevoja dhe arsyeja për përgatitjen dhe miratimin e këtij projektligji janë të domosdoshme. Me këtë projektligj, vërtet vihen themelet juridike të institucioneve të kulturës, përkatësisht krijohen kushte dhe mundësi institucionale edhe më të mira për institucionet ekzistuese të kulturës në Kosovë.

Projektligji në fjalë krijon hapësirë dhe modalitete të ndryshme për themelimin dhe veprimtarinë e institucioneve të tera jopublike të kulturës.

Të nderuar deputetë, shpresoj se me votën tuaj në parim do të pajtoheni që të aprovohet ky projektligj. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit . Hapim debat në parim. Z. Nimon Alimusaj në emër të LDK-së. Le të përgatitet Sala Ahmetaj në emër të PDK-së. Nimon urdhëroni.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ:

Faleminderit z. kryetar i nderuar ministër dhe ju kolegë deputetë.

Projektligji për institucionet e kulturës është njëri ndër ligjet që mëton rregull dhe rend në funksionimin dhe në regjimin e institucioneve të kulturës në Kosovë. Siç dihet një pjesë e institucioneve të kulturës ka vepruar edhe para luftës në Kosovë. Ndërkaq disa prej tyre janë riorganizuar dhe rikonstruktuar. Në qoftë se në nivelin qendror, pra në kuadër të Ministrisë së Kulturës ,qoftë në nivelin lokal, në kuadër të drejtorive komunale të kulturës. Në ndërkohë në Kosovë janë formuar edhe institucione private të kulturës, prandaj Projektligji që sot po e shqyrtojmë do të plotësojë një vakum legjislativ të kësaj fushe të rëndësishme të veprimtarisë kulturore në Kosovë. Siç theksoi edhe sponsoruesi ky është ligj bazë, sistemor i rëndësisë së veçantë për kulturën, prandaj që në fillim sjell konstatimin tonë se hartimi i tij është vonuar dhe si ligj bazik që ishte do të duhej të nixirrej para ligjeve të tjera nga kjo sferë. U tha se ligji në fjalë mëton rregull dhe rend në menaxhimin e institucioneve të kulturës, por për çudi në te nuk gjejmë ndonjë dispozitë që , siç kërkon teknika legjislative, do t'i përcaktonte qëllimin dhe objektivat e tij. Në strukturën e ligjit, si pjesë e rëndësishme të saj konsiderohet ajo pjesë në të cilën shprehen objektivat dhe qëllimet e ligjdhënësit që kërkojnë kujdes, sepse duke i shpjeguar ato me dispozita të caktuara mundësohet të ndikohet në vetë ligjin.

Në këtë projektligj nuk është respektuar duhet teknika legjislative. Kjo mund të argumentohet edhe me shembuj të tjerë,përveç me atë që sollëm më sipër. Në pjesën e parë të këtij projektligji janë përcaktuar mënyrat e themelimit të institucioneve publike dhe të atyre private të kulturës. Në këtë pjesë, me gjithë qëllimin e mirë që të përcaktohen sa më qartë e drejtë format e themelimit të institucioneve të kulturës ,mendojmë se janë shpenzuar shumë nene, 15 sosh, pra afërsisht një e katërta e krejt Projektligjit, që me një redaktim më të mirë gjuhësor dhe me një përkufizim më thelbësor të kësaj pjese ,ky projektligj do të ishte më koncizë,më funksional dhe më përmbajtjesor. Përpjekja për të futur çdo gjë në ligj e dëmton atë dhe e bën jofunksional.

Krahas vërejtjeve të përgjithshme ligjit mund t'i bëhen edhe vërejtje të veçanta, siç janë: mospërputhja e dispozitave, paqartësia e ndonjë dispozite që gjithsesi kërkojnë riformulime. Për lëshimet e tilla ,siç është konfrontimi ndërmjet disa dispozitave. Më lejohet ta marr një shembull.

Në neni 6 thuhet: konform me ligjin, institucione mund të themelojë :

1. Kuvendi i Kosovës, 2. Qeveria e Kosovës, kurse në nenin 8.1. thuhet: Themeluesi i institucionit publik ka obligim që nga Ministria e Kulturës të kërkojë vlerësimin e përputhshmërisë së vendimit apo të marrëveshjes, përkatësisht të aktit të themelimit, në përputhje me ligjin. S'do mend, nëse institucionin e krijon Qeveria ky nuk mund ta kërkojë vlerësimin e Ministrisë së Kulturës.

Me këtë projektligj ,siç po na ndodh shpesh edhe në projektligjet e tjera, është problematike edhe çështja e terminologjisë. Në këtë projektligj, aty- këtu, hasim konfrontime termash. Në këtë projektligj lypset të bëhet një përcaktim më i mirë i institucioneve qendrore dhe i atyre lokale të kulturës dhe i kompetencave të tyre.. Po ashtu mendojmë se institucionet e caktuara të rëndësisë shtetërore, siç janë: Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Menamenteve të Kulturës, Instituti i Arkeologjisë etj. nuk mund të kenë të njëjtin rregullim në përcaktimet e dhëna me këtë ligj. Një aspekt pozitiv

që meriton të theksohet në përmbajtjen e këtij ligji, është edhe formimi i këshillit profesional, përkatësisht artistik ,që shqyrton dhe vendos për çështjet profesionale, artistike të punës së institucioneve të kulturës .Kjo është shumë e dobishme për faktin se veprimtaria e kulturës në një mënyrë kalon në duart e njerëzve profesionistë, në këtë kohë kur kemi shumë pseodovlera. Vërejtjet që mund t'i bëhen këtij projektligji ,disa prej të cilave edhe u theksuan, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mendon se ky tekst ligjor paraqet një bazë të mirë legjislative, që do t'i bashkërendonte veprimtaritë e institucioneve publike dhe private të kulturës që nga niveli lokal e deri te ai qendror. Grupi Parlamentar do të kontribuojë që me procedurën e mëtejme ky tekst legjislativ të marrë formën sa më të përkryer. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Nimon ju faleminderit, Sala Ahmetaj, le të përgatitet Myrvete Dreshaj -Baliu.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë.

Një vend në transicion dhe me demokraci të brishtë ,siç është Kosova, po përballet me vështirësi natyrash të ndryshme sa u përket ruajtjes dhe kultivimit të vlerave të mirëfillta kulturore, që për pasojë ka sjellë një shturje vlerash që po përjetohej si krizë identiteti, si shpërbërje dhe zvetënim i identitetit kulturor me përmasa shqetësuese. Prandaj, ndërhyrja e institucioneve në këtë fushë është e ngutshme. Ligji që kemi përpara synon t'i sistemojë dhe t'i strukturorë institucionet e kulturës dhe veprimtaritë e tyre me qëllim që të krijohen mekanizmat që drejtojnë dhe menaxhojnë veprimtarinë kulturore. Kështu synohet të shmangen veprimet deviante që bëhen duke u fshehur nën petkun e ndonjë aktiviteti kulturor. Kultura është ushqim shpirtëror dhe kur kjo shpërfillet, ose zvetënohet ,nuk krijohen hapësira dhe mundësia e shpërfaqjes së vlerave kulmore që për pasojë përshpejton shpërbërjen e identitetit të mirëfilltë kulturor. Ne edhe me këtë rast bëjmë thirrje të çmohen dhe të ruhen vlerat e mirëfillta të kulturës. Çdo ditë dhe çdokënd po përballemi me pseudovlera, që po na ngulfatin dhe po na bëjnë të padinjitetshëm. Një ndërgjegjësim shoqëror për të promovuar vlerat e mirëfillta është i domosdoshëm.

Institucionet e kulturës i kanë barrën dhe përgjegjësinë për ta bërë këtë, kurse detyrim yni është ta monitorojmë këtë përgjegjësi. Përkushtimi i institucioneve të kulturës do ta këndellte shoqërinë dhe shtresat e caktuara sociale, në mënyrë që ta përjetojmë dhe ta shijojmë ndjenjën e krenarisë për vlerat që krijojmë e jo të tjetërsuara në asgjë për të mbështetur krijuesit e mirëfilltë dhe vlerat kulmore e jo pseodovlerat . Kjo gjithnjë duke u udhëhequr nga parimi se një vlerë kombëtare është edhe universale.

Me këtë ligj synohet që për institucionet e kulturës të krijohen mundësi për veprimtari të denjë të përgjegjshme. Por ne kemi edhe disa vërejtje, përfillja e të cilave shpresojmë se do ta begatonte këtë ligj. Vërejtjet tona i kemi sistemuar në disa rrafshe.

1. Në rrafshin strukturor,
2. Në rrafshin kuptimor dhe si gjithnjë

3. Në rrafshin gjuhësor.

1. Në rrafshin strukturor kemi shumë dilema dhe fakti se kush duhet ta orientojë, cili duhet ta drejtojë ose ta mbikëqyrë veprimtarinë kulturore, a duhet të kenë institucionet kulturore liri të pakufishme ose të pakufizuar në objektet e tyre, a do të duhej ato të mbështeteshin në ndonjë strategji kombëtare që do t'i orientonte rrjedhat kulturore të cilat do t'i zvetënonte parametrat e rrezikshmërisë të identitetit kulturor. Në rrafshin kuptimor, shpeshherë për arsye keq përkthimi, më tepër se për arsye të tjera, siç është njohja e lëndës e tjerë. Ndonjë nen duket i pakuptueshëm, i paqartë ose konfuz p.sh. shikojeni nenin 10, në të cilin, ndër të tjera, kemi gjetur edhe fjalën besë. Në ligj s'ka vend fjala besë, ajo do me thanë besa i takon një kodi tjetër dhe është pjesë e një sistemi tjetër socio- kulturor, në ligj s'punohet me besë, por me parime dhe rregulla që duhet të përfillen dhe të zbatohen. Kemi edhe shumë vërejtje të tjera, sidomos sa i përket rrafshit kuptimor dhe shpeshherë nenet e caktuara janë në kundërtënie me nenet e tjera ose edhe sa i përket aspektit të përfaqësimit dhe 3. kemi vërejtje edhe në rrafshin gjuhësor që do t'i paraqesim gjatë punës sonë në komisione.

Megjithëkëtë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet na parim këtë projektligj dhe ne me përkushtim do të punojmë në përsosjen e tij në komisionin përkatës. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Faleminderit, Myrvete Dreshaj Baliu, le të përgatitet Nuran Malta.

I nderuari z. kryetar dhe kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar i AAK-së e ka shqyrtuar me kujdes dhe hollësi Projektligjin për institucionet e kulturës dhe ka bërë një vlerësim të drejtë për hartuesin në përpjekje për të bërë një ligj që konsiston t'i rregullojë veprimtarinë dhe funksionimin e institucioneve të kulturës.

Kosova ka trashëguar pasuri shumë shtresore të kulturës që kërkon mbrojtje, menaxhim, administrim dhe mbi të gjitha orientim profesional sipas kriterëve që janë të baras vlefshme me standardet evropiane. Projektligji në parim përmban të specifikuar kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit të institucioneve të kulturës, por fillimisht i mungon pjesa e dispozitave hyrëse që përcakton qëllimin e këtij projektligji dhe objektin e veprimtarisë së tij. Projektligjit i mungon edhe grupi i punës, hartuesi i këtij projektligji. Më tutje gjatë vlerësimit që i ka bërë Grupi i AAK-së për një përkrahje të sotme, kemi vërejtur se ka paqartësi në shpjegimet e kreut 1 dhe 2 të quajtur dispozitat e përgjithshme dhe themelimi i institucioneve. Në mënyrë të veçantë shpjegimet e neneve 9, 10, 12 lidhen me formimin dhe funksionimin e disa institucioneve dhe të degëve të tyre. kompetencat që u jepen institucioneve nga komunat dhe rrjedhore që mund të dalin nga themelimi i këtyre institucioneve mbi baza ndërkomunale. Në parim e përkrahim këtë projektligj që të procedohet në Komisionin Funkcional të Parlamentit për shqyrtim të mëtutjeshëm. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Myrvete, ju faleminderit dhe Nuran Malta.

DEPUTETJA NURAN MALTA

Teşekkür ederim. Sayın Başkan, Sayın Meslektaşlarım
Biz diğer grup üyelerinin de söyledikleri gibi, bu Kültür Enstitüleri Yasasının öneminden dolayı, 6 + gurubu olarak başta geçmesine, ancak bütün uyarılarımızı Komsiyon toplantılarında yapacağımızdan dolayı, 6+ gurubu adına bu Yasa Tasarısının geçmesine kararlıyız.

Teşekkür ederim.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit. Tani pas shqyrtimit në parim ju ftoj që të përgatitemi ta mbështesim në parim projektligjin e debatuar. Regjia :bëhemi gati për ta votuar dhe votojmë tani.

Lus deputetët që të kthehen në sallë, e pas këtij vendimi, pastaj bisedojmë e bëjmë pauzën e nevojshme. Deputetët le të kthehen në sallë.

Regjia, tani e kam sinjalin që kuorum për vendim ka, te bëhemi gati, uluni ju lutem te gjithë, bëhemi gati për të votuar për Projektligjin në shqyrtim te parë dhe votojmë tani:

72 DEPUTET janë **për**
2 janë **kundër**,

Prandaj konsideroj që në shqyrtim të parë është aprovuar ligji .

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI:

Hartimi i një projektligji, kërkon të respektohet një teknike legjislativë. Projektligji i propozuar që në fillim, nuk na paraqet një respektim të parimeve të teknikës legjislativë;

Së pari: Në projektligj, nuk ka dispozite që ta përcaktojë se cili është qëllimi i këtij ligji, çka përbën edhe një kusht të domosdoshëm të ekzistencës së tij.

Së dyti: Në projektligj mungon objekti i veprimtarisë së ligjit. Çdo ligj ka objekt të caktuar të veprimtarisë dhe rregullon një fushë të caktuar të saj.

Së treti: Dispozitat e propozuara të projektligjit karakterizohen nga një konfrontim termave juridikë.

Së katerti: Duke iu referuar dispozitave të ligjit, të krijohet konsiderata se ndodhemi përpara një akti ngjashëm me statutin e organizimit të një personi juridik.

Së pesti: Gjuha e përdorur kërkon një shqipërim.

Duke iu referuar dispozitave përkatëse ligjore, sugjerojmë këto rregullime:

- Institucioni themelohet për të ushtruar veprimtari kulturore dhe artistike. Koha e ushtrimit të kësaj veprimtarie përcaktohet në aktin e themelimit (neni 2.2).
- Institucionet janë publike dhe private.

Institucionet publike krijohen me akt të organit kompetent.

Institucionet private krijohen në bazë të aktit të themelimit dhe të regjistrimit të tyre në organin kompetent.

Institucionet publike dhe private fitojnë zotësi juridikë, që nga momenti i krijimit të tyre nga organi kompetent apo të regjistrimit të tyre pranë organit kompetent (neni 3).

- Neni 6 dhe neni 8.1, janë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Në rast se institucioni krijohet nga Kuvendi apo Qeveria e Kosovës, ky institucion nuk mund të kërkojë vlerësimin nga Ministria e Kulturës, nga pikëpamja e hierarkisë shtetërore. Në këtë kontekst duhet një formulim adekuat i nenit 8.1.
- Në konceptin e degës së dhënë në nenin 9, ai nuk është i qartë dhe i saktë. Çdo person juridik mund të ketë degët e tij, që nënkuptojnë ushtrimin e veprimtarisë së institucionit në vende të caktuara. Në këtë drejtim, duhet një formulim i drejtë i "konceptit degë", të institucionit. Dispozita është e stërzgatur dhe pikat përbërëse të saj, konfrontohen me njëra-tjetrën.
- Neni 10, të shqipërohet, pasi dispozita është e paqartë. Të përcaktohet qartë se çfarë kompetence ka komuna mbi institucionin.
- Neni 12, duhet të riformulohet. Në varësi të faktit nëse një institucion është publik apo privat, do të ndryshojë dhe mënyra e themelimit të tyre.
- Duke iu referuar dispozitave vijuese, në vazhdimësi edhe mendimit të sipërcituar, mund të themi që ato pak a shumë u referohen neneve nga të cilat mund të përbëhet statuti i një personi juridik.

Pa dyshim, përfshirja e dispozitave të tilla është më se e nevojshme, por në rastin e krijimit dhe të konstituimit të institucioneve të kulturës, për vetë specifikën që ato prezantojnë dhe për larminë e madhe të sferës kulturore dhe artistike që ato mbulojnë, propozojmë të bëhet një specifikim i llojit të institucionit, ose ligji në dispozitat e përgjithshme të tij, të përcaktojë në mënyrë të specifike, që nga rregullimi i këtij ligji bëjnë përjashtim institucione të caktuara, si Instituti i Monumenteve të Kulturës; Instituti i

Arkeologjisë, etj, që për rëndësinë dhe pozicionin e tyre, nuk mund të kenë të njetin rregullim me përcaktimet e dhëna në këtë projektligj. Me një fjalë duhet të kemi parasyshë faktin që institucionet qëndrore të kulturës duhet të kenë ligje të veçanta për secilin institucion.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit dhe tani varet nga ajo sa jeni lodhur, në qoftë se jeni gati për pauzë mund të shkojmë një orë në pauzë dhe koha e mëngjesit në ndërkohë le të shfrytëzohet për këtë dhe vazhdojmë tani. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Të nderuar deputetë me qenë se kemi kuorum për të zhvilluar debat lidhur me ligjin. A fillojmë?

Po fillojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës që është shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 28. 10.2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'u adresohen për shqyrtim komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet ministri Agim Veliu, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit,ta prezantojë Projektligjin.

Z. ministër e keni fjalën.

MINISTRI AGIM VELIU

Faleminderit kryesues, të nderuar deputetë. Projektligji përfshin një fushë shumë të rëndësishme ligjore të nevojshme , të arsimit dhe të aftësimin privat në Kosovës.

Ministria e Arsimit është duke punuar në përgatitjen e bazës ligjore për avancimin e procesit arsimor në frymën e integriteteve rajonale, evropiane edhe më gjerë ,si dhe të krijimit të standardeve të pranuarra të arsimit evropian në përputhje në procesin e Deklaratës së Bolonjës.

Ky projektligj rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, financimin dhe qeverisjen e institucioneve arsimore dhe aftësuese private, duke përfshirë nivelet: parashkollor, parauniversitar dhe universitar, me qëllim të sigurimit të konkurrencës cilësore, si dhe të përfshirjes së numrit sa më të madh të qytetarëve në arsim, aftësim, kërkim dhe në pasurimin e sistemit të tashëm arsimor,krijimin e kushteve më cilësore për aftësim të qytetarëve të Kosovës.

Kosova ka pasur kaheerë nevojë të ketë ligj për arsimin dhe aftësimin privat. Kjo është bërë edhe më e domosdoshme në fazën e tanishme të procesit të ndryshimeve teknike teknologjike dhe të transicionit që për shoqërinë kosovare janë rrethana të reja. Projektligji ka rëndësi të madhe për shoqërinë kosovare ngase është i natyrës së zhvillimit të arsimit dhe aftësimin privat në Kosovë. Me këtë ligj arsimit dhe aftësimin privat avancohen dhe proceset e përgjithshme zhvillimore në shoqërinë tonë arrijnë kuptueshmërinë e vet ligjore. Ky ligj ofron përparimin e konkurrencës arsimore dhe ka rëndësi praktike për nevojat e gjithmbarshme në kuadër të zhvillimit të proceseve ndërkombëtare me qëllim të krijimit të kushteve optimale për zhvillimin e arsimit dhe të aftësimin privat në pajtim me zhvillimet dhe me të arriturat e reja të harmonizuara me standarde ndërkombëtare. Në përgatitjen e këtij projektligji është punuar gjatë dhe janë konsultuar ligjet e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të shteteve të rajonit. Mirëpo ai është hartuar në pajtim me kushtet dhe rrethanat e Kosovës.

Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë ekspertë të Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe Teknologjisë dhe të Qeverisë, por janë konsultuar legjislacioni i Francës, i Gjermanisë, i Belgjikës etj. Kjo ka kontribuar që ky projektligj të jetë në harmoni me legjislacionin e BE-së dhe që t'i plotësojë mangësitë ligjore të arsimit dhe të aftësimin privat në Kosovë.

Projektligji për arsimin dhe aftësimin privat është i avancuar dhe ky vlerësim është jo vetëm i anëtarëve të grupit të punës, por edhe i ekspertëve të shumtë vendorë dhe i opinionit të shumtë kosovar që ka marrë pjesë në diskutim publik. Të gjitha këto vlerësime e bëjnë Projektligjin të harmonizuar më praktikën e standardeve vendore dhe me atë ndërkombëtare. Projektligji i arsimit dhe i aftësimin privat është një risi në legjislacionin e tashëm. Ai paraqet konkurrencën në punën e shërbimit të arsimit krijues e sistematik që ndërmerret me qëllim të arritjes së njohurive të reja dhe shfrytëzimit të tyre në praktikë në pajtim me zhvillimin e proceseve ndërkombëtare. Ligji i arsimit dhe aftësimin privat në Kosovë adreson themelimin, organizimin, funksionimin, financimin dhe qeverisjen e institucioneve të arsimit dhe të aftësimin privat, duke përfshirë të tri nivelet: parashkollor, parauniversitar dhe universitar. Ju faleminderit dhe ju ftoj që këtë projektligj ta miratoni.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit z. ministër. Po shkojmë sipas radhës së paraqitjes nga grupet parlamentare për të dhënë mendimin për Ligjin. Në emër të Grupit Parlamentar Lidhjes Demokratike të Kosovës është paraqitur Ragip Zekolli.

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI:

Faleminderit z. kryesues. Ligji për arsimin privat është nevojë imediate për Kosovën dhe për arsimin kosovar në përgjithësi. Ky ligj është edhe një nga nevojat urgjente që në këtë moment e kemi para vetes dhe mendoj se me vërejtjet dhe sugjerimet që do të bëhen, do të jetë pozitiv për komisionet funksionale. Ligji përmban arsyet për nxjerrjen e tij ,

çështjet e adresuara, përmbajtjen, dispozitat e përgjithshme, të veçanta, ndëshkuese si dhe dispozitat kalimtare dhe të fundit.

Çështja pozitive që është në këtë ligj është se ky është në pajtueshmëri me Deklaratën e legjislacionit evropian. Komisioni gjatë punës së vet ka shqyrtuar një sërë legjislacionesh të shteteve të Bashkësisë Evropiane, por edhe më gjer në radhë të parë duke marrë shtete që janë mostër apo të përafërta me Kosovën, kështu që është shqyrtuar edhe ligji belg, duke përfshirë komunitetin, francez, gjermanofolës, komunitetin flaman, pastaj janë shfrytëzuar ligjet e rajonit çfarë është ai grek, gjithashtu ai spanjoll e kështu me radhë.

Një çështje që duhet të rregullohet me udhëzim administrativ është neni 11 i këtij ligji dhe mendoj se Ligji, përveç Komisionit funksional të arsimit gjithsesi duhet të kalojë edhe te Komisioni për Buxhet, për arsye se kur është fjala për sanksionet, përkatësisht për gjrobat, kjo çështje duhet të bëhet nëpërmjet dy komisioneve dhe të unifikohet për arsye se këto çështje janë të paraqitura, janë elastike dhe lëvizin nga shuma të ndryshme. Duke parë domosdoshmërinë se pa tjetër duhet që një ligj i tillë të jetë para institucioneve kosovare, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike jep mundësi që ligji të miratohet në parim dhe të kalojë në shqyrtim në komisionin funksional. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit z. Zekolli. Në radhë është deputeti Enver Hoxhaj, që në emër të Partisë Demokratike të Kosovës do ta prezantojë mendimin e partisë.

DEPUTETI ENVER HOXHAJ:

Ju faleminderit, z. kryesues, i nderuar z. ministër, të nderuar kolegë.

Debati i sotshëm rreth Projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat tregon që Kosova aktualisht ballafaqohet me dy sfida kryesore.

Sfida e parë është që Kosova e ka një Qeveri që arsimin nuk e ka prioritet të saj dhe debati i djeshëm rreth buxhetit dhe shumë më se simbolike të cilën e ka ndarë Qeveria për arsim, tregoi që arsimi do të jetë prioritet në periudhat e ardhshme.

Gjëja e dytë është së jo vetëm arsimi nuk është prioritet, por brenda për brenda arsimi nuk ka prioritete, nuk dihet se cili profil i arsimit vërtet nuk do të duhej të kishte përparësi të caktuar në kuadër të politikave edukative. Kjo është pasoja e saj, meqë nga nëntori i vitit të kaluar Kosova ka një Qeveri që nuk ka program. Ligji për arsimin dhe aftësimin privat është reflektim i saj që kjo Qeveri nuk ka hierarki ligjore dhe nuk e di se cilat ligje do të duhej të draftohen dhe të formulohen e të propozohen në Kuvendin e Kosovës. Mendimi i Grupit Parlamentar të PDK-së është që ky ligj nuk rregullon asgjë, nuk plotëson kurrfarë vakumi, por përfaqëson vetvetiu një vakum. Qeveria as në programin e saj, as në këtë ligj, as në ligje të tjera, nuk ka qenë në gjendje ta japë përgjigjen e pyetjes: cili duhet të jetë roli i arsimit publik në Kosovë e i cili duhet të jetë roli i arsimit privat në Kosovë. Si duhet të referohen këto dy aspekte të arsimit ndaj njëri-tjetrit. Unë mendoj, që çështja e arsimit privat në Kosovë, kur është fjala për arsimin e lartë, ka mund

të adresohet përmes Agjencisë Kosovare të Akreditimit. Qeveria e Kosovës ka dështuar sistematikisht tre vjetët e fundit që ta themelojë Agjencinë Kosovare të Akreditimit. Licencat që iu kanë dhënë institucioneve private janë bërë prej një komisioni që dëshmon për shkelje të ligjit dhe nuk është fare kompetent për një gjë të tillë. Agjencia kosovare e akreditimit dhe institucionet e tilla zakonisht shpërdoren nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. Kjo nuk ka ndodhur.

Përkitazi me këtë ligji dhe me projektligjin në fjalë, ne mund edhe ta titullojmë si ligj për licencim. 80% e këtij projektligji dhe ky është debati parimor që Grupi Parlamentar i PDK-së e reflekton, merret vetëm me çështjen se kujt duhet t'i jepen licencat, çfarë forme duhet t'i jepet, kuptohet se qëllimi i ligjit është formuluar që Qeveria mendon të krijojë kushte më të mira për edukim, arsim dhe aftësim. Ne mendojmë që Kosova ka nevojë të ketë arsim privat, që secili qytetar në Kosovë duhet të ketë mundësi ta ndjekë arsimin, që dëshiron. Çdokujt duhet t'i ofrohet qasje, por ndodh të them që debati rreth licencimit të institucioneve private për këtë vit ka treguar se Qeveria jo vetëm që s'ka krijuar kushte, por ka dështuar sa i përket përgjegjësisë, që e ka pasur në këtë fushë.

U përmend edhe nga kolegë të tjerë deputetë përvoja e vendeve të tjera evropiane, dua të them që legjislacioni i Francës, i Gjermanisë, i Belgjikës dhe i Austrisë janë legjislacione që nuk reflektojnë trendët më të fundit sa i përket reduktimit. Në këto vende ka debate të mirëfillta vazhdimisht (aktualisht) se si të përmirësohen ligjet, cilat ligje janë pengesë qoftë për zhvillimin e arsimit publik, qoftë për zhvillimin e arsimit privat. Prandaj, Qeveria nuk është dashur t'i referohej vetëm një legjislacioni të atyre vendeve që i theksuam, legjislacion që më tepër është institucion fluid a ligjor, sesa institucion i qëndrueshëm. Kuptohet që për shkak të hapësirës kohore do t'i përmend vetëm disa vërejtje kryesore, përndryshe këto çështje janë më tepër të konceptit. Më lejoni vetëm t'i përmend disa gjëra kryesore.

Sa u përket neneve 1 e 2 nuk kam çka të shtoj, kurse për nenin 3 edhe z. ministër edhe kolegët e mi nga Komisioni për Arsim, Shkencë e Kulturë i Kuvendit të Kosovës e dinë që Ministria për Arsim është aktualisht duke hartuar kornizën kombëtare të kualifikimeve, ndërsa Komisioni ynë ka marrë iniciativën për hartimin e ligjit për kornizën kombëtare të kualifikimeve. Komplet neni 3 është punë e kornizës kombëtare të kualifikimeve. Kjo referohet në atë situatë që Ministria nuk e di se cili ligj do të duhej të hartohej paralelisht. Sa i përket statutit të institucioneve private deri tash, dua të them se Komisioni ynë ka vizituar një pjesë të institucioneve të arsimit të lartë dhe për përfundimet tona kanë qenë që asnjë institucion i arsimit të lartë nuk ka as rregullore të punës dhe as statut. Ministria nuk është në gjendje t'i ushtrojë kompetencat e veta.

Neni 3 i referohet formulimit të vlerësimit të nevojave të tregut dhe të shoqërisë. Ky është më tepër formulim demagogjik, sesa të sjellë diçka konkrete, meqë ne nuk dimë deri tash se si MASHT-i vërtet mund të caktojë dhe t'i vlerësojë nevojat e tregut për ndonjë politikë arsimore në përgjithësi e lere më për këtë ligj. Sa u përket politikave të caktuara për licencë ato janë politika që i takojnë një shoqërie tonë dhe nuk mund të rregullohen nëpërmjet një ligji.

Neni 12 ka të bëjë në tërësi me licencimin e kornizës kombëtare për kualifikim. Jam shumë i sigurt që punonjësit të Ministrisë, që punojnë në kornizën kombëtare të kualifikimit dhe në Komisionin që e drejtojnë, e ndajnë qasjen që këto janë çështje që rregullohen nëpërmjet agjencive si korniza kombëtare të kualifikimit, ku nuk është çështje e përgjegjësisë së një ministrie të caktuar, mirëpo është çështje e tërë shoqërisë kosovare. Pjesa tjetër e ligjit është vetëm përsëritje e asaj si do të duhej të jepeshin licencat dhe së fundi mbikëqyrja dhe kontrolli janë për t'u befasuar si Ministria nuk është në gjendje së paku në letër deri më tash nuk mund t'i zbatonte në praktikë që fjalën mbikëqyrje të paktën ta zëvendësonte me monitorim dhe fjalën kontroll ta zëvendëson me evaluim. Deri më tash institucionet e arsimit privat asnjëherë e as nuk janë monitoruar as evaluar dhe komplet pjesa tjetër e ligjit, që referohet pas nenit 27, për mendimin tim nuk është funksionale e askujt nuk i shkakton ndonjë problem. Dhe vërejtja ime e fundit është për nenin 30 në pikën e tretë të të cilit thuhet me një memorandum të mirëkuptimit Ministria e Ekonomisë dhe e Financave do të duhej t'i lironte institucionet private nga tatimi në profit. Do të them që ka dallim thelbësor mes institucioneve private joprofitabile që ekzistojnë në vendet perëndimore dhe në mes institucioneve private, shumë profitabile që ekzistojnë aktualisht në Kosovë për këtë koncept mendimi im është se Ministria nuk është fare e vetëdijshme. Sa u përket politikave tatimore në lidhje me këtë do të duhej të jemi shumë të kujdesshëm, se çka kërkojmë. Mendimi i Grupit Parlamentar të PDK-së është që nuk ka ligje të mira ose të këqija, por çdo herë ka ligje që janë në gjendje të implementohen apo jo. Ky ligj dëshmon se Ministria nuk është në gjendje as t'i implementojë ligjet, por as të hartojë ligje të mira, prandaj kërkojmë që ky ligj t'i kthehet Qeverisë që të hartohet paralelisht me kornizën kombëtare për kualifikim dhe me iniciativën që ka marrë Komisioni ynë sa i përket hartimit të ligjit për kornizën kombëtare të kualifikimeve. Vetëm kjo do ta respektonte hierarkinë e politikave të fushës së edukimit, për të cilën ka nevojë Kosova në këtë fushë. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit z. Hoxhaj. Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Ymer Halimi.

DEPUTETI YMER HALIMI:

Faleminderit z. kryesues, përshëndes të pranishmit.

Deputetë të nderuar, jemi dëshmitarë se përkundër numrit të madh të diplomave që kemi, sot Kosovës i mungon dija vetanake adekuate. Kjo është shumë shqetësuese dhe domethënëse. Projektligji për arsimin dhe aftësimin privat për lëmin e arsimit është i një rëndësie të veçantë së paku në fazën që jemi, është ëndërr. Edhe pa u hartuar mirë ky projektligj gjeti zbatim të duhur, do të hapë horizonte për zhvillimin e konkurrencës së arsimit dhe të aftësimin të gjeneratave të reja, që do të rezultojë me zhvillim të përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik afatgjatë. Projektligji për arsimimin dhe arsim privat, që sot e kemi në dorë për shqyrtim, është projektligj përshkrues të cilit i mungojnë përkufizimet e sakta në shumë nene.

Në nenin 8 për politikat e licencimit të MASHT-it shkruan se do të lejohen pa asnjë vlerësim të nevojave të tregut e të shoqërisë, po vërtet mund të jetë nevojë e shoqërisë, por jo edhe mundësia e saj që të hapë institucione arsimit dhe aftësimi privat nëse nuk ka kuadër profesional adekuat. P.sh. Universiteti Publik ka hapur pranë Fakultetit të Mjekësisë degët e studimit për farmaci dhe fizioterapi. Studentët e farmcisë janë vonuar për diplomim pa fajin e tyre dy vjet për shkak të mungesës së kuadrit, kurse dega e fizioterapisë ka 22 lëndë të specializimeve të ngushta me vetëm një doktor shkence të kësaj fushe, pa asnjë magjistër. Për mungesën e kuadrit mësimin e kanë mbajtur profesorët nga Kanada, një vit studimi dhe nga Franca dy vjet studimi. Në anën tjetër MASHT-i ka licencuar po të njëjtat drejtime, pa asnjë kuadër të vetëm pranë fakultetit të licencuar. E njëjta gjë është edhe me disa të ashtuquajtura universitete apo fakultete të tjera private. A do koment kjo?. Studentët për kushte të punës private mbajnë mësim edhe deri në orën 21. Ka edhe orar të shkurtuar tri ditë për shkak të hapësirës së vogël të mësimin. Këta kanë dhënë miliona në ato institucione që Ministria i ka licencuar, apo e ka vazhduar licencën e tyre, ndërsa ajo fare nuk kujdeset për mbikëqyrjen e këtyre institucioneve .Kjo flet për papërgjegjësinë e institucioneve.

Sipas nenit 11 lejohet transferi i nxënësve dhe i studentëve në çdo nivel nga shkollat private në shkolla dhe në universitete publike. Këtu duhet specifikuar raste të veçanta ,sepse hapet mundësia e keqpërdorimit .

Në nenin 13, duke shikuar përbërjen numerike të komisioneve të licencimit,ku parashikohet të jenë 9 anëtarë ,një e treta jashtë MASHT-it, por nuk përcaktohet nga cilat asociacione apo institucione vijjnë ata. Kjo duhet të përcaktohet dhe komisioni të jetë në përbërje 5 me 4 e jo 6 me 3. Për përcaktimin e kostos së studimeve, nuk është e arsyeshme të merren paralogaritë e mësimin për sektorin publik, sepse kjo varet çka ofron institucioni i arsimit dhe i aftësimin privat klientëve të vet.

Në nenin 34 nuk parashihet saktësisht forma e shuarjes, ose e ndërprerjes, por edhe detyrimin e mos ndërprerjes për kohë të caktuar të punës së institucionit të arsimit dhe të aftësimin privat. Besoj që Komisioni për Arsim i këtij Kuvendi vëmendshëm do ta shqyrtojë këtë projektligj ,sepse ka të bëjë me të ardhmen e gjeneratave të reja. Prandaj Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet për procedim në Kuvend, edhe pse ka vërejtje të tjera. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI

Faleminderit z. deputet. Në emër të Grupit Parlamentar ORA është paraqitur deputeti Genc Gorani.

DEPUTETI GENC GORANI

Faleminderit z. kryesues, të nderuar kolegë, deputetë dhe ministra.

Ky projektligj është në fazë tepër të hershme në tavolinën tonë, mjerisht, por po desha të argumentoja duhet t'i përsëris shumë prej argumenteve të dy parafolësve të mi, mirëpo do të isha ndalur vetëm në dy- tri vërejtje parimore.

Së pari infrastruktura ekzistuese ligjore është e tillë që nuk lejon që ky ligj të zbatohet dhe të vihet në relacion me ligje të tjera, është i hershëm si projektligj sistemor. Mu për këtë shkak në shumë ligje të miratuara dhe sot në implementim ka devijime dhe është simptomatike situata në këto projektligje ,pra implementimi i tyre shkakton më tepër telashe sesa zgjidhje. Në rastin e këtij projektligji është një tentim që të kapërcehen disa prej problemeve kyçe në arsimin privat dhe aprovimi i këtij projektligji në këtë fazë,qoftë edhe me kusht e di çfarë pune fundamentale ka bërë komisioni,nuk do të na sjellë rezultate të pritura.

Grupi Parlamentar ORA nuk e përkrah këtë projektligj në parim. Propozojmë të kthehet, të ripunohet dhe në veçanti të merret parasysh iniciativa e Komisionit për Arsim gjatë përpunimit të projektligjit dhe të kornizës nacionale të kualifikimeve. Ne besojmë se kthimi i përkohshëm i këtij projektligji do të ishte shumë më i dobishëm me qëllim të përgatitjes së infrastrukturës ligjore ,sepse ky projektligj pasi të përpunohet më vonë do të jetë shumë më i efektshëm. dhe implementimi i tij do të japë rezultate të pritura. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit z. deputet. Në emër të Grupit Parlamentar 6+ fjalën e ka znj. Nuran Malta.

DEPUTETJA NURAN MALTA

Sayın başkan, sayın bakanlar, sayın milletvekilleri

Elimizde buluan bu Yasa Tasarısı'ndan, maddelerden çok beni aslında çalışma gruplarına birkaç sözüm var. Billhasa kültür ve eğitim bakanlığından çıkan Yasa tasarılarında azınlıklar temsilcilerin, ilk dönemde olmasına rağmen şu anda temsilcilerimiz yok, bunun dikkate alınmasını istiyoruz 6+ olarak. Yasa tasarısının başta kabul edilmesine ondan sonra komisyon çalışmalarında önergelerimizi sunacağız

Teşekkür ederim

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit, tani sipas radhës janë paraqitur disa deputetë për të diskutuar, në radhë është deputetja Naxhije Doçi, le të përgatitet Drita Statovci.

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI

Faleminderit z. kryesues, i nderuari z. kryeministër, të nderuar kolegë deputetë dhe të nderuar të gjithë ju që jeni në sallë.

Institucionet arsimore dhe aftësuese private në Kosovë janë formë e re e përfshirjes së qytetarëve tanë në edukimin, arsimimin dhe në aftësimin profesional . Kërkesat për hapjen e institucioneve të tilla edukative dhe arsimore te ne, në Kosovë, erdhën ndër të tjera edhe si rezultat i pamundësisë së përfshirjes së të gjithë qytetarëve të grup moshave të ndryshme në edukimin dhe arsimimin publik. Interesimi për funksionimin e institucioneve arsimore, aftësuese, private në Kosovë ishte edhe i mëhershëm, por realizimi dhe formalizmi i një interesimi të tillë u mundësua plotësisht pas luftës së fundit në Kosovë kur shoqëria kosovare po kalonte nëpër procese të rëndësishme të transicionit dhe kur krijoheshin rrethana krejtësisht të reja të edukimit dhe të arsimimit të qytetarëve. Konsiderojmë se edukimi, arsimimi dhe aftësimi privat në Kosovë janë një formë e rëndësishme dhe premtuese të realizohen synimet e qytetarëve të Kosovës ,ndër të tjera edhe për cilësinë e punës. Këtë konsideratë e mbështesim me moton se ku ka konkurrencë ka edhe cilësi të punës, si dhe suksese në rritje. Me ligjet e Unionit Evropian edukimi dhe arsimimi të administruar nga sektori privat përfshijnë forma dhe kategori të ndryshme ,ashtu si edhe sistemi i edukimit dhe i arsimimi në përgjithësi që secilin herë shkon në reformimin e sipër. Me qëllim të vetëdijesimit të spektrit të gjerë për arsimin dhe edukimin privat institucionet e Bashkimit Evropian bënë hulumtime në shtetet anëtare për këtë lloj të edukimit, për aspektet organizative të tij dhe për statusin në secilin shtet veç e veç. Më vonë u vërejt se këto hulumtime kanë treguar sukses se kanë ofruar të dhëna krahasuese për mënyrën e hapjes së shkollave private.

Arsimi privat dallohet nga arsimi publik. Këtë formë të arsimimit e organizojnë personat privatë ose shoqatat e përfshira me ligjin privat. Në këtë projektligj kjo formë është shumë e domosdoshme për organizimin e sistemit edukativo- arsimor. Që të jetë e suksesshme dhe kualitative, te ne në Kosovë, kërkon rregullsi dhe të drejta, se vetëm në këtë mënyrë ua mundësojnë kushtet cilësore personave të interesuar fizikë dhe juridikë t'u ofrojnë qytetarëve të Kosovës sistem të shëndoshë edukativo- arsimor dhe aftësues.

Projektligji në fjalë është shumë i nevojshëm dhe i një rëndësie të veçantë për shoqërinë kosovare. Me këtë edukimi dhe arsimi privat avancohen sipas standardeve ndërkombëtare dhe ofrohet përparim në konkurrim të gjithmbarshëm. Projektligji është hartuar në Ministrinë e Arsimit,nga një grup pune dhe është risi në legjislacionin e tanishëm që mund të themi se i plotëson mangësitë e rregullativës ligjore për arsimin dhe aftësimin privat te ne në Kosovë. Ky projektligj është bërë sipas modelit të legjislacionit të vendeve të Bashkimit Evropian në përshtatshmëri të kushteve dhe të rrethanave të zhvillimit të proceseve reformuese në Kosovë. Mund të themi se Projektligji për arsimin dhe i aftësimin privat është i kuptueshëm dhe praktik, se e parasheh përfshirjen e të gjitha niveleve të edukimit dhe të arsimit privat në Kosovë si dhe përfshin: edukimin parashkollor, edukimin e arsimimin parauniversitar dhe arsimin universitar, tek arsimimi parauniversitar përfshihen: shkollimi fillor, i mesëm, i ulët dhe i mesëm i lartë.

Ky projektligj i ka të parashtruara qëllimet për krijimin e kushteve të nevojshme të personave fizikë dhe juridikë, ndër të tjera edhe për përfshirjen e numrit sa më të madh të qytetarëve të interesuar për edukim, për arsimim dhe aftësim profesional ,si dhe për të siguruar konkurrencë cilësore. Projektligji në fjalë i ka 34 nene, me të cilët është përfshirë tërë fushë veprimtaria e funksionimit të kësaj forme të re të edukimit dhe të

arsimimit rregullativ të ne, duke përfshirë edhe veprimtarinë hulumtuese dhe botuese të nevojshme e të domosdoshme. Me këtë projektligj legjislativ për ushtrimin e të drejtave të personave privat dhe juridikë, për krijimin e institucioneve arsimore dhe aftësuese private të të gjitha niveleve të shkollimit në Kosovë, e bën Ministria e Arsimit, ashtu siç i bën mbikëqyrjen e kontrollin. Kërkesa për dokumente të kompletuara për licencën e dërguar në Ministrinë e Arsimit nga personat e interesuar për konkurrim, ashtu si dhe vlerësimi pozitiv ose negativ i kërkesave të tyre nga Ministria e Arsimit, kanë afat të caktuar dhe pa u respektuar këto afate, ende pa u kryer licencimi, institucioni në fjalë nuk mund ta fillojë aktivitetin. Kjo parashihet në nenin 11, pika 2. Licencimi i ka edhe kompetencat e veta. Licencimin e institucioneve të arsimit dhe të aftësimit të lartë privat e bën MASHT-i në bazë të propozimit të Agjencionit për Akreditim të Kosovës, ndërsa licencimin e edukimit dhe të arsimit të aftësimit privat, do të thotë fillor dhe të mesëm e bën MASHT-i. Kushtet dhe kriteret për institucionin e edukimit, të arsimit e të aftësimit privat rregullohen me ligje të veçanta për sistemin arsimor. Në projektligj MASHT-i ka të drejtë t'ia ndalojë të drejtën e veprimtarisë institucionit në fjalë, nëse konstaton se veprimtaria e tij paraqet rrezik për shëndetin dhe për jetën e nxënësve dhe të personelit si edhe nëse institucioni konstaton se personat fizikë dhe juridikë bëjnë mashtrime dhe parregullsi serioze. Në rastet të tilla institucioni në fjalë përgjigjet financiarisht për pasojat e shkaktuara, për të cilat mendoj se duhet të jenë të rrepta e jo me dallime. Në fund po theksoj se e përkrah këtë projektligj me shpresën se Komisioni funksional do të plotësohet dhe do të amendamentohet si duhet. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Faleminderit z. deputete, fjalën e ka deputetja Drita Statovci. Le të përgatitet Gjylshen Berisha

DEPUTETJA DRITA STATOVCI:

Z. kryesues, ministra, zonja dhe zotërinj të nderuar.

Rregullimi me ligj i veprimtarisë së arsimit dhe të aftësimit privat në Kosovë dëshmon për një filozofi të re të mënyrës së projektimit të arsimit në përgjithësi. Për një vend të zhvilluar dhe me një bazë ekonomike të fortë, si dhe me një superstrukturë të formuar shoqërore, kjo dukuri do të shfaqet fare e përballueshme dhe e arsyeshme. Nuk jam shumë e sigurt nëse diçka e këtillë qëndron tërësisht për vendin tonë. Sidoqoftë arsimit privat të ne, tanimë është bërë realitet, prandaj na mbetet të përpiqemi për normalizimin e rrjedhave në këtë segment shoqëror. Ndërtimi formal i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat reflekton një strukturë më të gjerë juridike që u referohet aspekteve të organizimit dhe të funksionimit të rregullt të arsimit dhe të aftësimit privat në Kosovë. Me kujdesin juridik projektligji pretendon edhe trajton çështjet të ndryshme të arsimit të niveleve parashkollore, shkollore dhe akademik universitar. Në këtë kontekst të themi se rregullativa tekniko-juridike duket sikur të jetë e pranueshme, me gjithë faktin se mund të bëhen vërejtje serioze.

Së pari lypset që projektligji t'i sanksionojë kriteret prerazi, të qëndrueshme, që do të nxisin dhe do t'i mbanin gjithnjë aktuale dhe me rezultate pozitive, cilësinë dhe nivelin e dëshiruar: parashkollor, para universitar ose atë universitar të arsimit privat. Ky realitet nuk fuqizohet sa duhet në këtë projektligj.

Së dyti me rastin e sanksionimit të komisioneve të veçanta, siç është Komisioni i Qeverisë, domosdo imponohet edhe sanksionimi i qartë i obligimeve dhe i detyrave të një komisioni të tillë, si dhe sanksionimi i instrumenteve vepruese në këtë drejtim, çfarë vërtetë mungon në këtë strukturë ligjore.

Së treti lidhja funksionale ndërmjet neneve të caktuara të strukturës së këtij projektligji duhet të korrespondojë në mënyrë të drejtë dhe me efekte pozitive dhe jo siç ndodh për shembull me nenin që rregullon çështjen e licencimit të institucioneve private të arsimit të lartë të mbështetet në nenin që rregullon diçka tjetër, përkatësisht çështjen e arsimit parashkollor ose parauniversitar. Marrë në përgjithësi Projektligji për arsimin dhe aftësimin privat kërkon ndërtim edhe më të mirë tekniko-juridik e veçmas substancial dhe në anën tjetër duke njohur gatishmërinë e kompetentëve të ndihmojnë në këtë drejtim, shpreh mendimin se duhet të jepet afati që ky ligj të ripunohet dhe të hartohet si duhet. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI

Faleminderit, fjalën e ka deputetja Gjylshen Berisha. Le të përgatitet Hajredin Hyseni.

DEPUTETJA GJYLSHEN BERISHA

Faleminderit për fjalën, i nderuari kryesues, të nderuar ministra, zonja dhe zotërinj deputetë.

Në zhvillimin e shoqërisë dhe me rritjen e ritmit të ndryshimeve shoqërore dhe tekniko-teknologjike edhe në Kosovë rëndësia e arsimit dhe roli i tij përcaktohen si një vlerë që nga shoqëria, në veçanti nga Qeveria, kërkon që arsimit në vazhdimësi të jetë prioritet. Në funksion të kësaj Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka proceduar disa projektligje me një ritëm të shpejtuar dhe ka bërë mirë që ka vepruar kështu

Ne jemi vonuar me ligje, por se asnjë ligj që procedohet në Kuvend nuk është i hershëm, por është i vonuar, andaj mendoj se edhe Projektligji për arsimin privat është projektligj që vërtet do ta plotësojë një vakum në legjislacionin tonë dhe se patjetër ky projektligj, edhe pse e kam lexuar dhe analizuar mirë në komisionin funksional, do të amendamentohet me disa vërejtje, por që janë ,fatmirësisht të pakta.

Vërejtjet e mia për këtë projektligj janë për nenin 2, sipas të cilit duhet të bëhet një riorganizim i financimit të institucioneve të edukimit dhe të trajnimit privat, pastaj për nenin 31, nuk pajtohem me gjobat në numrin 1, 2 e 3- gjoba minimale, kurse në nenin 31.4 mendoj që duhet të propozohet marrja e licencës, jo vetëm gjobë në mjete financiare. Gjithashtu në nenin 29 pika 3 fondi i propozuar në Projektligj për shkollat

private apo për arsimin privat është për t'u përkrahur që të përkrahen nxënësit në gjendje të rëndë sociale që të mund të arsimohen në shkollat konkurruese. Mendoj se komisionit i mbetet jo shumë punë që t'i plotësojë dhe t'i korrigjojë me amendamente mangësitë eventuale që mund t'i ketë ky projektligj. Nuk më duket e qëlluar që leximi në parim të shfrytëzohet për të nxitur akuzat joparimore kundër Ministrisë, Qeverisë etj., por të përqendrohemi në projektligje. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI

Faleminderit, fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni. Ie të përgatitet i fundit Agim Krasniqi.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë, ministra të pranishëm.

Duhet përshëndetur iniciativën për këtë projektligj për aftësimin dhe arsimimin privat, sepse një nga çështjet që duhet të rregullohen e të saktësohet me ligj. është edhe kjo fushë, sidomos kur dihet se në këtë aspekt ka mjaft kritika për punën e Ministrisë. që tani është kompetente për rregullimin e kësaj çështjeje. Dihet se konkurrenca është një formë e përparimit dhe e krijimit të vlerave të mirëfillta, andaj edhe konkurrenca në arsim duhet të shikohet në këtë prizëm dhe duhet të përshëndeten iniciativat e shumta që ekzistojnë për themelimin e institucioneve private në Kosovë. Por, fatkeqësisht, kjo konkurrencë nuk është lënë të ketë zhvillim normal, sepse për themelimin e këtyre institucioneve shpesh është vendosur jo sipas kriterëve të përcaktuara, ngase kam vërejtur kriterë të ndryshme dhe varësisht kush ka qenë themelues i atij institucioni dhe çfarë mendimi ka pasur Ministria, apo anëtarët qeveritarë si në ministrinë e mëparshme dhe në këtë të tashmë kanë marrë vendimin. Pra duke vazhduar politizimet dhe duke u sjellë në mënyrë të papërgjegjshme, në raport me këto institucione, saqë shpesh këto janë bërë biznes dhe formë e vetme e përfitimit, si për themeluesin ashtu edhe për qeveritarët, kurse themelimi i këtyre institucioneve nuk ka rëndësi vetëm të biznesit, por të nxjerrjes së dijës që do të duhej ta kishte preokupim Ministria e Arsimit. Se është i nevojshëm të ekzistojë një ligj i mirëfilltë që do t'i saktësonte kushtet dhe kriteret e themelimit të institucioneve private është parë edhe gjatë këtyre ditëve të licencimit të tyre. Në opinionin publik u krijuan shumë paqartësi, duke humbur besimin tërësisht në institucionin përgjegjës që është Ministria e Arsimit dhe e Teknologjisë e që do të duhej t'i rregullonte këto çështje. Ajo me veprimet e veta është e papërgjegjshme edhe ndaj institucioneve edhe ndaj atyre që regjistrohen në to. Ajo lejon që në këto institucione të regjistrohen studentë të paguajnë këtë regjistrim dhe pa u brengosur për humbjet që u shkaktohen këtyre studentëve me fajin e saj dhe në fund deklaron se ky institucion nuk i plotëson kushtet.

Zonja dhe zotërinj, një fakultet si p.sh. Fakulteti i Gazetarisë "Faik Konica", licencohet vetëm për dy vjet, për t'iu ndërprerë puna e mëtutjeshme edhe pse ky fakultet ka një traditë dhjetëvjeçare dhe i plotëson nevojat me kuadër për ekzistimin e tij, kurse Ministria e Arsimit nuk mendon kështu dhe për ironi në vend të këtij fakulteti në ndërtesën e tij ajo parasheh se duhet të vazhdojë Fakulteti Publik i Gazetarisë i themeluar

tani, me çka në rend të parë pamundësohet konkurrenca e lirë për krijimin e vlerave të qëndrueshme të nevojshme për këtë popull. Kriteri dhe kushtet zbatohen varësisht nga simpatitë e Ministrisë që ka për themeluesin. Në Kosovë, të nderuar deputetë, mund të licencohet Universiteti i Shkencave Mjekësore, Rezonanca, që nuk i plotëson as kushtet themelore, sepse unë nuk e di se ku do të bëjnë praktikë studentët dhe a mund të mendohet një mjek pa praktikë. Kjo ndodh vetëm në Kosovë, sepse fakultete të tilla private nuk ekzistojnë askund në Evropë, kurse Kosova bëhet vend eksperimental. Por kësaj radhe nga institucionet e papërgjegjshme të saj. Kjo ndodh sepse ende nuk ekziston ligj i domosdoshëm dhe licencimi i këtyre institucioneve ka qenë në mëshirën e Qeverisë dhe të simpativëve apo të interesave që kanë ata për këto institucione. Për të mos vazhduar kjo mendoj se ky projektligj duhet të jetë shumë i qartë dhe të mundësojë krijimin dhe funksionimin e pavarur të këtyre institucioneve.

Por në nenin 13 të këtij projektligji, të krijimi i komisioneve të licencimit, mbetet e paqartë dhe nuk saktësohet nga kush do të zgjidhet një e treta e komisionit që nuk do të jetë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, andaj mendoj se këto duhet të qartësohen mirë dhe të mos mbeten zbrazëti në ligj që të vazhdojë kjo agoni e sotme. Që të kemi arsim që krijon vlera shumë të domosdoshme për prosperitetin e shoqërisë arsimit duhet të depolitizohet tërësisht. Duhet të kuptojnë të gjithë ata që fatkeqësisht arsimin e kanë bërë arenë për beteja politike, se duhet të ndërpritet kjo praktikë dhe tërësisht duhet ta respektojnë ligjin dhe të mos veprohet si në kohën e komiteteve. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI

Faleminderit, fjalën e ka deputeti Agim Krasniqi dhe pas tij Remzije Nimani.

DETUTETI AGIM KRASNIQI

Faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë dhe ministra.

Shumëçka u tha lidhur me Projektligjin që është në procedurë e sipër, por unë mendoj që për këtë projektligj më tepër mund të flitet pozitivisht sesa negativisht, se vërtet është përpjekje e parë më të cilin sanksionohen të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me themelimin e institucioneve tona vendore për arsimimin dhe aftësimin privat, por me gjithë këtë desha të them disa fjalë që do të ndërlidheshin kryesisht me kapitullin e dytë, që ka të bëjë me procedurën e licencimit.

Karakteristikë e përgjithshme e këtij projektligji ose shumë çështje që mund të sanksionohen, thjeshtë të precizohen qartë me dispozitat e këtij projektligji e ligji i lidhen më vonë me akte të tjera nënligjore, por mendoj se nuk është aq lehtë, madje në këtë ligj mund të precizohen, në mënyrë që qysh tani të ketë edhe amendamente shtesë, do të thotë po të zëvendësoheshin aktet nënligjore me këtë ligj. Do të theksoj edhe një herë se vërejtjet e mia për kapitullin e dytë, rreth çështjeve të licencimit, në disa nene të këtij kapitulli përmenden komisionet, por komisionet si shkalla e parë e shqyrtimit të kërkesave për dhënie të licencës. Unë do të them se këtu përmendet si akt përfundimtar

administrativ, nëse shqyrtohet një ankesë dhe nëse ankesa i adresohet sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Arsimit. Mendoj se këtu duhej të precizohet qartë se duhet të ekzistojë një komision si shkallë e dytë e shqyrtimit, që do të kryhet brenda Ministrisë. Gjithashtu pajtohem me kolegët e mi që patën vërejtje rreth përbërjes (strukturës) së Komisionit 9 anëtarësh, që një e treta janë të Ministrisë së Arsimit, por mendoj se duhet të jetë, të paktën, e kundërta. Kjo ka të bëjë me nenet 12 e 13 .Një vërejtje tjetër e kam për nenin 19, që ka të bëjë me mosdhënien ose mos përsëritjen e licencës, mendoj se gjithashtu do të duhej të definohej qasja e paragrafit të nenit 19, që thotë se nëse brenda 3 vjetësh ka pasur licencë dhe ajo i është marrë ,d.m.th një sqarim shumë konfuz e i pakuptueshëm ,si mund të refuzohet dhe të mos jepet licenca, d.m.th duhet të definohet më qartë.

Neni 23 paragrafi 3 fjala është për ndryshimet e mëtutjeshme që janë dhënë rreth kriterëve dhe kushteve të licencimit dhe jepet afat tre muajsh, mendoj se ky afat është shumë i shkurtër, sepse nëse bëhen ndryshime të tilla esenciale etj. drejtuesit e institucioneve duhet të kenë më shumë kohë që të jenë të përgatitur. Ky afat duhet të zgjatet jo më së paku për tre muaj, por më së paku 6 muaj.

Në nenin 26 fjala është për ankesat eventuale të studentëve, të nxënësve, të prindërve ku thuhet se kanë të drejtë të bëjnë ankesë, nuk dihet se ku do të adresohet kjo ankesë. E ajo nuk shqyrtohet në kuadër të Ministrisë së Arsimit, por do të duhej, si shkallë e parë, të bëhet një ankesë e lëshuar me shkrim, pra do të duhej nenin 26,paragrafit 1, t'i shtohet se vendimi jepet me shkrim për të pasur mundësi të ushtrohet ankesë.

Neni 27 që ka të bëjë me mbikëqyrjen ,me kontrollin dhe me sqarimet e duhura, që kontrolli do t'i jepte dhe që do të ishin në disfavor të institucioni,. mendoj se do të ishte dashur të precizohet afati i ndërprerjes së përkohshme të punës, sepse ndërprerja do të duhej të ketë kohë që të mund të merren masa për të vazhduar pastaj udhëheqësit e atij institucioni në procesin e edukimit dhe të arsimimit, sepse kjo nuk precizohet dhe nuk dihet si të veprohet më tutje.

Përpjekja e Ministrisë së Arsimit në këtë projektligj ka qenë një përpjekje e vërtetë, mirë e orientuar që ia vlen ta përkrahim në parim që me procedim të mëtutjeshëm do ta kemi një ligj të mirë që institucionet tona,duke filluar nga viti i ardhshme, të kenë sukses. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI

Fjalën e ka deputetja Remzije Nimani. Më falni se do ta lus Sekretarinë që deputetët pas diskutimit të fundit, do të votojnë.

DEPUTETJA REMZIJE NIMANI

Faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra, zonja e zotërinj deputetë.

Duke shqyrtuar Projektligjin për arsimin dhe aftësimin privat vlerësoj se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka bërë punë shumë të mirë dhe të qëlluar me rastin e propozimit të këtij ligji. Me këtë projektligj plotësohet një zbraçeti juridike e rregullimit të çështjes së arsimit dhe të aftësimin privat në veçanti në kohën e ekonomisë së tregut të lirë dhe të nevojës së konkurrencës së arsimit privat dhe të atij shoqëror apo publik. Andaj me këtë projektligj krijohen edhe kushtet për funksionimin dhe rregullimin ligjor të arsimit privat në të gjitha nivelet. Projektligji ka një përmbajtje të mirë juridike që nga fillimi, nevoja dhe rëndësia e tij, deri te forma e licencimit në punë private në arsim. Atë që unë e vlerësoj të dobishme është fakti se projektligji mjaft mirë i përcakton edhe përgjegjësinë, përkatësisht mbikëqyrjen dhe kontrollimin e procesit mësimor në arsimin dhe aftësimin privat, duke përcaktuar edhe masa ndëshkuese për shkelësit ose mospërfillësit e ligjit. Me këtë projektligj avancohen arsimi dhe edukimi në Kosovë, duke krijuar mundësi për arsimin privat në pajtim me të arriturat arsimore më të reja ose me reformat dhe me harmonizimin me standardet ndërkombëtare. Ky projektligj është risi në legjisllacionin tonë, sepse hap me të drejtë konkurrencën në punë në edukimin dhe arsimimin e të rinjve, duke shtuar si domosdoshmëri edhe përgatitjen permanente të edukatorit dhe të arsimuesit. Vlerësoj se preambula e këtij projektligji duhet të fillojë me Kornizën Kushtetuese, përveç qeverisjes së përkohshme në Kosovë e pastaj me Rregulloren e UNMIK-ut, duke u mbështetur në Ligjin për arsimin fillor të mesëm dhe atë të lartë.

Në veçanti mendoj se duhet të jemi korrektë, të saktë dhe rigorozë me rastin e dhënies së lejeve për punë të arsimit dhe të aftësimin privat duke kërkuar garanci të plotë jo vetëm financiare e infrastrukturë, por edhe kuadër profesional, sepse secilit nuk duhet t'i mundësohet të punojë në institucionet private dhe në ato publike ose shoqërore. Liria e arsimit dhe e aftësimin privat nuk duhet keqkuptuar dhe interpretuar në mënyrë subjektive.

Institucionet private patjetër duhet t'u përmbahen plan programeve të institucioneve gjegjëse dhe të gjitha rregullave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë. Mendoj se është shumë e arsyeshme që pranë Qeverisë u formua komisioni që do ta kontrollojë punën e institucioneve private. Në veçanti duhet menduar vlefshmërinë e barabartë të dëshmimeve për edukimin dhe arsimimin privat me atë shoqëror ose publik. Mendoj se procedura për dhënien apo mosdhënien e lejes për punë të arsimit privat, duhet të jetë me afat të shkurtër dhe efektiv. Për të dhënat financiare të institucioneve private duhet të informohet Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë me një raport vjetor.

Po ashtu dokumentacioni i nevojshëm duhet të ruhet në institucionin privat. Edhe dënimet apo dështimet administrative për shkelësit e këtij ligji, mendoj se janë të vogla apo të ulëta. Shikuar në tërësi unë përkrah Projektligjin në parim duke lënë mundësinë që të plotësohet me amendamente nga Komisioni për Arsim, Shkencë e Teknologji dhe nga komisionet përkatëse. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI

Faleminderit z. deputete. Për fjalë është paraqitur kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Faleminderit z. kryesues.

Unë nuk do ta zgjas, por e mbështes atë që e kanë thënë Grupi Parlamentar dhe kryetari i Komisionit për Arsim i Partisë Demokratike, dua të them një gjë që ky projektligj duhet të kthehet në rishikim, sepse duhet të nxirret një ligj që e avancojnë procesin e arsimit, pra edhe arsimin privat në Kosovë, por kur kemi parasysh se gjatë këtyre viteve në Kosovë kemi pasur lulëzim të arsimit privat të pakontrolluar, që më tepër ka qenë biznes privat me arsimin dhe me procesin e edukimit të arsimit, se sa një proces i mirëfilltë arsimor, kërkojmë, në emër të grupit, që ky projektligj të mos votohet, të rikthehet për përpunim dhe kështu duhet të bëhet ligj i standardeve të vendeve që kanë përvojë dhe traditë në procesin e arsimit privat. Kështu siç është, nuk i plotëson kriteret për ta votuar as në parim, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike kërkon që ky ligj të kthehet, se ne nuk do ta votojmë.

KRYESUESI XHAVIT HALITI

Faleminderit z. deputet dhe kryetari i Grupit Parlamentar, ne kemi hyrë në proces të votimit, është diskutuar ligji dhe sipas Rregullores nuk mund ta ndërpres procedurën e së drejtës së deputetëve për ta votuar pro dhe kundër. Para se ta hedhim në votim do t'i lutja ata që i lënë kartelat në mëngjes e dalin ose ua lënë kolegëve për t'i marrë me vete le t'i heqin se po kemi problem me numërimin e deputetëve. Sekretaria ia jep një numër tjetër, këtu është i regjistruar numër tjetër, megjithatë sipas numërimit të pranishëm janë 72 deputetë, që konstatoj se kuorumi mjafton vota dhe do të lusja që të bëheni gati për votim. Tash ju lus t'ia fillojmë votimit:

Sipas njoftimit nga Sekretaria prezent janë 72 deputetë në sallë. Kanë votuar:

për	41 deputetë
kundër.....	31 deputetë
kanë abstenuar	3 deputetë

Kjo do të thotë janë 75 e në letër kanë ardhur 72. Unë nuk e di që në Rregullore dikujt i jepet mundësia ta delegojë votën te kolegu, prandaj sipas kësaj jam i detyruar ta përsëris votimin, sepse votimi është në s'përputhje me prezencën e deputetëve në sallë.

Prandaj Sekretaria ngarkohet që edhe një herë t'i numërojë saktësisht deputetët pastaj të shohim se si po votohet.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Fatmir Urdhëro.

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

Z. kryetar ju përshëndes.

Pak para se të hynit në sallë, votuam, ishin prezentë 72 deputetë, tre që kanë abstenuar, nuk e di a i ka shtypur dikush sustat apo jo, ky është muhabet tjetër, sepse 72 janë, që dulën 41 **pro** dhe 31 kundër. Në bazë të këtij rezultati projektligji në lexim të parë ka kaluar. Prandaj kjo pjesa tjetër që ndodhi mendoj që është çështje e Grupit Parlamentar, pas këtij votimi, nuk e zhvlerëson votimin e mëparshëm. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Faleminderit. A do të prononcohet shefi apo prononcimi i Fatmirit është përfundimtar. Jo unë nuk po ju ftoj, veç thashë a është përfundimtar ta di. Jo, jo unë s'kam nevojë ta ftojë askënd.

DEPUTETI ALUSH GASHI

Ju faleminderit z. kryetar.

Ne edhe në disa seanca të mëparshme, si Grup Parlamentar, e kemi ngritur çështjen e udhëheqjes së seancës plenare nga kryetari dhe kemi kërkuar të respektohet Rregullorja që në mungesë të kryetarit Daci ,që është nga radhët e LDK-së, zëvendësimi të bëhet nga anëtari i radhës i LDK-së,sikur të ishte ajo sot ne nuk kishim pasur nevojë të provojmë ta përsërisim dhe ta shkelim Rregulloren pas votimit të rregullt. Në këtë seancë sot z. kryetar kanë votuar 41 deputetë,që në çdo formë shumica është e pranishme dhe këtë çështje e konsiderojmë të mbyllur. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

z. Xhavit Haliti, urdhëro

DEPUTETI XHAVIT HALITI

Çështja e udhëheqjes së seancave mendoj se nuk është çështje e dëshirës së njërit ose grupit parlamentar por është problem i zgjidhur me Kornizën Kushtetuese të Kosovës.

Së dyti, nuk mund ta mashtroj këtë Kuvend duke qenë në drejtim të seancës dhe të them së votimi është i rregullt, përderisa janë 4 veta që kanë votuar dhe nuk janë në sallë. Me Rregullore ,po e përsëris nuk kemi të caktuar ose të saktësuar që një deputet të

mund t'ia delegojë të drejtën e votës deputetit tjetër, nuk po e kontestoj numrin e votave **pro** prezent,,por konstatoj që duke qenë në udhëheqje të seancës vendimi nuk është marrë me qenë se është bërë falsifikim në votim dhe u mor vendim këtu që të përsëritet votimi. Prandaj, mendoj që në qoftë se interpretimin e Rregullores e bëj unë z. kryetar i Grupit Parlamentar, sepse unë kam qenë në udhëheqje të seancës. Në qoftë se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe i ORËS kanë dalë jashtë, konstatoj se në sallë nuk ka kuorum. Unë nuk dola edhe pse mund të dilja me ta, por për t'iu respektuar edhe me qenë se isha në drejtim të seancës, desha ta jepja sqarimin tim personalisht. Në qoftë se dikush mund ta interpretojë ndryshe, jam i gatshëm ta pranoj dhe s'kam problem si u votua **pro** ose **kundër**, është një kërkesë e grupit dhe është e drejtë e tyre të veprojnë sipas mendimit të tyre.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Faleminderit.

Një informatë bazë. Mendoj se një herë duhet ta falënderoj z. Xhavit Haliti, që pranon të jetë ndihmesë e kryetarit, sepse pjesa tjetër për informatën tuaj të saktë e Partisë Demokratike, për anëtarin e Kryesisë ,për arsye të veta, nuk do të participonte në ndihmesë të udhëheqjes së seancës. Le të jetë kjo e para. E dyta, krejtësisht është e saktë ajo që shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së ka kërkuar zyrtarisht dhe me të drejtë, kurse unë kërkoj mirëkuptim në këtë. Z. Fatmir Sejdiu mungon. Unë kam pasur takim me zëvendës administratorin në orën 10 për çështje të buxhetit. Shpeshherë me të vërtetë ka nevojë të ngutshme , po e kemi pasur edhe Naimin në dispozicion që e kemi lutur, sepse edhe Xhaviti e ka lënë punë të rëndësishme për të ndihmuar sot. Sa i përket procedurës, me Kornizë Kushtetuese kam vështirësi, sepse anëtarët e Kryesisë me rregull një rotacion e ndihmojnë kryetarin, por unë e akceptoj kërkesën e LDK-së ,sepse numri i caktuar i ministrive e ka shpjeguar në fillim, prandaj duhet të kemi mirëkuptim.

Një çështje tjetër e Rregullores thotë interpretimi final gjatë seancës është i kryesuesit ose i kryetarit . Gjithmonë e mbaj argumentimin dhe atë që e kam obligim ta them,mirëpo atë që e tha Fatmir Rexhepi është plotësisht koincidence me letrën që e kam unë këtu. Për këtë arsye,që të mos ngritët tensioni në qoftë se po e them juridikisht Xhavitit po i falënderohem,. E pamë puna plotësisht është një mbështetje siç thashë dhe përputhet me letrën që e kam .Ligji ka kaluar në qoftë se kontestohet ligjshmëri nga dikush, që unë nuk e shoh që ka arsye, sepse në të gjitha rregullat e vendimmarrjes .41 deputetë janë të plotfuqishëm për vendim, por atë që ka bërë Xhaviti derisa ishte në udhëheqje ai e ka dhënë mendimin e vet ,kurse unë nuk e kam asnjë të drejtë rregullative ose kushtetuese ta kontestojë, por personalisht unë e falënderoj gjithmonë kur tregon gatishmëri të ndihmojë, sepse disa të tjerë nuk gjejnë as kohë as mundësi. Mund ta lutja Naimin, kur ishte në seancën e mëparshme,sepse nuk mund ta bija njeriun e sëmurë të zëvendësonte dhe në parim kudo që do të shkoja unë ose kudo të jem, ju e se Fatmiri e merr udhëheqjen në mungesën time, gjithmonë e merr dhe s'kemi mospajtime, prandaj kur kam qellim të bëjmë pauzë ose ta ndërpresim ose ta vazhdojmë. Të hënën do të vazhdojmë me pikën e buxhetit, prandaj nuk kemi nevojë, ju lutem as LDK-ja e as PDK-së t'i tensionojnë deputetët që në sallë e kanë kryer me përgjegjësi punën e vet,por jo të

akuzohet Xhaviti ose Daci ose dikush tjetër. Kjo i dedikohet gjithë seancës plenare. Këtë që po e them, urdhëro të lutem.

DEPUTETI FETAH BERISHA:

Z. kryetar, z. Xhaviti e ka pasur përpara numrin sa kanë qenë prezentë në Parlament, të cilën e kanë sjellë të tjerët, ndërsa këtu në aparat para së cilit deputet ka dalë numri i të pranishmëve 75, por 31 kanë qenë **kundër**, 3 kanë **abstenuar** dhe 41 kanë qenë **pro**. Do me thanë kjo është e vërteta. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Fetah, thashë e pranova, sepse gjeta faktografi dhe juridikisht dhe proceduralisht është shumë në rregull ajo që thotë: 41 deputetë kanë votuar **pro**, 72 kanë qenë, është vendimi që ne nuk kemi arsye ta kontestojmë në qoftë se konteston procedura dhe ligjet ose drejtësia, ne duhet t'i nënshtrohemi asaj. Prandaj në qoftë se nuk kemi kuorum ta vazhdojmë. Propozoj dy alternativa ose pauzë ose ta lemë pas buxhetit e vazhdojmë ligjin, se s'na prish punë. A pajtohemi për të hënë?

Të hënë në orë 10,00 ju lutem do të vazhdojmë me buxhetin dhe e përfundojmë. Ju faleminderit.

PJESA E PARË E Mbledhjes Parlamentare, Më 19.12.2005

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Mirëmëngjesi, mirëseardhje në vazhdimin e punës së Seancës plenare. Të pranishëm në sallë janë 81 deputetë.

Ne u informuam të premtën që pika e parë në vazhdim të seancës së punës së sotme është vazhdimi me punën për aprovimin e buxhetit në shqyrtimin e dytë të Projektligjit. Unë të premtën i kam pasur në dorë të gjitha amendamentet e komisionit funksional. Shpresoj që edhe deputetët kanë arritur që ta kenë këtë informatë, dhe do të doja ta ftoja kryetarin e Komisionit për Buxhet që nëse e sheh të arsyeshme të thotë ndonjë fjalë rasti, urdhëroni z. Naser!

DEPUTETI NASER OSMANI:

I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra dhe kolegë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka proceduar në tërësi Ligjin për Buxhet. Vetëm më mbetet që ta falënderoj Komisionin për punë intensive që ka bërë, në kohën tejet të shkurtër, për ta shqyrtuar ligjin në fjalë. Pas 14 mbledhjeve të mbajtura intensive e ka përfunduar punën dhe para jush e ka sjellë Ligjin e buxhetit në fjalë edhe ju kisha lutur z. kryetar të insistoni që ky ligj të miratohet kështu si e ka aprovuar Komisioni për Buxhet

dhe Financa dhe mund të them që Ligji është aprovuar me konsensus në komisionin përkatës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit! A jeni anëtar i Komisionit, urdhëroni!

DEPUTETI NAZIM JASHARI:

Këtu më duhet ta përgënjeshtroj kryetarin e komisionit. Ligji nuk është miratuar me konsensus, është miratuar me shumicë votash. Ka pasur kundërshti, ka pasur debate në komision, prandaj mos e gënjej këtu seancën se nuk është në rregull të gënjehet seanca, pra është miratuar me shumicë votash.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit! Replikë, Naser Osmani, urdhëroni!

DEPUTETI NASER OSMANI:

Nuk është e mirë prej kolegut që shprehet në këtë mënyrë para opinionit për arsye se megjithatë unë jam edhe kryetari i tij në komision. Kur është aprovuar ligji në fjalë, është aprovuar me konsensus. Personi në fjalë, kolegu në fjalë nuk ka qenë prezent kur është aprovuar Ligji me konsensus. Një kundërshtim i vogël që është bërë, është bërë lidhur me amendamentin që e ka parashtruar grupi parlamentar i PDK-së, por edhe ajo është vendosur me shumicë votash, kështu që po them e gjithë puna tjetër është kryer me konsensus të plotë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Gani Koci, a jeni anëtar i Komisionit?

DEPUTETI GANI KOCI:

Për hir të korrektësisë duhet thënë që komisioni vërtet ka punuar me një përkushtim shumë të madh dhe për pjesën më të madhe të çështjeve ka pasur konsensus të plotë, me përjashtim të disa çështjeve për cilat nuk është arritur një pajtueshmëri, për të cilat ndoshta do të kemi rastin edhe tash të diskutojmë. Por, si tërësi, megjithatë Komisioni e ka pranuar si të tillë pa pasur mundësi të ndryshimeve të tilla, edhe pse si anëtarë të komisionit kanë shprehur gatishmërinë e tyre që të kontribuojnë në ndryshimin e disa çështjeve, por nuk ka pasur mundësi. Prandaj, nuk mund të themi në mënyrë absolute se ka pasur një konsensus të plotë. Ka pasur një konsensus në çështjet më të mëdha dhe ka pasur kundërshti lidhur me çështje tjera të vogla, për të cilat do të njoftohemi gjatë këtij debati, nëse shtrohet çështja. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit! Falënderoj Komisionin për punën e bërë. Kryeministri i Kosovës është i fundit për diskutim dhe pastaj të kalojmë në procedurë.

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, BAJRAM KOSUMI:

I nderuari Kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë,

Falënderoj Komisionin për Buxhet të Kuvendit, që ka punuar me përkushtim në shqyrtimin e Projektligjit për buxhet 2006, dhe menjëherë mund të them qëndrimin e Qeverisë lidhur me amendamentet.

Qeveria pajtohet me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet, që janë të përfshira në listën e amendamenteve. Mund të jetë që një ose dy amendamente do të na paraqesin vështirësi të vogla, por do të insistojmë që të jenë në përputhje me këto siç janë propozuar nga Komisioni. Ne do t'i përkrahim këto amendamente. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Kryeministër; ju faleminderit!

Regjia le të bëhet gati për punë. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional-Komisioni për Buxhet dhe Financa:

Amendamenti 1. Bëhemi gati për vendimmarrje, regjia le të përgatitet për votim!
Amendamenti i parë, komisioni funksional, kush është për:

Votojmë tani:

Të pranishëm në sallë janë 90 deputetë.

-23 vota janë kundër, kurse

-4 vota abstenime.

Prandaj, konsideroj se ka kaluar amendamenti 1.

Amendamenti 2

Kush është për:

A ka votë kundër?

-22 vota janë kundër,

-5 abstenime.

Ka kaluar edhe amendamenti 2.

Amendamenti 3

Kush është për:

-16 vota kundër,

-1 abstenim.
Ka kaluar amendamenti 3.

Amendamenti 4

Kush është për:
-19 vota janë kundër,
-Nuk ka abstenime.
Kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5

Kush është për:
-22 vota janë kundër.
Ka kaluar amendamenti 5.

Amendamenti 6

Kush është për:
-20 vota janë kundër,
-1 abstenim.
Ka kaluar amendamenti 6.

Amendamenti 7

Kush është për:
-19 vota janë kundër,
-Nuk ka abstenime.
Ka kaluar amendamenti 7.

Amendamenti 8

Kush është për:
A ka votë kundër?
-19 vota janë kundër.
Ka kaluar amendamenti 8.

Amendamenti 9

Kush është për:
-21 vota janë kundër,
-Nuk ka abstenime.
Ka kaluar amendamenti 9.

Amendamenti 10

Kush është për:
-20 vota janë kundër,
-1 abstenim.
Ka kaluar amendamenti 10.

Amendamenti 11

Kush është për:

-21 vota janë kundër,

-Nuk ka abstenime.

Ka kaluar amendamenti 11.

Amendamenti 12

Kush është për:

-20 vota janë kundër,

-1 abstenim

Ka kaluar amendamenti 12.

Amendamenti 13

Kush është për:

-21 vota janë kundër,

-1 abstenim.

Ka kaluar amendamenti 13.

Amendamenti 14

Kush është për:

-19 vota janë kundër,

-Nuk ka abstenime.

Ka kaluar amendamenti 14.

Amendamenti 15

Kush është për:

-19 vota janë kundër,

-Nuk ka abstenime.

Amendamenti 16

Kush është për:

Faleminderit, a ka votë kundër?

-20 vota janë kundër.

-Nuk ka abstenime

Ka kaluar amendamenti 16.

Amendamenti 17

Kush është për:

A ka vota kundër?

-20 vota janë kundër,

-1 abstenim.

Ka kaluar amendamenti 17.

Amendamenti 18

Kush është për:
A ka vota kundër?
-20 vota janë kundër,
1 abstenim.
Ka kaluar amendamenti 18.

Amendamenti 19
Kush është për:
A ka vota kundër?
-20 vota janë kundër,
-Nuk ka abstenime.
Ka kaluar amendamenti 19.

Amendamenti 20
Kush është për:
-20 vota janë kundër,
-1 abstenim.
Ka kaluar amendamenti 20.

Amendamenti 21
Kush është për:
A ka abstenime?
-19 vota janë kundër,
-Nuk ka abstenime.
Ka kaluar amendamenti 21.

Amendamenti 22
Kush është për:
A ka abstenime?
-13 vota janë për,
Nuk kalon amendamenti 22

Unë e kam pasur kopjen time, të premtën, propozimin e drejtpërdrejtë nga Komisioni. Ju lutem për korrektësi, amendamentet në vijim janë pa përkrahje nga komisioni funksional.

Amendamenti 23
Kush është për:

DEPUTETI GANI KOCI:

Amendamentin 23 e ka propozuar Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe ka të bëjë me ndryshimin e emërimit të linjës buxhetore në tabelën 2. Rreth linjës buxhetore të Kryetarit të Kuvendit Grupi parlamentar i PDK-së të Kosovës duke u bazuar në Kornizën Kushtetuese, në nenin 9.7 dhe 9.1.7, 9.1.28 ka konsideruar se kjo linjë buxhetore nga Kryetari i Kuvendit duhet të ndryshohet në Kryesia e Kuvendit, duke pasur parasysh se Kryesia e Kuvendit është organi më i lartë i Kuvendit dhe propozimi i PDK-

së ka qenë nëse duhet të mbetet si linjë buxhetore linja për Kryetarin e Kuvendit, duke pasur parasysh funksionin e Kryesisë së Kuvendit të krijohet linja e re për Kryesinë e Kuvendit, sepse nuk mundet që Kryesia e Kuvendit të mbetet nën linjën për anëtarë të Kuvendit. Ky ka qenë propozimi pa ndryshuar asgjë në vlerat që janë propozuar, por që do të definohet qartë edhe linja buxhetore për Kryesinë e Kuvendit duke pasur parasysh autorizimin dhe përgjegjësitë që ka Kryesia e Kuvendit në bazë të Rregullores së punës po edhe të Kornizës Kushtetuese të Kosovës. Prandaj, konsiderojmë se kjo duhet të miratohet dhe ky propozim nuk është i ri, ka qenë edhe në buxhetin për vitin e kaluar, nuk kemi marrë arsytetime nga propozuesit për këtë linjë buxhetore absolutisht, as vitin e kaluar, dhe as këtë vit, prandaj konsiderojmë se duhet të bëhet ky ndryshim i tillë.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Sa për informim, disa herë edhe në mandatin e kaluar është shqyrtuar kjo çështje, dhe asnjë herë nuk ka gjetur përkrahje. Unë po e procedoj edhe atë arsyetim në mënyrë të zakonshme, ju lutem!

Amendamenti 23 pa përkrahje nga komisioni funksional,

Kush është për:

Numëroni votat, ju lutem!

-30 vota janë për,

Nuk kalon amendamenti 23.

90 deputetë janë të pranishëm, pranohet vërejtja. Kush është kundër, ju lutem?

-57 vota janë pro,

a ka kush që abstenon?

Një sqarim ju lutem, 30 deputetë ishin pro amendamentit 23. 57 janë kundër, prandaj nuk kalon amendamenti.

DEPUTETI NASER OSMANI:

Z. Kryetar, këtu nuk qenka e përshkruar aq qartë, amendamenti 24 dhe amendamenti 25, janë dy amendamente që kanë kaluar me konsensus në komisionin dhe ju kisha lutur që të përkrahen.

KRYETARI I KUVNEDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, ju e dëgjuat, ne do të shkojmë në procedurë, do të thotë Kryetari i Komisionit propozon, edhe pse këtu thotë: Grupi parlamentar me konsensus janë aprovuar, prandaj le të kemi mirëkuptim. Ne do të shkojmë me procedurë, do të thotë kryetari i Komisionit propozon edhe pse këtu thotë Grupi parlamentar, me konsensus janë aprovuar, prandaj le të kemi mirëkuptim dhe të votojmë.

Kush është për?
A ka votë kundër?
-6 vota janë kundër,
-Nuk ka abstenime.
Kalon amendamenti 24.

DEPUTETI, GANI KOCI

Zoti Kryetar, unë vetëm desha një sqarim edhe për Grupin parlamentar të Partisë Demokratike se vërtet amendamenti 25 ka pasur konsensus të plotë dhe unë Grupin parlamentar të PDK-së e ftoj që të votojë pro këtij amendamenti.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, shumë!

Amendamenti 25, i dëgjuam sqarimet.
Kush është për?
A ka votë kundër, numëroni, ju lutem!
-1 votë kundër
-1 abstenim
Ka kaluar amendamenti.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Urdhëro z. Naser, kryetar i Komisionit.

DEPUTETI NASER OSMANI:

Z. Kryetar, ju kisha lutur që për pjesën shtojcë të këtij projektbuxhetit në mënyrë të veçantë të votohet buxheti për ART-në që e kemi votuar në bazë të ligjit edhe kjo duhet të kalojë edhe në Kuvend.

DEPUTETI, NAZIM JASHARI:

Para se të kalojmë në votim, ju kisha lutur për pak sqarime se Kuvendi ka nevojë për sqarime, pasi që e kemi këtu Ministrin e Ekonomisë dhe të Financave. Shpresoj që z. ministër të na sqarojë paksa lidhur me buxhetin e ART-së. Ne në komision kemi pasur bukur shumë konfuzion lidhur me këtë detyrë që na është dhënë. Në ligjin për telekomunikacion thuhet qartë që autoriteti rregullativë i telekomunikacionit është agjenci e pavarur në kuadër të Ministrisë së Komunikacionit. Neve na është dhënë detyra për ta përcaktuar buxhetin, do të kisha dashur shumë z. Haki Shatri të na sqarojë. Këta 14 milionë euro që janë këtu si të hyra nga tarifat dhe licencat e autorizimet, a janë përfshirë në shumën e përgjithshme të buxhetit? Dhe në rast se po, atëherë pse nuk janë përfshirë

në atë dokument që e kemi parë paraprakisht në Projektligjin për buxhetin edhe shpenzimet e nevojat e këtij e Agjensioni e këtij autoriteti? Pra, kemi qenë në konfuzion, në komision. Unë konfuzionin e kam akoma në kokë, kështu që kisha pasur dëshirë shumë që të na sqarohet lidhur me këtë punë çka kemi bërë. Këtë nuk e kemi bërë me konsensus, por edhe disa punë nuk i kemi bërë me konsensus, prandaj edhe reagova pak më parë.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ministri i Financave, a ka sqarim, urdhëroni z. Shatri!

MINISTRI HAKI SHATRI:

Ju faleminderit z. Kryetar,

Është e vërtetë që Agjencia Rregullativë i Telekomunikacionit në bazë të Ligjit për telekomunikacionin është agjenci e pavarur. Buxhetin e Agjencisë të ART-së e shqyrton dhe miraton në mënyrë të veçantë Kuvendi Kosovës, ndaras nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës. Agjensioni po ashtu sipas ligjit është i obliguar që t'i paraqesë raport për shpenzimet dhe të hyrat e veta Kuvendit të Kosovës, në mënyrë të veçantë, pra ndaras nga raportimi që bëhet për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Sa për informim, ju them se të hyrat që do të realizohen nga licenca për Operatorin e dytë të telefonisë mobile që pritet të aprovohet në vitin 2006, janë përfshirë si të hyra në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Po ashtu edhe të hyrat nga taksa në ekstra profit të PTK-s- janë përfshirë në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Unë nuk e kam parë buxhetin e ART-së çfarë është i propozuar për Kuvend, dhe nuk kam për obligim që të merrem me atë, sepse është pjesë krejt e ndarë dhe unë nuk prezantoj para Kuvendit për atë çështje dhe nuk kam as autorizim që të arsyetoj ose ta mbuloj ose ta qortoq atë buxhet, por them që ART-ja i paraqet të hyrat nga shërbimet që të bëjë që të hyra vetanake dhe shpenzimet që do t'i bëjë me veprime dhe programe konkrete, prandaj edhe kërkohet që ai buxhet të shqyrtohet dhe miratohet ndaras nga Buxheti konsoliduar i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Z. Ministër ju faleminderit, urdhëro replikë, deputeti Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI:

Ma pak replikë, ndoshta më shumë nevojë për sqarime, sepse megjithatë mbetet akoma e paqartë, sepse ndryshon balanca në buxhet. Pra nga 700 mijë euro, që janë propozuar dhe miratuar në komision për buxhetin e ART-së, 300. 000 kanë qenë në vitin e kaluar. Kështu që ndryshon bilancin e buxhetit të përgjithshëm. Ky autoritet realisht të hyrat i krijon nga paraja publike, udhëheq me paranë publike edhe autoritetin e merr po ashtu

nga autoriteti publik, nga ai autoritet që ne ia japim, por është e pakuptimtë për mua se si mund të ndodhë që 700 mijë euro tashti në shpenzimet të mos përfshihen fare në pjesën numerike të buxhetit. Ndërsa ju thoni se të hyrat janë paraparë, mua megjithatë më mbetet e paqartë, sepse do ta kemi një dis-balans mes asaj që po e miratojmë në tërësi.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit! Fjalën e ka z. Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI:

Z. kryetar, shqyrtimi i dytë i Projektbuxhetit nuk ka qenë në rend dite për sot, absolutisht është vazhdimi i seancës së kaluar dhe ne e dimë si bëhet. Në fillim është dashur që të shtrohet kërkesa që ata fusim si shqyrtim të dytë dhe jo të vazhdojmë menjëherë me shqyrtimin e dytë të Projektbuxhetit dhe çështja e dytë që dua të them është se me Ligjin për telekomunikacionin qartë thuhet se ART-ja paraqet buxhetin e vetë ndaras nga Projektbuxheti për vitin fiskal i cili hyn dhe shumë mirë e thotë se ai projektbuxhet duhet t'i dorëzohet Kuvendit 2 muaj para shqyrtimit të parë. Këtë gjë ART-ja nuk e ka bërë dhe nuk konsideroj se buxheti i ART-së është sot pikë shqyrtimi këtu në këtë seancë, sepse ne po miratojmë Projektbuxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin fiskal 2006. Prandaj, unë konsideroj se ka zbrazëtira të mëdha juridike sa i përket funksionimit të ART-së, por me këtë çështje duhet të merren ata të cilët kanë përsipër funksionimin e ART-së, sepse nuk e thotë prej nga e merr atë buxhet dhe nga e krijon atë buxhet ART-ja, kujt i jep llogari. Ata thonë se i japin Kuvendit, dhe kush e nënshkruan këtë, kush është autoriteti i fundit që e nënshkruan buxhetin për ART-në. Prandaj, rreth sqarimit të këtyre çështjeve juridike propozoj që të mos jetë temë shqyrtimi sot buxheti i ART-së meqë ligji nuk e thotë se atë duhet ta nënshkruaj Peterseni më 20 ose 25, siç keni paralajmëruar ju buxhetin 2006. Pra, le të hiqet nga rendi i ditës Projektbuxheti i ART-së.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Kryetari i Komisionit për Buxhet, Naser Osmani.

DEPUTETI NASER OSMANI:

Ligji për telekomunikacion, kapitulli 1, neni 5 dhe neni 6 në mënyrë decisive tregojnë se si formohet buxheti për ART-në. Meqenëse ne jemi vonuar me këto kërkesa që kërkohen tash 2 muaj ditë që të parashtrahet buxheti para Kuvendit, ne jemi të obliguar kështu si po e procedojmë edhe buxhetin në tërësi që ndaras ta aprovojmë edhe buxhetin për ART-në për arsye se në vitin e ardhshëm fiskal kjo organizatë buxhetore do të hyjë pa buxhet. Prandaj, ju lutem që pasi ta aprovojmë në tërësi buxhetin e konsoliduar të Kosovës, menjëherë të hedhim në votim aprovimin e buxhetit për ART-në. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Kryetari i Komisionit për Legjislacion, urdhëroni!

DEPUTETI HYDAJT HYSENI:

Mua më vjen keq se kjo çështje nuk u shtrua që në fillim të mbledhjes, por disi po na shkojnë si me nxitim pa rregull dhe vërtetë pastaj po vemi në situata të pamundshme. E tërë çështja sot sipas gjitha parametrave është shkelje procedurave. Unë po ju tërheqë vëmendjen tuaj vetëm në rregullën 32 e cila tekstualisht thotë: “Nocioni përmbajtjesor që është amendament duhet t’i dërgohet me shkrim mundësisht edhe në formë elektronike zyrës për propozime dhe parashtrës, jo më pak se tetë ditë pune para debatimit për rezolutën ose për Projektligjin të cilat i përkasin amendamentet” e të tjera.

Nuk është respektuar kjo rregull e domosdoshme, për më tepër ne sot e kemi marrë tekstin e amendamenteve të propozuara. Po të ishte një çështje e dytësore, tretësire, le të shkojë, por është çështja për buxhetin, çështja më e rëndësishme për këtë organ. Jo vetëm që janë shkelur procedurat, por jemi vënë në situatë të pamundshme për t’i shqyrtuar ato, për t’i analizuar dhe për të dhënë mendimin profesional. Kështu që detyrohemi ose të votojmë pa ditur për çka po votojmë, ose të votojmë kundër përsëri pa e ditur për çka po kundërshtojmë.

Unë, prandaj, do të kisha kërkuar dhe kisha lutur për mirëkuptim, me që meqë ka kohë, le të krijojmë një hapësirë të nevojshme dhe nëse jo brenda këtij viti, unë nuk shoh gjë të keqe që brenda këtij viti ta kem edhe një seancë të veçantë edhe t’i shqyrtojmë këto çështje siç duhet dhe në mënyrë meritore. Besoj se kjo do të na ndihmojë që t’i afrojmë qëndrimet dhe të ndërtojmë qëndrime konsensuale që do të duhej të ishin edhe interes i përbashkët. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Z. deputet, ju faleminderit, sepse përmbajtja nuk ishte detyrë e kryetarit të Komisionit. Alush Gashi, në emër të LDK-së, urdhëro!

DEPUTETI ALUSH GASHI:

Ju faleminderit z. Kryetar, mendojmë se çështja të cilin e kemi në rend dite, buxheti, në këtë fazë ka shkuar sipas procedurave të parapara për miratim të buxhetit. Ajo çka ne si grup na bën të lusim që pasi që ministri Shatri është përgjegjës për financa dhe e ka propozuar këtë buxhet, në një mënyrë nuk dha sqarime të nevojshme, apo ato ndoshta janë sqarime, por ne ende nuk e dimë sepse ndoshta mungon përvoja e miratimit të buxhetit të një agjencie. Pasi që këtu e kemi edhe kryeministrin, kishte me qenë mirë që z. Kryeministër, mbasi sot ka ardhur për ta prezantuar buxhetin, të merret pak me këtë agjenci. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Z. Kryeministër edhe ashtu e ka kërkuar fjalën, urdhëroni z. Kryeministër!

KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI:

Kërkesa që buxheti i ART-ë të miratohet i veçantë është i drejtë dhe të përputhet me ligjin. Por, po ashtu, nevoja që edhe ART-ja të ketë buxhetin 2006 prej janarit është e domosdoshme.

Qeveria propozon dhe unë e mbështesë propozimin që doli këtu në Kuvend që miratimi i buxhetit të ART-së të shkojë si pikë e veçantë. Ne tash le të miratojmë Buxhetin e konsoliduar të Kosovës pa këtë pjesën e ART-së. Ju mund të vendosni, Kuvendi mund të vendosë që këtë ta bëjnë në fund të kësaj seance për shkak se është nevoja që edhe ART-ja të ketë buxhetin prej 1 janarit. Mund ta themi që ART-ja të vijë me raportin për buxhetin e vet, por pajtohemi që të jetë pikë e veçantë, dhe ju vendosni kur do ta miratoni buxhetin e ART-së. Mund të jetë pikë e veçantë, mund të jetë ndaras, por jo pjesë e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, ne e dëgjuam tërë debatin në këtë çështje. Unë mendoj që kryetari i Komisionit për Buxhet ishte kristal i qartë, ministri i Financave ishte i qartë, prandaj ne po e votojmë si propozim.

Fatmire Kollçaku, urdhëro!

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU:

Shumë qartë i kam parashtruar dy pyetje në seancën e datës 15, për ministrin konkret.

1. Ligji për të startojë më në fund të realizohet,
2. Çka ka ndodhur me pikën e pestë të rekomandimeve të këtij Kuvendi të datës 7. korrik të seancës, pika nr. 5, ku u premtohen pensionistëve 6 milionë euro. Kjo nuk është realizuar për muajt vitit kalendarik 2005. A janë bartur këto mjete në vitin e ardhshëm, nëse jo këtu duhet dikush të japë përgjigje çka ka ndodhur me këtë rekomandim.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Kryetare e Komisionit, ju faleminderit. Vetëm një sqarim. Ligji mbi vlerat e luftës është iniciuar shumë herë në mandatin e kaluar, unë nuk po e marr rolin e ministrit të Financave. Buxheti është planifikuar mbi bazën e ligjeve ekzistuese. Ai ligj ka kaluar një rrugë të gjatë dhe ne jemi të gjithë të lumtur që do të vijë shpejtë në procedurën përfundimtare, prandaj do të kërkojë mund shtesë për Qeverinë. Vendimet që aprovohen në seancën plenare për ta mbështetur kryetarin e Komisionet dhe Komisionin, janë ekzekutive, janë ekzekutive për Qeverinë në kohën kur ajo mund ta ekzekutojë dhe formën që si të ketë nevojë të konsultohet me parlamentin. Por, Qeveria nuk mund të

polemizojë pa përgjigje profesionale në seancën Plenare në parlament, prandaj, unë po ju them se ministri nuk ka nevojë për informata shtesë, le të urdhërojë, por nuk e besoj që ka nevojë. Prandaj, po ju lus që sipas propozimit të komisionit për buxhet të votojmë ndaras propozimin.

Kush është për kreun IV pikën 1 të Komisionit për Buxhet, kush është “për” ju lutem?

Alush urdhëro, mirë urdhëro profesor Sejdiu.

DEPUTETI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit z. kryetar, çështjet janë shumë të thjeshta, nëse duam t’i komplikojmë i komplikojmë. E kemi Ligjin për buxhet në proceduar me amendamentet dhe le shprehemi për tërësinë e amendamenteve të projektit, kjo është e para, pastaj për të tjerat të shohim. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Kush është për aprovimin e Ligjit me amendamentet që i kemi aprovuar deri më tash? Ju faleminderit, shumica absolute!

A ka votë kundër, ju lutem?

A ka abstenime?

-28 vota janë kundër,

-2 abstenime.

Konstatohet që Ligji i amendamentuar ka kaluar.

Kemi pjesën e dytë ta sqarojmë. Janë dy propozime, është propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, i mbështetur nga ministri dhe kryeministri, por është edhe një propozim që nuk është i paarsyeshëm i atyre që mendojnë ndryshe, që ta ndajmë këtë pjesë për sot. Por, ju lutem, unë po ju lus në një mënyrë që sot këtë pikë të rendit të ditës ta pushojmë. Ne e aprovuam ligjin me amendamentet, kurse këtë pjesë e shohim në fund të seancës ose në një seancë të radhës. A je i kënaqur Gani. Naser ke nevojë për fjalë? Naser unë mendoj që nuk dëmtohet askush, sepse unë po komunikoj me deputetët, mendoj që edhe shefi i grupit parlamentar u pajtua kur thash ta ndajmë këtë pjesë dhe kemi mjaft punë për sot. Ne nuk e kundërshtuam propozimin e komisionit, por sot nuk e votuam, prandaj ju lutem për mirëkuptim.

Urdhëro, vërejtje procedurale, deputeti Jashari!

DEPUTETI NAZIM JASHARI:

Z. kryetar, ne e kemi marrë një rend të ditës me 16 pika, dhe pika e katërt ka qenë Shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Ne këtë e ndamë dy pjesë, e bëmë të parë dhe të dytë, mirëpo tash unë nuk po e kuptoj se si po e ndajmë

pikën në shqyrtimin e dytë. Në rast se e kryejmë shqyrtimin, atëherë duhet të votohet në tërësi dhe të kalojmë pastaj në pikën tjetër. Tash a kemi edhe nënpika, këtu nuk po shoh që kemi nënpika, ose kjo është një udhëheqje shumë e keqe e seancës, kështu nuk punohet, ju lutem, nuk është në rregull. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Mirë, për komplimentet tuaja kam krijuar afinitet të mjaftueshëm. Ne tash votuam ligjin dhe ishte kërkesë e dy grupeve përgjegjëse të dy grupeve parlamentare më të mëdha. E shikojmë dhe e vejmë në rend dite si pjesë të veçantë, sepse ashtu mendojmë të gjithë.

VAZHDIMI I SEANCËS, PJESA E DYTË, më 19.12.2005

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Unë do t'i lusja deputetët të ulen në vendet e veta. I kemi 66 deputetë të pranishëm, prandaj të vazhdojmë me punë, sepse në orën 13,00 pesë deputetë kanë një angazhim të vetin në Komisionin për të pagjeturit. Të punojmë dhe pastaj të bëjmë një pauzë e të merremi vesh për vazhdim.

Kemi në rend dite pikën 7:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat

Ajo që formalisht ka ngjarë të premtën, ka qenë konstatim i drejtë i kryesuesit të seancës që ta bëjë vlerësimin. Prandaj, ju lutem uluni edhe ju deputetët tjerë, meqë debati në parim është shterur, votimi është kontestuar me të drejtë nga kryesuesi si procedurë, prandaj ju ftoj që pasi e kemi dëgjuar debatin, ta votojmë dhe ta akceptojmë në parim shqyrtimin e Projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat.

Kush është për, ju faleminderit shumë.

A ka votë kundër, 23 janë kundër.

A ka abstenime, nuk ka abstenime. Pra, 77 deputetë janë në sallë, prandaj konsideroj që në shqyrtim të parë ka kaluar Projektligji në fjalë.

Kalojmë në pikën e radhës,

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 28.10.2005, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'ia adresojmë për shqyrtim komisionit funksional përgjegjës për dhe komisioneve kryesore.

Ftohet zëvendësministrja Angjelina Krasniqi që në emër Qeverisë ta arsyetojë Projektligjin. Urdhëroni zonjë!

ZËVENDËSMINISTRJA ANGJELINA KRASNIQI:

I nderuari z.kryetar,
Të nderuar deputetë,

Projektligji për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës në radhë të parë ka për qëllim të rregullojë sa më mirë organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Operës, Baletit dhe Filarmonisë në Kosovë.

Me këtë Projektligj do të mundësohet ngritja e cilësisë së krijimtarisë artistike, skenike dhe muzikore të institucioneve të Kosovës që merren me këto lëmi artistike.

Meqenëse kjo fushë nuk ka qenë e rregulluar më parë me asnjë ligj, Ministria e Kulturës e ka konsideruar si shumë të rëndësishëm hartimin e këtij Projektligji. Projektligji përcakton në mënyrë të veçantë organizimin e brendshëm të tri institucioneve artistike, siç janë Opera, Baleti dhe Filharmonia.

Me dispozitat e veçanta të këtij Projektligji janë paraparë format e nxitjes, zhvillimit, avancimit e promovimit të krijimtarisë artistike, formimi i politikave të krijimtarisë artistike, organizimit të punës kërkimore, shkencore, bashkëpunimit ndërkombtar, botimit të publikimeve nga fusha e artit skenik-muzikor etj.

Projektligji gjithashtu përcakton të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Operës, Baletit dhe Filharmonisë. Projektligji për Operën, Baletin dhe Filarmoninë është harmonizuar me legjislacionin e Unionit Evropian duke u përshtatur me ato kushtet dhe rrethanat ekzistuese në Kosovë.

Në Grupin Punues për shqyrtimin e këtij Projektligjit kanë marrë pjesë një grup i ekspertë të lëmive të ndryshme e sidomos ekspertët të veprimtarisë artistike të Operës, Baletit dhe Filarmonisë.

Me aprovimin e Projektligjit për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës dhe në funksionim të zhvillimit të mirëfilltë të aktivitetit të këtyre institucioneve, Ministria e Kulturës parasheh që të bëjë zgjidhje të infrastrukturës ligjore për këto institucione.

Të nderuar deputetë, ne shpresojmë se edhe kësaj radhe do të kemi përkrahjen tuaj në këtë seancë plenare dhe kështu do të kemi edhe një ligj të domosdoshëm për funksionimin e kësaj fushe kulturore artistike. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit për debatin. Në emër të LDK-së është paraqitur Gjylshene Berisha. Urdhëroni Gjylshene!

DEPUTETJA GJYLSHENE BERISHA:

Projektligji për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës, i hartuar, si thuhet në fillim, nga ekspertë vendës dhe të huaj, në tetë kapitujt e tij dhe 78 dispozita, fillon të mbulojë tri sfera tejet të rëndësishme të vlerave artistike, skenike dhe muzikore të Operës, të Baletit dhe të Filarmonisë, megjithëse do të ishte mirë që në titull së pari të ishte Filarmonia, pastaj Opera, dhe në fund Baleti.

Këto tri sfera të kulturës deri më tani nuk qenkan mbuluar, siç konstaton në fillim sponsoruesi me asnjë ligj, andaj së këndejmi Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të duhej ta shtronte më herët nevojën për nxjerrjen e këtij ligji.

Sidoqoftë, kjo ministri ka bërë mirë që tani e ka parë nxjerrjen e Ligjit për Operën, Baletin dhe Filarmoninë si shumë prioritare. Që në fillim të theksoj që, sipas nesh, sponsorizuesi me këtë ligj ka arritur të na ofrojë një bazë të mirë ligjore me të cilën mëton të rregullojë këto fusha kaq të rëndësishme të veprimtarisë kulturore në Kosovë. Sa i përket strukturës së organizimit të këtij teksti ligjor, konstatojmë se ky i ka plotësuar ato veçori e të bëjnë të pranueshëm një tekst ligjor, siç është qartësia, lejueshmëria, kuptimi i lehtë, konciziteti i dispozitave, e të tjera. Megjithatë, këtij Projektligji mund t'i bëhen disa vërejtje, qofshin ato të përgjithshme, qofshin ato të veçanta. Vërejtjet e përgjithshme, së pari ky projektligj ka një memorandum shpjegues i cili, ndryshe nga teksti i vetë ligjit, ka gabime të pa tolerueshme të natyrave të ndryshme të cilat nuk i duron teksti ligjor. Ligji megjithatë është dokument më i rëndësishëm administrativ i një shteti, andaj nuk duhet lejuar gabime të tilla tekstuale.

Së dyti, edhe në këtë Projektligj, siç po ndodh në disa projektligje të tjera, nuk janë respektuar sa duhet parimet e teknikës legjislative. Dihet se struktura e tekstit ligjor shtrihet në disa pjesë dhe renditjet e tyre deri diku janë standarde. Është e pakuptueshme që ky projektligj të mos e ketë atë pjesë që quhet “përkufizimet”, funksioni i të cilave është i dyfishtë, rritë precizitetin dhe qartësinë e ligjit, na mundëson ekonomizimin e shprehjeve në pjesën thelbësore të ligjit.

Së treti, edhe problemi i vazhdimësisë së renditjes së pjesëve të strukturës së këtij teksti ligjor nuk është i qëlluar. Kështu, p.sh. sillen në fillim dispozitat që flasin për fushëveprimin, rëndësinë, themelimin, natyrën, veprimtarinë, selinë, simbolet, mëvetësinë, mjetet, kujdesin, organizimin e brendshëm e tjera të këtyre institucioneve kulturore. Në nenin 13 tregohet qëllimi i Projektligjit i cili duhet të ishte që në fillim.

Vërejtje të veçanta, një numër i madh i dispozitave të Projektligji u referohet përnjëherë të tri institucioneve, por herë pas herë harrohet ndonjë institucion p.sh. te neni 8. Në disa dispozita hasim në paqartësi dhe konfuzitet. Kështu, p.sh. dispozitat që rregullojnë themelimin dhe statusin e Operës, Baletit dhe Filarmonisë nuk janë precizuar sa duhet Për shembull, në nenin 4.2 thuhet: Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Kulturës dhe komunat e Kosovës themelojnë Operën, Baletin dhe Filarmoninë si institucion publik. Nga kjo dispozitë nuk na del e qartë se në cilin akt të cilit organ kompetent krijohen këto institucione si institucione publike. Ndërkaq, në asnjë dispozitë nuk tregohet se kur ato janë private krijon në bazë të aktit të themelimit të regjistrimit të

tyre në organin kompetent, pra nuk precizohet si dhe kur fitojnë ato zotësi publike. Lëshimet e natyrave të tilla të këtij teksti ligjor qofshin ato të përgjithshme, qofshin ato të veçanta, mund të eliminohen lehtë, prandaj grupi ynë parlamentar e miraton në parim këtë projektligj.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit Gjylshene! Sala Ahmetaj në emër të PDK, urdhëroni!

DEPUTETJA SALA AHMETAJ:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,

Ligji që po shqyrtojmë tenton të sanksionojë disa veprimtari kulturore kulmore. Është vështirë të strukturoren, të harmonizohen dhe të gjenden mekanizmat me të cilët veprojnë Opera, Baleti dhe Filarmonia që janë njëkohësisht edhe të ndryshme edhe të veçanta, por edhe të ngjashme. Për ne ende mbetet dilemë çështja dhe mënyra e bashkëpunimit dhe e koordinimit të punës në mes tyre. Këto si struktura nuk duken të harmonizuara, madje ato me asnjë nen nuk e kanë të sanksionuar mënyrën e bashkëveprimit kur shfaqet ajo e nevojshme, sidomos marrëdhëniet në mes të Operës dhe Filarmonisë. Ta zëmë, neni 7.6 ku duhet të qartësohet kursi i institucioneve të pavarura. Opera dhe Filarmonia obligohen ose do të obligoheshin që të bashkëpunojnë.

Ndoshta këto dilema do t'i qartësojmë gjatë dëgjimit publik të këtij ligji. Kemi edhe dilema të tjera në rrafshin funksional. Në këtë ligj nuk saktësohet qartë veprimtaria e Operës, e Baletit dhe e Filarmonisë. Të gjithë e dimë se Opera, Baleti dhe Filarmonia si përkushtim dhe si veprimtari kanë kultivimin e vlerave artistike dhe prezantimin e tyre para opinionit e jo edhe studimin ose organizimin e sesioneve shkencore. Këtë punë duhet ta bëjnë institucionet e tjera të caktuara. Shtrohet pyetja, si duket struktura e ligjit dhe si dalin mekanizmat që e bëjnë funksional? Përgjigja gjendet vështirë sepse në shumë nene shohim përzierje kompetencash, hierarkish dhe funksionesh. Kështu si janë shkruar ose si janë shtruar vështirësojnë zbatimin e këtij ligji, madje në disa nene duken edhe elemente që sforcojnë autokracinë dhe burokracinë. Për shembull, drejtorit të Operës i janë dhënë shumë kompetenca, disa prej të cilave do të duhej t'i kishte Këshilli drejtues. Pyetja tjetër në të cilën do të kërkonim përgjigje është kush duhet ta themelojë Operën, Kuvendi, Ministria ose dikush tjetër? Ky konfuzion duhet të qartësohet. Ne jemi thellësisht të bindur se institucionet e një rëndësie të veçantë si është, ta zëmë, Opera duhet t'i themelojë Kuvendi i Kosovës, siç është themelues edhe i institucioneve tjera të rëndësishme në Kosovë, Ose dilema tjetër, kush duhet ta mbikëqyrë ose monitorojë punën e Këshillit artistik dhe të Këshillit drejtues, ministri, ministria ose mekanizma të tjerë. Kështu si është shtruar në Projektligj, nuk lejon mundësinë e transparencës. Dilema shtrohet edhe rreth mënyrës së formimit të Këshillit artistik. Ne do të pyesnim, a do të duhej të ishte përfaqësimi institucional më i denjë në këtë këshill. P.sh. nga Fakulteti i Arteve ose nga Akademia i Shkencave të Arteve të Kosovës. Natyrisht se po. Çështje tjetër janë institucionet private të pavarura të cilat janë paraparë me këtë projektligj. A mund të ketë Kosova e varfër dhe e vogël operë dhe filarmoni private? Absolutisht jo.

Natyrisht, kjo do të lejohet me ligj, por mos të bëhemi megaloman duke i imituar të tjerët, të pasurit, të mëdhenjtë, të fuqishmit dhe ata që kanë krijuar kaheër traditë në këtë fushë. Ne fatkeqësisht ende s'i kemi të konsoliduara këto institucione. Në shumë nene ndeshim nocione dhe koncepte që duhet të rishikohen, sepse kështu si janë, krijojnë paqartësi dhe konfuzion. Ja disa shembuj, neni 61, pas pikave, vazhdojnë, dëshmojnë profesionalizëm të lakmuar, në qoftë se nuk është i lakmuar profesionalizmi, profesionalizmi nuk është as i lakmuar as i palakmuar, por është profesionalizëm. Ligjet nuk duhet të kenë fjalë me epitete.

Neni 65, përveç tjerash ata janë punëtorë, ata janë artistë të cilët duhet të marrin mirënjohje për veprimtarinë e tyre përkushtuese e jo falënderime. Ndonjë nen se dimë a është nen apo do të duhej të parashihej ndonjë strategji, p.sh. neni 13, ose në nenin 25.1 Këshilli artistik i Operës është me shumë paqartësi sepse nuk e kemi plotësisht të qartë a është ai këshillëdhënës apo vendimmarrës, pastaj drejtori a duhet të zgjidhet domethënë me konkurs, a zgjidhet apo emërohet etj. Megjithatë, ne në parim do ta përkrahim këtë Projektligj dhe shpresojmë se mangësitë që i kemi vënë re do t'i mënjanojmë gjatë punës së Komisionit dhe disa paqartësi tjera do t'i shohim edhe në dëgjimin publik. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Mazllum Kumnova, në emër të Aleancës, dhe le të përgatitet Behxhet Brajshori.

DEPUTETI MAZLLUM KUMNOVA:

Zoti kryetar, edhe këtë Projektligj grupi i AAK-së në këtë Kuvend e ka shqyrtuar me kujdes dhe ka konstatuar për shqyrtimin në parim. E para, e përgëzoj ministrinë përkatëse që ka bërë përpjekje për të rregulluar me ligj organizimin dhe funksionimin e Operës, Baletit dhe Filarmonisë në Kosovë, si institucione me rëndësi të veçantë të kulturës sonë që deri më tani ka munguar një rregullativë e tillë. E dyta, me këtë Projektligj do të krijohen kushte më të favorshme për t'ju kthyer krijimit të vlerave të qëndrueshme të kulturës, të mos hijezimit të tyre, në veçanti mundësia që këto institucione të themelohen, organizohen dhe drejtohen nga profesionistët e artit. Mirëpo, si në rastet e tjera, hartuesi nuk u ka kushtuar kujdesin e duhur disa rregullativave, sidomos në organizimin dhe administrimin e këtyre institucioneve të kulturës sipas nivelit qendror dhe lokal, përkufizimit të tyre, veçoritë dalluese organizative dhe menagjuese. Po ashtu, të shqyrtohet mundësia e organizimit të Baletit alternativ si formë e njohur e organizimit artistik. Duke lexuar vërehet se te këshillat artistike të këtyre institucioneve kulturore, formimi i organeve kolegjiale, përbërja dhe përfaqësimi i tyre është e domosdoshme të përfaqësohen me profesionistë artistikë, sepse si është dhënë në këto nene, në këto këshilla mund të zënë vend edhe ndonjë punëtorë teknik, pse jo edhe ndonjë roje nate apo dite. Kur jemi te kjo pjesë e projektligjit, kemi propozim se edhe udhëheqësit artistik të

këtyre institucioneve të zgjidhen me konkurs publik, sidomos drejtuesit. Ky Projektligj pretendon të zgjidhë edhe çështjen e pensionimit të mëhershëm përkundër vullnetit të mirë të hartuesit p.sh. moshë ime nuk mund të ngjitet në skenën e baletit. Mendoj se kjo çështje është dhe duhet të jetë pjesë e ligjit për pensione sipas kontributit në punë, do të thotë kreu i pensioneve intelektuale dhe artistike. Projektligji ka mangësinë e formimit gjuhësor dhe gabime në formulime juridike, mungesë e një shpjegimi të përkufizimeve, në veçanti memorandumit shpjegues, ku gati çdo fjalë është shkruar gabimisht. Përkundër kësaj, si grup i këtij Kuvendi kemi mendim se Projektligji duhet të kalojë, me sugjerim për një përmirësim gjatë procedurës së këtij Kuvendi dhe e kemi gatishmërinë tonë për votë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit , unë e ftoj udhëheqësin e Grupit të ri parlamentar, Ferid Aganin të cilin nuk e kam parë që është në sallë. Urdhëroni, fjala është e juaja, e pastaj Behxhet Brajshori.

DEPUTETI FERID AGANI:

Ju faleminderit z. kryetar. Është kënaqësi e imja që në cilësinë e Grupit parlamentar për integritet të paraqitem për herë të parë në këtë Kuvend dhe t'ju informoj që në mungesë të kushteve teknike për takimin e Grupit parlamentar, meqenëse ende jemi grup i ri në formim dhe këto kushte ende nuk janë krijuar, unë nuk jam në gjendje që sot të paraqes një qëndrim si grup parlamentar lidhur me këtë Projektligj, por vetëm një mendim timin si deputet në Kuvendin e Kosovës dhe këtë do ta bëj pasi që të respektohet radha e prezantuesit.

KRYETARI I KUENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit shumë, fjalën e ka Behxhet Brajshori, kurse le të përgatitet Fadil Kryeziu.

DEPUTETI BEXHET BRAJSHORI:

Faleminderit z. Kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë, Unë e përgëzoj Ministrinë e Kulturës që ka bërë përpjekje të na sjellë një ligj të këtillë në Parlamentin tonë jo vetëm dy ligje që patëm në seancën e kaluar dhe e konsideroj të veçantë miratimin e këtyre ligjeve, në veçanti të këtij ligji i cili rregullon një fushë shumë të rëndësishme- funksionimin normal të institucionit kulturor të Operës së Kosovës. Por ajo që është shumë me rëndësi dhe që dua ta përsëris kërkesën time më të hershme është nevoja e domosdoshme e shtimit të interesimit tonë për të siguruar funksionimin normal në kuptimin e mbështetjes buxhetore të zhvillimit të kulturës tek ne dhe në këtë rast në veçanti do të thoja të mbështetjes së Operës së Kosovës dhe të përmirësimit të infrastrukturës fizike të institucioneve të kulturës. Ne jemi dëshmitarë të gjithë se në kushte shumë të vështira po funksionojnë të gjitha institucionet tona të kulturës dhe ajo

që më tepër më ka shqetësuar kohëve të fundit është se deri sa ne bënim përpjekje së paku në këtë drejtim të përmirësojmë këtë infrastrukturë fizike dhe institucionet tona të kulturës të kenë edhe me një objekt në qendër të Prishtinës, pra t'i jepet thjeshtë Ministrisë së Kulturës objekti i Unionit, tani marrim të dhëna se ai do të privatizohet. Do të ishte më mirë sikur ai të adresohet në një muze të arteve bashkëkohore sepse Kosova vërtet ka nevojë për te. Prandaj, nganjëherë është e nevojshme që të konsultohemi në bazë më të gjerë dhe mundësia e sigurimit të kësaj infrastrukture fizike në vërtetë është e vogël, por duhet të bëjmë përpjekje së paku ta shtojmë interesimin tonë në këtë drejtim. Ndërtimi i një shtëpie të Operës në Kosovë duhet të jetë në interesin e secilit prej nesh. Unë e mbështes dhe vërtet kërkoj që Kuvendi t'i kushtojë një vëmendje më të madhe në procedurat tjera buxhetore financimit të zhvillimit të kulturës në vendin tonë.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Fadil Kryeziu, le të përgatitet Hydajet Hyseni.

DEPUTETI FADIL KRYEZIU:

Ju faleminderit z. Kryetar. Unë e kam për qejf këtë sferë të kulturës. Po i them dy fjalë për t'ia tërhequr vërejtjen komisionit funksional. Ne e kemi para vetes një ligj për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës, ndërkaq brenda ligjit sidomos në nenin 3, në nenin 4 dhe nenin 5 mëtohet që me këtë projektligj të lejohet edhe në sferën private, domethënë këtë sferë të kulturës ta kemi të organizuar. Ndërkaq, pas këtyre neneve në tërë nenet që pasojnë tërë kohën flitet për Filarmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës. Vetëm t'ju përkujtoj p.sh. nenin 3 pika 1 ku thuhet: Themelimi, përkatësisht vazhdimësia e punës dhe e veprimtarisë së Operës, të Baletit dhe të filarmonisë, dhe thuhet se mund t'i themelojnë personat juridikë, personat juridikë e fizikë, e në anën tjetër në përgjithësi flitet për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës dhe thuhet në 4.1 mund të jenë institucione publike dhe institucione private. Në fakt, tërë kohën flasim për institucionin publik, prandaj duhet që komisioni ta ketë këtë parasysht. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

DEPUTETI, HYDAJET HYSENI:

Ju faleminderit z. kryetar për fjalën. Për kolegët dhe për opinionin Hysen Kaloshi është mbiemri im zyrtar i regjistruar dhe është si pasojë e një gabimi që ka qenë në administratën e mëparshme. Mbiemri ka qenë i shkruar gabimisht Hyseni dhe nuk ka të bëjë me gjenealogjinë dhe askush nga të parët e mi nuk e ka pasur këtë emër, kështu që kam qenë i detyruar ta bëj këtë. Do të ishte e panevojshme ta sqaroj këtë, por mu imponua.

Z. kryetar, zonja dhe zotërinj deputetë. Unë nuk e kam ndërmend të diskutojë për përmbajtjen e Projektligjit për institucionet e kulturës. Mbështes atë që u tha në

paraqitjet e mëparshme, por duhet të ndalem dhe të tërheq vërejtjen në një aspekt tjetër. Po vihemi vazhdimisht në situatë të rëndë për do aspekte që vërtet nuk na janë të nevojshme. Edhe lidhur me ligjin e mëparshëm nuk ju dha fjala deputetëve të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës para se të votohej dhe kjo pastaj natyrisht që shkakton edhe reagime. Tani po vazhdohet praktika e legjitimitit të prirjes që ligjet në Kuvendin e Kuvendit të Kosovës të prezantohen nga zëvendësministri. Kjo do të mund të kuptohej për ato ministri ku nuk kemi ministra megjithëse ne e kemi pasur praktikën që në ato ministri ligjet të prezantohen prej kryeministrit. Për Qeverinë dhe për secilën ministri nuk ka çështje më të rëndësishme se sa ligjet që mbulojnë fushën e tyre, prandaj unë nuk mund ta kuptoj këtë tolerancë të Kuvendit të Kosovës që me ligjet të luhet në njëfarë mënyre, të dërgohet një zëvendësministër, kurse pastaj të shqyrtohet çështja dhe ajo nuk është e saktë. Kjo edhe do të mund të tolerohej edhe pse është krejtësisht në kundërshtim në rregullat e procedurës. Në rregulloren tonë fillim e mbarim janë ministrat ata që prezantojnë ligjet dhe drejtat që i kanë, por jo edhe nivelet e tjera të qeverisë. Për mendimin tim, ky është një indikator shumë domethënës i trajtimit të fushave që mbulojnë drejtuesit e Qeverisë. Nëse nuk kanë gatishmërinë për të qëndruar bashkë me ne gjatë shqyrtimit të kësaj çështje, e merrni me mend cili do të jetë qëndrimi i tyre në zbatimin ligjeve, në realizimin e atyre që përcaktohen pastaj edhe në ligj. Apeloj prandaj që kjo praktikë të ndërpritet, të korrigjohet dhe të kërkojmë që ministrat dhe kryeministri për fushat që mbulojnë të jenë këtu bashkë me ne. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Më duhet një të jap një sqarim për hir të opinionit, edhe pse gati plotësisht pajtohem. Kur ti ia qëllon rastësisht, unë nuk të kundërshtoj. Unë dje ju thashë se të premtën apo të enjten kam marrë shkresë zyrtare nga Qeveria e Kosovës me të cilën na informon që zëvendësministrat duhet t'i prezantojnë ligjet. Unë po ju informoj dhe po e shfrytëzoj rastin që ka një kohë të caktuar që Zyra ime bashkë me Sekretarinë po përgatisim një projekt propozim të programit 3 deri 6 mujor të vitit 2006 që do ta ketë Kryesia dhe në të cilin do të vendosim për të gjitha këto shqyrtime. Unë jam shumë i bindur që punë më të rëndësishme se prezantimi i projektligjit për një ministër nuk mund të ketë. Unë po e them publikisht dhe gjithmonë e kam thënë, edhe në atë pjesë të propozimit do të ketë kërkesë të tillë, por nuk po dua që ministrat dhe qeveria të jetë e pranishme në debat për projektligje apo për tema të caktuara dhe një gjë të tillë unë as që e kam shikuar. Kam menduar që pikërisht në votimin e dytë edhe formalisht po respektohet një vërejtje që kryesuesi i seancës e ka bërë konform Kornizës kushtetuese dhe Rregullores dhe isha i lumtur që edhe partia që substancialisht kishte të drejtë në numrin e votave, e përkrahu këtë. Nga kryetari asnjë qëllim më i vogël nuk ka qenë që të nënvlerësohet grupi i dytë ma i madh parlamentar ose një grup parlamentar, por e konsiderova si një formalitet se debati është sterruar dhe në debat nuk ka pasur elemente të atilla që të hiqet prej rendit të ditës ose nuk ka pasur propozime të tilla, prandaj ju lus që emocionet që i ka çdo individ, përfshirë edhe kryetarin e Kuvendit në punën e ligjeve, në punën e seancës të mundohemi të mos ndikojnë. Pra unë i kërkoj falje në qoftë se dikush ka menduar që nuk e kam dhënë për qëllime të nënvlerësimit ose të mosrespektimit. Nuk ekziston ai disponim i imi ndaj tyre, prandaj shpresoj që do të qëndrojnë të gjitha këto. Ferid Agani, le të përgaditet Kamber Kamberi.

DEPUTETI FERID AGANI:

Ju faleminderit z. kryetar,

Duke përshëndetur përpilimin e këtij Projektligji, i cili mendoj se do të jetë një kontribut tejet i rëndësishëm në avancimin e kulturës në Kosovë, një vërejtje të cilën e tha edhe parafolësi dhe në esencë bëhet fjalë për një huti në lidhje me fushëveprimin e këtij ligji, në titull adresohet themelimi i Operës, Baletit dhe Filarmonisë së Kosovës, ndërsa brenda teksti ligjor pretendohet që të rregullohet tërë lëmi i themelimit të këtyre institucioneve të kulturës si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik. Kështu, mendoj se para komisionit funksional ekziston një punë mjaft serioze në mënyrë që të veçohen këto dy aspekte. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Kamber Kamberi, dhe në qoftë se janë prapë për debat Enver Hoxhaj e pastaj Jakup Krasniqi, urdhëroni!

DEPUTETI KAMBER KAMBERI:

Ju faleminderit z. kryetar,

Është bërë e zakonshme tashmë në parlamentin tonë të thuhet se ky ligj është i rëndësishëm së veçantë, është nevojë imediate ose i një rëndësie dhe nevojë të domosdoshme, e kështu me radhë.

Kësaj radhe pajtohem me parafrazimin se Opera, Baleti dhe Filarmonia e cila nuk shkruhet njëjtë në këtë Projektligj, diku shkruhet filarmonia e diku filarmonia, ushtrojnë aktivitete e veprimtari kulturore artistike me interes të veçantë për Kosovën, prandaj trajtimi dhe përkrahja gjithashtu duhet të jenë të veçanta. Mendoj që ky Projektligj është përpiluar kujdesshëm, por me gjithë këtë mund të bëhen edhe vërejtje të arsyeshme në mënyrë që komisioni përkatës gjatë riformulimit t'i inkorporojë përmirësimet që forma përfundimtare e ligjit të dalë e kompletuar dhe e harmonizuar. Po përpiqem që të mos i përsëris ato çfarë pajtohem me kolegët e mi, vërejtjet që i dhanë. Kam vërejtje të neni 2, 2.2. ku thuhet pos tjerash se me këtë ligj mund të themelohet dhe të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe institucionet tjera të Operës, Baletit dhe Filarmonisë. Që të mos ketë hamendje apo zbrazëtirë, këtu duhet të ceket se cilat institucione mund të themelohen.

Neni 6. pika 6.3 ka të bëjë me përcaktimin e vulave dhe ceket për vulën katrore dhe katërkëndëshe, mendoj se vula katrore mund të zëvendësohet me vulën e rrumbullakët, nëse jo duhet të hiqet, sepse edhe katrori edhe katërkëndëshi kanë nga katër kënde. Në të kundërtën të shikohet se çfarë përfaqësojnë këto vula.

Neni 10. pika 10.2 që ka të bëjë në rast të ndërprerjes së punës të veprimtarisë së Operës, Baletit dhe Filarmonisë vendimin e bie Qeveria e Kosovës në bazë të mendimit të

ministrit të Ministrisë së Kulturës. Ky tekst të zëvendësohet: “ në bazë të vlerësimeve dhe të argumentimit me shkrim të ministrit të Ministrisë së kulturës”, sepse vlerësimi dhe paraqitja me shkrim dhe mendimi kujtoj se kanë kuptime të ndryshme. Te Këshilli drejtues, neni 50, përbërja dhe përfaqësimi i Këshillit duhet të kërkojë në përbërjen e Këshillit të Operës dhe të Baletit nga 5 anëtarë e jo siç është shprehur këtu nga 4 anëtarë dhe kryetari, sepse edhe kryetari është anëtar i këtij këshilli, prandaj 4+1 bëjnë pesë gjithsej.

Gjithashtu, këtu duhet cekur se nga të deleguarit cili mund të zgjidhet kryetar, në të kundërtën të ceket se secili nga të deleguarit mund të zgjidhet kryetar. Ka vend edhe për plotësime tjera, por ndoshta këto do të rregullohen me rregullore apo me akte të tjera nënligjore. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Para se të deklarohe mi, unë do ta lutja komisionin funksional lidhur me një propozim që ishte nga z. Sala Ahmetaj, e besoj që një numër i madh i deputetëve e ndajnë këtë mendim, që kur është fjala për projektligjet dhe ligjet e rëndësishme së veçantë të nivelit nacional, është mirë që themelues të jetë Kuvendi i Kosovës. Ka ide në çarçet brenda Akademisë së Shkencave, brenda Universitetit, brenda profesionistëve që të shqyrtohet me shumë seriozitet kjo substancë. E dyta, ka lutje, sugjerime që për shkak të nivelit zhvillimor që ka Kosova, edhe kadrovik, edhe profesional, edhe financiar, të mos atomizohen tepër institucionet e rëndësishme nacionale, prandaj do të thotë komisioni funksional brenda mundësisë me propozuesin e ligjit të jetë bashkë sponsorues i këtij ligji në mënyrë që juridikisht të tejkalojmë instancat dhe besoj të kemi bashkëpunim të mirë me bazën profesionale. Tani ju ftoj që të përgatitemi për të votuar, ta aprovojmë në parim Projektligjin. Tani votojmë:

Për janë 67 vota,
Kundër 1 votë,

Konstatohet se Projektligji u aprovua në parim. Kalojmë tani në pikën e radhës:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 31.10.2005 dhe kështu janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'ia adresojmë për shqyrtim komisionit funksional përgjegjës për raportim, dhe komisioneve kryesore. Ftoj ministrin, Ibrahim Selmanaj që në emër të Qeverisë së Kosovës të prezantojë projektligjin.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ:

Të nderuar deputetë,

Sot para jush gjendet Projektligji për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal në Kosovë, sponzorues i të cilit është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ekspozeja ime, ka për objektiv të ofrojë ca shpjegime të nevojshme lidhur me Projektligjin e lartpërmendur.

Aktualisht në Kosovë është në fuqi Rregullorja nr.2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës, përmes së cilës rregullohen çështjet e punësimit në Kosovë, marrëdhëniet e punës dhe raportet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, në procesin e punës.

Me dispozitat e Rregullores nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës është paraparë edhe e drejta për organizim dhe ujdi kolektive dhe mbrojtja ndaj akteve të diskriminimit sindikal.

Të nderuar deputetë,

Liria për themelimin dhe anëtarësimin në Sindikatë është liri civile e njohur në botë dhe njëra nga të drejtat kryesore të punëtorëve. Respektimi i parimeve të lirisë së bashkimit në sindikatë ka rëndësi thelbësore për funksionimin e duhur të sistemit të marrëdhënieve të punës. Në anën tjetër është më rëndësi liria e themelimit të sindikatës, ku sindikata luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe funksionimin e ekonomisë së tregut, e cila në përgjithësi më mirë funksionon në kushtet e demokracisë.

Bashkimi, organizimi i lirë dhe vullnetar në sindikatë është e drejta e punëtorit që të vendos vetë për anëtarësimin apo mos anëtarësimin në sindikatë. Sindikata do të përpiqet për prosperitetin e të gjithë punëtorëve pa varësisht nga bashkësitë etnike, nacionaliteti, gjinia, raca, feja me qëllim që të sigurohet paqë dhe zhvillim demokratik të punonjësve në themelimin dhe organizimin sindikal.

Të nderuar deputetë,

Projektligji i propozuar rregullon krijimin e kushteve dhe standardeve më të mira të punës së punonjësve, mbrojtjen e të drejtave ekonomike, profesionale, industriale dhe sociale për punonjësit, avansimin dhe zhvillimin e dialogimit social mes partnerëve social, eliminimin e formave të diskriminimit etnik, racor, fetar, gjinor, politik, kulturor dhe sindikal.

Prandaj rregullimi normativ i kësaj lëmie, është njëri ndër prioritetet e MPMS-së në mënyrë që:

- të përcaktohet sigurimi i të drejtës ligjore për punëtorët për të krijuar dhe për t'iu bashkangjitur sindikatave sipas zgjedhjes së tyre pa ndonjë autorizim të mëparshëm,
- të merren të gjitha masat e nevojshme dhe të duhura që punëtorët lirisht të veprojnë në kuadër të sindikatës, duke përfshirë atë mos diskriminuese,
- të krijohen kushtet për veprim optimal sindikal, dhe
- të respektohet legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë.

Për këtë arsye Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka përgatitur këtë Projektligj i cili ka për qëllim që të rregulloj shumë çështje më rëndësi parësore për punonjësit, duke përfshirë lirinë e organizimit sindikal, regjistrimin e sindikatës, refuzimin e regjistrimit të sindikatës, legjitimitetin sindikal, raportet e sindikatës me Qeverinë dhe dialogimin social.

Projektligji për të Drejtat dhe Liritë e Organizimit Sindikal në Kosovë, i cili është para jush për shqyrtim, ka vërejtje dhe plotësime eventuale, është në harmoni më zgjidhjet më të reja konceptuale dhe aktualisht zbatueshme në vendet në tranzicion si dhe në përputhje me nivelin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe social të vendit tonë.

Duke miratuar Projektligjin për të Drejtat dhe Liritë e Organizimit Sindikal në Kosovë, ne do të krijojmë një bazë solide ligjore edhe për shumë aspekte tjera të nevojshme të kësaj lëmie, e cila me rregullore dhe udhëzime administrative të cilat do të hartohen pas e bëjnë plotësisht të implementueshëm.

Të nderuar deputetë,

Në hartimin e Projektligjit për të Drejtat dhe Liritë e Organizimit Sindikal, përveç ekspertëve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kanë marrë pjesë edhe partnerët social, përkatësisht përfaqësuesit e Bashkimit të Sindikatave të pavarura të Kosovës dhe Odës Ekonomike të Kosovës si dhe ekspertë tjerë Qeveritar.

Shpresoj se ky Projektligj do të begatohet edhe më tepër, pas diskutimit me vërejtje që mund të rrjedhin nga diskutimet e juaja. Faleminderoj.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ministër, ju faleminderit. Hapim debatin në parim. Ramadan Kelmendi në emër të LDK-së

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra, deputetë dhe të pranishëm të tjerë, më lejoni që në emër të Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës të paraqes vlerësimin për Propozim ligjin për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal në Kosovë. Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar Propozim ligjin e cekur dhe duke u mbështetur në përmbajtje të ofruar vlerëson me sa vijon.

1. Propozim ligji është i formuluar mirë,
2. Materia që e trajton dhe materia që është shtruar është konceptuar drejtë në kuptimin juridik formal dhe përmbajtjesor sindikal,
3. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ka bërë për një punë të mirë me ofrimin e këtij propozim ligji në shqyrtim kuvendor, dhe
4. Propozim ligji plotëson një vakum ligjor në fushën e veprimtarisë sindikale në Kosovë.

Prandaj, mbështetur në këto fakte e disa të tjera, Grupi parlamentar i LDK-së është i mendimit se ky propozim ligj mbi liritë dhe të drejtat e sindikatës në fazën e parë të shqyrtimit parlamentar të miratohet në parim dhe të begatohet në procedurën e mëtutjeshme kuvendore, por duke lënë mundësi të paraqiten edhe këto amendamente me të cilat, natyrisht, do të begatohet dhe konkretizohet në disa segmente. Me gjithë këto anë pozitive, Grupi parlamentar i LDK-së ka parasysh faktin e ri dhe rolin e ri të sindikatës në rrethanat e reja ekonomike, në lirinë e tregut, në biznesin privat dhe ndryshime të shumta që janë bërë në rolet dhe masivizimin e sindikatave dhe organizimin e funksionimit të tyre në kuadër të Bashkësisë Evropiane ku ka ndryshime të dukshme dhe atje sindikata mbështetet në përcaktimet në kontratat kolektive të punëtorëve dhe në kontratat individuale të punës, të drejtat dhe liritë e përcaktuara duke eliminuar mundësitë e lajthimeve dhe të keqpërdorimeve politike të të drejtave sindikale nga punëtorët apo nga obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve, punëdhënësve dhe të interesuarave të tjerë në sistemin trepalësh të sindikatës.

Grupi Parlamentar i LDK-së konsideron se liria për të drejtën e organizimit sindikal të punëtorëve është një ndër të drejtat kryesore të punëtorëve, andaj e përkrahë idenë që kjo të përcaktohet dhe sanksionohet ashtu si është paraparë me këtë propozim ligj si një e drejtë ndërkombëtare për funksionalizimin ekonomik të sindikatave në tregun e lirë ngase edhe ILO-ja gjegjësisht Organizata Ndërkombëtare e Punës përcakton se punëtorët janë të lirë dhe vullnetarisht mund të anëtarësohen në sindikata edhe konventat ndërkombëtare mbi të drejtat në punë po e pranojnë lirinë e organizimit sindikal, por duke plotësuar kushtet në nivel të sindikatave lokale dhe qendrore dhe në konfederatat e sindikatave. Grupi i LDK-së vlerëson se sindikatat patjetër duhet të jenë të cilësuar dhe të regjistruara si subjekte juridike, andaj mbështetur në këtë duhet t'i respektojmë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me Konventën ndërkombëtare dhe të bartin përgjegjësi për veprimtarinë sindikale të vetin në kuadër të veprimtarisë, sepse sundimi i ligjit në Kosovë është parakusht për përmirësimin dhe sigurimin e jetës së punëtorëve duke ndaluar, siç u theksua edhe në fjalën hyrëse, diskriminimi sipas gjinisë, racës prejardhjes sociale, gjendjes ekonomike, përcaktimit politik, fetar e të tjera. Vlerësoj se mbrojtja e interesave, gjegjësisht vlerësojmë se gjendja sociale e punëtorëve është më tepër kategori e institucioneve adekuate të Kosovës se sa e sindikatave. Shumë çështje të cilat janë në interes të përgjithshëm për punëtorë duhet përcaktuar me ligjin mbi marrëdhëniet e punës, kontratën kolektive dhe kontratat e punës dhe jo me urdhëresa dhe direktiva administrative që nuk do të ishte mirë. Preambula e propozim ligjit nuk është në harmoni edhe me qëndrimin e këtij Kuvendit edhe pse çdo herë jemi marrë vesh ashtu, duhet të mbështetemi në Kornizën kushtetuese, pastaj në Rregulloren e UNMIK-ut e tjera e tjera. Propozim ligji duhet të jetë më i qartë kur e përkufizon nocionin sindikatë dhe organizata sindikale. Vlerësoj se të drejtat themelore të organizimit sindikal pa pëlqimin e Qeverisë dhe të punëdhënësit si e drejtë nuk duhet të nënkuptohet edhe si veprimtari dhe pa përgjegjësi sindikale me problematikën politike dhe dëmet materiale që mund të shkaktohet nga sindikata dhe grevat sindikale.

Ligji nuk përcakton në mënyrë të qartë lirinë e bashkimit sindikal në shërbimet civile apo vetëm në ndërmarrjet private të përziera dhe ato shtetërore dhe të tipave të

ndryshëm. Përcaktimi i detyrimeve të punëdhënësve për krijimin e kushteve dhe lehtësirave të nevojshme për veprimtari sindikale nënkupton edhe vetë anëtarësimin e punëdhënësit në sindikatë, duhet shikuar në nenin 7, mendoj se nuk kemi të drejtë këtu, sepse veprimtaria private dallohet nga organizimi sindikal. Vlerësoj se anëtarët e sindikatës nuk mund të jenë persona që kanë plotësuar moshën për punësim se në këtë rast do të kishim sindikatën më të madhe të të papunëve, por në sindikatë duhet të anëtarësohen vetëm ata që janë të punësuar pa marrë parasysh në cilën veprimtari dhe kategori.

Dhe në nenin 17, Propozim ligji nuk e zbërthen dhe konkretizon organizimin e sindikatës në formën juridike, duke përfshirë Kuvendin, Kryesinë, kryetarin dhe forma të tjera. Po ashtu mbetet diskutabil neni 20, ku shtrohet çështja e pronës së sindikatave në rrethanat e reja të krijuara. Mendoj se pa aprovimin dhe nxjerrjen e Ligjit mbi pronën as në këtë drejtim nuk duhet lëshuar në tërësi. Grupi parlamentar i LDK-së edhe njëherë e konfirmon mbështetjen parimore të miratimit të këtij propozim ligji në procedurën e mëtutjeshme kuvendore. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Në emër të PDK-së ka disa të paraqitur, kush flet, z. Berat Luzha, urdhëroni!

DEPUTETI BERAT LUZHA:

Të nderuar kolegë deputetë, vlerësojmë se sot në shqyrtim e kemi një ligj të përpiluar mirë sipas standardeve ndërkombëtare dhe me kritere profesionale.

Ligji është i shkruar rrjedhshëm në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, prandaj edhe është i lehtë për zbatim. Në këtë ligj normohen drejtë veprimet sindikale. Që të ishte sa më i kompletuar, ligjit ndoshta i mungon një kapitull ku do të normoheshin edhe metodat e veprimit sindikal, por edhe mënyrat e lidhjes së marrëdhënies të punëdhënësve dhe punëmarrësve. Mendoj se emërtimi i ligjit mund të thjeshtëzohet dhe ai të quhet shkurt, Ligji për sindikatat.

Për hartimin e ligjit është angazhuar një grup punues prej 10 personave, por në memorandumit e projektligjit në listën e grupit 5 prej tyre janë anonim, nuk u dihet identiteti, por është shënuar vetëm institucioni prej nga ata duhet të vinin në grupin punues. Këtij Projektligji mund t'i bëhen edhe vërejtjet të cilat edhe ashtu nuk do të pengonin zbatimin e tij. Mendojmë se nuk duhet të sanksionohet me ligj një vijë vertikale e organizimit sindikal, shoqatë, federatë, konfederatë, por kjo vijë duhet të mbetet si variant i mundshëm dhe i dëshiruar.

Shumë nene të ligjit për nga natyra duhet të ishin nene të statuteve sindikale apo të rregulloreve përkatëse. Me gjithë këto vërejtje të cilat shpresojmë që do të eliminohen gjatë procedurës së mëtejshme në Kuvend, Grupi parlamentar i Partisë Demokratike pajtohet për miratimin e tij në shqyrtimin e parë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Doktoreshë Zylfije Hundozi, le të përgatitet Teuta Sahatçiu!

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI

Z. kryetar, kolegë deputetë, ministra të pranishëm,

Projektligji për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal është edhe një kontribut për legjislacionin të dalë nga ky Parlament. Për kah forma ky Projektligj është i shkruar dhe i konceptuar mirë dhe lehtë kuptohet. Me siguri se ky ligj do të bëhet edhe më i rëndësishëm dhe i aplikueshëm në jetën e përditshme po të ishte miratuar më herët nga ky Kuvend Ligji për punë dhe marrëdhënie të punës e jo që një lëmi jetësisht e rëndësishme për Kosovën të jetë e rregulluar me Rregullore të UNMIK-ut. Për shkak të mungesës së legjislacionit të përmendur ne edhe përballemi me diskriminime të llojllojshme në punë si është rasti pas privatizimit të ndërmarrjeve ku edhe pse premtohet se punëtorët do të punësohen dhe do të riaktivizohen, në ndërmarrje shpesh ndodhë e kundërta. Punëtorët pas disa muajsh mbesin pa punë pa kurrfarë kompensimi e lokalet e ndërmarrjeve shndërrohen në depo për mallra. Ose rasti i përjashtimit të shumë shtatzënave nga puna vetëm pse janë shtatzëna, mungesa e së drejtës për pushim me pagesë, të lehonave, të pushimeve mjekësore.

Qëllimi i formimit të sindikatës është krijimi i kushteve më të mira për punonjësit, mbrojtja e të drejtave ekonomike, profesionale, eliminimi i formave të diskriminimit të çdo lloji, prandaj që të arrihen të gjitha këto, në kushtet ekzistuese në Kosovë duhet një riorganizim i sindikatave, një vendosmëri më e madhe në punën e tyre. Prandaj, Grupi parlamentar i AAK-së e përkrah në parim miratimin e këtij projektligjit dhe vërejtjet konkrete do t'i parashtrojmë në komisionin përkatës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Teuta Sahatçiu, le të përgatitet Hysnija Beshkoviq

DEPUTETJA TEUTA SAHATÇIU

Ju faleminderit, i nderuari kryetar, ministra, të nderuar deputetë,

Në RTK transmetimi i seancës nuk është duke u bërë. Seancat janë publike dhe sipas rregullës 24 duhet të përcillen. Nuk e di a është ndonjë problem teknik këtu në Kuvend, apo është problem teknik në RTK, por do të duhej ta kemi parasysh këtë dhe seancat të përcillen në televizionin publik duke ditur se çdo familje paguan për RTK dhe duhet të kenë qasje dhe të shohin seancat e Kuvendit që janë publike.

Sa i përket ligjit, desha së pari ta falënderoj ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale që me praninë e tij dhe me arsyetimin e ligjit e sheh si një punë serioze dhe nderon

Kuvendin e Kosovës i cili ia ka dhënë mandatin, gjë të cilën nuk mund ta themi për secilën ministër.

Grupi parlamentar ORA e përkrah në parim ligjin dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Hysnija Beshković, le të përgatitet Flora Brovina.

DEPUTETI, HYSNIJA BESHKOVIQ

Poštovani predsedavajući, poštovani ministri i kolege poslanici. Nacrt zakona za pravo i organizovanu sindikalnu slobodu na Kosovu je neophodan i pruža adekvatno rešenje i napredak na ovom polju. Sloboda o osnivanju sindikata je jedno od glavnih prava radnika, predloženi projekat reguliše i određuje pravo na slobodu radnim ljudima za stvaranje slobodno i samovoljno ujedinjivanje i organizovanje sa ciljem zastupanja i zaštite svojih ekonomskih, profesionalnih i socijalnih interesa, Radnici imaju pravo da osnuju sindikate i da se učlane u njima po statusu i međunarodnim sindikalnim standardima, odnosno Konvencijama međunarodne organizacije rada. Predloženi projekat predlaže regulisanje važnih pitanja za zaposlene, organizovane i osnivanje sindikata, kreiranje i ujedinjenje sindikata u formi federacije ili saveza na nacionalnom i međunarodnom nivou. Ovim zakonom se predviđa osnivanje boljih uslova i standarda za zaposlene radnike, unapređenje i razvoj socijalnog dijaloga i međusocijalnih partnera, eliminisanja forme etničke, rasne, verske polne, socijalne i političke i sindikalne diskriminacije. Odredili su i procedure registracije sindikata, sindikalna legitimnost i odnosi između Vlade i Sindikata. Parlamentarna grupa 6+ smatra da ovaj Nacrt zakona ispunjava uslove koji su neophodni za jedan zakon ovakve prirode, i u načelu ga podržavamo i daćemo svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Hysnija ju faleminderit, Flora Brovina le të përgatitet Sanije Alijaj.

DEPUTETJA FLORA BROVINA:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra, kolegë dhe kolege,

Pas leximit dhe konsultimit edhe me sindikatat në lidhje me Projektligjin mbi liritë e të drejtat sindikale, pajtohem se këtij Projektligji duhet t'i paraprinte edhe Ligji për marrëdhëniet në punë, sepse do të ishte më funksionale që këto dy ligje të shkonin edhe paralel ose ti paraprinte ligjit në fjalë, prandaj këtë që në këtë seancë ministri për Punë dh Mirëqenie Sociale do të merr vërejtjen që ligji për të cilën folëm për marrëdhëniet në punë duhet të përgatitet sa më shpejtë në mënyrë që edhe sindikatat të mund të funksionojnë dhe ligji të mund të funksionojë ashtu si duhet.

Ky Projektligj nuk ka implementime buxhetore, por ka implementime tek ata të cilëve ju dedikohet. Është shumë i mirëpritur dhe i një rëndësie të veçantë për të punësuarit në mënyrë që të mbrohen të drejtat e tyre sindikale, aq më tepër kur dihet se të drejtat sindikale në Kosovë për një kohë të gjatë u shkelën. Le të kujtojmë sidomos kohën e viteve 90-ta kur vetëm për shkak të përkatësisë nacionale një numër i madh i punëtorëve e humbi të drejtën në punë e sindikalistët u bënë të njohur në kuadër të sindikatave botërore dhe të përkrahur nga ata.

Shkelja e të drejtave vazhdon. Do të përmend këtu vetëm të drejtat e invalidëve të punës, të drejtat e pensionistëve, të drejtat e atyre që ishin në marrëdhënie pune dhe humbën këto të drejta pas privatizimit. Edhe pas aprovimit të ligjeve në këtë Kuvend, gjithashtu vazhdon shkelja, sidomos në sektorin privat. Vazhdon shkelja edhe në ata sektorët e garantuar tani më në mungesë edhe të Ligjit për marrëdhënie pune, siç është e drejta kolektive, e në kuadër të kësaj të drejtat për pushime mjekësore dhe të drejtat e lehonisë.

Një ditë sigurisht së shpejti ky Kuvend do të debatohet për shkeljen ose humbjen e të drejtës në marrëdhënie pune vetëm e vetëm për shkak të shtatzënisë. Tani më është një numër konsideruar i grave që kanë humbur këtë të drejtë dhe këtu ka shumë punë sindikata, e natyrisht edhe ne, edhe ministria.

Ligji është i shkurtër dhe mjaft i qartë dhe megjithatë mendojmë se mund ta pasurojmë me amendamente që do t'i themi në komisionin e veçantë. Jam në favor të këtij ligji dhe votoj në këtë moment.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit Flora: Sanije Alijaj, le të bëhet gati Sala Berisha Shala!

DEPUTETJA SANIJE ALIJAJ:

I nderuar z. Kryetar, të nderuar ministra, të respektuar deputetë,

Organizimi sindikal në fillim të viteve të 90-ta ka luajtur një rol të rëndësishëm për sensibilizimin e opinionit sindikalist liridashës në botë për shkeljen e të drejtës së punës si e drejtë themelore e garantuar edhe me konventat ndërkombëtare në periudhën e suprimimit të Kushtetutës së Kosovës nga ana e pushtuesit serb, që në atë kohë i shërbeu edhe synimit tonë kombëtar për pavarësinë e Kosovës. Prandaj, futja e kësaj të drejte në kornizë ligjore për herë të parë në Kosovë është shumë e domosdoshme. Me këtë Projektligj normohet dhe rregullohet e drejta dhe liria e punonjësve për krijim, bashkim dhe organizim të lirë në sindikata me qëllim të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave ekonomike, profesionale dhe sociale të punëtorëve në punë, që në momentet nëpër të cilat

po kalon Kosova po ndihet nevojë për vendet e reja të punës. Mbrojtja e këtyre të drejtave edhe përmes organizimit sindikal është e një rëndësie të madhe. Por, me këtë rast do të theksoja se është shumë e domosdoshme të hartohet edhe Projektligji për krijimin e marrëdhënies së punës. Ajo që vlen për tu vlerësuar në këtë Projektligj janë zgjedhjet në sindikatë. Komisioni statutar paraqet raport me shkrim para organit kompetent të sindikatës, që mendoj se rritë autoritetin e këtij organizimi dhe obligon punëdhënësin dhe institucionet e tjera për respektimin e kërkesave dhe të drejtave të punëtorëve që deri më tani nuk ka qenë në nivel të duhur. Në kreun 6 të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të sindikatës, neni 22 garanton imunitetin e përfaqësuesve sindikal, e ndër të tjera ndalohet diskriminimi ndaj përfaqësuesve të organizatave sindikale, kur për aktivitete sindikale pa pëlqimin e sindikatës nuk mund të ndërpritet kontrata e punës, caktohet vend tjetër i punës dhe vihet në pozitë të palakueshme. Kjo e drejtë e garantuar me ligj dhe në harmoni me ligjet e BE-së mendoj se avancohet aktivitetin sindikal, gjë të cilën sot e kësaj dite nuk e kanë deputetët e parlamentit të Kosovës. Me këtë rast do të theksoja edhe një çështje që Qeveria e Kosovës të merr nismën e hartimit të një projektligji i cili garanton dhe definon detyrat dhe të drejtat e deputetit. Këtë e arsyetoj me faktin që deputeti ka përgjegjësitë e mëdha për proceset në të cilat po kalon Kosova. Me ligj t'i caktohet pozita pra statuti dhe roli i tij në Parlament e në veçanti imuniteti i tij në mënyrë që më vonë të mos vijë në pozitë të palakmueshme. Kjo është shumë e domosdoshme sepse këtë të drejtë e gëzojnë deputetët e parlamenteve tjera demokratike.

Projektligjin e përkrahi në parim sepse është i mirë pa implikime buxhetore dhe është në harmoni me ligjet e Bashkësisë Evropiane. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, Sala Berisha Shala, le të përgatitet Teuta Hadri!

DEPUTETJA SALA BERISHA SHALA:

Z. kryetar, të nderuar deputetë, z. ministër.

Projektligjin për të drejtat dhe liritë të organizimit sindikal në Kosovë e konsideroj që është edhe një shërbim i mirë i organizimit të punëtorëve në sindikata për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Liria sindikale është një e drejtë jo vetëm elementare për punëtorinë, por edhe e rëndësishme për zhvillimin dhe funksionimin e ekonomisë së tregut në kushtet e demokracisë.

Projektligjin në fjalë e kam analizuar me vëmendje. Këtu shihet që rregullon çështjet e rëndësishme për klasën punëtore, megjithatë mendoj se duhet të plotësohet dhe rregullohet edhe më tutje gjatë fazës së amendamentimit në mënyrë që të dalë sa më i

plotë dhe i kompletuar. Andaj, në këtë rrjedhë po i paraqes arsyetimet për disa propozime që mendoj që duhet ndryshuar dhe plotësuar. Kështu, p.sh. në nenin 2 paragrafi 2, 3, 4, 6 dhe 7 fjala “interesa” të zëvendësohet me fjalën “të drejta”. Arsyetim: Këto ndryshime janë të nevojshme sepse punëtorët me organizim sindikal krijojnë një mekanizëm të veprimit në nivel më të lartë të mbrojtjes të të drejtave të një game më të gjerë të nevojave të tyre. Tani neni 19 ka nevojë të riformulohet sepse deri sa në fillim të Projektligjit thuhet se ky projektligj nuk ka implikime buxhetore, bazuar në atë se anëtarësimi sindikal është vullnetar, gjë që qëndron kjo e dhënë, atëherë kuotizacioni sindikal me donacione të ndryshme, burime nga prona sindikale e ndërron këtë konstatim. Kështu si është, pa përcaktuar donacionet e ndryshme, i hapin derën financimit komprometues të sindikatës dhe e bëjnë të dyshimtë moralin e organizatës së punëtorëve nga i cili para se gjithash ajo udhëhiqet, pastaj mos definimi i të ardhurave nga prona sindikale, etj. Shtrohet pyetja: në çfarë mënyre sigurohen të ardhurat nga prona, duke shitur pronën apo si, kur dihet se është një konstatim me ligj kur prona e sindikatës nuk tjetërsohet. Mendoj se edhe këtu duhet një definim më i qartë për të ardhurat nga prona. Mandej në këtë nen në paragrafin 2 përcaktohet shfrytëzimi i mjeteve nga kuotizacioni, por jo i mjeteve nga burimet tjera që janë të shkruara në këtë projektligj, si nga donacionet e ndryshme, nga ndihmat humanitare, nga prona sindikale.

Në nenin 20 rregullohet prona e sindikatës. Aty duhet të jetë edhe një nen shpjegues se në këtë pronë të identifikuar do të kenë të drejtë të gjitha sindikatat të regjistruara, kur ka mundësi për shfrytëzimin e saj. Kështu do t’i kontribuonin pluralizmit sindikal, ndryshe mund të hapim mundësi që të mos mund të ketë organizim të sindikatave tjera në mungesë të objekteve për veprimtari sindikale.

Neni 24. paragrafi 1 duhet riformuluar. Në këtë paragraf thuhet:” Qeveria e Kosovës do të sigurojë masat e nevojshme që punëtorët të ushtrojnë lirshëm të drejtën për organizim dhe veprim sindikal”. Mendoj se duhet formuluar kështu:” Qeveria e Kosovës nuk do të pengojë organizimin dhe veprimin sindikal të punëtorëve mbi baza ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre”. Ky formulim do t’ia heq mundësinë Qeverisë që të ndikojë në shantazhimin e sindikatës, e cila duhet të jetë e lirë dhe e pavarur në organizimin dhe në veprimtaritë e saj në bazë të ligjeve të zbatueshme. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, Teuta Hadri, le të përgatitet Bajrush Xhemaili

DEPUTETJA TEUTA HADRI:

Të nderuar deputetë, i nderuari z. Kryetar,

Pranimi i kushteve për veprim të sindikatave në Kosovë, respektimi i legjislacionit të aplikuar, mbrojtja ndaj veprimeve diskriminuese të punëtorëve, sigurimi i të drejtave dhe lirive sindikale, mosndërhyrja në ushtrimin e lirisë së sindikatave dhe garantimi i të drejtave ligjore për organizim në sindikata kanë krijuar nevojën e ngutshme të Qeverisë për krijimin e projektligjit që po diskutohet sot, pra të Projektligjit për të drejtat dhe liritë

e organizimit sindikal në Kosovë. Gjatë këtyre viteve, punësimi në institucionet tona dhe në organizatat punuese ka pasur mjaft shkelje diskriminuese, jo vetëm nga ana profesionale e gjinore, por edhe në fushën e funksionimit të sindikatës. Kur themi diskriminim profesional, nuk ka pasur asnjë organizim të kontrollit nga ana e Qeverisë, nga ana e institucioneve qeveritare, as nga organizatat punuese ku vazhdimisht është shkelur aftësia dhe ngritja profesionale, nuk është respektuar profesioni, pa kurrfarë kriteri janë diskriminuar profesionistët duke u zëvendësuar me njerëz të paafte profesional e që si kriter pune kanë pasur lidhjet familjare, kështu që sot institucionet tona janë mbushur me dajallarë, halla, teze, të dashura, gjë që nuk i sjell Kosovës zhvillim, por ngecje edhe të proceseve politike. Pastaj, një shembull që përmenda më lart është edhe forma e diskriminimit gjinor, që vërehet që nga organet qeveritare e deri te organizata më e thjeshtë punuese. Në 12 komisione parlamentare kemi vetëm 2 femra drejtuese, për çudi. Pastaj, vlen të përmendet edhe klinika dhe institucione shëndetësore ku 70% të fuqisë punëtore janë të gjinisë femërore. Ato diskriminohen si në të drejtën për organizim, ashtu në pozicionet e larta drejtuese, e çka është më keq, edhe në të drejtën e pushimit, të lehonisë. Pra, është cenuar e drejta e tyre. Njerëzit që nuk shohin më lart se vetvetja, kanë ndikuar në zvogëlimin e pushimit të lehonisë prej 1 viti në tre muaj dhe kështu atë çka me forcë pushteti kolonizues nuk e ka bërë, e bëjmë ne sot. Një cenim i sindikatës me qëllim kontrolli u bë nga organet qeveritare me nenin 23 dhe 24 i këtij ligji. Neni 23.4 thotë: “veprime ndërhyrëse konsiderohen si: aktet që pengojnë krijimin dhe funksionimin e sindikatave, aktet që dëmtojnë organizatat sindikale për shkak të përkatësisë ose duke diskriminuar dhe atë me qëllim të kontrollit të organizatave sindikale”. Prandaj, sipas këtij neni u bë shkelje ligjore nga ana e Qeverisë dhe nga individ i veçantë, siç është zëvendëskryeministri me rastin e grevave të punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë pak muaj më parë.

Qeveria e Kosovës në vend që t’u sigurojë masa dhe akte siç flitet në nenin 24 të këtij ligji, ku thuhet se roli i qeverisë është të sigurojë lirinë e veprimit sindikal, të merr masa të nevojshme që punëtorët të ushtrojnë lirshëm të drejtën për organizim dhe veprim sindikal, ajo ndërhyri kundër ligjit dhe bëri diskriminim me qëllim të presioneve në marrëveshje të Sindikatës së punëtorëve të arsimit e të Sindikatës së punëtorëve shëndetësorë. Siç dihet, gjatë grevave duke i përçarë e duke i larguar nga marrëveshja, kontrata e nënshkruar në mes dy palëve duke i detyruar kryetarin e Sindikatës së Shëndetësisë të trajtojë interesat e punëtorëve shëndetësorë duke nënshkruar vetëm si individ, pa e pyetur edhe komisionin prej 5 anëtarësh. Ky është akt kundër statusit të sindikatës dhe sot punëtorët shëndetësor falë dobësisë së tij mbetën pa ngritje page as 7 euro, ashtu siç i morën punëtorët e arsimit. Ndërsa Komisioni i Sindikatës së Arsimit qëndronte në kërkesat për të drejtat elementare të tyre dhe me këmbëngulje kërkonte ngritjen e pagave si dhe kërkonte pagat e ndara për çka ka marrë vendimin Qeveria jonë. Kemi një shkresë me vendim me datën 23.8.2005, ku punëtorëve të arsimit iu është ndarë shuma prej 7 milionë e 500 mijë eurove. Këto para, jo vetëm që Qeveria ka marrë vendim dhe vetë zëvendës kryeministri ka nënshkruar, në vend që tu ndahen dhe të plotësohen kërkesat e drejta të punëtorëve të arsimit që kanë bërë greva, ato sot nuk u janë ndarë.

Të nderuar deputetë, nxjerrja e këtij Projektligji sot duhet të miratohet menjëherë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Bajrush Xhemaili dhe i fundit Gani Koci!

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAILI:

Përshëndetje z. Kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë,

Është mirë që në fund organizimi sindikal vullnetar dhe i pavarur, përpos që do të ketë mundësi të mbështetet në ligj, ka mundësi që në mënyrë strikte t'i dijë obligimet dhe përgjegjësitë dhe në këtë mënyrë të ketë një organizim më të fuqishëm. Është ky një ligj i punuar mirë, prandaj e përkrah në parim, por kam pasur disa vërejtje, disa nga ato janë cekur më parë nga kolegët e mi. Unë do të përqendrohem, do të mundohem që për komisionin funksional t'i japë dy vërejtje, të cilat është mirë t'i ketë parasysh. Nën një, edhe pse përkufizimet për atë se është federatë dhe konfederatë janë në nenin 2, megjithatë në një nen të veçantë të ligjit duhet të përcaktohet mënyra e bashkimit të organizatave sindikale në federata. Kjo mënyrë e organizimit nuk është përcaktuar edhe mendoj se vendin e ka në nenin 12 menjëherë aty ku përcaktohet se sindikata bazë më së paku duhet t'i ketë 25 anëtarë. Ndërkaq, nën dy, vërejtja qendrore e imja është që në nenin 20 ku ka të bëjë me pronën e sindikatës, do të ishte shumë e drejtë dhe e nevojshme që sa më shpejtë t'u kthehet pasuria e sindikatës, ashtu që gjendja materiale aq e rëndë, nëse nuk mund të zgjidhet, së paku të zbutet. Një pasus i këtij neni në pikën 5 nuk premtonte zgjidhje të shpejtë, sepse kthimi i pronës lidhet me dispozitat e ligjit për pronën, siç thuhet në këtë nen, e ky ligj mund të vonojë për shkak të fuqive të rezervuara që pronën e Kosovës e kanë në kompetencë. Prandaj, z. ministër nuk di a keni menduar si ta gjejmë mënyrën e kthimit para se të privatizohet se ajo pronë mendoj që ndoshta duhet të privatizohet, por duhet të them që të zgjidhet një mënyrë që sapo ky ligj të hyjë në fuqi me një vendim administrativ, apo ta gjejmë një formë që tua kthejmë pronën e cila vetëm është e tyre dhe ju takon, përndryshe mendoj që do të zvarritet shumë dhe në këtë gjendje të rëndë të sindikatës të ndikojë shumë negativisht në zhvillimin e saj. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. I dëgjuam të gjithë diskutuesit dhe propozimet. Lus regjinë që të bëhet gati të votojmë në parim. Votojmë tani:

Për janë 63 vota.

68 deputetë të numëruar janë të pranishëm, prandaj konstatoj që projektligji u aprovua. Propozoj një pauzë deri në orën 14,30, e pastaj vazhdojmë.

Ju faleminderit!

Pjesa e III e dt. 19.12.2005

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Vazhdojmë me rendin e ditës, kuorum pune kemi.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inspektoratin e produkteve të ndërtimit

Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 25.11.2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore duhet t'i adresohen Komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore. Ftohet ministri Bujar Dugolli që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantoj Projektligjin. Ministër urdhëroni.

MINISTRI, BUJAR DUGOLLI

I nderuara Kryetar, Të nderuar deputet,

Në vijim do përpiqem të paraqes në vija të shkurta qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për Inspektoratin e Produkteve të Ndërtimit.

Ky projekt ligj ka për qëllim të përcaktojë kuadrin rregullator e institucional për themelimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Produkteve të Ndërtimit si organ ekzekutiv, i specializuar, për inspektimin e produkteve të ndërtimit.

Mandej të inspektojë respektimin e kritereve të parapara për licencimin e ndërmarrjeve nga fushë veprimtaria e kuadrin rregullator e institucional.

Duhet theksuar se ky projektligj është i zbatueshëm për të gjithë personat, ndërmarrjet dhe autoritetet publike në Kosovë.

Rëndësia e nxjerrjes së Projektligjit për Inspektoratin e Produkteve të Ndërtimit rrjedh nga fakti që ky instrument ligjor rregullon një fushë të rëndësishme të ekonomisë së tregut atë të mbikëqyrjes inspektuese të produkteve ndërtimore duke siguruar në këtë mënyrë një përputhshmëri të normave vendore me ato ndërkombëtare dhe me legjislacionin dhe praktikën e BE-së për sa i takon mbikëqyrjes inspektuese në Kosovë.

Projektligji për Inspektoratin e Produkteve të Ndërtimit, për nga gjerësia e rregullimit të kësaj fushe, është strukturuar në gjithsej: 6 Kapituj dhe 17 Nene.

Pas përkufizimit të fushës së rregullimit dhe qëllimit, kreu i dytë i projektligjit ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e inspektoratit të produkteve të ndërtimit, detyrat të drejtat dhe përgjegjësit e Inspektoratit.

Në kreun tretë bëhet fjalë për bashkëpunimin me administratën publike. Në kreun e katërt bëhet fjalë për procedurat sipas ankesës. Në kreun e pestë bëhet fjalë për dispozitat ndëshkuese. Në kreun e gjashtë bëhet fjalë për dispozitat kalimtare dhe hyrjen në fuqi të ligjit.

Projektligji përmban një kornizë rregullative të detajizuar sa i përket mbikëqyrjes inspektuese të produkteve ndërtimore.

Të nderuar deputet,

Rëndësia e rregullimit juridik të kësaj fushe është vitale për ndërtimin e një ekonomie formale në Kosovë të bazuar në parimet e ekonomisë së tregut. Ky projektligj do të vendoste një rregull ligjor për sa i takon mbikëqyrjes inspektuese të produkteve ndërtimore në Kosovë, duke ofruar edhe garanci juridike, institucionale dhe gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga mbikëqyrja inspektuese. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në lëmin e ekonomisë në përgjithësi, ju rekomandoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë parlamentare.
Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Hapim debatin në parim, kemi kuorum pune dhe vendimmarrje. Lutfi Zharku në emër të LDK-së.

LUTFI ZHARKU

I nderuari z. Kryetar, i nderuari kryeministër, kolegë deputet.

Të gjithë jemi dëshmitarë se në Kosovën e pasluftës, ndërtimtaria po thuhet se ishte dega më e rëndësishme në rindërtimin e vendit dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Siç shihet ndërtimtaria vazhdon edhe sot të mbetet promotor kryesor i zhvillimit ekonomik, prandaj është shumë i arsyeshëm aktiviteti i Qeverisë në rregullimin ligjor të këtij sektori. Kështu në vazhden e kompletimit të infrastrukturës ligjore në lëmin e ndërtimtarisë dhe produkteve të ndërtimtarisë, Projektligji për inspektoratin e produkteve ndërtimore gati e rumbullakon atë si dhe krijon kushte për zbatimin e ligjeve tjera të kësaj lëmie të cilat tani më janë aprovuar nga Kuvendi i Kosovës sikurse Ligji mbi ndërtimin, Ligji për produktet e ndërtimit, Ligji për standardizim si dhe Ligji për kërkesa teknike dhe vlerësim të konformitetit.

Me aprovimin e këtij Projektligji do të mundësohet zbatimi i inspektimit të prodhimit të produkteve ndërtimore nga ana e ndërmarrjeve prodhuese si dhe tregtimit të tyre nga ana e ndërmarrjeve tregtare e që do të mundësojë tregtimin e tyre të sigurt për jetën dhe shëndetin e njerëzve si dhe mbrojtjen e pasurisë dhe ambientit, ma merr mendja se është e panevojshme të ceket kualiteti i importit të produkteve ndërtimore pas lufte e deri më tani.

Projekti po ashtu përcakton themelimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit të ndërtimit si organ ekzekutiv i specializuar dhe i autorizuar për inspektim në bazë të detyrave, të drejtave dhe përgjegjësisë që jipen sipas këtij Projektligji dhe së fundi Projektligji krijon bazë ligjore për inspektimin dhe respektimin e kriterëve të parapara për licencimin e ndërmarrjeve që aparojnë në këtë veprimtari. Ky Projektligj ka rëndësi më të madhe nëse marrim parasysh se në Kosovë nuk ka asnjë ligj që rregullon këtë çështje deri më tani. Vërejtjet tona kanë të bëjnë me përkufizimet duke marrë parasysh përdorimin e një terminologjie që nuk është e zakonshme dhe përkufizime tepër të detajuara dhe

vërejtja tjetër lidhet me nenin 4 që ka të bëjë me statusin e inspektoratit i cili do të duhej të lirohej nga disa paragrafe që rregullojnë organizimin e brendshëm, sepse ky do të duhej të rregullohej me urdhëresa administrative. Procedura sipas ankesës që përcaktohet sipas nenit 13 do të duhet të eliminoj mundësinë e heshtjes administrative duke marrë parasysh masa të ashpra që mund të merren nga ana e inspektoratit, po ashtu shkeljet në kapitullin e dispozitave ndëshkuese duhet të specifikohen në mënyrë më të përafërt, në mënyrë që të eliminohet mundësia e interpretimit arbitrar nga ana e inspektoratit. Nga shkresat përcjellëse të projektligjit shihet që zyra e proceseve të integritetit Evropian në fillim ka lëshuar një deklaratë në të cilën konstaton se Projektligji nuk është plotësisht në pajtueshmëri me legjislacionin e UE, për kundër asaj se kemi deklaratën nga zyra e kryeministrit se janë bërë modifikimet e nevojshme, nga shkresat nuk shihet se cilat rekomandime janë marrë parasysh apo ku kanë qenë vërejtjet kryesore për këtë mospërputhshmëri.

Grupi parlamentar i LDK-së në parim e mbështet Projektligjin dhe do të jap kontributin e vetë në komisionet përkatëse. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit Lutfi, fjalën e ka Mahir Jakcilar, sepse ka me udhëtua dhe le të përgatitet Hatixhe Hoxha .

DEPUTETI MAHIR JAĞCILAR

Sayın Meclis Başkanı, sayın bakanlar ve milletvekilleri

6+ Parlamenter grubu, İnşaat üretimlerinin Müfettişliğine ait Yasayı görüştüktan sonra bu Yasa ile ilgili bazı görüşlerini ve bu yasanın kabul edilmesiyle için yerine getirilmesi gereken bazı şartlarını ortaya atmak istiyor.

Çelişkili olan sorularımız şunlardır:

- Bu Yasa, inşaat üretimlerine ait Yasa ile ne kadar uyumludur ?
- Bu Yasa, Ticaret müfettişliğine ait Yasa ile ne kadar uyumludur?
- Yukarıda adı geçen iki Yasadan başka bir yasanın daha olması gerekli midir? Dolayısıyla, İnşaat üretimlerine ait Yasanın, inşaat üretimlerinin müfettişliğine ait özel bölümü (6. Bölüm) zaten içerdiğini vurgulamak istiyorum.

Somut uyarılarımız şunlardır:

- Yayın ve enstitü kadrosu teriminin, Ticaret ve Endüstri Bakanlığı anlamında olduğunu belirten 3.9 noktası ile ilgili olarak, Bakanlığın bu tür tanımlanması için gereksinimin var olup olmadığını sormak istiyoruz.
- 4.2 noktası yöresel müfettişlerinden söz etmektedir. Ancak politik ve örgütsel strüktüre göre Kosova'da yöreler yoktur.

- 4.6 pikta s müfettişliđin üniform, gereçler, makineler ve yasadışı işlemlerin engellenmesi için diđer mekanizmalara sahip olduđunu ileri sürüyor. Bu diđer mekanizmalar hangileridir diye sormak istiyoruz.
- 6. pikta, müfettişlik hakları terimi yerine, müfettişliđin yetkileri başlıđını içermelidir.

6.5 piktasındaki : inşaat malzemelerine el koyma konusunda, bize göre, bunun mahkeme kararı ve müfettişin, kendi yetkisini aşmadan özel sürece göre yapılması gerekir.

- Yasanın ceza hükümleri de, bu alandaki diđer Yasalarla uyumlaştırılması gerekir diye düşünülüyoruz.

Bu Yasa ile ilgili ilkesel ve somut uyarılarımız ve diđer milletvekillerin uyarılarının göz önünde bulundurulmasıyla, Görevsel komisyonun, deđiştirgeler sayesinde, bu Yasanın en uygun ve elverişli çözüm yolunu bulabileceđine inanıyoruz.

Dikkatinize teşekkür ederim

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Mahir ju faleminderit, fjalën e ka Hatixhe Hoxha, kurse le të përgatitet Zylfije Hundozi.

DEPUTETI HATIXHE HOXHA

Z. kryetar të nderuar deputet.

Sot para nesh kemi ligjin për inspektoratin e produkteve të ndërtimit dhe me këtë Projektligj dhe së bashku me Ligjin për produktet e ndërtimit, Ligjin për standardizimin, Ligjin për kërkesat teknike dhe produkte dhe vlerësim të konformitetit, është plotësuar zbrazësia ligjore në këtë fushë. Mendojmë se Ligji për inspektoratin e produkteve të ndërtimit do të mundësoj zbatimin e ligjeve të lartpërmendura, mendojmë se ky ligj do të mundësoj inspektimin, zbatimin e punimeve të prodhimit dhe të tregtimit të produkteve të ndërtimit, përdorimin e produkteve të prodhimit si dhe do të inspektoj edhe respektimin e kritereve të parapara për licencim edhe pse ky Projektligj nuk është voluminoz dhe nuk ka shumë gabime përmbajtjesore dhe gjuhësore, unë do të dëshiroja të theksoj këtu vetëm disa vërejtje. Shpesh duke u mundur të ruhet struktura e përkthimit janë shkaktuar paqartësi në të kuptuarit e disa neneve. Vërejtjet tona kanë të bëjnë me këto nene. Neni 3 te përkufizimet paragrafi 4. Neni 4.1, Neni 5.10, Neni 6.3, p.sh. te neni 7.1 thuhet: “Inspektorët për moszbatimin e punëve i përgjigjen kryeinspektorit” mendojmë se ata kanë për obligim dhe detyrë, do të duhet t’i përgjigjen inspektorit jo vetëm kur nuk, i zbatojnë detyrat apo nuk i kryejnë ato. Në nenin 9.1 ku flitet për etikën profesionale thuhet: “Inspektorët duhet të përmbushin detyrat e tyre me aftësi dhe në mënyrë të pavarur”. Mendoj se në nenin 5 ku bëhet fjalë për detyrat dhe kompetencat e inspektoratit mund të thuhet ndër të tjera edhe kjo:

a/ Gjatë inspektimit është mirë të mbahet një procesverbal nga ana e inspektorëve dhe një kopje t’i dorëzohet palës që inspektohet,

b/ Inspektori çdo herë do të duhet të jetë i shoqëruar edhe nga ndonjë përcjellës. Po ashtu vërejtjet tona kanë të bëjnë edhe në disa nene ku bëhet fjalë për disa kompetenca të ministrit e të cilat ne mendojmë se duhet t'i takojnë Ministrisë e jo ministrit. Do të dëshiroja të theksoja këtu një çështje që mund të krijoj huti në lidhje me detyrat që ka apo që i dedikohen inspektoratit të produkteve të ndërtimit në kuadër të këtij Projektligji për faktin se në Ligjin për produktet e ndërtimit detyrat që i përcaktohen në këtë Projektligj për të cilin po bëjmë fjalë i përcaktohen Inspektoratit të Tregut. Kjo mund të shihet në kapitullin IV të Ligjit për produktet e ndërtimit ku flitet për mbikëqyrjen e tregut. Për të mos pasur dyfishim detyrash apo për të mos lejuar paqartësi duhet të harmonizohen këto dy ligje si Projektligji për Inspektoratin e produkteve të ndërtimit me Ligjin për produktet e ndërtimit dhe shumë qartë të përcaktohen detyrat e inspektoratit të produkteve të ndërtimit e mos të ngatërrohen me ato të inspektorëve të tregut. Besojmë se me vërejtjet e dhëna në seancë dhe me punën në komision do të arrihet një plotësim i këtij Projektligji, duke pasur domosdoshmërinë në këtë Projektligj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet në parim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Hatixhe ju faleminderit, Zylfiuje më fal duhet të presim Ymer Halimin në emër të AAK-së e pastaj ju

DEPUTETI YMER HALIMI

Faleminderit z. Kryetar, përshëndes të pranishmit. Deputet të nderuar Projektligji për produktet ndërtimore është interaktiv edhe me ligjet e tjera të cilat janë miratuar nga ky Kuvend, por ky ligj përfshin nominimin e duhur juridik për kontrollimin e prodhimeve si nga cilësia dhe forma e deri në fazën përfundimtare të përdorimit të tyre. Në këtë Projektligj puna e Inspektoratit mbështetet mbi aftësinë profesionale të ekspertëve të Inspektoratit duke i ndarë kompetencat e veprimit në rrafshin horizontal dhe vertikal në mënyrë uniforme në tërë territorin e Kosovës. Për këtë Grupi parlamentar i AAK-së e përkrah procedimin e këtij Projektligji në Kuvend sepse Projektligji në fjalë do të mundësojë edhe të eliminojë dobësitë e shfaqura në këtë fazë tranzicioni në Kosovë. Edhe pse Projektligji është i shkurtër me gjithsej 17 nene sipas mendimit tonë ka ca lëshime që komisioni funksional besoj me lehtësi do t'i eliminojë, për ilustrim po ceku disa: Te neni 4 pika 3 është e udhës një ridefinim sepse kemi ripërtëritje kuptimi. Te neni 7 mungon adresimi i përgjegjësisë së Inspektoratit përkatësisht inspektorit kryesor, ndërsa inspektorët e kanë adresimin e saktë të fajësisë ose të punës së vetë për të cilën duhet të përgjigjen. Ndonjë akt nënligjor është e udhës që të përcaktohet me kohë me nene ligjore. Gjobat ligjore janë në një shtrirje më të ngushtë në mes të gjobës së vogël dhe asaj të lartë. Grupi parlamentar i AAK-së e përgëzon hartuesin e Projektligjit për punën e bërë dhe shpresojmë që komisioni funksional do ta pasurojë dhe do ta nxjerrë sa më parë nga Kuvendi për një zbatim të qëndrueshëm. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ymer ju faleminderit, fjalën e ka Teuta Sahatqija.

DEPUTETI TEUTA SAHATOIJA

I nderuari z. Kryetar, deputet.

Ndërtimtaria dhe produktet e ndërtimit janë veprimtari prodhuese e rëndësishme e ekonomisë sonë dhe si e tillë meriton një trajtim të posaçëm duke pasur parasysh se kjo veprimtari punëson një numër të madh të fuqisë punëtore që në kushtet tona është e mirëseardhur. Si veprimtari e rëndësishme së tillë. Legjislacioni do të duhej që me ligje adekuate të stimulojë atë e jo të vështirësojë punën e bizneseve të tilla. Projektligji i ofruar për Inspektoratin e Produkteve të ndërtimit është një ligj fushëveprimi i të cilit trajtohet edhe nga ligjet të cilat janë miratuar në Kuvend, siç janë: Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve, Ligji për produktet e ndërtimit, Ligji për Inspektionin e Tregut dhe Ligji për kërkesat teknike të produkteve dhe vlerësimin e konformitetit. Këto ligje rregullojnë mbikëqyrjen e prodhimit të importit, të inspektimit të të gjitha produkteve dhe me atë do të duhej ta përfshijnë edhe fushën e produkteve të ndërtimit. Frikohem që krijimi i legjislacionit të dyfishtë si pasoj do të ketë vështirësi në zbatimin e ligjit dhe ndërlidhje të kompetencave. Duke pasur frikën dhe dëshirën për zhvillimin e kësaj veprimtarie me këtë ligj do të krijohen vështirësi në zbatimin e ligjit dhe në punën e bizneseve që merren me prodhime të ndërtimit, për të mos pasur konflikt në mes të kompetencave të ligjeve të ngjashme gjë që do të rezultonte negativisht në punën e bizneseve, na mbesin dy zgjidhje njëra zgjidhje është se a ta krijojmë edhe një inspektorat dhe të shpenzojmë edhe 70 mijë euro dhe të jemi në dilemë a do të ndërlidhen kompetencat në mes të ligjeve të aprovuara dhe këtij Ligji, apo ta procedojmë këtë ligj në komision dhe komisioni ta ketë një punë të vështirë. D.m.th duke i pasur parasysh të gjitha këto grupi ynë parlamentar do të kishte sugjeruar Ministrisë që ta kthejë ligjin dhe t'i shikoj ndërlidhjet e kompetencave dhe koordinimin me këto ligje tjera, për ndryshe në qoftë se ligji kalon në kontributin tonë do ta japim në Komisionin funksional, por do të kishim preferuar që ligji të kthehet dhe të akordohet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit, fjalën e ka Zylfije Hundozi, kurse le të prëgatitet Milazim Haliti

DEPUTETI ZYLFIJE HUNDOZI

Z. kryetar, kolegë deputet, z. Ministër.

Miratimi i këtij Projektligji është i nevojshëm për arsye se në Kosovë gjer më tani janë bërë shumë produkte ndërtimore pa kurrfarë kontrolli që do të garantonte sigurinë e objekteve të ndërtuara. Projektligji është i kartë nuk ka implikime buxhetore, unë nuk do t'i përsëris diskutimet e parafolësve të mi, mirëpo e kam një vërejtje në nenin 6 pika 6 ku thuhet se: Të drejtat e inspektoratit janë edhe kontrollimi i licencave profesionale të ndërmarrjes të lëshuara nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë. Inspektorati ka të drejtë të bëjë kontrollimin e licencave por këtë do ta zbatonte më së miri sikurse vetë inspektorët të ishin të licencuar dhe që kjo punë të bëhet sa më kualitative, kuadri teknik profesional duhet urgjentisht të licencohet që mos të vazhdon kaosi ekzistues në ndërtimtari. Tu jepet shans ekspertëve të udhëheqin punët në ndërtimtari si në krejt botën civilizuese, e jo

personat joprofesional dhe mos të ndodh e njëjta gjë si në lëmin e mjekësisë dhe farmacisë kur pas 6 vite pune nëpër institucione shëndetësore u gjetën persona që pa diploma po kryenin punën shumë me përgjegjësi, për ndryshe pala e cila po inspektohet mund të refuzoj inspektimin me të drejtë nga personi i cili nuk ka përgatitje adekuate për lëmin të cilën e inspekton, me gjithë atë unë e përkrah miratimin në parim duke shpresuar që në ndërkohë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do ta bëj licencimin e gjithë kuadrit teknik profesional dhe do të mundësoj zbatimin e këtij ligji në praktikë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit, fjalën e ka Milazim Haliti, kurse le të përgatitet Ibush Jonuzi

MILAZIM HALITI

Ju faleminderit z. Kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar kolegë deputet. Me Projektligjin për inspektimin e produkteve të ndërtimit do të bëhet i mundur sigurimi i inspektimit dhe zbatimit të punimeve të produkteve të ndërtimit si nga ndërmarrjet prodhuese po ashtu edhe nga ato tregtare. Miratimi i këtij Projektligji mundëson edhe implementimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi siç janë Ligji për Produktet e ndërtimit, Ligji për standardizimin dhe ligji për konformitetin e produkteve. Pasi që në Kosovë shumë produkte të ndërtimit prodhohen dhe dalin në treg dhe përdoren pa kurrfarë kontrolli ishte i domosdoshëm hartimi i këtij Projektligji me qëllim që këto produkte të prodhohen dhe të përdoren duke i zbatuar rregullat dhe standardet e obligueshme në vendet e zhvilluara në rajon. Miratimi i këtij Projektligji është i rëndësishëm sepse bëhet plotësimi i vakumit ligjor, pasi deri më tani nuk ka pasur ligj në Kosovë që e rregullon çështjen e inspektimit të produkteve të ndërtimit. Projektligji ka një strukturë të mirë ligjore, është përmbajtësor dhe jo voluminoz me 6 kapituj dhe 17 nene. Me gjithë këtë Projektligji ka nevojë që t'i bëhen disa riformulime dhe plotësime të disa neneve. Në nenin 4 paragrafi 2 dhe 3 ka nevojë që t'u jepet një kuptim më i plotë këtyre paragrafëve, pastaj neni 12 paragrafi 3 mendoj se po ashtu duhet të riformulohet. Në kreun e V dispozitat ndëshkuese neni 14 ku thuhet: Se do të dënohet për kundërvajtje subjekti juridik nëse nuk bashkëpunon me inspektorin sipas nenit 9 të këtij ligji, ndërsa neni 9 bën fjalë për etikën profesionale për inspektor. Për kundër vërejtjeve të përmendura në parim e mbështes miratimin e këtij Projektligji dhe shpresoj se Komisioni funksional gjatë fazës së amendamentimit do të bëj plotësimet dhe riformulimet e nevojshme të këtij Projektligji. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Milazim ju faleminderit dhe falën e ka Ibush Jonuzi i fundit, urdhëroni.

DEPUTETI IBUSH JONUZI

Faleminderit z. Kryetar, deputet të nderuar dhe ministër.

Diskutimet e kolegëve të mëparshëm i mbështes në tërësi, përveç diskutimin e znj. Hundozi që vetëm ashtu duhet të veprohet për me qen funksional, i aplikueshëm dhe i dobishëm ligji në praktik, prandaj në Komisionin funksional ne do t'i japim plotësimet se mendoj se ka hapësirë për me qen ligji më i dobishëm në praktikë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit, 74 kartela identifikuese janë, ndërsa 67 deputet janë në sallë, regjia ju lutem të përgatitemi për të votuar dhe ju ftoj që të deklarohe mi për aprovim në parim. Votojmë tani:

Ju faleminderit, 62 deputet janë **për**,
Konsideroj se Projektligji është aprovuar.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

11. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për siguri

Më lejoni t'i them disa konstatime hyrëse që i kam të përgatitura. Kryesia e Kuvendit të Kosovës në dy mbledhje radhazi 1 nëntor dhe 8 dhjetor 2005 shqyrtoi dhe mbështeti kërkesën e Komisionit për gatishmëri dhe Emergjencë për formimin e Komisionit për siguri. Njëherit Kryesia nxorri përfundimin me të cilin kërkohet nga grupet parlamentare që Kuvendit t'ia propozoj kandidatët për anëtar të Komisionit për siguri të cilët do të kenë njohuri nga fusha e sigurisë dhe sipas kriterëve të numrit të anëtarëve të deritashëm të Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë. Grupet parlamentare (pjesërisht janë deklaruar lidhur me përfundimin e Kryesisë). I kemi dy mundësi veprimi në mungesë të propozimeve të të gjitha grupeve parlamentare për krijimin dhe emërimin e anëtarëve në Komisionin për siguri, propozohet që kjo çështje të shtyhet për seancën e radhës ose nën dy, ftojmë shefat e grupeve parlamentare nëse e shohin të arsyeshme të deklarohe mi lidhur me krijimin e Komisionit për siguri dhe propozimin e anëtarëve të këtij Komisioni, prandaj mua më duhet deklarimi.

Unë dua ta di se çfarë të veprojmë, të shkojmë me variantin e parë që të shtyhet për seancën e radhës apo e dyta.

DEPUTETI FADIL KRYEZIU

Unë po flas jo në emër të grupit, por si deputet dhe si anëtar i Komisionit për Gatishmëri Emergjente. Proceduralisht jemi në rregull ne e kemi një vendim të Kuvendit për themelimin e Komisioneve që janë 10 komisione, kjo seancë duhet të nxjerrë vendimin e ri konform qëndrimit të Kryesisë dhe duhet të jap shpjegime se çka do të ndodh me Komisionin për Çështje Emergjente, a do të jetë komisioni i ri në të cilin do të barten edhe përgjegjësitë e punës të këtij Komisioni ekzistues konform Ministrisë eventuale të Rendit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Seanca plenare është instanca e fundit e Kuvendit që merr vendim definitiv. Konform propozimit në fillim të mandatit të tri parlamenteve evropiane që kanë punuar si ndihmë Parlamentit të Kosovës është Asambleja Nationale Franqeze, Bundestagu Gjerman dhe Parlamenti Belg dhe në procedurë të rregullt parlamentare janë aprovuar të funksionojnë 10 komisione. Me gjithë atë unë dua t'ua them mundësitë. Seanca plenare e ka mundësinë e vetë që të formoj komision të ri ose në qoftë se respekton vendimin e vetë në fillim të mandatit duhet të nxjerrë vendim për formimin e komisionit për siguri dhe pastaj të merr vendim që Komisioni për Emergjencë të suprimohet me që në ministrinë e re të brendshme që formohet ekziston departamenti për emergjencë dhe të mos dyfishohen, me gjithë atë është e drejtë e seancës plenare dhe unë nuk dua të kam propozim timin personal. Unë kam kërkuar në një takim me shefat e grupeve parlamentare dhe anëtarë të Kryesisë që janë qëlluar në fillim të kësaj seance plenare me që nuk janë kristalizuar në plotëni që të shtyhet për një seancë tjetër të radhës deri sa vërtet të kristalizohen, prandaj unë qëndroj në propozimin tim, por e drejtë e seancës plenare të merr vendim.

Fjalën e ka Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

I nderuari z. Kryetar, kryeministër, deputet të nderuar.

Unë kisha dashur që edhe njëherë të përsëris qëndrimin e grupit parlamentar të AAK-së që është duke u nisur nga ky Kuvend që ia ka përcaktuar, në mandatin e kaluar i kemi pasur 19 komisione, kemi vendosur që t'i bëjmë 11 komisione dhe kemi pasur një komision ad-hoc. Rregulla 48 ku janë komisionet kryesore dhe komisionet funksionale d.m.th komisionet funksionale dhe Komisioni për Gatishmëri Emergjente është votuar në Kuvend me 22 dhjetor 2004 dhe në bazë të rregullës që përcakton proporcionin e forcës së grupeve parlamentare në Kuvend, gjithashtu duke u bazuar edhe në kreun 9.1.21 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullës 42 të Rregullores së punës së Kuvendit qëndrojnë të gjitha këto që i thash, pos kësaj ju përmendët edhe argumentin që Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë dhe përgjegjësitë e atij komisioni do t'i kalojnë vetë Ministrisë së Rendit, prandaj nuk mendoj që është funksionale që të kemi një komision të ri, propozimi i grupit parlamentar është që komisionit ekzistues t'i zgjerohen kompetencat në qoftë se Parlamenti vendos me e quajt Komisioni për siguri mundet me e ndërrua emrin, por në qoftë se formojmë komision të ri atëherë edhe rregulla e punës, gjegjësisht rregullorja e punës së Kuvendit ndryshon, d.m.th propozimi i grupit parlamentar të Aleancës është që Komisioni për Gatishmëri Emergjente t'i zgjerohen kompetencat dhe mendoj se kanë fituar një përvojë në këtë lëmi dhe nuk janë të ngarkuar në këtë aspekt dhe mund të quhet Komisioni për Gatishmëri Emergjente ose thjesht vetëm Komisioni për Siguri dhe nuk është emërtimi i tij një problem, por konsideroj se nuk kemi nevojë për formimin e një Komisioni të ri. Në qoftë se me gjithë atë Kuvendi vendos me e shuar këtë komision dhe formimin e komisionit të ri. Atëherë në bazë të forcës proporcionale atëherë unë dua t'ia tërheq vëmendjen Kuvendit që ai i takon AAK-së, gjegjësisht udhëhiqet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Unë kam edhe një arsye. Unë po e vërej se shefi i grupit parlamentar të LDK-së ti jepet kohë dhe ky propozim i ri pikërisht është që le të vazhdoj deri sa ne të merremi vesh, Komisioni funksionimin e vetë normal. Në ndërkohë ne do të kemi takim me Kryesinë dhe grupet parlamentare është çështje e ndjeshme, janë ministri të reja që formohen prandaj të jemi në përgatitje të plotë dhe ju lutem që të lihet për një seancë tjetër sepse nuk dëshiroj që të mbivotohemi në këto çështje kur grupi më i madh parlamentar ka nevojë për konsultime të mëtejshme.
Fjalën e ka z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Ne e respektojmë kërkesën e grupit më të madh parlamentar, por unë dua të them diçka në emër të grupit të PDK-së.

1. Koha kur kanë qenë të formuara komisionet në Qeverinë e Kosovës nuk është bërë fjalë për dy ministrinë e reja, për Ministrinë e Rendit dhe të Drejtësisë. Këto dy fusha janë një nga fushat më të rëndësishme dhe më vitale për kohën dhe momentin që po hyn Kosova dhe unë mendoj se kjo çështje duhet të trajtohet ndoshta në mënyrë më serioze, dihet se këto dy ministri do t'u takojnë koalicionit në fuqi dhe ne nuk kemi asgjë kundër, por vërtetë duhet të shkohet në formimin e një komisioni të ri duke e suprimuar Komisionin e vjetër dhe në emër të Partisë demokratike them se ky komision duhet për shkak të rëndësisë dhe peshës së vetë specifike që e ka duhet të drejtohet nga opozita. Kjo është kërkesa e grupit parlamentar të PDK-së që të kihet parasysh në procedurat e ardhshme. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Edhe një arsye plus, d.m.th i gjithë niveli i grupeve parlamentare në mënyrë që parapërgatitjet të bëhen në thellësi dhe gjëri dhe të kemi një harmoni të veprimeve.

Ferid Agani në emër të grupit të ri parlamentar.

DEPUTETI FERID AGANI

Faleminderit z. Kryetar

Ne me datën 8 dhjetor e kemi marrë një kërkesë nga Kryesia e Kuvendit për vendpropozimin për kandidat të Komisionit për Siguri dhe në pajtim me këtë ne i kemi bërë propozimet tona. Unë konsideroj se grupi parlamentar për integrim duhet të jetë i përfaqësuar në Komisionin e ri për siguri dhe atë duke e theksuar një parim se në këtë komision do të ishte mirë që të jenë të përfaqësuar të gjithë përfaqësuesit e të gjitha bashkësive etnike në Kosovë, me që bëhet fjalë drejtpërdrejtë për ta. Kështu unë kamë plotësisht konsideratë për ta dhe kërkesën të cilën e shtruar, por dëshiroj që të theksoj se në procedurën e ardhshme të kihet parasysh ky propozim i grupit parlamentar për integrim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ferid ju faleminderit dhe vazhdojmë.

Komisioni për Emergjencë me përgjegjësi ta përcjell situatën dhe përgatitjet dhe diskutimet në mes të grupeve parlamentare. Unë do të qëndroj i gatshëm gjithmonë si urë bashkëpunimi dhe do t'ju ftoj kur të arrijmë një konsensus ose një vendim që mund të përkrahet mund ta vejmë në rend të ditës.

Fjalën e ka Hajredin Hyseni si anëtar i grupit parlamentar.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI

Faleminderit z. Kryetar.

Unë mendoj se kjo çështje po zvarritet jashtë çdo norme. Ka 6 vite që grupi i LDK-së ankohet për mungesë kompetencash dhe tash i erdhi koha që të kenë sado pak kompetenca dhe ne po e zvarrisim këtë çështje pa asnjë arsye ose thjesht për shkaqe të ambicieve të tyre se kush do ta kryesoj këtë komision, ndoshta më e mira është siç e tha edhe shefi i grupit që ta kryesoj opozita dhe do të shpejtohet mbyllja e kësaj çështje. Tjetër unë propozoj që shefat e grupeve, Kryesia e Kuvendit ta ketë parasysh që ky Kuvend sipas meje dhe e kamë thënë edhe në Komision duhet të quhet Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri ose komisioni për Mbrojtje dhe kontrollin e forcave të armatosura, sepse ne e kemi një forcë mbrojtëse TMK-në të cilën nuk mund ta lëmë anash, është një forcë e pranuar ndërkombëtarisht dhe në të gjitha vendet tjera normale këto komisione quhen komisione për mbrojtje dhe jo komisione për siguri, pastaj është vullneti i popullit, deklarimi i partive për shtet të pavarur etj. Që unë kujtoj që ky vullnet dhe angazhimi dhe vendosmëria e partive politike do të qojnë edhe në krijimin e Ministrisë së Mbrojtjes, prandaj qysh sot të rregullohet kjo çështje. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit shumë dhe duhet të vendosim, propozimi final është që të shtyhet për një seancë tjetër dhe votojmë, kush është për:

Ju faleminderit shumë, shumica absolute, a ka votë kundër,
Nuk ka asnjë votë kundër, ju faleminderit.

Kalojmë në pikën tjetër të radhës.

12. Shyrtimi i propozimit për emërimin e deputetit Mahir Yagcilar, anëtar të Kryesisë.

Konformë rregullës 4 pika (f) me kërkesë dhe propozim të grupit parlamentar 6+ të deputetëve të PDTK-së, Vakati dhe IRDK, në pajtim me marrëveshjen e komuniteteve në fillim të konstituimit të Kuvendit më 2 dhjetor 2004 Kryesia e Kuvendit mbështeti propozimin që deputeti Mahir Yagcilar të emërohet anëtar i Kryesisë. Materiali i nevojshëm u është shpërndarë të gjithë deputetëve.
Kuvendi e miraton këtë me një votim formal.
Kush është për këtë propozim.

Ju faleminderit shumë, njëzëri bëhet ndryshimi dhe më lejoni që t'i përcjell konkluzat e Kryesisë, ta falënderojmë z. Xhezair Muratin për një punë shumë konstruktive, aktive në punon njëvjeçare të Qeverisë dhe t'i dëshirojmë sukses në funksionin e ri që e merr si shef i grupit parlamentar.

Prandaj kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

13. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e deputetit Xhezair Murati, për anëtar të Komisionit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim euroatlantik.

Konform rregullës 42.4 Kryesia e Kuvendit e mbajtur më 8 dhjetor 2005 shqyrtoi kërkesën dhe propozimin e grupit parlamentar 6+ dhe vendosi që Kuvendit t'i propozon emërimin e deputetit Xhezair Muratit për anëtar të Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Euroatlantik në vend të deputetit Mahir Yagcilar.

Materialet u janë shpërndarë deputetëve me kohë, miratimi bëhet me një votim formal.

Kush është **për**,

Ju faleminderit, a ka votë kundër, nuk ka prandaj Xhezair punë të mbarë në komisionin e ri.

Numri i deputetëve në sallë është 66.

Kalojmë në pikën e radhës.

14. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e Kuvendit e mbajtur më 8 dhjetor 2005 shqyrtoi kërkesën e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të këshillit të agjencisë kundër korrupsionit së bashku me listën e të nominuarëve nga institucionet e përcaktuara me ligj dhe propozimi i reviduar nga zyra e presidentit të Kosovës. Me që kjo listë duhet të plotësohet edhe me 3 përfaqësues të emëruar nga Kuvendi. Kryesia vendosi të kërkoj nga kryetarët e grupeve parlamentare që deri në seancën e sotme me marrëveshje t'ia propozon Kuvendit tre anëtar për t'i emëruar në Këshillin e agjencisë kundër korrupsionit.

Për kundër këtij përfundimi Kuvendit i kanë arritur propozime të veçanta nga disa prej grupeve parlamentare dhe atë.

1. Nga grupi parlamentar i LDK-së Sadudin Berisha dhe Fadil Gashi,
2. Nga grupi parlamentar i PDK-së, nuk ka propozim
3. Nga grupi parlamentar i AAK-së, Ymer Halimi,
4. Nga partia demokratike serbe si pjesë e grupit parlamentar të komunitetit serb Sasha Gjokiq,
5. Nga grupi parlamentar për integrim, Ferid Agani,

Kërkohet nga shefat e grupeve parlamentare që të deklarohen rreth marrëveshjes eventuale.

A ka marrëveshje, z. Jakup Krasniqi urdhëroni.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

z. Kryetar, komisioni dhe pastaj bordi i Agjencisë anti – korrupsion është i Agjencisë së pavarur Anti – korrupsion, është një këshill por edhe një bord që do të pason më vonë i një rëndësie të veçantë, prandaj ne shefat e grupeve parlamentare për këtë çështje nuk jemi marrë vesh dhe kërkesa e grupit parlamentar të Kosovës është se edhe kandidatët që janë ofruar nga subjektet tjera sidomos që janë të detyruara ose të obliguara me Ligj t’i bijën kandidatët që i kanë sjellur kandidatët, por për shkak të rëndësisë së veçantë që ka ky këshill, për asnjë kandidat ne nuk kemi të dhëna biografike se kush janë, nga vijnë, cila është përgatitja e tyre shkollore dhe sa ata do të jenë të përgjegjshëm për ta marrë një detyrë kaq me rëndësi, sa mund të jenë të pavarur në caktimin e bordit anti-korrupsion, prandaj ne mendojmë se kjo çështje duhet të shtyhet për një seancë tjetër duke sjellur biografitë për të gjithë kandidatët që ofrohen jashtë Parlamentit dhe pastaj shefat e grupeve parlamentare të ulën dhe të bisedojnë për kandidatët ose përfaqësuesit e Parlamentit në atë këshill dhe asnjëra nga këto nuk ka ndodhur, unë në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike kërkoj që kjo çështje të shtyhet për një seancë tjetër.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit, e dëgjuam propozimin e partisë demokratike. Unë do të thoja se padrejtësisht po akuzohet Parlamenti që po e zgjat nga një numër i caktuar i mediave të cilat dihen, prandaj ju lutem në asnjë fazë, në asnjë moment Kryesia e Parlamentit ose Kryetari ose ndonjë organ nuk ka bërë një destruksion të këtyllë dhe të mos keqpërdoren siç po ngjajnë në vazhdimësi këto liri ose në shojza liri, prandaj unë nuk kamë individualisht as sugjerim nga asnjë grup parlamentar në veçanti, e mendoj se ka nevojë për konsultime të mëtejme në mes të grupeve parlamentare. Këto çështje që janë të ndjeshme të mundohemi brenda mundësisë dhe në kufirin ku lejon procedura që të mos mbivotohemi, por me gjithë atë në qoftë se insistojnë grupet tjera, sepse sipas procedurës duhet të deklarohemi për propozimin e PDK-së, sepse grupi parlamentar kërkon ashtu.

DEPUTETI XHYLNAZE SYLA

Faleminderit z. Kryetar.

Unë pajtohem me kolegun tim Krasniqi sepse duhet të kemi biografën e të gjithëve dhe me qenë se ne shefat e grupeve nuk kemi arrit ose nuk kemi ardhur në një përfundim se cili do të jetë vendimi ynë, kurse pajtohem që të shtyhet për një seancë të radhës, d.m.th të përcaktohet koha se kur do të merret vendimi e mos ta lëmë në njërën prej seancave, por si grup parlamentar për shkak se është e nevojshme që ky këshill të formohet atëherë të jetë në seancën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Unë mendoj se është kërkesa e arsyeshme, z. Kolë Berisha në emër të LDK-së.

DEPUTETI KOLË BERISHA

Z. kryetar LDK-ja është e gatshme që sot të procedoj, por me gjithë atë e respektojmë mendimin e grupeve tjera parlamentare dhe le të mbetet që në një seancë të ardhshme të bisedohet për këtë.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit shumë, procedura thotë që formalisht duhet ta votojmë.
Kush është që në seancën e parë të radhës të marrim vendim për këtë.
Ju faleminderit, besoj se njëzëri, a ka ndonjë votë kundër,
Nuk ka, ju faleminderit.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

15. Rekomandimi i Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me mocionin e grupit parlamentar Ora.

Konstatim hyrës.

Sipas mocionit të grupit parlamentar Ora, për të konstatuar zbatimin e rregullores së punës, Komisioni për çështje gjyqësore dhe legjislacion dhe kornizë kushtetuese Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandimin e tij lidhur me mocionin. Rekomandimi i Komisionit u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

E keni të shkruar.

Fjalën e ka Hydajet Hyseni, kryetar i Komisionit për Legjislacion

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Ju faleminderit z. Kryetar.

Është hera e dytë që Komisioni për çështje legjislative ka rekomanduar lidhur me çështjet e kontestuara nga grupet parlamentare të respektohet rregullorja e punës së Kuvendit. Por e konsideroj si të drejtë në emër të arsytimit të këtij rekomandimi të provojmë që jo vetëm të konstatojmë, por edhe të përpiqemi që të korrigjojmë praktikën. Fjala është për rendin e ditës, është shtruar disa herë edhe në mbledhje tjera nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, mendoj se është koha se ne ta korrigjojmë këtë çështje dhe të mos ndodh që përsëri të shqyrtojmë çështje të ngjashme. Ne sa po miratuar një pikë të rendit të ditës së mbledhjes së ardhshme, janë disa çështje për të cilat Kryesia dhe Kuvendi kanë vendosur që t'i kenë në mbledhjet e ardhshme, unë nuk do t'ju lodh, por vetëm po përkujtoj që pika 6.3 e rregullores e obligon Kryesinë që rendin e ditës ta përcaktoj në afatin e duhur, sot nuk e respektojmë në lidhje me shqyrtimin e buxhetit. Rregulla 8 thotë: Mbledhjet e Kuvendit i thërret kryetari dhe jo siç po na ndodh vazhdimisht shkresat, ftesat të na dërgohen nga sekretari i Kuvendit. Rregulla 7.5 dhe 23, kërkon që Kryesia dhe kryetari me rastin e caktimit të rendit të ditës të konsultoj shëfkat e grupeve parlamentare, nuk po respektohet gjithmonë. Rregulla 23 parasheh që në fund të seancës të merret qëndrimi për rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme, është kërkuar disa herë dhe do të ishte mirë që të fillojë kjo praktikë dhe në funksion të kësaj. Z. Kryetar ka tre muaj që unë i kam shtruar dy pyetje parlamentare për çështje elementare siç është çështja e shpenzimit të mjeteve të parapara për zhdukjen e pasojave të tërmetit që janë dhënë 5 milion. Sipas

rregullit ministrat janë të obliguar që në pyetje të përgjigjen më së shumti 2 javë pas parashtrimit të pyetje, 3 muaj kanë kaluar, pyetja tjetër është për një çështje të ndjeshme se çka po bën Qeveria për personat e zhvendosur nga Presheva e viset tjera në Kosovë, një çështje po ashtu e ngutshme, 3 muaj nuk kemi përgjigje, kërkoj që të fillojmë praktikën e përcaktimit të rendit të ditës dhe në këtë kuadër unë propozoj që pyetjet parlamentare siç jemi të obliguar edhe me rregullore dhe kemi thënë çdo të enjte që do të jetë e rezervuar për to të zbatohet që në rastin e mbledhjes së ardhshme dhe në fund të kësaj mbledhje të përcaktojmë rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Z. kryetar, ju keni qenë në një pjesë, jo si individ por në kundërshti me krejt këtë që e thatë. Në qoftë se kryetari i Parlamentit ka të drejtë me e konvokuar seancën plenare, as ju as unë nuk jemi jurist, e njëjta procedurë vlen edhe për eliminimin e asaj. Në rastin konkret si komision nuk e keni respektuar rregulloren fare, në këtë që t'i insiston në qoftë se kryetari i Parlamentit e ka pasur informatën me shkrim nga Qeveria informatë zyrtare që nuk do të jetë kryeministri në atë seancë, në qoftë se kryetari i Parlamentit e ka pasur me nënshkrime të opozitës që opozita nuk do të merr pjesë në seancën plenare në qoftë se nuk është kryeministri është dashur kryetari të bëj shpenzime dhe t'i fton anëtarët e Kryesisë, kryetari e ka shfrytëzuar të drejtën e kësaj konform rregullores që t'i informoj anëtarët e Kryesisë që nuk janë plotësuar kushtet për ftesë për ta pasur seancën plenare dhe shtyhet kjo. Unë në plotni pajtohem që rregullorja duhet të respektohet, por rregullorja jo vetëm për kryetarin dhe Kryesinë, por edhe për deputet dhe grupe parlamentare dhe këtu nuk kemi asnjë keqkuptim. Unë ju njoftova se është në përgatitje në propozim që nuk dua t'i jap detajet në të cilin do të ketë obligime Qeveria me qenë në Seancë plenare dhe të mos ngjaj kjo që 3 ose 5 muaj të mos përgjigjet ministri apo kushdoqoftë në pyetje të deputetit, prandaj jemi në një ecje të vazhdueshme të progresit, por po ju them se në dy vendime që i ka marrë Komisioni për procedurë ka vend që Komisioni ta analizoj vetveten. Në qoftë se ju duhet të na ndihmoni neve a është Kushtetuta më e lartë apo rregullorja, çdo nen i rregullores që është në kundërshtim me Kushtetutën nuk është i aplikueshëm, as për kryetarin dhe as për një deputet, prandaj unë e mbështes në plotni çdo kërkesë. Tri vite keni qenë anëtar i Kryesisë dhe jemi munduar që ta respektojmë këtë që në fund të seancës plenare deputetët ta kenë propozimin e Sekretarisë dhe të plotësohet rendi i ditës dhe asnjëherë nuk e kemi arritur, nuk ka qen vullnet i kryetarit që të prolongohet kjo, por mungesë e furnizimit me informacione dhe me material të mjaftueshëm dhe këtu dom ta bëjmë një prerje të kësaj praktike negative të kryetarit, të Kryesisë dhe të deputetëve, në mënyrë që për 3 muaj ta kemi agjendën dhe nëse mundemi për 6 muaj dhe atëherë nuk do të kemi problem. Komisioni le ta shqyrton njëherë me seriozitetin e plotë jo me lojta politike.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Nuk dua të bëj polemikë e as replikë, por do të dëshiroja që të kuptohet se propozimi im është që ne të fillojmë praktikën e përcaktimit të rendit të ditës sipas rregullores, kurse lidhur me çështjet e hapura unë do të propozoja që të organizojmë një debat për

funksionimin e Kuvendit edhe në këtë kuadër edhe për rregullat e procedurës dhe do të isha i disponuar për të marrë pjesë në një debat të tillë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Hydajet gjithmonë çdo debat do të lejohet, por nuk do të lejohen lojëra të paskajshme që nuk mbështeten as në kushtetutë as në rregullore, sepse kryetari po e lejon që të debatohet për ligjin e caktuar dhe deputeti flet krejt jashtë agjendës dhe kryetari e ka të drejtën me e ndërpre atë debat ose me kërku që të fshihet kjo, ju e dini shumë mirë sepse ju jeni 3 vjet anëtar i Kryesisë, unë nuk e kam shfrytëzuar atë të drejtë, prandaj debat do të ketë në çdo seancë, largojeni njëherë e përgjithmonë sepse opinionin po e bombardon një pjesë e mediave në mënyrë jo të argumentuar me qëllime të caktuara politike, po të ishim në fazën e zgjedhjeve tolerohet, unë them që në ato raste njerëzit kalojnë në institucione.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës .

16 Përgjigja e Kryeministrit të Kosovës në pyetjen e deputetit Berat Luzha

Konstatimet hyrëse.

Në pajtim me rregullën 26.4 të rregullores së punës së Kuvendit deputeti Berat Luzha i është drejtuar me pyetje për përgjigje gojore kryeministrit z. Bajram Kosumi. Pyetja e deputetit dhe përgjigja e kryeministrit u është shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve, me që në seancën e kaluar deputeti ishte i pakënaqur me përgjigjen me shkrim dhe insistoj në përgjigje plotësuese gojore dhe çështja u shty për seancën e sotme. Kryeministri nuk është në seancë, urdhëroni Berat, ju e keni shtruar pyetjen.

DEPUTETI BERAT LUZHA

z. kryetar pyetja ime ka të bëjë me pezullimin e Ligjit për lojërat e fatit nga Qeveria e Kosovës. Pyetjen e kamë shtruar me 8 shtator të këtij viti, d.m.th kanë kaluar mbi 3 muaj. Në mbledhjen e kaluar edhe pse me vonesë kryeministri nuk ka ardhur, nuk ka ardhur edhe sot, nuk ke di se kur do të vijë dhe a do të vijë fare. Gjithashtu një pyetje të cilën ia kamë shtruar ministrit për punë dhe çështje sociale para 6 muajve në qershor të këtij viti, asnjëherë nuk kamë marrë përgjigje, është vërtet indikative se pse kabineti Qeveritar nuk përgjigjet në pyetjet për çka janë të obliguar, sigurisht se ka të bëjë me një mosrespekt total të këtij Parlamenti ose me frikën që të ballafaqohen me pyetjet e deputetëve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Unë po besoj se po e përfundojmë me një lutje të deputetëve të opozitës. Unë kamë lexuar rapet në media dhe sa mund t'u besohet. Kryetari i Parlamentit nuk është përgjegjës për veprimet e askujt përpos të vetave dhe prania ose mospranim e dikujt në seancën plenare mos të keqpërdoret dhe mund të akuzoni sa të doni, por nuk është ferë kur injorohet faktografia.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Z. kryetar, jemi në pikën e fundit të rendit të ditës për të biseduar për rendin e ditës së seancës së ardhshme. Fillimisht dua të them se as unë as grupi parlamentar i Partisë Demokratike nuk është në pozitën as të prokurorit për ta akuzuar dike, nuk është as në pozitën e gjykatësit për të gjykuar dike, as në pozitën e opozitës për të debatuar dhe ngritur çështje që janë të rëndësishme jo vetëm për grupin parlamentar të PDK-së por që janë të rëndësishme për Kosovën. Nuk ka qenë akuzë në fjalën time kur kam thënë: Që kryeministri nuk po i përgjigjet dhe ndoshta me lejen e vetë Kryesisë dhe kryetarit të Parlamentit interpelancës, nuk është akuzë kur kam dhënë se ministresh e Shërbimeve Publike po e vonon interpelancën që e kemi bërë kërkesën krejt në mënyrë ligjore, kam kërkuar të debatohet edhe për çështje të arsimit, mendoj se asnjëra nga këto nuk ka qenë akuzë, kanë qenë shqetësime dhe deputetët kanë nevojë dhe janë të obliguar të kërkojnë, t'i ngrisin shqetësimet dhe të kërkojnë përgjegjësi, edhe nga kjo që u dëgjua deri më tani, për pyetjet që janë bërë nga qershori i këtij viti e tani jemi në dhjetor, në fund të vitit 2005 dhe mospërgjigjet e kryeministrit dhe të ministrave në pyetjet me gojë apo me shkrim mendoj se flet për jo një funksionalitet të institucioneve të Kosovës edhe kjo duhet ta shqetëson Parlamentin se Qeveria dhe i gjithë kabineti qeveritar janë zgjedhur nga ky Parlament dhe ata duhet t'i përgjigjen këtij Parlamenti, këto z. Kryetar nuk janë akuza, këto janë kërkesa të drejta, të ligjshme dhe në fund të fundit të gjitha këto na obligojnë edhe si deputet, jo vetëm si shefa të grupeve që t'i ngrisin shqetësimet tona, që t'i kemi kërkesat tona dhe që Qeveria dhe qeveritarët të përgjigjen për shkeljet që po i bëjnë.

Z. kryetar, nëse veç i shfletojmë gazetat shohim se vërtet ka keqpërdorime të shumta. Ky Parlament duhet të bisedoj, debatoj në një seancë tepër të afërt për përbërjen e kabinetit qeveritar, a ka nevojë Kosova t'i ketë më shumë se 12 ministri apo jo. Ky Parlament duhet të bisedon vërtet se cila duhet të jetë shumica për blerjen e një veture apo të një xhipi, unë jam i bindur se edhe blerjet e veturave nga kryeministria të firmave më të shtrenjta, mendoj se blerjet e veturave të tilla nuk di se a ju lejohen edhe Qeverive që kanë një buxhet shumë herë më të mirë se Qeveria e Kosovës, vërtet janë duke u keqpërdorur mjetet financiare që i japin tatimpaguesit e Kosovës dhe këto keqpërdorime mendoj që duhet të ndërpriten dhe ne si opozitë e kemi këtë detyrë dhe obligim që çdo keqpërdorim që bëhet nga cilido institucion i Kosovës ta ngrisin dhe të kërkojnë përgjigje, përgjigje nuk po marrim dhe kjo mendoj se është një papërgjegjësi tjetër e njerëzve që drejtojnë institucionet në Kosovë.

Ju lutem qëherave tjera mos ta përdorni fjalën akuzë, ne nuk akuzojmë, unë nuk jamë prokuror për të akuzuar, unë jam deputet për të kërkuar përgjegjësi për keqpërdorimet që i bëjnë njerëzit që janë në krye të institucioneve të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

z. Krasniqi, unë isha shumë i kuartë dhe në qoftë se është e saktë ajo që kanë shkruar mediat, unë e thash përgjegjësinë time se sa herë që ka ardhur kërkesë e një grupi parlamentar për interpelancë dhe pyetje, Kryesia e Kuvendit nuk e ka vonuar, por e ka drejtuar sipas procedurës në adresë të duhur dhe këtu përfundojnë të gjitha. Çdo kërkesë

për debat do të aprovohet. Unë u mora vesh me kryetarin e Komisionit, duhet të respektohet Rregullorja në plotëni z. Shef i grupit parlamentar, jo të zgjidhen nenet ose rregullat që i pëlqejnë kryetarit të Parlamentit dhe me ato të punoj, d.m.th mos trokitni në derë të hapur sepse do ta keni gjithmonë përkrahjen e kryetarit dhe të Kryesisë në rrugë procedurale dhe ligjore, por do të ketë përgjegjësi edhe për deputet edhe për bartës të çfarëdo funksioni në qoftë se përmendet në seancë plenare diçka ajo nënkupton që dikush e ka të drejtën njësoj me kërkim, për mua të parin sepse jam në krye të institucionit dhe në asnjë mënyrë nuk dëshiroj ta mënjanoj në plotëni transparencën, por do ta kërkojmë si deputet dhe si institucion për secilin edhe për shefin e grupit parlamentar të PDK-së edhe për kryetarin e Orës edhe për secilin, sepse çdo deputet që të përmendet në seancë plenare po ashtu krijohet mundësia e jo hetimeve. Unë po ju them me sinqeritetin më të madh se një pjesë e mediave e në veçanti një prej mediave, po sillet edhe si prokuror, po sillet edhe si gjykatës, si njollosës, vendimmarrës edhe si avokat. Një periudhë shumë e dhimbshme nëpër të cilën kemi kaluar, por jo edhe ajo medija të shukatet, mos ta kryej funksionin. Deputet të nderuar, unë me vëmendje ju dëgjova dhe askujt nuk ja ndërpreva fjalën dhe nëse nuk doni të dëgjoni e drejtë e juaja është me e lëshua seancën.

Të gjitha propozimet që janë në vijë të rregullores dhe Kushtetutës do të jenë pjesë e debatit dhe e vendimmarrjes.

Ju faleminderit, shihemi në seancën e radhës.

Këtu e përfundon punën Kuvendi i Kosovës.

